

ENVER HOXHA

VEPRA

42

PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!

ENVER HOXHA

VEPRA

**BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE
SHQIPËRISE**



ENVER HOXHA

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

ENVER HOXHA

V E L L I M I

42

TETOR 1969 — SHKURT 1970

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË, 1984

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 42-TË

Materialet e këtij vëllimi, shumë nga të cilat botohen për herë të parë, janë të periudhës tetor 1969-shkurt 1970. Në to shquhet lufta e pandërprerë e Partisë dhe e popullit për të çuar përpara arritjet e 25 vjetëve të Çlirimit. Bisedat e ngrohta të shokut Enver Hoxha, në vigjilje të 29 Nëntorit, me grupe punonjësish, me pionierë e me miq të huaj, fjalimi në mbledhjen solemne me rastin e festës hedhin dritë mbi rrugën e përshkuar dhe mbi detyrat e së ardhmes. Në këto dokumente të kohës ritheksohet se sukseset duhet të shërbejnë si nxitje për të parë ç'mund të bëhet akoma më shumë e më mirë.

Ndër detyrat kryesore që nënvizohen janë ato që lidhen me zgjerimin dhe me përmirësimin e strukturës së prodhimit industrial e bujqësor. Punonjësit e ekonomisë porositen të synojnë kryesisht për të rritur rendimentet. Në fjalën e mbajtur në Plenumin e 9-të të KQ të PPSH, nga njëra anë, trajtohet ky problem i gërshetuar ngushtë me teorinë, me politikën, me teknikën etj., nga ana tjetër, zbërthehen shumë aspekte të tij, duke i shoqëruar me analiza konkrete të punëve.

Për të realizuar një orientim të tillë, vihet në dukje rëndësia e madhe e organizimit dhe e disiplinës proletare në punë. Që lufta për t'u futur 'punëtorëve' në

gjak këtë disiplinë, për t'u forcuar ndërgjegjen socialiste të këtë sukses të plotë, shoku Enver Hoxha orienton të zhvillohet me nivel puna ideopolitike.

Mjaft probleme të ekonomisë shtrohen dhe u jepen zgjidhje të drejta në diskutimet në mbledhjet e Byrosë Politike të KQ të PPSH më 19 dhjetor 1969, më 26 shkurt 1970 etj. Ato kanë vlera jo vetëm për kohën kur janë mbajtur, por edhe për të sotmen.

Këshilla konstruktive gjejnë në faqet e këtij vëllimi punonjësit e organeve drejtuese në qendër e në bazë. Ata udhëzohen si t'i zgjidhin drejt disa çështje të ekonomisë, si: vendosjen dhe zbatimin e normave teknike në ndërmarrje, pjesëmarrjen e plotë në punë të forcave dhe shfrytëzimin e kohës së punës, intensifikimin e propagandës së prodhimit etj.

Si kudo, edhe në fushën e ekonomisë, roli udhëheqës i Partisë është vendimtar. Ajo, thekson shoku Enver Hoxha në një nga materialet e vëllimit, t'u përgjigjet hovit dhe iniciativave të punonjësve me një punë drejtuese me nivel të lartë. Organeve dhe organizatave-bazë të Partisë u kërkohet të parashikojnë masa organizimi nga më kryesoret. Autori ë drejton vëmendjen edhe te puna që bëjnë ato për përgatitjen, për zërthimin dhe për kontrollin e zbatimit të vendimeve. Duke ndjekur fazat nëpër të cilat kalojnë vendimet, ndalet te realizimi i tyre. Në këtë çështje evidencohet roli vendimtar i organizatës-bazë të Partisë, e cila, siç theksohet në vëllim, duhet të zhdukë çdo formë burokratike, çdo shfaqje formalizmi e rutine; të përpiqet që njerëzit të rritin ndjenjën e përgjegjësisë individuale dhe kolektive.

Edhe në dokumentet e kësaj periudhe shoku Enver Hoxha porositi të ruhet kurdoherë e pacenuar dhe të forcohet pareshtur udhëheqja e Partisë, në kundërshtim me teorizimet sabotuese të revizionistëve. Kujdesi i vihet, sidomos, gjallërimit të forumeve të Partisë. Diskutimi në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH «Shokët e zgjedhur në udhëheqje drejtpërdrejt nga prodhimi përbëjnë një forcë të madhe drejtimi» përmban orientime të rëndësishme lidhur me aktivizimin e të zgjedhurve në forume.

Nga disa materiale të vëllimit del mësimi i vlefshëm: «Të jemi kurdoherë ushtarë besnikë të Partisë e të popullit». Shoku Enver Hoxha shpjegon se atdheu mbrohet duke realizuar një për një detyrat, si dhe duke u përgatitur të gjithë ushtarakisht. Prej këtyre dokumenteve efektiv i ushtrisë dhe mbarë populli nxjerrin detyra lidhur me forcimin e rolit udhëheqës të Partisë në ushtri, me intensifikimin e punës politike dhe të stërvitjeve, me ngritjen e vigjilencës ndaj armiqve etj.

Vigjilencë kërkohet edhe ndaj «armiqve të padukshëm», mbeturinave të së kaluarës e ndikimit të ideologjisë borgjezo-revizioniste. Në mënyrë të veçantë, në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH, më 18 tetor 1969, ku trajtohet gjerësisht problemi i gruas, shtrohet nevoja e luftës së gjithanshme kundër koncepteve frenuese, për të arritur plotësisht në praktikë liritë dhe të drejtat që u ka dhënë Partia grave. Autori, nëpërmjet një vargu shkrimesh, orienton që puna edukuese me njerëzit e, sidomos me rininë, të përsoset më tej, të bëhet më e thellë, më bindëse, më luftarake. Kjo kër-

kon kombinimin e drejtë të propagandës me aksionin revolucionar masiv, të edukimit me vetedukimin, të masave edukuese me ato ekonomike e organizative etj.

Një analizë e hollësishme u bëhet në vëllim situatave në botë. Ndërsa godet me forcë politikën agresive e ekspansioniste të imperializmit, shoku Enver Hoxha dënon demagogjinë dhe veprimtarinë sabotuese të revizionizmit modern. Artikulli «Pesë vjet të hrushovizmit pa Hrushovin» bën të qartë edhe një herë, siç e kishte parashikuar Partia jonë, se «politika e re» e klikës së Brezhnjev-Kosiginit s'mund të ishte për ndryshim vije, drejtimesh e synimesh, pasi krerët revizionistë janë të vendosur ta pinë deri në fund kupën e tradhtisë. Në disa dokumente të periudhës demaskohet teoria e tyre famëkeqe e «sovrانيتit të kufizuar». Duke stigmatizuar lojën e ndyrë të superfuqive në arenën ndërkombëtare, autori ngrihet në mbrojtje të interesave sovranë të popujve. Liria dhe pavarësia, nxjerr përfundimin, mbrohen vetëm me luftë të vazhdueshme e pa kompromis të komunistëve e të forcave përparimtare kundër armiqve imperialistë dhe revizionistë.

Me tematikën e larmishme, me vlerën historike e njëkohësisht aktuale, ky vëllim i Veprave të shokut Enver Hoxha do t'u çelë një horizont të ri masave të popullit, do t'i ndihmojë ato në punën që bëjnë për ta pritur me sa më shumë suksese përvjetorin e 40-të të Çlirimit.

Vëllimi është i pajisur me tregues.

PESE VJET TË HRUSHOVIZMIT PA HRUSHOVIN

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

12 tetor 1969

Pesë vjet më parë, në mesin e tetorit të 1964-ës, një lajm i shkurtër i agjencisë TASS i njoftonte botës se një plenum i KQ të PK të Bashkimit Sovjetik, «Për shkak të moshës së kaluar dhe gjendjes jo të mirë shëndetësore», kishte liruar Nikita Hrushovin nga të gjitha funksionet që ai mbante deri atëherë në parti e në shtet.

«Grushti i pallatit», që ndodhi brenda mureve të Kremlinit, megjithëse sensacional për sa i përket mënyrës së kryerjes, nuk habiti njeri. Nikita Hrushovi, kreu i kursit revizionist kundërrevolucionar në Bashkimin Sovjetik dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, ishte demaskuar dhe diskredituar keqas. Reformat e tij revizioniste brenda vendit kishin krijuar një pështjellim të madh dhe një kaos të vërtetë në të gjitha fushat, ndërsa sharlatanizmat dhe aventurat e tij në politikën e jashtme kishin goditur rëndë prestigjin dhe pozitat e Bashkimit Sovjetik në botë.

Veprimtaria e pakontrolluar, paqëndrueshmëria e

ndërpritnin polemikën e luftën ideologjike, për të mos e trazuar dhe për ta lënë të qetë që të zbatonte kursin e ri të hrushovizmit pa Hrushovin.

Partia jonë që në fillim demaskoi pa mëshirë esencën mashtruese të taktikave të reja djallëzore të pasardhësve të Hrushovit dhe paralajmëroi për rrezikun që mund të përbënte për lëvizjen revolucionare e nacionalçlirimtare të popujve krijimi i çfarëdo iluzioni ndaj tyre. Në artikullin e «Zërit të popullit» kushtuar rrëzimit të Hrushovit thuhej: «Likuidimi politik i personit të N. Hrushovit, edhe pse ky ka qenë shefi i revizionizmit modern, nuk do të thotë likuidim i kursit të tij politik, ideologjik, ekonomik e organizativ, që u ka sjellë kaq e kaq të këqija e dëme Bashkimit Sovjetik, marksizëm-leninizmit, kampit socialist e lëvizjes komuniste e punëtoare, kauzës së revolucionit, të lirisë e të pavarësisë së popujve, kauzës së paqes. Me përjashkrimin e N. Hrushovit nga udhëheqja e partisë dhe e shtetit sovjetik, nuk vdes revizionizmi hrushovian, nuk likuidohet ideologjia dhe politika e tij, që shprehen në vijën e Kongresit të 20-të e të 22-të të PK të BS. Ato i kanë rrënjët të thella dhe për të bërë që rreziku të zhduket, që t'i priten mundësitë e përsëritjes, revizionizmi duhet të zhduket që nga rrënjët»¹.

Koha e vërtetoi katërcipërisht drejtësinë e qëndrimit tonë. Klika e Brezhnjev-Kosiginit shkoi edhe më larg se Hrushovi si në drejtim të intensifikimit të restaurimit të kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik, ashtu edhe në luftën kundër marksizëm-leninizmit e inter-

1 Enver Hoxha. Vepra, vëll. 28, f. 99-100.

nacionalizmit proletar, për sabotimin e revolucionit e të socializmit, për minimin e luftërave çlirimtare të popujve. Brenda këtyre pesë vjetëve aleanca sovjeto-amerikane u konkretizua dhe u zhvillua në të gjitha fushat. Në qoftë se Hrushovi është ideatori dhe promotori, Kosigini është arkitekti i saj, është ai që bashkë me Xhonsonin i dhanë fytyrën e sotme kundërrevolucionare, që përcaktuan strategjinë globale, drejtimet dhe masat e përbashkëta praktike për ndarjen e zonave të influencës dhe për vendosjen e sundimit të dy fuqive të mëdha mbi botën. Aktualisht aleanca sovjeto-amerikane sundon gjithë skenën kapitalisto-revizioniste.

Tanimë SHBA dhe Bashkimi Sovjetik kanë ndarë zonat e influencës dhe të veprimtarisë kundërrevolucionare, ku luftojnë secili për llogari të vet ose bashkërisht për të shtypur luftërat çlirimtare dhe revolucionin proletar. Ata ndihmojnë njëri-tjetrin dhe veprojnë aktivisht kudo ku popujt luftojnë për lirinë e pavarësinë e tyre, në Azi, në Afrikë dhe në Amerikën Latine, në Vietnam dhe në Lindjen e Mesme, në gjirin e vetë aleatëve të tyre, si në NATO, ashtu edhe në Traktatin e Varshavës.

Por aspekti më negativ që karakterizon këtë periudhë që kur Hrushovi «u nxor në pension», është fakti se revizionizmi sovjetik kaloi në socialimperializëm me tipare të theksuara fashiste e agresive. Në arenën ndërkombëtare ai vepron si një imperializëm gjakatar e i pangopur, me pretendime të mëdha ekspansioniste e hegjemoniste, që lufton me të gjitha mjetet të zgjerojë sferën e influencës në botë dhe të shtrijë

sundimin e vet mbi popujt dhe mbi shtetet e kontinenteve të ndryshme.

Agresioni barbar kundër Çekoslovakisë vitin e kaluar përbën shembullin më tipik dhe më të qartë të degjenerimit politik të udhëheqjes së sotme hrushoviane në Bashkimin Sovjetik, të shndërrimit të saj në një grup aventurierësh të paparim, që mund të krahasohen vetëm me ish-krerët hitlerianë të Gjermanisë naziste. Ndërhyrja e armatosur dhe pushtimi i Çekoslovakisë nxorën në shesh, gjithashtu, se në Bashkimin Sovjetik është bërë një evolucion i madh prapa, që e ka çuar atdheun e dikurshëm të socializmit në kohën e carëve, në kohën e Ruisë së vjetër shoviniste e ekspansioniste, kur ajo robëronte e kërcënonte popujt.

Në këtë kurs agresiv bëjnë pjesë edhe provokacionet e rënda kufitare që udhëheqja sovjetike organizoi kundër Kinës, presionet që u bëhen vendeve të Ballkanit, kërcënimet kundër vendit tonë etj.

Një hov akoma më të madh ka marrë kohët e fundit politika e hegjemonisë koloniale e ndjekur nga krerët e Kremlinit ndaj shteteve të reja të Azisë e të Afrikës. Kthetrat e saj të përgjakura janë futur tani në vendet arabe dhe në Afrikë, kapitali sovjetik, ashtu siç veprojnë edhe neokolonialistët e tjerë, pasi hyri thellë në Indi, në Birmani etj., ka filluar të eksportohet edhe në Amerikën Latine. Në mbrojtje të kapitaleve të borjezisë së re të Bashkimit Sovjetik, në mbrojtje të politikës ekspansioniste ka dalë tani flota detare sovjetike, e cila, me mijëra milje larg brigjeve të saj, zbaton politikën e vjetër të kanonierave, bën shantazhe dhe kërcënon popujt e botës.

Shtimi i agresivitetit të imperializmit të ri revizionist sovjetik ka ecur krahas, ose më mirë të themi ka genë pasojë e drejtpërdrejtë e intensifikimit të transformimit kapitalist dhe të fashistizimit të jetës së brendshme të Bashkimit Sovjetik. Tradhtia e filluar nga Hrushovi u çua deri në fund nga renegatët e tjerë që i zunë vendin. Klika sunduese ia grabiti popullit sovjetik fitoret e lavdishme të Revolucionit të Tetorit dhe shqelmoi pa mëshirë veprën e madhe socialiste, gjakun dhe djersën e gjithë atyre brezave që, nën udhëheqjen e Leninit, të Stalinit e të bolshevikëve, derdhën për idealin e larta të komunizmit e të internacionalizmit. Mbi popullin sovjetik rëndon sot zgjedha e rëndë borgjeze revizioniste që nuk e lë të marrë frymë, mbi të sundojnë terrori fashist, prangat e egra revizioniste. Vendlin që i dha botës shembullin e madh të çlirimit nga zgjedha kombëtare e sociale, që shpalli parimet e mëdha të lirisë e të demokracisë së vërtetë, që u bë burimi i frymëzimit revolucionar dhe model i shtetit të proletariatit, klika revizioniste e Brezhnjev-Kosiginit e ktheu përsëri në një burg popujsh të shfrytëzuar e të shtypur barbarisht.

Evolucioni i klikës Brezhnjev-Kosigin, degjenerimi i saj i mëtejshëm politik e ideologjik, sigurisht, nuk është një gjë e rastit. Revizionizmi i saj, si rrymë regresive antisocialiste e antirevolucionare, as mund të qëndrojë më këmbë, as mund të çohet përpara në tjetër mënyrë përveçse me vendosjen e diktaturës borgjeze brenda dhe me politikën e agresionit jashtë. Historia tanimë e ka provuar se kushdo që ka tradhtuar marksizëm-leninizmin dhe është hedhur në luftë të hapët

kundër tij, ka shkarë gjithnjë e më thellë në batakun e kundërrevolucionit, është shndërruar në vegël të bindur të reaksionit dhe në më të shumtën e rasteve ka përfunduar në radhët e banditizmit të thjeshtë politik. Ky rregull nuk ka të bëjë vetëm me individët, por këtë fat pësojnë edhe fraksionet, grupet e partitë që tradhetojnë marksizëm-leninizmin dhe ngrenë flamurin e lekosur të kundërrevolucionit.

Nuk është e rastit që tani revizionistët e klikës Brezhnjev-Kosigin nuk teorizojnë më si në kohën e Hrushovit për çështjet e mëdha të «revolucionit», të «shtetit e të partisë», të rrugëve për në «socializëm e komunizëm» etj., por përpunojnë «teoritë» që justifikojnë agresionin, siç është ajo e «sovrانيتit të kufizuar», e shpallur nga Brezhnjevi, ose pretendimi i Gromikos se «interesat e Bashkimit Sovjetik shtrihen në të gjithë botën». Ky ndryshim, domethënë kalimi nga teorizimi oportunist socialdemokrat tek ideologjia shoviniste e tipit hitlerian, është një dëshmi tjetër që vërteton se revizionizmi nuk mund të mbetet në mes të rrugës, ai evoluon drejt ideologjive e politikave më ekstremiste të borgjezisë. Sot është vështirë të bësh ndonjë dallim kush është më reaksionare e më e egër, ideologjia e imperializmit amerikan apo ajo e revizionizmit sovjetik. Në qoftë se ky i fundit mban akoma ndonjë maskë, kjo nuk e ndryshon aspak esencën, ajo ka të bëjë me taktikën dhe imponohet nga kushtet në të cilat ka lindur dhe është zhvilluar revizionizmi. Por sa më shumë kalon koha, maskat bien dhe del në shesh fytyra e tij e vërtetë imperialiste e kundërrevolucionare.

Kushdo që do të bënte bilancin e rezultateve të

arritura nga klika e Brezhnjev-Kosiginin gjatë këtyre pesë vjetëve që ajo qëndron në fuqi, nuk mund të mos arrinte në përfundimin se ai është me të vërtetë i vajtueshëm e katastrofik. Vija dhe politika e udhëheqjes revizioniste sovjetike kanë ndeshur në vështirësi të mëdha si brenda vendit, ashtu edhe me aleatët e vet. Satelitët e Bashkimit Sovjetik, ashtu si edhe ai vetë, kanë hyrë në një krizë të rëndë politike, ideologjike dhe ekonomike, nga e cila nuk mund të dalin dot. Shndërrimi i tij në një vend kapitalist imperialist, përpjekjet për të shfrytëzuar e për të grabitur sa më shumë partnerët revizionistë, kanë ngjallur te këta të fundit pakënaqësi të mëdha, rezistencë, revolttime. Për më tepër, sa më shumë rritet shovinizmi rusomadh, në njërin anë, aq më tepër shtohen edhe tendencat nacionaliste, në anën tjetër. Duke kërkuar rrugëdalje nga situata e rëndë dhe për të zbutur disi zgjedhën që u qëndron mbi qafë, aleatët revizionistë i shtojnë urat e flirtet me shtetet kapitaliste të Perëndimit. Kjo gjendje, nga ana tjetër, nuk mund të mos shtojë zemërimin e udhëheqjes sovjetike, e cila, për të ruajtur hegjemoninë e vet, shton edhe më shumë presionet politike e ekonomike, forcon edhe më tepër sundimin e saj ushtarak.

Një kaos i vërtetë është krijuar në marrëdhëniet midis partive të ndryshme revizioniste dhe Bashkimit Sovjetik. Në një pjesë të madhe të tyre, sidomos në ato të mëdhatë, Moska ka humbur shumë nga kontrolli i saj i mëparshëm. Ato jo vetëm që për shumë çështje nuk i binden asaj, por edhe në mjaft raste e luftojnë hapur. Pushtimi i Çekosllovakisë i shtoi edhe më tepër përçarjet, grindjet dhe luftën e brendshme në frontin revizio-

nist. Tendencat centrifugale e policentriste janë shtuar dhe ata që i karakterizojnë sot marrëdhëniet midis partive revizioniste të vendeve të ndryshme janë mosbesimi reciprok, lufta për epërsi e pozita të veçanta, mbrojtja pa asnjë parim e interesave të ngushtë nacionalë.

Mbledhja e kohëve të fundit e partive revizioniste në Moskë, e nisur nga Hrushovi dhe e përfunduar me shumë mundime nga pasardhësit e tij, zbuloi ndoshta më mirë se çdo gjë tjetër pamundësinë e sundimtarëve të Kremlinit për t'i detyruar partitë revizioniste t'i binden «shkopit të dirigjentit» të Moskës, mungesën e plotë të unitetit për çështje kryesore ideologjike, politike e të marrëdhënieve ndërkombëtare. Secila parti mbrojti pikëpamjet e veçanta në përputhje me interesat e borgjezisë së vet kombëtare dhe u përpoq t'ua imponojë të tjerëve me çdo kusht e me çdo mënyrë.

Degjenerimi i plotë politik e ideologjik në të cilin ka rënë udhëheqja renegate që sundon sot Bashkimin Sovjetik, është pasojë e pashmangshme e tradhtisë dhe e vijës së saj antimarksiste e kundërrevolucionare. Por falimentimi i saj në të gjitha drejtimet, pamundësia për ta zbatuar këtë vijë si të donte ajo vetë janë rezultat i drejtpërdrejtë i luftës parimore e konsekuente që kanë bërë Partia jonë dhe partitë e tjera marksiste-leniniste, të cilat kanë demaskuar nga rrënjët strategjinë dhe taktikat kundërrevolucionare të udhëheqjes sovjetike, kanë minuar komplotet, intrigat dhe manovrat e saj, kanë nxjerrë në shesh fytyrën e saj të vërtetë prej grabitqari imperialist dhe kanë paralajmëruar popujt për rrezikun që ajo paraqet për lirinë e pavarësinë e tyre, për revolucionin e socializmin.

Qëndrimet e vendosura dhe lufta dhëmb për dhëmb e partive tona marksiste-leniniste ua kanë kufizuar shumë fushën e veprimit revizionistëve sovjetikë, i kanë detyruar t'i hedhin poshtë maskat dhe të dalin hapur me planet e veprimet kundërrevolucionare. Kjo ka bërë të mundur që gjithë bota të shikojë se cilat janë synimet dhe qëllimet e vërteta antikomuniste e proimperialiste të revizionistëve sovjetikë.

Por marksistë-leninistët e vërtetë, tërë forcat revolucionare në botë, me gjithë sukseset e arritura në luftën kundër revizionizmit hrushovian, nuk flenë mbi dafina dhe nuk e dobësojnë për asnjë fije vigjilencën e tyre. Ata do ta vazhdojnë luftën deri në fund, deri atëherë kur revizionizmi të jetë shkatërruar plotësisht ideologjikisht e politikisht, derisa të ketë triumfuar përsëri revolucioni socialist në vendet revizioniste, derisa fronti revizionist të shembet krejtësisht pa asnjë shpresë ringjalljeje në të ardhmen.

Kontradiktat e brendshme në Bashkimin Sovjetik dhe vështirësitë e tij të jashtme, pa shtytjen dhe luftën parimore antirevizioniste të forcave marksiste-leniniste, nuk mund të çojnë në një përmbysje të afërt të tradhtisë dhe të kundërrevolucionit që ka pllakosur këtë vend, nuk mund të mënjanojnë rrezikun që paraqet për revolucionin, lirinë e pavarësinë e popujve imperializmi i ri revizionist sovjetik.

Si në çdo vend borgjez, edhe në Bashkimin Sovjetik, në sferat e larta të udhëheqjes së tij, në varësi nga koniunkturat e brendshme e të jashtme, ekziston me siguri një luftë e ashpër për pushtet midis klaneve të ndryshme. Por kontradiktat, grindjet dhe lufta për

pushtet midis krerëve revizionistë, ashtu siç ndodhte edhe në kohën e Hrushovit, nuk janë dhe nuk mund të jenë për ndryshim vije, drejtimesh e synimesh. Ato kanë të bëjnë me metodat dhe taktikat praktike në lidhje me zbatimin e vijës revizioniste, me aplikimin e politikës imperialiste agresive.

Shtypi borgjez, sigurisht jo pa dijeninë dhe mirëdashjen e Kremlinit, e paraqet udhëheqjen e sotme sovjetike të ndarë më dysh. Brezhnjevin dhe grupin e ushtarakëve i paraqet si «skifterë», ndërsa Kosiginin dhe shokët e tij si «pëllumba».

Në të vërtetë, ky stil amerikan emërtimi e ndarjeje përdoret për të mashtruar popujt, për të thyer hovin revolucionar të masave, për të ngjallur iluzione dhe për të ushqyer shpresa të kota se shpëtimi nga revizionizmi, nga presionet e kërcënimet sovjetike mund t'u vijë nga «urtësia» e «politika e mençur» e «të moderuarve» ose nga shpërthimi i hapët i grindjeve në gjirin e udhëheqjes sovjetike. Pra, sipas këtij arsytimi, le të presin revolucionarët, le të lidhin duart e të shpresojnë popujt, le t'i lënë të qetë revizionistët të vazhdojnë veprën e tyre të tradhtisë!

Falsitetin dhe rrezikshmërinë e kësaj propagande i ka provuar historia e kohëve të kaluara dhe të tanishme e imperializmit amerikan, britanik etj., ashtu siç e provoi edhe «grushti i pallatit» në Kremlin më 1964.

Në fuqi në SHBA kanë qenë edhe demokratët, edhe republikanët, «skifterët» e «pëllumbat», por lufta kundër popullit vietnamez ka vazhduar, ashtu siç ka vazhduar pa ndërprerje edhe politika agresive e imperialistëve amerikanë kundër lirisë e pavarësisë së

popujve. Nuk dihet kur ka bërë më shumë agresione imperializmi britanik, kur kanë qenë në fuqi konservatorët apo laburistët.

Marksizëm-leninizmi na mëson, dhe praktika e gjatë e ka vërtetuar, se politika e shteteve imperialiste, megjithëse zbatohet nga njerëzit që janë në pushtet, në fund të fundit nuk përcaktohet nga ata. Është vetë sistemi shoqëror ai që i pjell agresionet, shtypjen dhe shfrytëzimin kapitalist. Kështu qëndron puna edhe me udhëheqësit revizionistë sovjetikë, të cilët janë pjellë dhe përfaqësojnë rendin kapitalist, të rivendosur tanimë plotësisht në Bashkimin Sovjetik.

Dhe, në fakt, a ekziston ndonjë farë ndryshimi principial, për shembull, midis Brezhnjevit e Kosiginin? I pari i shpall teoritë që justifikojnë agresionin, ndërsa i dyti është farkëtuesi i politikës për forcimin e aleancës kundërrevolucionare sovjeto-amerikane. Brezhnjevi proklamoi politikën e rrethimit të Kinës dhe Kosiginin ndërmerr masat konkrete për të organizuar praktikisht të ashtuquajturin sigurim kolektiv në Azi, i cili dihet mirë se ku synon. Me shembuj të tillë mund të vazhdojmë pa fund, por të gjithë ata tregojnë se krerët e sotëm revizionistë të Bashkimit Sovjetik janë të vendosur ta pinë deri në fund kupën e tradhtisë së tyre dhe asnjë shpresë nuk ekziston se ata mund të ndreqen ndonjëherë. «Grushte pallati» si ai i 1964-ës mund të ndodhin përsëri, por ato do të jenë një qërim i brendshëm hesapësh. Bandën e gangsterëve revizionistë dhe bashkë me të edhe politikën e saj imperialiste agresive do ta zhdukë vetëm revolucioni i ri proletar, i cili do t'u vërë fshesën atyre dhe gjithë shtresës

së lartë borgjeze që sundon sot Bashkimin Sovjetik.

Procesi i zhvillimit të sotëm të revizionizmit hrushovian ka marrë të tatëpjetën dhe tendenca e tij është të bjerë gjithnjë e më shumë. Në këtë situatë interesat e lartë të marksizëm-leninizmit, të revolucionit dhe të socializmit në botë kërkojnë nga të gjithë komunistët që u qëndrojnë besnikë mësimëve ngadhënjimtare të marksizëm-leninizmit, ta intensifikojnë edhe më shumë luftën për demaskimin e mëtejshëm të revizionizmit hrushovian dhe të krerëve të tij, të organizojnë akoma më mirë luftën për shpartallimin e plotë politik e ideologjik të tij.

Sigurisht, marksistë-leninistët dhe pjesa e ndër-gjegjshme revolucionare e proletariatit botëror nuk mendojnë dhe as kanë menduar kurrë se lufta kundër revizionizmit hrushovian do të jetë e lehtë dhe e shkur-tër. Ajo do të kërkojë akoma shumë punë, sakrifica dhe energji të mëdha. Por ata nuk i tremben dhe nuk i shmangen kurrë luftës së vendosur, pasi vetëm me anë të saj do të mund t'u bëjnë ballë me sukses sulmeve të tërbuara të revizionistëve hrushovianë, do të mund të demaskojnë komplotet dhe të shpartallojnë planet e tyre agresive.

Për të mbytur idenë e madhe të revolucionit proletar dhe të diktaturës së proletariatit, për të shkatërruar socializmin dhe për t'i hapur rrugën kapitalizmit, revizionistët hrushovianë, dhe në radhë të parë udhëheqja e sotme renegate sovjetike, përpiqen të vënë maska të reja, të përdorin forma të reja organizimi e mashtrimi, të gjejnë forma të reja lufte.

Por marksistë-leninistët nuk mashtrohen. Ata e

dinë mirë se lufta për liri e pavarësi, lufta për socializëm është një dhe e pandarë me luftën kundër imperializmit e revizionizmit. Asnjëra nuk mund të bëhet me sukses pa tjetrën. Sulmet, kërcënimet, shantazhet dhe anatemat e pafund që ata lëshojnë kundër forcave revolucionare marksiste-leniniste, nuk janë aspak provë e forcës, përkundrazi, ato janë ndërmarrje të dëshpëruara për të fshehur dobësinë dhe kalbëzimin e tyre, përpjekje për të krijuar atmosfera artificiale, që do të pengonin përkohësisht përçarjen e kampit të tyre të tronditur. Demonstrimi i forcës dhe vringëllimi i armëve që revizionistët sovjetikë i kanë bërë pjesë të pandarë të sjelljeve të tyre, bëhen me qëllim që të frikësojnë dhe të nënshtrojnë të dobëtit — ata që i lëshojnë nervat. Por marksistë-leninistët, revolucionarët, gjithë ata që janë të vendosur të luftojnë për ta çuar deri në fund çështjen e madhe të revolucionit, të socializmit dhe të çlirimit të popujve, nuk tërhiqen përpara asnjë vështirësie e pengese.

Duke bërë fjalë për luftën që revizionistët zhvillojnë kundër nesh dhe për dështimin e saj, më 21 dhjetor 1968 në Konferencën e 17-të të Partisë për Tiranën, thamë: «Fakt është se revizionistët modernë, me ata sovjetikë në krye, ishin më të fuqishëm në ekonomi, në organizim, në propagandë, por fakt është, gjithashtu, se ata jo vetëm nuk na thyen dot, nuk na mundën, por jemi ne që i demaskuam keqas e i dobësuam ata. Dhe sa më e furishme vazhdon kundër tyre lufta jonë parimore, sa më shumë përpiqen ata të na luftojnë, aq më tepër koalicioni i tyre çorganizohet, shembet, lindin divergjenca të reja e më të mëdha në

kampin e tyre të cilat ata i minojnë, kurse luftën tonë të drejtë kundër tyre e fuqizojnë»¹.

Le të hidhen në sulm revolucionarët dhe gjithë marksistë-leninistët, le të bashkohen këta gjithnjë e më fort në luftën kundër imperializmit dhe revizionizmit hrushovian! E ardhmja i përket revolucionit, komunizmit. Revizionizmi sovjetik falimentoi me Hrushovin, po falimenton përsëri tani pa të, me Brezhnjevën e Kosiginin. Dështimi dhe shembja e revizionizmit është një verdikt i historisë, të cilit ai nuk mund t'i shmanget. Tradhtarët dhe renegatët revizionistë tani për tani e mbajnë akoma të lidhur popullin sovjetik. Por kjo nuk mund të vazhdojë gjatë. Një popull që ka bërë Revolucionin e Tetorit dhe ka shkatërruar fashizmin, një vend me tradita të mëdha revolucionare e internacionaliste nuk mund të bëhet kurrë skllav, as edhe vegël e bindur në duart e një klike renegatësh për të zbatuar planet e saj agresive e ekspansioniste. Ai me siguri do të ngrihet një ditë kundër tradhtisë revizioniste dhe do t'ia kthejë përsëri vendin e nderit dhe lavdinë e mëparshme Bashkimit Sovjetik.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 244 (6596), 12 tetor 1969

Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 503

¹ Enver Hoxha. Vepra, vëll. 39, f. 473.

I GËZOFSHI SHTËPITË E REJA, PUNË TË MBARË DHE PLOT SUKSESE

*Nga biseda me një grup kooperativistësh të Izvorit
e të Rabies të rrethit të Tapelenës*

16 tetor 1969

Fshatarët e Izvorit dhe të Rabies, dy fshatra që u ngritën krejt të reja mbi rrënimet e tërmetit të 3 prillit 1969, për të falënderuar Partinë, si dhe për të uruar udhëheqësin e saj të dashur me rastin e ditëlindjes, dërguan në Tiranë një grup kooperativistësh. Shoku Enver Hoxha i priti në shtëpinë e tij, i përqafoi dhe zhvilloi me ta një bisedë shumë të ngrohtë.

Populli ynë do të gëzohet shumë kur të marrë vesh se shkatërrimet e tërmetit u likuiduan plotësisht, si në të gjitha zonat e dëmtuara, ashtu edhe në Rabie e në Izvor.

Të dy fshatrat tuaja kanë të drejtë të mburren për të kaluarën e tyre historike, pse izvorasit dhe rabinjotët kanë kontribuar kurdoherë me trimëri të madhe për çlirimin e Shqipërisë.

Ka shumë rëndësi për Partinë që ju, ashtu si tërë populli ynë, jeni kaq të kënaqur e të gëzuar. Gjer tani

thujse janë ndrequr të gjitha shkatërrimet e tërmetit të 3 prillit të këtij viti jo vetëm në dy fshatrat tuaja, po kudo ku ndodhi kjo fatkeqësi. Punë të mëdha si këto, gjetkë nuk bëhen lehtë. Gjëra të tilla bëhen vetëm në Shqipëri, ku udhëheq me guxim e me urtësi Partia jonë e Punës. Tërmete kanë rënë dhe bien kudo në botë, por rrënimet e shkatëruara prej tyre mbeten për një kohë shumë të gjatë. Unë mbaj mend ato kohë të vështira në të kaluarën, kur një tërmet i tmerrshëm si ky që ra këtë vit, shkatërroi krejt Tepelenën, duke i lënë gjyshërit tanë në diell, pa çati e pa një plaçkë që të hidhnin në kurriz. Kështu ngjiste në Shqipëri në kohën e kaluar, që rinia jonë nuk e ka jetuar. Kështu vuajnë edhe sot e kësaj dite popujt në vendet kapitaliste e revizioniste, ku fuqinë nuk e kanë ata në dorë si populli shqiptar, i cili, me Partinë në krye, gjithçka e bën për interesin e tij dhe të atdheut.

Te ne pushteti është i popullit, çdo punë drejtohet me një nikoqirllëk të madh, saqë, kur ngjasin fatkeqësi të tilla të natyrës, sado të mëdha të jenë ato, merrren menjëherë masa, shërohen shpejt plagët dhe njerëzit nuk i ndiejnë. Kështu sikurse te ju ndodhi parvjet në rrethin e Dibrës dhe në atë të Librazhdit, ku pasojat e rënda të tërmetit u zhdukën me shpejtësi të madhe, pse në Shqipëri, si i thonë fjalës: «Të gjithë punojnë për një dhe një punon për të gjithë».

Ju e dini shumë mirë se Partia vendosi që në mbarë vendin, jo vetëm në qytet, po edhe në fshat, të zhduket pisha, qiriri e llamba me vajguri si mjete ndriçimi dhe vendin e tyre ta zërë kudo drita elektrike. Në botë ka vende që disponojnë energji elektrike

shumë më tepër se ne, po nuk e përdorin në interes të popullit. Me anë të saj kapitalistët vënë në lëvizje makineritë e ndërmarrjeve të tyre, nga të cilat nxjerrin fitime kolosale, kurse miliona njerëz nuk kanë as bukë për të ngrënë, as çati ku të futin kokën. Partia jonë, që s'ka tjetër qëllim veç mirëqenies së popullit, udhëheq Shqipërinë e vogël që ndërton socializmin dhe, duke kapërcyer shekuj të tërë brenda një kohe shumë të shkurtër, vendosi me guxim që deri në fund të vitit 1971 të gjitha shtëpitë e fshatarëve të kenë dritë elektrike. Ky vendim do të zbatohet, bile para afatit.

Prandaj të jemi të tërë ushtarë besnikë të kësaj Partie dhe të këtij populli, të ndjekim mësimet e Partisë dhe të sakrifikojmë çdo gjë për interesat e lartë të saj, pse vetëm kështu jeta jonë do të bëhet më e bukur. Patjetër, ato që kemi realizuar gjer tani na kënaqin, por Partia, që na ka hapur sytë, mendon se janë të pamjaftueshme, prandaj ajo punon vazhdimisht që në vendin tonë të ndërtohen vepra të tjera akoma më madhështore për të mirën dhe lumturinë e popullit.

Ne, të shkuarit në moshë, nuk do të rrimë duarlidhur, duke u kënaqur me sukseset që kemi arritur, përkundrazi, vazhdimisht do të përpiqemi të punojmë me të gjitha forcat për popullin dhe për Partinë. Natyrisht, nuk do të arrijmë të bëjmë gjithçka që dëshirojmë, kështu që shumë vepra të tjera do të mbeten t'i bëjë brezi që vjen. Ne nuk mburremi me ato që kemi bërë, pse Partia na mëson të jemi kurdoherë të thjeshtë, po kemi besim të plotë se rinia jonë e mrekullueshme, besnike e Partisë, do të bëjë gjëra të tjera shu-

më më të mëdha e më të bukura nga sa ka realizuar brezi ynë. Kjo është arsyeja që Partia na këshillon ta ndihmojmë dhe ta mbështetim me të gjitha forcat rininë në rrugën e saj, mbasi të rinjtë dhe të rejat janë e ardhmja e Shqipërisë.

Edhe ne vetë kemi qenë dikur të rinj, po atëherë prindërit tanë, gjithë populli, për fajin e sundimtarëve të urryer, ishin të varfër e të paditur. Megjithatë ata bënë sa mundën për ne. Edhe ne, gjithashtu, sa mundim po bëjmë për popullin, por e dimë dhe jemi të bindur se nuk do të bëjmë dot ato gjëra të mëdha që kanë për të bërë brezat e rinj. Kjo është dialektika e jetës dhe shpjegohet edhe me faktin se ne po i ndihmojmë të rinjtë më shumë nga sa patën mundësi të na ndihmonin ne të parët tanë. Prandaj sa më shumë të bëjmë për rininë, aq më mirë do të punojë ajo dhe aq më të mëdha e më të bukura do të jenë realizimet e saj.

Izvori dhe Rabia, që u ndërtuan nga themelet, tani u bënë shumë më të bukur nga ç'ishin, por të jemi të sigurt se, kur të plakemi ne edhe ca më shumë, të rinjtë kanë për të na thënë: «Vërtet mirë keni punuar e keni ndërtuar ju, po ne tani do t'i bëjmë fshatrat tonë akoma më të bukura». Dhe me të vërtetë, shtëpitë që kemi ndërtuar nëpër qytete e fshatra janë të bukura, por ato që do të bëjë rinia në të ardhmen s'ka dyshim që do të jenë edhe më të mira. Çdo gjë do të bëjë populli nën udhëheqjen e Partisë, prandaj popullin dhe Partinë t'i duam si shpirtin.

U gëzova shumë kur mësova se ju keni ardhur të takoheni me mua pikërisht në kohën kur jeni duke u

futur në shtëpitë e reja. Ma do zemra të vij t'ju uroj atje, por tani nuk kam mundësi, prandaj, ju lutem, takimin tonë këtu e merrni sikur po e bëjmë në fshatrat tuaja të reja, sikur kam ardhur unë t'ju uroj në shtëpitë e reja. I gëzofshi me shëndet dhe kalofshi jetë të lumtur në to vetë dhe me gjithë të dashurit e zemrës! Unë jam i bindur se, po të kisha ardhur, ju do të më kishit gostitur; meqenëse tani erdhët ju në shtëpinë tonë, edhe ne ju kemi përgatitur një ëmbëlsirë. Prandaj mirë se erdhët dhe ju bëftë mirë!

Më thatë se Rabia ka ndërtuar 76 shtëpi të reja dhe Izvori 110 e qenkeni plotësisht të kënaqur jo vetëm nga shtëpitë e bukura, por edhe nga vendi i përshtatshëm ku u ndërtuan ato. Prandaj po më thotë xha Bektashi¹ se Tepelena tani nuk i hyn fare në sy përpara bukurisë së fshatit të tij të ri.

Ju them edhe një herë me gjithë shpirt se jam jashtëzakonisht i gëzuar kur ju shoh kaq të lumtur që po hyni në shtëpitë e reja me dy e me tri dhoma, që keni ndërtuar këto dy fshatra të reja socialiste me shkolla, ambulancë, furrë buke, lavanderi, banjë, dyqane, reparte artizanati, maternitet e shtëpi kulture etj.

Dëshiroj të falënderoj shumë gjithë popullin e krahinës suaj për përsëndetjet që më ka dërguar dhe për ftesën që më bën për të marrë pjesë në ceremoninë e inaugurimit të fshatrave tuaja të reja. Por s'ka gjë, edhe pse s'kam mundësi të vij dot, të jeni të bindur se, po të më jepet rasti, mund të vij ndonjëherë tjetër dhe atëherë do të jetë një kënaqësi e veçantë për

1 Bektash Mahmuti nga Rabia.

mua kur t'i shikoj ato fshatra të reja për herë të parë.

Tani mendoj se duhet të keni kujdes që jo vetëm shtëpitë brenda t'i mbani pastër, po tërë fshatin ta zbukuroni, ta pyllëzoni me pemë, të bëni parqe të lulëzuara dhe rrugë të reja. Por, në radhë të parë, u vini rëndësi pastërtisë dhe higjienës personale, si dhe pastërtisë brenda shtëpisë. Të dyja këto duhet të shkojnë së toku, se janë një nevojë e domosdoshme dhe kënaqësi e njeriut. Më parë njerëzit mendonin se punëtorët dhe fshatarët, kur kthehen nga puna të lodhur, nuk kanë nevojë të pastrohen. Ky mendim nuk është i drejtë, pse pastërtia e çlodh njeriun, ajo, në radhë të parë, ruan shëndetin dhe trupin nga shumë sëmundje, duke ia zgjatur jetën njeriut. Ju kooperativistët, si dhe punëtorët, vërtet ktheheni të lodhur nga puna, po lodhja nuk ju pengon aspak për mbajtjen e pastërtisë. Sa mirë i vjen njeriut kur, pasi lan fytyrën e këmbët, hyn në një odë të bukur, që ndrit nga pastërtia e rregulli, e pajisur edhe me ndonjë radio e me mobilie të bukura, dhe ulet të çlodhet në minderin e mbuluar me makate të pastra. I kënaqet shpirti njeriut të punës në një ambient të tillë, ku i përtërihet jeta. Në këto kushte ai prehet me të vërtetë. Partia kurdoherë na mëson që edhe të punojmë me të gjitha forcat, po të dimë edhe të çlodhemi, prandaj kohën pas punës ta kalojmë në mënyrë të kulturuar në ambientet e pastra të shtëpisë, sepse, siç thashë, pastërtia ndikon shumë për zgjatjen e jetës. Dhe jetën tani duhet ta gëzojmë, pse është me të vërtetë për t'u gëzuar në Shqipërinë e re. Jeta në vendin tonë sot që kanë ndryshuar kushtet nuk është si më parë, kur njerëzve nga

hidhërimi, nga skamja dhe nga sëmundjet ajo u qe mërzitur.

Në të ardhmen ne do të bëjmë edhe gjëra të tjera më të mëdha. Pasi të mbarohen së ndërtuari veprat që kemi filluar, të cilat do ta forcojnë më shumë Shqipërinë, populli do të furnizohet shumë më mirë se tani, pse edhe bujqësia, edhe industria do të jenë më të përparuara. Këta dy vjetët e fundit gruri dhe misri po na bëhen mirë. Edhe sektorët e tjerë të ekonomisë shumë mirë po na shkojnë, pse pikërisht për këtë qëllim punon Partia. Por, për të ecur vazhdimisht e kurdoherë përpara, duhet të punojmë, pse çdo gjë bëhet vetëm me punë. Pa punë asgjë nuk mund të realizohet. Prandaj kush nuk punon, humbet. Të gjitha ato që janë ngritur, u bënë me punën dhe me djersën e popullit, me zotësinë, me mençurinë dhe me zgjuarsinë e tij.

Tani të gjithë, djem e vajza, të rritur e të mosshuar, janë mobilizuar si asnjëherë në punë, atyre u është përtëritur zemra, u është zhvilluar truri. Vajzat tona, me zotësinë dhe me mençurinë e tyre, sot janë në gjendje të realizojnë gjëra shumë të bukura që nuk i bëjnë dot as makinat më të mira. Edhe makinat i krijon mendja e njeriut. Ato bëjnë më shumë gjëra si numër, por nuk mund të krijojnë vlera të tilla si ato që krijon mendja e vajzave dhe e djemve tanë.

Në lidhjet me masat dhe në përkrahjen e iniciativave të tyre krijuese qëndron forca e Partisë. Kur themi se Partia është mendja e popullit, do të thotë që ajo nuk është mendja e një njeriu të vetëm, por e të gjithëve, ajo është mendja e gjithë popullit, e cila

është shumë e fuqishme, ajo ndërton, prodhon, çan male dhe bën revolucionin. Të gjitha këto që janë bërrë e do të bëhen në vendin tonë, janë fryt i forcës, i mendjes, i diturisë së mbarë popullit e të Partisë të arritura me punë. Po të lidhësh duart, asgjë nuk zbret nga qielli.

Pavarësisht nga mosha, tani në kohën e Partisë edhe pleqtë te ne janë shumë të gëzuar. Ata kanë vuajtur shumë në jetë në të kaluarën dhe e dinë mirë ç'fatkeqësi e madhe ishte kur i prishej shtëpia ndonjërrit. Prandaj, kur plaku i Izvorit ose i Rabies sheh tani shtëpitë e bukura që u ndreqën kaq shpejt, ndien një kënaqësi të madhe. Ju të rinjtë dhe të rejat keni lindur në kohën e Partisë, nuk i keni jetuar ato kohë të zeza kur punëtori dhe fshatari robtoheshin në punë dhe s'kishin as krodhën e bukës të shuanin urinë. Edhe ju jeni shumë të gëzuar për këto suksese që janë arritur, po jetën e keni përpara dhe do të keni fatin të shihni gjëra të tjera më të mëdha. Ju e kuptoni ngazëllimin e madh të pleqve, por edhe ata i kuptojnë dëshirat tuaja, hovin tuaj rinor dhe nuk ju pengojnë të ecni përpara, kur ndiqni me besnikëri rrugën e Partisë.

Nganjëherë ndodh që ndonjë plak, padashur, nga moskuptimi si duhet i kërkesave të rinisë ose të grave, bëhet pengesë në udhën e tyre të drejtë. Dihet se gjërat e reja te disa njerëz me koncepte të vjetra konservatore futen një çikë me zor, por Partia përpiqet që edhe ata të sqarohen më parë, t'i kuptojnë drejt gjërat dhe të binden.

Rruga që na tregon Partia për rininë dhe për gratë

duhet të jetë e hapët. Partia na këshillon të mos e pengojmë të ecë përpara dhe t'i hapim rrugën sidomos gruas shqiptare, pse ajo është gjysma e shoqërisë. Pa gruan nuk ka shoqëri. Ligjet e Partisë janë ligjet që ka zbuluar Marks; do ose nuk do ndonjëri, këto ligje nuk pyesin, revolucioni zhvillohet. Donin apo nuk donin Ahmet Zogu, Benito Musolini dhe Adolf Hitleri apo tradhtarët si Qazim Koculi e Mustafa Kruja me shokë, revolucioni në Shqipëri do të bëhej, dhe u bë, populli ynë do të ngrihej të merrte armët për të fituar lirinë, që e fitoi, Shqipëria do të çlirohej, siç u çlirua. Ky është ligj. Ata që ishin kundër revolucionit dhe ligjeve të tij e pësuan si çaklli që i shkon ruli përsipër dhe e shtyp.

Shqipëria u çlirua, po bashkë me të, pavarësisht nëse duam apo nuk duam unë e ti, u çlirua edhe gruaja shqiptare. Edhe ky është ligj. Pa gruan shoqëria nuk mund të shkojë përpara. Kështu është edhe puna me ligjet e revolucionit. Le të çirrej sa të donte hoxha për «gjynahun e madh» që femra shqiptare merr pjesë aktivisht krah për krah me burrin në punë dhe në jetë, të tëra këto predikime mashtruese u rrëzuan nga Partia dhe nga populli. Mësimet e Partisë nuk i rrëzon dot asnjë armik, pse Partia jonë, që ecën sipas mësimëve të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, nuk ka mortje kurrë, ajo është e pavdekshme, siç është i pavdekshëm populli, nga gjiri i të cilit lindi.

U bëni shumë të fala shokëve dhe shoqeve, nënave, motrave dhe vëllezërve të Rabies, të Izvorit dhe të gjithë krahinës suaj, u çoni atyre, gjithashtu, urimet e mia. më të përzemërta për hyrjen në shtëpitë e reja. I gë-

zofshi dhe punë të mbarë e plot suksese nën udhëheqjen e Partisë! U thoni të gjithëve se unë, Nexhmija dhe gjithë shokët e tjerë të udhëheqjes së Partisë e të shtetit jemi jashtëzakonisht të gëzuar që ju do të hy-ni së shpejti në shtëpitë e reja.

Udhë të mbarë dhe mirupafshim!

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në këtë
takim që gjenden në AQP*

TË DREJTAT DHE LIRITË E GRUAS DHE TË RINISË TË KUPTOHEN THELLË E TË MBROHEN NGA TË GJITHË

*Fjala në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

18 tetor 1969

Një nga aspektet e shumanshme të demokracisë socialiste, si për burrat, ashtu edhe për gratë, është e drejta e tyre për shfaqjen e mendimeve për çdo problem, jo vetëm të administrimit ekonomik, por sidomos edhe për problemet shoqërore që na interesojnë shumë dhe që po i marrim në studim në disa pika të rendit të ditës të kësaj mbledhjeje.

Vihet re se në jetën ekonomike gratë mund t'u bëjnë kritika edhe burrave, të cilët deri diku i pranojnë. Por në çështjet shoqërore ose në «të drejtat» patriarkale e mikroborgjeze, të fituara brez pas brezi nga traditat, ata jo vetëm nuk i pranojnë, ose i pranojnë

1 Në këtë mbledhje u diskutua për disa çështje të marrëdhënieve midis të rinjve e të rejave të qyteteve dhe për disa drejtime kryesore të luftës për thellimin e procesit të krijimit të marrëdhënieve të reja martesore.

me shumë zor, por i luftojnë me shumë mënyra dhe disa herë me më të këqijat, të cilat janë mënyra të vjetra, të trashëguara dhe me frymëzime kapitaliste, borgjeze dhe mikroborgjeze. Këtu, natyrisht, zhvillohet luftë, obstruksion¹, presion dhe ka frenim të demokracisë për gratë e vajzat dhe në përgjithësi për të rinjtë. Nga ana e këtyre të fundit ka reagim të lejueshëm dhe të ligjshëm.

Kjo shtypje e demokracisë ndaj të rinjve fshihet gjoja prapa vlerës së madhe të eksperiencës së të mosshuarve dhe mungesës së eksperiencës së të rinjve e të të rejave. Por mbi këtë të vërtetë nuk duhet kurrsesi të abuzohet. Të gjithë e dimë, dhe është e drejtë të thuhet, se Partia me luftën e saj i dha lirinë gruas, i siguroi barazinë me burrin dhe të gjitha të drejtat si qytetare e barabartë e Republikës Popullore të Shqipërisë. Me ligj kjo është vendosur dhe në praktikë janë bërë përparime të mëdha. Por është arritur vallë plotësisht në praktikë, si në jetën politike dhe ekonomike, ashtu edhe në atë shoqërore ky objektiv i lartë i Partisë? Duhet ta njohim, për fat të keq, se jo, jemi akoma larg. Kërkohet shumë punë politike e ideologjike prej dhjetëra e dhjetëra vjetësh që të arrihet.

Të mos na gënjehet mendja dhe të mos dehemi nga sukseset e arritura, të mos i matim sukseset vetëm nga vendosja e parimeve dhe e ligjeve, por edhe nga rezultatet e zbatimit të tyre në praktikë, nga kuptimi i thellë i tyre dhe i ndryshimeve që sjell ky kuptim i drejtë në botëkuptimin e njerëzve. Kjo ka shumë

1 Nga frëngjishtja — pengesë me qëllim.

rëndësi. Shkalla e ndryshimeve në botëkuptimet, nga të vjetrat idealiste në ato të rejat materialiste, është ajo që do të sjellë realizimet cilësore që kërkojmë.

Pikërisht ndryshimet në botëkuptimet e njerëzve, nga ato idealiste në ato materialiste, bëhen ngadalë dhe janë mbrapa.

Të mos e harrojmë rrugën që ndoqi dhe që po ndjek Partia për këto probleme të mëdha shoqërore. Duhej luftuar për t'u krijuar personaliteti i gruas. Vetëm me dekrete kjo nuk bëhej. Gruaja dhe vajza duhej ta fitonin personalitetin me punë, me shkollë, me edukatë. Në këtë drejtim ne kemi arritur shumë rezultate të mira materiale dhe morale. Po a u zgjidh definitivisht problemi? Në asnjë mënyrë jo. Ai do të zgjidhet definitivisht në komunizëm. Çdo brez njerëzish do t'i përforcojë më tej realizimet e përgjithshme të shoqërisë, prandaj çekani i Partisë duhet të rrahë kurdoherë pa pushim mbi këtë problem jetik, shoqëror.

Gratë dhe vajzat, në shumicën dërrmuese ndjekin tani shkollat dhe punojnë si në fshat, edhe në qytet. Kjo është një fitore e madhe jo vetëm ekonomike, por edhe ideologjike e shoqërore. U thye rezistenca prapanike, patriarkale, që e mbante gruan të mbyllur dhe pa shkollë, por ka akoma zakone e mbeturina që do të zhduken me luftë të vazhdueshme ideopolitike. Pra, duke vënë si strumbullar kuptimin e lartë ideologjik marksist-leninist të zhvillimit të ekonomisë socialiste dhe të pjesëmarrjes absolute të gruas në punë, Partia bëri që plaku, plaka, nusja, e reja të kuptojnë nevojën jetike të punës, të pjesëmarrjes në të dhe kështu u thyen një sërë pengesash, por jo të gjitha. Kjo nuk

qe një punë e lehtë. Të mos i harrojmë luftën dhe vështirësitë, pse atëherë nuk do të luftojmë më tej kundër vështirësive të tjera, mbasi ky problem s'ka mbaruar.

Mjaft prindër që punojnë vetë dhe që kanë lejuar, gjithashtu, të punojnë edhe vajzat, edhe nuset, mjaft gra e vajza që kanë dalë në punë, në këtë drejtim kanë bërë të gjithë ndryshime të theksuara në botëkuptimin e tyre. Por akoma ruajnë pikëpamje të gabuara, akoma kanë ferra nëpër këmbë që i pengojnë të ecin me atë ritëm që duhet, ruajnë në ndërgjegjen e tyre paragjykimet e vjetra të dëmshme e të rrezikshme, të cilat nganjëherë nuk i kuptojnë, pse janë idealizuar në zemrën dhe në mendjen e tyre, ngandonjëherë i kuptojnë përgjysmë dhe reagojnë dobët, ngandonjëherë e kuptojnë rrezikshmërinë e tyre, por nuk reagojnë, se nuk kanë besim të plotë nëse i mbështet opinioni, ose, pse të mos e themi, mendojnë ngandonjëherë se «Partia nuk i mbështet, pse...» dhe lidhin në mendjen e tyre disa ndodhi që mund të kenë ngjarë kështu ose ashtu.

Por ne mund të dalim me një konkluzion të parë të drejtë: Është arritur një fitore e madhe që gratë dhe vajzat tona dolën në punë, në shkollë, në jetë dhe punojnë e luftojnë njëlloj si burrat, në mos më mirë; gjithçka që kanë fituar dhe po fitojnë çdo ditë, ato e kanë arritur me punë, me zotësi, me pjekuri politike dhe ideologjike.

Në fabrika, në ara, në shkolla, në pushtet e kudo gratë dhe vajzat punojnë tok me burrat dhe me djemtë, nuk bëhet asnjë dallim midis tyre, mbrohen deri në një të drejtat e tyre. Ato punojnë, realizojnë, kritikoj-

në e kritikohen pa dallim; sjelljet në punë në mes tyre në përgjithësi janë shumë korrekte. Ky është një sukses shumë i madh, gjë që ka lehtësuar atë situatë që gratë dhe vajzat në shumicën dërrmuese të mos pengohen të venë në punë dhe të ecë përpara me sukses emancipimi i gruas shqiptare.

Mirëpo vendet e punës, ku prodhohen të mirat materiale për njerëzit, ku gra e burra së toku punojnë si një trup i vetëm për socializmin, për jetën e lumtur të tyre dhe të brezave të ardhshëm, shkollat ku të rinjtë dhe të rejat edukohen së toku për të fituar diturinë dhe shkencën e për t'i vënë këto në shërbim të popullit dhe të atdheut, nuk janë vende automatësh. Ato janë në radhë të parë vende nga më të përshtatshmet, ku zhvillohen jeta dhe shoqëria, ku njeriu merr një zhvillim të madh politik, ideologjik, teknik; janë vende ku ai edukohet të drejtojë shtetin, ekonominë, zhvillimin e tij arsimor e kulturor, të krijojë shijet dhe etikën e vet; atje zhvillohen e kaliten prirjet dhe virtytet e tij më të mira si individ dhe si pjesëtar i shoqërisë socialiste.

Njerëzit, burra dhe gra, vajza e djem, në fabrika, në ara, në brigada, në shkolla, në aksione, në zyra, punojnë së toku, bëjnë mbledhje, venë në klubet e tyre, këndojnë, qeshin, bëjnë shaka me njëri-tjetrin, duhen si shokë e si miq të sinqertë, disa edhe dashurohen dhe martohen. Kjo është jeta. Të gjitha këto janë të natyrshme. Asgjë s'ka këtu jashtë natyrës. Këto bëhen dhe duhet medoemos të bëhen në frymën e lartë të moralit proletar. Por ndonjë që hiqet si shumë i zgjuar, mund të ngrihet e të thotë se «ngjasin edhe gjëra që

s'i lejon morali proletar». Po, ngjasin, i përgjigjemi ne. Po të thuash të kundërtën, nuk je realist, as marksist dhe kjo do të thotë se as «majën e veshit» nuk ia ke kuptuar dialektikës materialiste dhe as ndjenjave, pasioneve, brengave, gëzimeve, hidhërimeve, të metave e gabimeve të njerëzve, momenteve të tyre psikologjike, nuk ke kuptuar, gjithashtu, metodat e drejta që, të karakterizuara me plot urtësi, durim e dhembshuri, përdor Partia për të shpëtuar njeriun nga gabimet.

Që të mos e humbas fillin, çështjen e kam këtu: Kjo frymë e re edukimi, kjo jetë e re shoqërore e përbashkët në qendrat e punës e në shkollat, duhet të jetë strumbullari që të frymëzojë gjithë veprimtarinë e njerëzve tanë në kohën tjetër jashtë punës, në shoqëri dhe në familje. Kjo ka shumë rëndësi, sipas mendimit tim. Ky është kyçi i dytë që do të na hapë më mirë portat për të thyer një numër të madh paragjykimesh mikroborgjeze në jetën shoqërore, ashtu siç theu pengesat dhe hapi rrugën e madhe pjesëmarrja e gruas dhe e vajzës në punë e në shkollë. Nuk duhet të ketë dy ose tri lloje mënyrash jetese, duhet të ketë vetëm një, por ja që ka.

Shumë njerëz ndjekin një mënyrë të drejtë jetese, të hapët, të dashur, shoqërore si atje ku punojnë, ashtu edhe në shoqëri e në familje, nuk ka ndryshime parimore për ta. Ata janë spastruar nga mbeturinat kryesore, megjithëse kjo nuk do të thotë se janë imunizuar. Ata nuk janë liberalë në termin e keq të fjalës, të kuptohemi, ata janë në luftë me thashethemet, nuk i mundon më e kaluara patriarkale e familjes, e farefisit, e opinionit prapanik, nuk i mundon ndonjë gabim që

mund të kenë bërë në punë e në jetë, po ecin me guxim përpara në rrugën e Partisë.

Por ka pastaj njerëz të tjerë që në qendrën e punës janë pak a shumë në rregull, kurse me të dalë andej, në shoqëri, tregohen shumë të rezervuar, të mpirë, frikacakë, të druajtur, skeptikë, mizantropë pa dashje, nga zori. Kjo u ngjet edhe disa burrave, por për fat të keq u ngjet më shumë motrave, bijave e grave tona dhe shkak kryesor është qëndrimi dhe opinioni jo i drejtë i burrave. Këtu e ka burimin kjo ndrydhje e grave në jetën shoqërore jashtë punës dhe në shtëpi, në familje dhe kundër vullnetit të tyre, pse këtu, sidomos brenda katër mureve të shtëpisë, ndjenjat e burrit, natyrisht, manifestohen më me forcë.

Gruaja në përgjithësi ka fituar besim në çlirimin e saj ekonomik, po ajo nuk ka arritur që politikisht dhe moralisht të ndihet e njëllojtë me burrin në çdo moment dhe në çdo rrethanë, prandaj vuan nga mbe-turina e «epërsisë» së burrit dhe ia ka frikën opinionit prapanik, edhe kur është në të drejtën e saj. Nga ana tjetër, gruaja është një krijesë e gëzuar e me zemër të madhe, ajo është shumë më e lidhur me familjen dhe, që të mos i prishë këto lidhje, bën sakrifica parimore në të drejtat dhe në personalitetin e saj, kurse ka burra që abuzojnë në këto rrethana dhe përfitojnë nga këto virtyte të larta të gruas.

Disa burra flasin për «lirinë e gruas» nga zori, por në brendinë e tyre nuk janë plotësisht dakord. Ata s'kanë ç'thonë kur gruaja, vajza apo motra e tyre bën mbledhje në fabrikë, vete në klub, këndon e kërcen atje pa asnjë të keqe me shokët e saj të punës, por, me

të dalë nga fabrika, ai e shfaq humorin e tij prapanik, i thotë se «Gratë duhet të vijnë drejt në shtëpi», e pyet: «Ç'ishte ai burrë që të shoqëronte në rrugë?» etj. Lëre pastaj sikur të bëjë shaka e të vejë ndonjë shok pune t'i bëjë vizitë miqësore në shtëpi. Atëherë u bë skandali. Në shtëpi, sipas këtij prapaniku, nuk mund të vijnë veçse kushërinjtë e familjes dhe vetëm gra. Burra të huaj, shokë e miq të punës, pa qenë burri në shtëpi, është diçka amorale, skandaloze për këta konservatorë që flasin me gojë të madhe për «lirinë e gruas», por në fakt janë për «liri të kufizuar», liri të kontrolluar nga burri si në kohën e gjyshit. Sipas tij, garanti i nderit të gruas është vetëm burri dhe jo vetë gruaja.

Vazhdohet të mendohet prej disa burrave (dhe këta nuk janë të paktë, por, të kuptohemi, nuk janë njerëz të këqij, ata kanë lakra në kokë që duhet t'ua qërojmë) se gruaja nuk mund të ketë miq e shokë, të cilët mund t'i venë për vizitë në shtëpi, ta përshëndetin, të shëtitin me të në rrugë, të ulen me të në park. Ç'gjë të keqe ka këtu? Gruaja në shoqërinë e vjetër, natyrisht, ishte e mbyllur në shtëpi, shumë herë nuk lejohej t'u dilte as kushërinjve të saj, pale miqve të burrit. Tani ndërroi krejtësisht kjo situatë, në fakt duhet të ndërrojnë edhe mendimet e mykura.

Përse burri ka të drejtë të vejë të bëjë vizita ku të dojë dhe kujt të dojë, kurse gruaja jo? Përse burri mund të shëtisë në bulevard me një shoqe pune dhe gruan ta dënojë opinionin pse shëtiti me një shokun e saj të punës? Pse dy qëndrime të burrit dhe të opinionit konservator ndaj gruas në fabrikë dhe në sho-

qëri, jashtë fabrikës? Arsyeja e vetme qëndron në atë se këta i mundon e vjetra. Ata flasin për demokracinë, për të drejtat dhe lirinë e gruas, por nuk i kanë kuptuar thellë dhe drejt këto probleme kaq të mëdha jetike, shoqërore. Disa për këto gjëra, duke mbrojtur të vjetrën, hiqen si moralistë të mëdhenj, si njerëz tepër të ndershëm, por nuk thellohen se janë në bazë të shumë fatkeqësive, të shumë dramave, të shumë padrejtësive. Po të ecte Partia me moralin prapanik të njerëzve të tillë, atëherë gruaja duhej të qëndronte si përpara, skllave, e mbyllur në shtëpi, të rronte si kafshë, pa arsim e kulturë, të kalonte jetën në brenga e hidhërimi, të shitej për pesë pare si një berr, të ndahet nga burri e të vritej në bazë të kanuneve të kishës e të sheriatit. Jo, ajo kohë kaloi një herë e përgjithmonë dhe Partia do të luftojë me forcë të madhe kundër mbeturinave të asaj periudhe të llahtarshme.

Disa flasin kundër martesave me ndërmjetës, dënojnë me të drejtë ata prindër që i fejojnë fëmijët në moshë të mitur, ose që marrin pare, flasin kundër shpenzimeve dhe pajave të mëdha. Kjo është vija e Partisë, e cila duhet të kuptohet thellë, të zbatohet me rreptësi, të merren masa kundër atyre që e shkelin dhe të mos e flemë mendjen se këto zakone kaq të këqija morën fund me kaq, ose do të zhduken kaq shpejt. Këto janë plagë shoqërore, vazhdimësia e të cilave paskëtaj mund të mos paraqitet në format e acaruara dhe brutale si më parë, por do të ketë të atillë që do të gjejnë e do të krijojnë mjaft arsye të paqena për ta lyer helmin me pak sheqer. Dhe ashtu po bëjnë disa.

Vija e Partisë nuk konsiston vetëm në luftën kundër atyre që thashë më lart. Partia e ka përcaktuar vijën marksiste-leniniste të një martese me të vërtetë të shëndoshë, të qëndrueshme, në bazë të njohjes, të pëlqimit të lirë e të hapët të çiftit, të sinqeritetit dhe të një dashurie të pastër e të zjarhtë proletare në mes të të riut dhe të së resë. Kjo krijon bazën e harmonishme të një familjeje të shëndoshë.

Mund të themi se po ecet në këtë rrugë, kemi suksese, por duhet të njohim se kemi edhe pengesa, të cilat vijnë nga botëkuptimet e vjetra te njerëzit. Cilat janë këto pengesa, duhet t'i shohim në sy, t'i gjykojmë dhe jo t'u vijmë rrotull.

Mosbesimi i disa më të moshuarve ndaj të rinjve dhe të rejave në kuptimin e drejtë të dashurisë në dritën e moralit proletar. Ky mosbesim nga ana e tyre, për mendimin tim, nuk ka asnjë bazë të shëndoshë dhe nuk vërtetohet nga jeta e nrekullueshme e me një moral të lartë shembullor e rinisë sonë. Nuk mund të përgjithësohen disa raste vagabondësh, ashtu si nuk mund të përgjithësohen disa raste divorci të të moshuarve; se na flitet për të rinjtë që divorcohen, por na del që divorcohen më shumë nga ata që janë me mjekër.

Frika e madhe, sidomos e disa prindërve, se mos vajzës së tyre i del nami i keq, e dënon opinionin, frikë që e ka burimin në botëkuptimet e vjetra, bën që me fjalë asaj t'i jepet liri, por, në fakt, për vajzën nuk ka liri të njihet dhe të zgjedhë atë që do. Ky është një problem shumë serioz. Në të parë duket sikur gabon po të thuash se prindi nuk ka të drejtë të qederoset, pse në realitet ai ka të drejtë dhe duhet të ketë të

drejtë të qederoset, por as në parim dhe as në praktikë prindi nuk ka të drejtë t'i zhdukë lirinë dhe të drejtat vajzës së tij. Vajzën ai duhet ta edukojë me frymën e re për të luftuar në jetë, për të kapërcyer vështirësitë, t'i kuptojë dhe t'ia shpjegojë rreziqet që mund t'i turren në jetë, të jetë me të jo një prind patriarkal, por një prind revolucionar, jo një prind që të ketë frikë dhe turp mikroborgjez që t'i flasë vajzës ç'është dashuria proletare, bile edhe më parë se ajo të ketë rënë në dashuri me ndonjë djalë që ka njohur. Prindi duhet ta ndihmojë vajzën për kapërcimin e vështirësive të jetës, pse jeta nuk është e shtruar kurdoherë me lule, ta ndihmojë në mënyrë që vajza të shohë te prindi njëkohësisht një shok dhe jo vetëm një qortues dhe një diktator të egër.

Disa thonë se të rinjtë «më parë se të martohen, duhet të njihen». Por të gjithë nuk e kuptojnë njëlloj këtë fjalë me një kuptim të madh. Konservatorët mendojnë se mjafton të njihen nga fytyra dhe kjo mund të bëhet një mëngjes në rrugë o nga penxherja dhe kështu, po u pëlqyen nga «kashta», mund të martohen dhe, më parë se të bëjnë shaka, të dalin shëtitje në rrugë, në ndonjë park, apo të venë në kinema, duhet të fejohen zyrtarisht, domethënë të bëjnë celebrimin, me fjalë të tjera të martohen. Të bukur të njohur! Pak ndryshim ka nga ajo kohë, kur martoheshin «si derri në thes».

Por ekziston edhe ekstremi tjetër, ku hyjnë ata të rinj (që, për fat të mirë, për arsye të punës dhe të edukatës së shëndoshë të familjes, të organizatës së rinisë dhe asaj të Partisë, janë të paktë) që njohjen para

martesës e kuptojnë në mënyrë liberale, lisencioze¹, karakteristika këto të degjenerimit borgjez e mikro-borgjez. Kësaj Partia, rinia, opinioni duhet t'i shpallin një luftë të paprerë politiko-ideologjike.

Ekziston edhe njohja e vërtetë, e ndershme, proletare, e sigurtë, e çlirët në mes të të riut dhe të së resë. Një njohje e tillë nuk është aspak e domosdoshme të bëhet me qëllime martesë. Kjo njohje normale, kjo jetë normale, takimet e hapëta e të përzemërta janë shprehja logjike dhe natyrore e dashurisë në mes njerëzve në shoqëri, janë vazhdimi i asaj dashurie të pastër e të sigurtë të feminisë, të moshës së mitur, por këtë herë një dashuri akoma më e zjarrtë, pse piqen gjykimet, hapen horizontet e jetës, zgjerohen sferat e bashkëpunimit, ku duhet të forcohen akoma më shumë dashuria dhe uniteti me njëri-tjetrin. Nga një njohje e tillë në jetë e në punë lind edhe ajo dashuri e natyrshme që e çon çiftin në bashkimin e tyre, në martesë.

Mirëpo këtu ngatërrohen punët dhe në këtë drejtim duhet të ndërmerrem një edukim serioz në Parti, në rini dhe në popull që t'i sqarojmë pikëpamjet që do të them më poshtë. Cilat janë këto pikëpamje që duhen sqaruar?

Pikërisht duhet të luftohen ato pikëpamje anti-marksiste, borgjeze, lisencioze e poshtëruese për gruan dhe për burrin, sipas të cilave, «gruaja është e destinuar vetëm për krevat dhe burri në jetën e tij nuk ka për objekt tjetër veçse të kërkojë gruan, cilëndo grua, për të shuar epshet e tij seksuale». Ata që kanë

¹ Nga frëngjishtja — të shturur.

pikëpamje të tilla s'janë njerëz, por kafshë, ata nuk mund të kuptojnë ç'do të thotë sentiment, ndjenjë, zemër, ç'do të thotë dashuri e vërtetë që lidh burrin me gruan, nuk mund të kuptojnë lidhjet miqësore në shoqëri të burrave dhe të grave me njëri-tjetrin, nuk mund të kuptojnë zhvillimin normal të jetës dhe të njohjes së të rinjve e të rejave. Ata kudo, në çdo veprim të pastër të burrave e të grave, shohin «dashuri» seksuale jashtë çdo ligji, jashtë çdo norme. Borgjezia ka kaluar në degjenerim, por konservatori ynë patriarkal, mikroborgjez, që ëndërron kohën e kaluar, kur gruan dhe vajzën e mbyllte në kafaz, e rrihte, e shiste, e ndante dhe e vriste, tashti që këto nuk i bën dot. (por që në mendjen e tij i quan si kulmin e drejtësisë, të nderit të gruas e të fisit), demokracinë, lirinë dhe të drejtat e gruas i quan shthurje dhe, sipas pikëpamjes së tij, prishje të moralit.

Askush të mos e nënvleftësojë rrezikshmërinë e bartësve të këtyre pikëpamjeve, pse ka edhe nga këta. Ata denigrojnë me thashethemet e tyre, ata frenojnë shoqërinë të ecë përpara.

Shihni! Influenca e kujt është që akoma ka pak martesë në mes të të rinjve e të rejave me ish-fe të ndryshme? Mos e kanë fajin të rinjtë? Jo, në asnjë mënyrë! Shihni! Ka të rinj e të reja që s'martohen me njëri-tjetrin, pse janë nga një fshat, megjithëse mund të jenë 20 breza larg, në mos dhe më shumë¹. Mos e kanë fajin për këtë të rinjtë? Jo, në asnjë mënyrë!

¹ Këtu ka parasysh të dhënat që ishin paraqitur në mbledhjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror të Partisë.

Partia do t'i mbrojë me të gjitha forcat e saj të rejtat dhe të rinjtë dhe të gjithë e dinë se ç'forcë kolosale është Partia. Prandaj faji duhet kërkuar dhe luftuar gjatë, në ideologjinë reaksionare.

Shihja një ditë disa statistika të divorceve. Ato nuk ishin aspak shqetësuese. Kishte edhe të divorcuar të rinj. Por më të shumtat e divorceve ishin të njerëzve të pjekur. Konservatorët, pra, të mos ia vënë menjëherë fajin papjekurisë, kjo mund të ngjasë, pse mund të mos jenë njohur mirë, ose mund t'u kenë ndodhur aksidente në jetë etj. Asgjë nuk mund të idealizohet. Por në qoftë se familja, shkolla, organizata e rinisë dhe ajo e Partisë nuk i edukojnë jo vetëm të rinjtë, por edhe të moshuarit, në radhë të parë, si të trajtojnë ndjenjat e pastra të të rinjve, t'i kanalizojnë ato në rrugë të drejtë, divorce mund të ketë edhe më shumë.

Ç'ngjet? Të rinjtë dhe të rejtat dëshirojnë të zhvillojnë një jetë normale, por që në shëtitjen e parë u ngjitin bishtra, opinioni i fejon, në një kohë kur atyre as që u ka shkuar akoma në mendje një gjë e tillë. Mirëpo kjo është me shumë zarar, pse i riu dhe e reja kanë të drejtë të piqen edhe me shokë e me shoqe të tjera. Opinioni i sëmurë aty i fejon, aty i ndan, sipas qejfit, duke shpifur një mijë gjëra, për vajzën në radhë të parë. Djali cilësohet vagabond, vajza imorale. Këto venë në vesh të prindit, të cilit i ngjallen ndjenjat e vjetra dhe detyron vajzën të mos dalë, e rreh atë dhe i rekomandon edhe burrin e ardhshëm. Këto rrethana e detyrojnë vajzën që, për t'u pjekur me atë që do dhe për t'u ruajtur nga opinioni i sëmurë e nga babai,

pjekjen ta bëjë natën, në një vend larg atyre që e njohin, të përdorë shumë stratagjema¹.

Ç'tragjedi i krijohet rinisë nën petkun e njëfarë morali që nuk është yni, nën presionin e një opinioni të sëmurë, të përpunuar nga thashethemet e neveritshme. Nga një anë, Partia dhe pushteti me forma të drejta përpigën të krijojnë atë ambient të ngrohtë shoqëror pune, ku njerëzit të rrojnë në dashuri dhe në shoqëri, nga ana tjetër, janë gjithë këto mbeturina mikroborgjeze që influencojnë në të kundërtën. Dhe e keqja është se ka edhe komunistë që bien me dashje o pa dashje në këto pozita prapanike. Nga këto pozita prapanike lindin pa asnjë bazë shpifje, thashetheme, skena mërie, zemërimi, xhelozie të pabazuar, divorce, deri edhe krime. Nga pozita të shëndosha partie duhet t'u hapim breshëri zjarri të gjitha këtyre të këqijave që dëmtojnë shoqërinë tonë, që hidhërojnë jetën e lumtur e të gëzuar të të rejave dhe të të rinjve tanë. Të mos i lëmë barërat e këqija të hedhin shtat, po t'i shkulim nga rrënjët.

Do të jetë gabim dhe jorealiste të thuhet se në shoqërinë tonë nuk ngjasin edhe gjëra të papëlqyera, veprime të dënueshme nga ligjet. Të mos mbyllim sytë, dhe ne nuk i mbyllim, para këtyre fenomeneve negative, këtyre plagëve e njollave që ka trashëguar nga e kaluara shoqëria jonë.

Duhet t'i kuptojmë mirë momentet që po kalojmë, të cilat po i analizon orë e çast Partia në të gjitha aspektet dhe përpigjet jo pa sukses t'u japë problemeve

1 Nga frëngjishtja — mënyra të tjera, marifete.

zgjidhje të drejtë. Të mos harrojmë se sapo kemi dalë nga një etapë e vështirë, e errët, ku problemet shoqërore kuptoheshin dhe zgjidheshin ndryshe nga sot. Me luftë e me revolucion kaluam etapat shekullore të errësirës feudalo-borgjeze, të fashizmit dhe dolëm në socializëm. Transformime të mëdha janë bërë tani në vendin tonë dhe në njerëzit tanë. Megjithatë faqja e tokës mund të ndërrohet më shpejt, kurse 25 vjet janë pak, bile shumë pak, për të çrrënjosur mbeturinat e mbrapshta të së kaluarës nga ndërgjegjja e krejt njerëzve tanë. Prandaj Partia jonë vazhdon me vrull dhe do ta vazhdojë edhe në të ardhmen e kurdoherë revolucionarizimin e njerëzve dhe të jetës së të gjithë vendit.

Duhet ruajtur vija që solli sukseset që kemi arritur në punë e në jetë nga çdo pikëpamje fetishiste, fataliste ose idealiste, pse nocione të tilla nuk të armatosin kundër vështirësive të jetës dhe të luftës. Jeta nuk ecën si diçka e fjetur dhe ideale, po zhvillohet në mënyrë revolucionare, në luftë me të kundërtat. Lufton e reja që lind, me të vjetrën që vdes e kështu ngjasin vazhdimisht hope cilësore. Ka njerëz që mbërthehen nga e vjetra dhe e quajnë atë «kulmi i përsosmërisë». Mirëpo, duke menduar kështu gabim për disa çështje, ata kanë deziluzione, i adaptohen me zor së resë, më të përparuar, më revolucionare, ose i vihen asaj kundër.

Ligjin e dialektikës, ligjin e revolucionit s'ka forcë në botë që ta shtypë dhe ta zhdukë, ai vepron edhe jashtë vullnetit të njeriut. Partitë marksiste-leniniste këtë ligj e kanë të tyrin, dialektika materialiste është filozofia e tyre.

Situatat u poqën dhe Partia Komuniste e Shqipë-

risë do të formohej kundër vullnetit të fashizmit, të reaksionit dhe terrorit të tij. Lufta Nacionalçlirimtare do të pëlciste dhe populli do të ngrihej në revolucion, donte apo nuk donte «xha Emrushit», por ky e deshë Luftën Nacionalçlirimtare, rrëmbeu pushkën dhe, nën udhëheqjen e Partisë, luftoi okupatorët dhe Shqipëria u çlirua. Partia e respekton dhe e nderon «xha Emrushin». Por nuk mund të kuptohet liria e Shqipërisë pa lirinë, pa emancipimin e gruas shqiptare, pa ia dhënë asaj *de jure* e *de facto* të gjitha të drejtat. «Xha Emrushit» duhet të jetë konsekuent, duhet të ndjekë revolucionin. Në qoftë se nuk i kupton këto gjëra, Partia të bëjë përpjekje të mëdha që ai t'i kuptojë; në qoftë se nuk është i bindur, ta bindim; në qoftë se nuk bindet, ta neutralizojmë; në qoftë se, më në fund, ai ngre dorën kundër revolucionit, atëherë diktatura e proletariatit e shtyp. Këtë shembull impersonal e solla për të treguar se e reja përparimtare i lufton këta.

Për komunistët, për të rinjtë e të rejat, për gjithë popullin tonë çështja vihet që këtë ligj të dialektikës ta kuptojmë si vepron në fenomenet e zhvillimit dhe si duhet ta zbatojmë konkretisht në të gjitha shfaqjet e tij në jetë. Gjatë kalimit nga një etapë e shoqërisë në një tjetër, siç ndodhi te ne me ndërtimin e socializmit, me zbatimin e reformave të mëdha, me sukseset e arritura, ne kemi hasur, hasim dhe do të hasim edhe në kontradikta që lindin nga lufta e domosdoshme e klasave, nga lufta e të kundërtave, nga lufta e pikëpamjeve marksiste-leniniste kundër pikëpamjeve idealiste, nga lufta e së resë që lind e rritet, kundër së vjetrës që perëndon dhe vdes.

Komitetet e Partisë dhe gjithë Partia duhet t'u vënë një rëndësi shumë të madhe, edhe më shumë se ç'u kanë vënë deri tani, shpjegimeve konkrete të këtyre ligjeve kapitale të teorisë sonë, të shpjegojnë luftën e të kundërtave, të sqarojnë mirë e me durim problemet e mëdha shoqërore, të mos i trajtojnë ato përciptas dhe në rrugën idealiste e patriarkale, por në rrugën e re të proletariatit dhe të dialektikës materialiste.

Kudo ka filluar studimi sistematik e me kujdes të madh i Historisë së Partisë sonë. Kjo është shumë e mirë. Por studimi i Historisë së Partisë nuk mund të mbarojë në një kohë të shkurtër dhe, kështu si është filluar, ka rrezik të lihet ca mënjanë studimi i veprave të klasikëve të marksizëm-leninizmit dhe i dokumenteve të shumta aktuale të gjera të Partisë sonë që i duhen asaj për luftën e përditshme. Këto dokumente në Historinë e Partisë së Punës të Shqipërisë, natyrisht, janë përmbledhëse dhe vijnë në kapitujt e mëvonshëm. Prandaj duhet bërë kujdes në këtë drejtim që, nën pretekstin se studiohet Historia e Partisë, të mos lihen mënjanë veprat e klasikëve të marksizëm-leninizmit dhe dokumentet e Partisë. Ne duhet të bëjmë përpjekje të mëdha të tërë, që të gjitha këto t'i kuptojmë thellë dhe të mundohemi t'i zbatojmë drejt.

*

* *

Sot nuk kisha në mendje të flisja, sepse kam folur edhe disa herë të tjera për këto probleme, por më shtyu një ngjarje shumë e dhimbshme dhe tragjike që

ndodhi muajin e kaluar në Tepelenë. Dy udhëheqës të rinisë, shoku Qazim Shehu, sekretar i parë i komitetit të rinisë dhe anëtar i plenumit të komitetit të Partisë, tjetra Xhevahire Sinaj, anëtare e byrosë së komitetit të rinisë të këtij rrethi dhe përgjegjëse e pionierëve, vranë veten. Kjo është drama.

Përse e vranë veten? Ata lanë një letër për Partinë, plot dashuri, besim dhe besnikëri për të, por nuk duruan dot fjalët e poshtra që ishin hapur për ta në opinion (caktojnë edhe autorët e këtyre shpifjeve), se ata gjoja dashuroheshin me njëri-tjetrin. Ata pohojnë se ishin vetëm shokë pune dhe lufte, se djali do t'ia propozonte këtë shoqe të vëllait të tij që të fejojeshin. Këtë e vërteton edhe letra e gjetur që është shkruar prej tyre. Djali ishte i martuar dhe kishte tre kalamanë, vajza ishte e pamartuar. Një nga shpifësit, Hekuran Aliaj, bile anëtar partie, që ishte fejuar dhe ka lënë një rënë pas tjetrës shtatë vajza e më në fund ndau edhe gruan, kishte marrë guximin dhe kishte shkuar deri te sekretari i Komitetit të Partisë të Rrethit të Tepelenës dhe i kishte denoncuar këta dy shokë të rinisë për veprime gjoja amorale, dhe sikur gjoja i kishte parë vetë me sytë e tij. Shoku sekretar e thirri kolegun e tij të rinisë dhe ky i tha se gjithë këto që thuhën janë shpifje të poshtra. Këto ishin fjalët e shokut të rinisë, të cilat vërtetohen plotësisht se ishin të drejta. Mirëpo shpifjet vazhduan e vazhduan, dhe disa shokë të byrosë së komitetit të Partisë, në vend që të merrnin masa kundër shpifësve e t'i shqetësonin këta, morën masa transferimi për dy të rinjtë,

të cilët, të bindur te Partia, e pranuan transferimin.

Më vonë plasi drama, të rinjtë e mjeruar humbën perspektivën, i mbuloi dëshpërimi. Duhet theksuar se këta shokë të rinisë luftuan vetë me vendosmëri kundër shpifjeve, por disa shokë të byrosë së komitetit të Partisë të rrethit që ishin në dijeni, nuk i ndihmuan të dilnin nga kjo situatë shumë e vështirë, përkundrazi, ata dyshonin në ta, bile edhe i gjurmuan jashtë çdo rregulli e norme partie. Kështu ata zgjodhën rrugën e gabuar, vranë veten, pasi lanë një letër të shkruar nga të dy.

Ja, shokë, një nga format më barbare e më dinake që përdor armiku i klasës për të luftuar Partinë, për të luftuar njerëzit e mirë të saj. Armiku shpifi sa mundi, mbushi botën me thashetheme dhe dy luftëtarë të vendosur të së resë, fëmijë besnikë, që Partia i kishte rritur me kaq kujdes e dashuri, i çoi në vetëvrasje. Dhe këta vrasës të maskuar shëtitin të lirë, mundet që ndonjëri mban akoma teserën e Partisë në xhep. Hekuran Aliaj, shpifësi kryesor, i cili u arrestua tani vonë, pohoi me gojën e tij përpara prokurorit se asgjë s'kishte parë, po kishte shpifur.

Si e trajtuan byroja e Komitetit të Partisë të Rrethit të Tepelenës dhe sekretari i saj këtë problem, si përpara ngjarjes, ashtu edhe pas saj? Meriton shumë të ndalemi dhe të nxjerrim mësimë nga kjo ngjarje e dhimbshme. Unë po bazohem në të dhënat e dokumentet që disponojmë. Para ngjarjes byroja e nënvleftësoi këtë ndodhi, ajo është njaftuar me ç'i ka thënë njëri e tjetri; shpifësit e llafazanët asgjëkundi nuk duket t'i kenë shqetësuar në punën e tyre minuese dhe anti-

parti që kanë bërë kundër dy udhëheqësve partie dhe rinie të rrethit. Përkundrazi, disa udhëheqës kryesorë të byrosë, pa asnjë fakt, pa asnjë provë, kanë dyshuar deri në fund te shokët e shëndoshë të rinisë.

Më vonë shohim që këta dy të rinj, udhëheqës besnikë e të zot, transferohen. Ka ndonjë gjë të keqe në transferim? Zakonisht jo, po në këtë rast ka. Këta transferohen se kanë dalë fjalë për ta, pra është gjetur mënyra më e keqe, që, ndërsa thashethemet për kuadrot i lënë të qarkullojnë lirisht, këta dy kuadro i transferojnë, domethënë këta që më parë i dënojnë politikisht, duke i dhënë indirekt të drejtë opinionit që përpunon armiku i klasës. Të shmangesh që të përballosh me luftë politike të hapët në opinion armikun e klasës, i cili po t'i diskrediton Partinë dhe kuadrot me metoda lufte dinake e dhelparake, luftë që në fakt e bënë me kurajë bolshevike të dy të rinjtë, dhe të marrësh masa të tërthorta, e sidomos kur Partia dhe kuadri sulmohen dhe shpifet kundër tyre pa asnjë arsye dhe bazë, kjo formon faj, është një gabim i madh politik dhe tregon se lufta e klasave jo vetëm nuk bëhet si duhet, por as kuptohet si duhet.

Mirëpo e keqja tjetër qëndron në atë që byroja e Komitetit të Partisë të Rrethit të Tepelenës dhe sekretari i saj arritën të influencoheshin nga opinioni i përpunuar, ata nuk ishin të bindur dhe nuk u besuan shokëve të tyre të rinisë. Ky është konkluzioni që nxjerr unë nga gjithë zhvillimi i ngjarjeve, nga veprimet e shokëve.

Mendoj se shokët e udhëheqjes së rrethit, në rast se do t'u kishin thënë shokëve të rinisë që «Ju s'keni

asnjë faj, prandaj t'i përvishemi luftës për t'i dërrmuar këta armiq dinakë», të rinjtë nuk do ta vritnin veten jo vetëm se ishin të pafajshëm, por edhe sikur ndonjë gabim të kishin bërë, Partia, që i do si fëmijët e vet, ashtu si janë, me të mira e me gabime, ata që bëjnë gabime i shëron, i ndreq, i bën luftëtarë të mirë si dhe të tjerët.

Kur pas pesë ditësh u zbuluan drama dhe kufomat e të dy shokëve tanë të mjeruar, shokët e byrosë së Komitetit të Partisë të Rrethit të Tepelenës, me sekretarin e saj në krye, e humbën gjakftohtësinë, humbën gjykimin e matur e të pjekur komunist dhe ranë në gabime akoma më të rënda. Është e hidhur të thuhet, por është fakt se ata ranë dashur pa dashur në pozitë e armikut të klasës.

Cilat ishin synimet e armikut të klasës në këtë çështje dhe në këto momente të revolucionarizimit të vrullshëm të Partisë dhe të masave? Të diskreditojë Partinë, të diskreditojë rininë, të pengojë revolucionarizimin, të pengojë emancipimin e gruas, të diskreditojë ata që luftojnë për këto gjëra të shenjta. Ç'donte të thoshte armiku i klasës me këtë rast? «Ja, ç'do të thotë emancipim i gruas, i rinisë! Korrupsion! Dhe kush e udhëheq këtë korrupsion? Partia, rinia!» Kështu foli armiku i klasës për këta dy militantë.

Po shokët e komitetit të Partisë ç'bënë? Si reagon? Ata me një mendjelehtësi të madhe dhe të habitshme ndihmuan armikun e klasës, i dhanë atij të drejtë, forcuan në mënyrë indirekte pozitë e tij në opinion, pse dënuan në mënyrë tragjike dhe pa të drejtë birin dhe bijën besnike të Partisë që i lindi, i

rriti, i bëri luftëtarë të shquar të një çështjeje të madhe. Shokët e Tepelenës këta luftëtarë të vendosur të kësaj kauze të madhe i quajtën «tradhtarë dhe armiq të Partisë e të popullit». Ky cilësim i urryer figuron në dokumentin zyrtar që iu dërgua Komitetit Qendror të Partisë nga byroja e Komitetit të Partisë të Rrethit të Tepelenës.

Por s'mjaftoi me kaq, kufomave të dy të rinjve, të rënë nga plumbat e shkaktuar nga puna e armikut të klasës, në zemrat dhe në dejt e të cilëve disa ditë më parë vlonte një dashuri e zjarrtë për Partinë dhe për popullin, disa shokë të byrosë së komitetit të Partisë të rrethit u futën edhe predhën e fundit «atomike», i mbyllën në dy kashune, i hodhën në një kamion dhe ua çuan prindërve, gruas, motrave e vëllezërve të tyre, ish-partizane dhe anëtarë partie.

Ah! Jo, shokë të Tepelenës, kjo është e padurueshme, kjo është e dënueshme. Më falni, po në këto momente që flas, jam shumë i emocionuar, pse jam komunist dhe zemra më qan për këta dy shokë të rinisë që humbëm, për shogën Xhevahire dhe shokun Qazim. Megjithatë, ju siguroj se nuk prirem nga emocionet, por ju ju gjykoj rreptësisht dhe me gjakftohtësinë më të madhe. Unë udhëhiqem nga parimet dhe nga logjika e shëndoshë marksiste-leniniste e Partisë sonë, pse ju konsideroj si shokë, pse jeni komunistë, ju kritikoj rreptë dhe ju këshilloj të mos bini kurrë më në të tilla gabime të rënda. Për të mos rënë në të tilla gabime dhe në çfarëdo lloj gabimi tjetër, të çdo natyre qoftë, duhen analizuar shkaqet dhe rrethanat e thella që e kanë shkaktuar gabimin dhe jo vetëm ato të sipërfaq-

shmet. Nuk mjafton, gjithashtu, «të jesh i penduar, ta ndiesh veten sinqerisht se je fajtor» dhe me këtë të mendosh se nuk do të gabosh më.

Për një komunist është, gjithashtu, tmerrësisht e gabuar që, pas një gabimi, atë ta mbulojë dëshpërimi, pesimizmi, saqë disa herë të vejë deri në aktin e marrë, të palejueshëm për kurrkënd, në vetëvrasje. Në vendin tonë socialist, ku udhëheq një Parti marksiste-leniniste kaq e drejtë, kaq e dashur me popullin dhe me njerëzit, kaq e kujdesshme për të zgjidhur me drejtësi, urtësi e kujdes kur duhet, deri edhe problemet më të vogla, duhet të zhduket akti i vetëvrasjes. Ai nuk është një akt që zgjidh gjë drejt, nuk është një akt moral.

Disa që i bëjnë apologjinë këtij akti të dënueshëm, e quajnë «të guximshëm, pse duhet të jesh trim që të vrasësh veten». Jo, nuk është ashtu, në fund të analizës vret veten ai që humbet gjykimin, që humbet perspektivën, që lodhet nga lufta, që e mbulojnë pesimizmi, dëshpërimet etj., që i mungon guximi të vazhdojë luftën. Trim është ai që i përballon situatat e vështira të jetës dhe jo ai që bën një akt të tillë për të shpëtuar nga këto vështirësi. Pra, këtu janë dy gjykime të kundërta, këtu përpiqen dhe janë në luftë pikëpamjet idealiste, fataliste me pikëpamjet materialiste, marksiste-leniniste.

Edhe te komunistët zhvillohet një luftë e pandërprerë në ndërgjegjen e tyre, luftë që udhëhiqet nga ideologjia e Partisë për të çrrënjosur pikëpamjet idealiste o fataliste ose mbeturinat e tyre që ekzistojnë akoma, që manifestohen në shumë raste e në shumë

forma, herë të acaruar, herë më pak të acaruar, por që kurdoherë ngrenë veshët te njerëzit e papërgatitur ideologjikisht.

Jo të gjithë ata që vrasin veten janë dhe mund të quhen tradhtarë ose armiq të popullit dhe të Partisë, në rast se nuk vërtetohet që vetëvrasja ka pasur për shkak të vërtetë krimin e tradhtisë, i cili dënohet nga ligjet e vendosura nga shteti i diktaturës së proletariatit.

Kur Partia thotë se e dënon aktin e vetëvrasjes, këtë ajo e ka kuptuar dhe e ka zbatuar kurdoherë drejt, domethënë nuk është dakord me aktin e vetëvrasjes dhe me pikëpamjet ideologjike që e frymëzojnë dhe e çojnë njeriun në këtë akt.

Partia kurrë nuk e ka cilësuar si tradhti aktin e vetëvrasjes, kur personi që e ka kryer atë nuk ka qenë as tradhtar, as armik.

Shtrohet pyetja: Mos vallë shokët e Tepelenës i ka çuar në gabim termi «vetëvrasjen e dënon Partia» dhe meqë atë e «dënon» Partia, atëherë mund ta quajmë edhe «tradhti», edhe kur humbasim krejt gjakftohtësinë dhe kur viktimat janë krejt të pafajshme?

Jo, ky mendim s'ka baza, këto janë arsye të sipërfaqshme, që mund të përdoren për të fshehur fajin. Shokët e Tepelenës nuk mund t'i ketë çuar në gabim termi «Partia e dënon vetëvrasjen», sepse ata janë udhëheqës partie, kanë eksperiencë partie dhe ekzistojnë shembuj konkretë se si i ka trajtuar Partia këto raste edhe ideologjikisht, edhe në praktikë.

Nga ana tjetër, termat «Mori dënim nga Partia», «Këtë shok e dënoi Partia» janë terma që përdoren në

nomenklaturën e Partisë dhe që, në fakt, janë një gamë këshillash morale, edukative dhe shëruese që u jep Partia atyre anëtarëve që gabojnë gjatë punës. Dhe kjo është e natyrshme, dialcktike, pse ka nga ata që bëjnë gabime.

Dënimi më i rëndë për një anëtar partie është përjashtimi nga Partia. Por edhe ata që janë përjashtuar ose që përjashtohen nga Partia, nuk janë tradhtarë apo armiq të Partisë dhe të popullit. Bëjnë përjashtim ata që në bazë të fakteve, provave e gjykimeve të drejta të Partisë, janë cilësuar elementë antiparti, tradhtarë të Partisë dhe të popullit. Kategoria e parë e të përjashtuarve kanë qenë njerëz që vazhdimisht kanë pasë përsëritur gabime të ndryshme, për të cilët janë bërë përpjekje të ndreqen, të edukohen, po ka qenë e pamundur, prandaj edhe nuk e meritonin të militonin në radhët e Partisë. Por prapë dhe prapë e deri në fund Partia kujdeset dhe e ka për detyrë të kujdeset për ta dhe, ashtu si me gjithë njerëzit, edhe me këta, ajo ka korrur rezultate të mira.

Pra, nuk është termi që i ka bërë shokët e Tepelenës të gabojnë. Shokët udhëheqës të organizatës së Partisë të rrethit të Tepelenës dhe mjaft komunistë, me gjithë punën dhe luftën e madhe që zhvillojnë çdo ditë e çdo orë nën udhëheqjen e Partisë, me gjithë sukseset që kanë në punë, me gjithë dashurinë dhe besnikërinë e zjarrtë për Partinë, kanë nevojë të madhe të bëjnë shumë përpjekje për zhvillimin e tyre teorik.

Zhvillimet e mëdha shoqërore që po bëhen me vrull në vendin tonë, udhëhiqen nga disa ligje objek-

tive të dialektikës materialiste, të cilat duhet të njihen dhe të zbatohen sa të jetë e mundur me korrektesë, duke u bazuar në realitetin konkret të vendit. Vetë shoqëria jonë, sipas këtyre ligjeve objektive materialiste, është në zhvillim të madh e të përhershëm nga ana materiale, ekonomike, shoqërore dhe shpirtërore. Të gjitha këto nuk qëndrojnë në vend, lëvizin drejt përmirësimit, drejt përsosjes, me luftë, me revolucion, derisa të ndërtohet shoqëria komuniste, shoqëria pa klasa. Por jemi akoma shumë larg kësaj epoke dhe këtë e kemi shpjeguar edhe herë të tjera.

Por këtu e kam çështjen në atë që shokët e Tepele nës (dhe në këtë drejtim ka edhe shokë të tjerë) nuk i kuptojnë si duhet teorikisht këto zhvillime të mëdha shoqërore, këto rrokullisje revolucionare në shoqëri, në ekonomi, në Parti, në ndërgjegjen e njerëzve që mbështeten në parimet marksiste-leniniste që u kanë mësuar Partia dhe lufta. Tek ata ngjallen doza pak a shumë të theksuara idealiste që e kanë burimin tek e vjetra që përmbysët, te mungesa e perspektivës, të cilën duhet ta hapë thellimi në studimin e teorisë sonë marksiste-leniniste, e kanë burimin te kuptimi i cekët, te kënaqësia dhe idealizimi i asaj që është arritur, por që nuk rri në vend, lëviz dhe duhet ta shtysh përpara e ta ndjekësh me konsekuencë. Më në fund ajo e ka burimin te kuptimi jo i drejtë i ligjeve, i normave marksiste-leniniste të Partisë sonë, që janë pasqyrimi dhe shprehja besnike e filozofisë dialektike materialiste, të Partisë që vepron sipas ligjeve dhe normave antiidealiste, të cilat ndjekin këmba-këmbës dhe frymëzojnë këto rrokullisje të mëdha revolucionare.

Në mosthellimin sa duhet në këto probleme teori-ke ne do të gjejmë shkaqet e të metave dhe të gabime-ve tona. Po të bëjmë kujdes më shumë, gabime do të bëjmë edhe më pak, por gabime ne do të bëjmë për-sëri dhe këto i ka parashikuar Partia, të mos biem në idealizma. Prandaj, duke bërë analizat e këtyre çësh-tjeve nga ana teorike, ju shokë të Tepelenës do të gje-ni shkaku që ju shtyu në gabimin që bëtë. Komiteti i Partisë dhe e gjithë organizata e Partisë e rrethit të Tepelenës duhet të ndalen veçanërisht në luftën kun-dër sedrës së sëmurë mikroborgjeze, kundër tendencave të rrezikshme të patriarkalizmit prapanik, kundër mbeturinave fetare, që shfaqen në formën e fatalizmit, fetishizmit etj., të luftohen të gjitha mburrjet e veça-nërisht ato që frymëzohen nga pikëpamje idealiste, mistiko-fetare ose interesa personale thjesht mikrobor-gjezë, të luftohen ndjenjat e sëmura të lokalizmit dhe të familjaritetit, pse ato pjellin ksenofobinë¹. Jo vetëm që këto probleme duhet të shtrohen publikisht me rastin e analizës që do t'i bëni kësaj ndodhie në Parti, të qortohen, të ndreqen njerëzit dhe të dënohen të pandreqshmit, por këto duhet të studiohen thellë teo-rikisht nga Partia si probleme të mprehta dhe me rën-dësi.

Mendoni, jo vetëm që ata dy shokë të rinj, që vra-në veten, ishin krejtësisht të pafajshëm, por në jetën e Partisë sa gabime keni hasur në njerëzit! U ndodh kjo njerëzve, shokë të Tepelenës, po njerëzit ndreqen,

¹ Urrejtje ndaj çdo gjëje të huaj; këtu ka kuptimin e përçmimit të njerëzve që s'janë nga e njëjta krahinë.

shërohen. Partia, vija e saj, logjika e saj ata i ndihmon, i shpëton dhe kjo është në nderin e Partisë dhe të njerëzve.

Me vendimin që morët ndaj këtyre dy të rinjve, ju ishit të bindur se «mbronit» Partinë, «mbronit nderin» e Partisë, po vepruat me mentalitetin e mykur të atyre gjyshërve që, për të mbrojtur nderin e fisit, zbatonin kanunin. Por a menduat ju se ç'dëm mund t'i silllet zhvillimit të lirë të gruas në ato krahina, lirisë dhe demokracisë së vërtetë, kuadrove? A nuk menduat ju se nga ky veprim i gabuar juaji do të mbeten gjurma në gratë dhe në vajzat e Tepelenës dhe këto mund të jenë më të ndrydhura për të dalë pa druajtje dhe pa frikë tok me djemtë dhe burrat në ara, në fabrika, në shkolla, në klube e në kinema? A e menduat ju se, pas kësaj që bëtë, do të gjenit aq lehtë si përpara vajza që të bëhen drejtuese të pionierëve, që puna dhe jeta i lidh me djem vazhdimisht, natën dhe ditën, në rrugë e pa rrugë? Jo, ju nuk menduat fare për këto. Përkundrazi, menduat si konservatorë të regjur, por të jeni të sigurt se këto mendime tuajat as Partia, as rinia, as populli përparimtar e liridashës i rrethit të Tepelenës nuk jua pranojnë. Si mendoni ju, do ta ndaloni dashurinë e lirë e të vërtetë, apo do të ktheheni në të vjetrën, në fejesën me shkesë e me duvak? Jo, natyrisht, Partia nuk ndalet, revolucionin nuk ndalet, rrota e tij do t'i shtypë ata që e pengojnë. Populli patriot i Tepelenës është me Partinë, me revolucionin, ai do të ecë përpara akoma më me vull.

Kuptohet, dhe, si konkluzion, unë nuk jam aspak dakord as me mendimet, as me vendimin e byrosë së

Komitetit të Partisë të Rrethit të Tepelenës për këtë çështje. Unë fola këtu duke u bazuar në dokumentet që ekzistojnë në Komitetin Qendror për këtë problem. Vendimi juaj është i padrejtë dhe duhet dënuar rëndë. Të dy të rinjtë duhet të rehabilitohen publikisht, të varrosen si komunistë viktima. Për shpifësit duhet të merren masa të rënda partie dhe ligjore.

Propozoj që të mblidhet Komiteti i Partisë i Rrethit të Tepelenës, të rishqyrtojë fund e krye çështjen, të nxjerrë përgjegjësitë e shokëve, të marrë vendimet e duhura dhe këto t'ia komunikojë Komitetit Qendror.

Botuar për herë të parë në broshurën: Enver Hoxha. «Të drejtat dhe liritë e gruas dhe të rinisë të kuptohen thellë e të mbrohen nga të gjithë». Tiranë, 1969

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1969-1970», f. 134. Tiranë,
1970*

**PUSHTETI YNË, I NGRITUR ME GJAKUN
E POPULLIT, DREJTOHET NGA VETË MASAT
PUNONJËSE**

*Fjala në drekën e shtruar në Berat me rastin
e 25-vjetorit të formimit të Qeverisë Demokratike
të Shqipërisë*

22 tetor 1969

Të dashur shokë dhe shoqe,

Në emër të Komitetit Qendror të Partisë, të Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe të Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë, dëshiroj me këtë rast të falënderoj nga zemra popullin luftëtar të Beratit, i cili, si në kohën e luftës, edhe tash gjatë ndërtimit të socializmit, na ka pritur dhe vazhdon të na presë me një bujari e përzemërsi të veçantë, prandaj këtu e kemi konsideruar veten kurdoherë si në shtëpinë tonë.

E fillova fjalën me falënderimin për mikpritjen, meqenëse një gjë e tillë është bërë zakon në vendin tonë, por, duke marrë parasysh se të gjithë ne jemi bijtë e bijat e popullit dhe ngjarja e shënuar që për-

kujtojmë i përket mbarë popullit shqiptar, nuk ka vend për falënderime, mendoj unë, pavarësisht se zakoni për të falënderuar në raste të tilla është i mirë.

Megjithatë duhet vënë në dukje se, në momentet e vështira të Luftës Nacionalçlirimtare, populli heroik i Beratit luftoi si gjithë populli shqiptar me armë në dorë, bijat e bijtë e tij më të mirë mbushën çetat partizane, ndoqën me besnikëri dhe me vetëmohim Partinë e lavdishme Komuniste dhe një numër i madh prej tyre ranë dëshmorë, duke kontribuar kështu me gjakun e vet për çlirimin e plotë të atdheut nga pushtuesit e huaj, nga feudalët dhe nga borgjezia reaksionare e vendit. Në mënyrë të veçantë dëshiroj të theksoj se, sa herë që iu desh Partisë, në momente shumë të vështira të Luftës Nacionalçlirimtare, populli i Beratit i hapi dyert e qytetit të vet për mbledhje nga më të rëndësishmet, siç ishte edhe ajo që u bë këtu, 25 vjet më parë.

Të flas tani gjatë për Mbledhjen e Dytë historike të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar dhe për rëndësinë e saj, më duket se s'ka nevojë, pasi për këtë çështje u fol në mitingun e sotëm, prandaj nuk po zgjatem shumë në këtë drejtim, vetëm dëshiroj të vë në dukje se ajo mbledhje ishte e domosdoshme të bëhej. Partia dhe Komiteti i saj Qendror vendosën që mbledhja të mbahej me çdo kusht e në çdo rrethanë që të paraqitej, bile edhe me sakrifica, po ta lypte nevoja, për arsye se në ato momente ne përgatiteshim të kalonim nga etapa e Luftës Nacionalçlirimtare në një etapë të re, në atë të çlirimit të Shqipërisë, sepse nga Mbledhja e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar e

Beratit do të dilnin konkluzionet e etapës së mëparshme të Luftës Nacionalçlirimtare dhe do të përcaktoheshin në vija të përgjithshme direktivat për etapën e dytë, atë të çlirimit të atdheut.

Me përpjekje e me sakrifica, me luftë shumë të ashpër, në të cilën u bënë fli me mijëra djem dhe vajza të popullit, komunistë e të paorganizuar në Parti, dhe u dogjën krahina të tëra, shumë probleme kapitale kishin marrë rrugën e zgjidhjes, ishin bërë të qarta në mendjen e njerëzve tanë, kishin marrë formë konkrete edhe në praktikë. Këto zhvillime të mëdha si në zonat e çliruara, edhe në ato që përkohësisht ishin të pushtuara nga armiku, duhej të ligjëroheshin. Populli, që luftoi për të ardhur në fuqi, donte të shprehte lirisht vullnetin e tij, duke bërë vetë edhe ligjet. Një vepër e tërë e madhe që ishte realizuar gjer në atë kohë nga mbarë populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia e tij, nëpërmjet luftërash të përgjakshme me armë dhe luftërash të tjera të ashpra politike e ideologjike me armiqtë, duhej konsakruar me ligj.

Në këto rrethana historike Partia dhe Komiteti i saj Qendror vendosën që në Beratin e çliruar të bëhej Mbledhja e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, i cili do të vendoste shndërrimin e Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar në Qeveri Demokratike të Shqipërisë, do të aprovonte ligjin për këshillat nacionalçlirimtarë, ligjin për zgjedhjet e këshillave, si dhe do të pranonte «Deklaratën mbi të drejtat e qytetarëve». Siç e dini, vendimet e Mbledhjes së Dytë të Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, që pasqyronin direktivat e mbledhjeve të mëparshme e sidomos të Kongresit

të Përmetit, kishin rëndësi të madhe, në radhë të parë për arritjen e fitoreve të reja politike dhe ushtarake të popullit shqiptar mbi fashizmin dhe reaksionin e brendshëm, por, në të njëjtën kohë, ato kishin rëndësi edhe për opinionin publik botëror. Partia nuk mund të lejonte që Lufta Nacionalçlirimtare të ishte si çdo luftë e mëparshme në Shqipëri, kur populli luftonte dhe të tjerët korrnin frytet e gjakut të derdhur prej tij. Kjo do të ishte lufta e fundit, me fitoren e së cilës do të shpartalloheshin jo vetëm pushtuesit fashistë, por edhe feudalizmi e borgjezia dhe do të vendosej në Shqipëri diktatura e klasës punëtore, demokracia popullore.

Populli duhej të vinte medoemos në fuqi. Kësaj here ky objektiv do të arrihej patjetër, gjersa situatat ishin pjekur dhe në udhëheqje të luftës qëndronte Partia. S'kishte forcë që ta ndalonte marshimin triumfal të Partisë. Ajo nuk iu tremb as fashizmit, as nazizmit, as topave e mitralozave të panumërt të tyre, as spiunëve e tradhtarëve. Partia udhëhiqte popullin sipas ligjeve objektive të zhvillimit shoqëror, të cilat, me krijimin e kushteve të caktuara, veprojnë, pavarësisht nga vullneti i keq i armiqve. Duke i njohur thellë këto ligje, Partia e dinte se lufta do të zhvillohej, do të përparonte dhe çështja e popullit do të fitonte, mjafton që ky të udhëhiqej drejt e pa u përkulur. Në këto kushte s'kishte forcë që mund ta ndalte revolucionin, ai do të ecte medoemos përpara, ashtu siç eci, gjersa udhëhiqej nga një Parti e çeliktë marksiste-leniniste.

Ju kujtohet, shoqe dhe shokë, se gjatë gjithë periudhës së Luftës Nacionalçlirimtare, në vendin tonë, në

sajë të veprimtarisë së lavdishme të Partisë Komuniste të Shqipërisë, sot Partia e Punës, janë bërë mbledhje, konferenca e kongrese me rëndësi të madhe historike, që qëndrojnë si piramida të mëdha të luftës heroike të popullit tonë. Në to e mbajmë mend mirë që janë marrë vendime të rëndësishme, të cilat do t'i jepnin tonin dhe karakterin kësaj lufte të rreptë popullore. Në luftërat e mëparshme, që nuk udhëhiqeshin e nuk frymëzoheshin nga një parti komuniste e ndriçuar nga teoria e klasës punëtore, nuk mund të përcaktoeshin detyra revolucionare. Asokohe kishte njerëz që flitnin shumë për «demokracinë», për «lirinë» dhe për shumë gjëra të tjera, por, në të vërtetë, për popullin nuk kishte as demokraci, as liri, pse vazhdonte të sundonte e egër diktatura e feudalëve, e borgjezëve, e tregtarëve dhe, siç thotë populli, përpjekjet e masave punonjëse, luftërat e tyre mbaronin duke i vënë çdo luftëtar nga një qylaf në kokë. Në fund të luftës klasat sunduese i nisnin në shtëpi luftëtarët që kishin derdhur gjak, i përbuznin e i fyenin me fjalët: «Tani, ju, fshatarët shkoni në shtëpi, se këto punë nuk i merrni vesh, ato i dimë vetëm ne». Ky qëndrim përçmues i përfaqësuesve të klasave sunduese duhej thyer një herë e përgjithmonë nga Partia; popullit i duhej forcuar besimi në forcat e veta dhe duhej punuar që ai të bashkohej e t'i shtohej fuqia. Dhe Partia e kaliti, e bashkoi, e udhëhoqi këtë popull heroik, i cili luftoi vetëm për vetëm kundër shumë armiqve të fuqishëm, pa pasur përkrah ndonjë fuqi të jashtme që ta ndihmonte brenda truallit të tij.

Në kushte shumë të vështira materiale, por me

një shpirt të lartë luftarak, populli ynë arriti fitore pas fitoresh. Partia i tregoi çfarë është në gjendje të bëjë me forcat e veta një popull, sado i vogël që të jetë, në cilat maja me horizonte të gjera mund të dilte ai, po të bashkohej dhe të udhëhiqej nga një Parti me parimet dhe me vijën e saj të drejtë. Partia i thoshte popullit se gjithë djemtë dhe vajzat, që ishin rritur nën shtypje e në mjerim dhe ishin hedhur në luftë, s'ishin as të Vërlacëve, as të Vrionëve me shokë, po bijtë e bijat e tij dhe të Partisë, prandaj e mësonte se pas Luftës Nacionalçlirimtare do të vinte koha që ai të qeverisej me ligjet e veta dhe këtë ia siguronte Partia.

Partia i deklaronte, njëkohësisht, edhe botës së jashtme, miqve dhe armiqve, se kishte marrë fund një herë e mirë koha kur të tjerët luanin me fatet e vendit tonë e se të drejtat e shqiptarëve nuk mund të cenoheshin më si gjer atëherë. Prandaj ato tashmë duhet t'i njiheshin e t'i respektoheshin deri në një, në rast të kundërt, shqiptari, që nuk e ka zakon të bjerë në gjunjë, nuk bën asnjë lëshim dhe atyre që do ta pengonin në rrugën ku e udhëhiqte Partia, do t'u qëndronte deri në fund, do t'i demaskonte e do t'u tregonte vendin.

Partia vepronte kështu, pse parashikonte që armiqtë nuk do të rrinin duarlidhur dhe, në fakt, kështu ngjau. Para dhe pas Mbledhjes së Beratit armiqtë e jashtëm dhe ata të brendshëm, të hapët e të maskuar, me ose pa taserën e Partisë në xhep, në forma të reja filluan luftën kundër pushtetit të ri që kishte vënë në rrezik pushtetin e borgjezisë.

Pushtetin popullor tash e njeh i madh e i vogël, po pas Çlirimit, meqë porsa qe ngritur, ai nuk njihej si duhet. Megjithatë armiqtë vëzhgonin me kujdes drejtimin që po merrnin ngjarjet, ata parashikonin ç'do të ngjiste në Shqipëri, prandaj luftonin që piketat dhe ligjet e pushtetit të ri të ishin liberale, larg normave të diktaturës së proletariatit. Dhe për t'ia arritur këtij qëllimi atyre u duhej më parë të zhduknin nga mesi pengesën kryesore, Partinë Komuniste të Shqipërisë, ta shkëputnin nga marksizëm-leninizmi, ndryshe nuk mund të kishin asnjë sukses në çështjen e pushtetit, që është, siç na mëson leninizmi, çështja kryesore e çdo revolucioni. Dhe këtij objektivi iu vunë armiqtë e brendshëm, agjentë të titizmit në Partinë tonë dhe të udhëhequr prej tij, tradhtarë të tillë, si: Koçi Xoxe, Pandi Kristo e Sejfulla Malëshova, të cilët vepruan me të gjitha mjetet që ta dobësonin Partinë, ta shndërronin atë në një parti liberale. Në këtë rrugë mendonin të dobësonin regjimin e diktaturës së proletariatit dhe të pengonin ndërtimin e socializmit në Shqipëri.

Në këtë proces armiqësor, të koordinuar apo të pa-koordinuar, u përpoqën të ndihmojnë edhe imperialistët anglo-amerikanë. Veprimtaria e të gjithë atyre ishte e vazhdueshme, por ata nuk mundën t'ua arrinin objektiveve, jo për arsye se një nga ushtarët e luftës kundër kësaj veprimtarie të rrezikshme armiqësore isha edhe unë, po sepse në Shqipëri kishin fituar Partia dhe revolucioni. Ishte e pamundur që disa krimba t'u dilnin përpara Partisë, hovit të madh revolucionar dhe luftës së popullit. Partia i shtypi armiqtë, të jashtëm

dhe të brendshëm, pse ajo u mbështet te populli, interesat e të cilit i mbrojti dhe do t'i mbrojë kurdoherë dhe gjer në fund me besnikëri e me fanatizëm.

Prandaj duhet të mos jesh marksist po të mendosh se, duke filluar nga dita e vendosjes së pushtetit popullor e gjer tani, çdo gjë ka ecur paq si në një kopsht me lule. Përkundrazi, si para, ashtu dhe pas Mbledhjes së Beratit, ne jemi ndeshur në pengesa e në vështirësi të shumta, të cilat i kemi kapërcyer me sukses, me këmbëngulje e me luftë të pandërprerë. Marksist është ai që i njeh dhe di t'i kalojë vështirësitë pa humbur perspektivën, që mendon se jeta është luftë e të kundërtave dhe, në shoqëri, luftë me armiqtë e klasës. Për armiqtë tanë ka vetëm disfata, kurse për marksistët kurdoherë fitore, pse këta të fundit bazohen në ligjet e revolucionit, në ligjet e pagabueshme të dialektikës materialiste, që tregojnë se si kryhet zhvillimi i natyrës dhe i shoqërisë. Bota gjatë zhvillimit të saj ndjek pikërisht këto ligje, kurse borgjezia, kapitalizmi janë në kundërshtim me to dhe, meqenëse nuk i përballojnë dot, pësojnë vazhdimisht disfatë pas disfate. Marksistët janë kurdoherë me të renë përparimtare që triumfon dhe ecën përpara, ndërsa kapitalistët janë me të vjetrën që plaket dhe vdes, prandaj shkojnë vazhdimisht poshtë, gjersa të shkatërrohen përfundimisht.

Partia, pse mendoi dhe pse mbështetet pikërisht në ligjet e dialektikës materialiste, asnjëherë nuk u kap në befasi nga armiku; atë nuk e zuri ndonjëherë gjumi mbi dafina, prandaj kurrë nuk ka gabuar. Kanë gabuar një, dy, tre ose pesë njerëz, por jo tërë anëtarët

e Partisë. Dhe pse gabuan disa, nuk mund të thuhet se ka gabuar Partia. Mund të qëllojë që ajo të dobësohet për disa momente, por shpejt e merr veten, sepse edhe në këtë çështje vepron ligji marksist-leninist i dialektikës. Ata që gabojnë, që gënjejnë, që tradhtojnë mund të fshihen për një kohë, por jo gjatë, sepse ky ligj i zbulon, i demaskon dhe i spastron nga radhët tona.

Mbledhja e Dytë e Beratit ka rëndësi pikërisht për ato vendime historike që mori. Tani, pas 25 vjetësh, ne shohim se si pushteti ynë i demokracisë popullore ka ecur drejt një përsosmërie e demokratizimi të vazhdueshëm.

Por, motra dhe vëllezër, demokratizim në asnjë mënyrë nuk do të thotë liberalizim në kuptimin e tolerancës ndaj armikut të klasës. Ka njerëz, sidomos revizionistë, që përpiqen ta «demokratizojnë» pushtetin. Edhe borgjezia flet shumë për «demokratizimin», po këto janë vetëm formula bajate e të përcipta. Në demokracinë parlamentare borgjeze gjatë fushatave elektorale popullit i bëhen pa kursim premtime të bujshme, por, sa i merret vota, përfaqësuesit e borgjezisë i harrojnë premtimet që të nesërmen dhe vazhdojnë si kurdoherë t'i japin popullit kopaçen.

Sipas konceptit tonë marksist për demokracinë, qytetari dhe qytetarja, masat e gjera punonjëse të Republikës sonë Popullore gëzojnë të gjitha të drejtat, të gjitha liritë, të cilat ua garanton dhe ua mbron diktatura e proletariatit. Ato ua garanton Partia jonë që përpunon dhe propagandon teorinë në lidhje me revolucionarizimin e gjithë jetës së vendit, me qëllim

që masat t'i kuptojnë sa më mirë këto të drejta dhe liri. Të drejtat dhe liritë e qytetarëve të ne zbatohen efektivisht dhe me rreptësinë më të madhe, pse kështu mbrohen diktatura e proletariatit, ligjet e Partisë, ligjet e popullit. Po nuk i mbrojti dhe po nuk i zbatoi secili mirë këto të drejta, do të thotë se ai nuk e kryen si duhet detyrën si qytetar i republikës. Por, që t'i zbatojë drejt, qytetari, në radhë të parë, duhet t'i kuptojë mirë ato dhe, që t'i kuptojë mirë, duhet të zhdukë nga koka dhe nga zemra e tij mbeturinat mikroborgjeze që e pengojnë ta shohë me syrin që duhet demokracinë tonë socialiste.

Shpifjet dhe thashethemet për njërin apo për tjetrin s'janë shfaqje të demokracisë ose të lirisë së fjalës, përkundrazi, janë antidemokraci e gjallë. Gjithashtu, nuk është aspak demokraci agjitacioni e propaganda me qëllime armiqësore kundër pushtetit popullor. Përse të shahet ky pushtet i ngritur me gjakun e bijve dhe të bijave më të mira të popullit dhe që drejtohet nga vetë masat punonjëse për interesat e tyre? Jo, s'ka përse të shahet, por ai që vepron kështu, e bën këtë se është armik i popullit dhe me një veprimtari të tillë kryen një krim të rëndë në dëm të shumicës, prandaj ligjet e diktaturës së proletariatit e ndëshkojnë rreptë. Vullneti dhe interesi i një apo i disa personave të veçantë, që ëndërrojnë të vijë përsëri koha e Vrionëve, e Toptanëve dhe e të tjerëve, nuk mund t'u kundërvihen vullnetit dhe interesave të mbarë popullit, i cili për këtë çështje ka të drejtë t'i japë dënimin më të rëndë fajtorit.

Në qoftë se një ose dy persona kanë gabuar në

punë, siç na mëson Partia, cilido mund dhe ka të drejtë t'i kritikojë, veçanërisht dhe publikisht, veç gabimet e tyre, cilëdo qofshin ata, nuk duhet të ngatërrohen kurrsesi me vijën e drejtë të Partisë dhe me çështjen e madhe që mbron diktatura e proletariatit. Në qoftë se një person ngre zërin se është kundër një vjedhësi, një vrasësi ose ndonjë keqbërësi tjetër, diktatura e proletariatit është një mijë herë dakord t'u bjerë në kokë njerëzve të tillë, sepse me veprën e tyre të keqe ndikojnë negativisht te njerëzit tanë, godasin pronën socialiste, dobësojnë pushtetin e demokracisë sonë popullore etj., etj.

Gjithë ky zhvillim i vrullshëm revolucionar, gjithë kjo veprimtari e madhe që drejton Partia kanë për qëllim që njerëzit tanë të edukohen sipas teorisë marksiste-leniniste, të jenë trima, të guximshëm, luftëtarë, të çiltër, të ndershëm, ushtarë besnikë të diktaturës së proletariatit, të dashur me njëri-tjetrin, por, në të njëjtën kohë, edhe të rreptë me armiqtë e klasës, qofshin këta të brendshëm apo të jashtëm, sepse pikërisht këtu qëndron garancia e të ardhmes së diktaturës së proletariatit, garancia e zhvillimit të drejtë të demokracisë sonë popullore.

Të mos harrojmë për asnjë çast, shoqe dhe shokë, se një nga detyrat tona kryesore është lufta kundër armiqve të klasës. E drejtë dhe detyrë e çdo qytetari dhe qytetareje, midis shumë të drejtave dhe detyrave të tjera, është edhe ajo që armikun e klasës, që vepron për të dëmtuar diktaturën e proletariatit dhe ndërtimin e socializmit, ta shpartallojë pa mëshirë, individualisht dhe kolektivisht, menjëherë dhe pa he-

zitim. Burra e gra, të rinj e të reja te ne, duhet të luftojnë për këtë qëllim me një ndërgjegje të lartë klasore revolucionare. Vetëm kështu do të korrim fitore, do të ecim kurdoherë përpara, do të plotësojmë planin pesëvjeçar në tre ose në tre vjet e gjysmë, do të bëjmë mrekulli si këto që po shohim.

Në vendin tonë njerëz të thjeshtë e pa një specializim të lartë, punëtorë, fshatarë, intelektualë, të rinj e të reja, gratë tona të mrekullueshme bëjnë çudi; brenda një kohe shumë të shkurtër ata realizojnë me mjete të thjeshta ato që të tjerët i prodhojnë me mjete shumë moderne. Po si është e mundur t'i bëjnë këto gjëra? Sepse u këndon zemra dhe, kur të këndon zemra, kur ajo është e pastër, kur je pa brennga dhe i lirë në pushtetin popullor, atëherë ecën përpara me guxim, asnjëri s'ta pret dot rrugën, po edhe në të daltë ndonjë ferrë, shpatën e ke zhveshur dhe di që përkrah ke Partinë. Çdo njeri duhet të dijë që në të drejtën e tij Partinë e ka e do ta ketë kurdoherë dhe në çdo moment pranë, ditë e natë.

Partia është deri në fund me ata që s'bëjnë gabime, po ajo nuk i hedh poshtë ata që gabojnë, por që i kuptojnë shpejt gabimet dhe bëjnë çdo përpjekje për t'i ndrequr. Partia nuk është me ata që bëjnë gabime pas gabimesh, mbushin kupën dhe nuk duan të korrigjohen. Këto që thotë Partia nuk i ka fjalë dhe populli ynë e di se në këtë drejtim ajo ka dhënë shumë prova, kurdoherë ka qenë dhe është me zemër të gjerë.

Ky qëndrim i Partisë e gjen shpjegimin te filozofia jonë materialiste që na mëson se njeriu, që nga

rinia e derisa plaket, nuk është ideal dhe i lindur me virtyte komuniste, pse shoqëria e vjetër ka lënë mbeturina dhe njolla në ndërgjegjen e tij. Gjatë rrugës së jetës këto u dalin njerëzve si ferrat nëpër këmbë, nga të cilat mund t'u çirren pantallonat, duart etj. Atëherë ç'duhet bërë me këta njerëz? T'i hedhim tej? Jo! Partia, që e di mirë çfarë mund t'u dalin njerëzve në jetë, na mëson se duhen bërë të gjitha përpjekjet për t'i shpëtuar këta, për t'i korrigjuar. Edhe në këtë rast vepron ligji, sipas të cilit çdo gjë mund të shndërrrohet. Në bazë të këtij ligji transformohet një botë e tërë dhe gjersa transformohet bota, si rrjedhim, tok me të transformohet edhe njeriu që është pjesë përbërëse e saj, edhe karakteri i tij. Nisur nga ky ligj, Partia i vihet punës me njerëzit dhe gradualisht i transformon, i bën ata gjithnjë e më të mirë. Ne shohim rezultatet e kësaj pune shumë të vlefshme që ka bërë dhe vazhdon të bëjë ajo me njerëzit; provat janë kudo të gjalla, të shumta, deri edhe te pleqtë dhe plakat. Njerëzve që kanë gabuar, Partia u ka dhënë dorën, i ka shëruar, i ka ndrequr dhe shumë nga ata, me forca të reja, janë hedhur në punë shoqërisht të dobishme. E tillë është Partia jonë, prandaj çdo njeri te ne ka besim të madh tek ajo. Secili duhet të mendojë, siç thotë populli, «Nënë e babë ty të kemi Parti», prandaj duhet që asaj t'ia hapë zemrën, pse kështu do ta ndihmojë.

Shumica e komunistëve i kupton drejt këto probleme, por nuk përjashtohet të ketë edhe nga ata që nuk i kuptojnë si duhet dhe në ndonjë rast mund të kundërshtojnë pa arsye. Edhe në këtë rast Partia nuk

duhet të dëshpërohet, pse atë nuk e përbën një, as pesë njerëz, as një celulë, ose si i themi tani organizatë-bazë. Jo. Partia është e madhe, nga baza e rrethi gjer në Komitetin Qendror. Prandaj jo vetëm njerëzit që kërkojnë të drejtën e tyre të shkelur nga ndonjëri, por edhe ata që gabojnë, trokasin në derë të Partisë, ia hapin zemrën asaj. Kur njerëzit nuk gjejnë te komunistët ose tek organizata-bazë atë ngrohtësi që këshillon Partia, duhet të shkojnë më lart; ata kurrë nuk duhet t'i humbasin shpresën dhe besimin te Partia. Ajo dëshiron që njerëzit të jenë të sigurtë. Atij që është i sigurtë, Partia i jep dorën. Edhe atë që nuk është i sigurtë, prapë mundohet ta edukojë, por përpjekjet e saj në këtë rast bëhen më të vështira. Pikërisht pse Partia ka vepruar kurdoherë drejt, prandaj pushteti është forcuar, është kalitur, janë kalitur në radhë të parë njerëzit, ekonomia jonë është zhvilluar dhe socializmi në Shqipëri po ndërtohet me sukses.

Suksese ne kemi nga të katër anët. Partia e Punës e Shqipërisë dhe Republika jonë Popullore gëzojnë një prestigj dhe një autoritet të madh edhe në botën e jashtme. Këto e kanë burimin te lufta e papërkulur e konsekuente që ka bërë populli ynë dhe te politika e drejtë parimore që ka ndjekur e ndjek vazhdimisht Partia në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Vija e drejtë e Partisë jo vetëm në teori, por edhe në zbatimin e saj praktik, ka gjetur jehonë kudo, pse të huajt, ashtu si ne shqiptarët, nuk vlerësojnë nga fjalët e bukura, por shohin, këqyrin, pastaj nxjerrin konkluzione dhe mbajnë qëndrimin e duhur. Të tjerët

që grijnë me fjalë, por s'kanë asgjë në trastë në terrenin politik, bota i përbuz si demagogë e tradhtarë. Drejtësia e vijës marksiste-leniniste të Partisë sonë është verifikuar në jetë.

Uniteti i çeliktë i udhëheqjes me Partinë, siç e dini edhe vetë, është siguruar në sajë të luftës së ashpër parimore që ajo ka zhvilluar më parë kundër tradhtarëve revizionistë titistë dhe agjentëve të tyre në Shqipëri. Ky unitet u kalit pastaj më shumë në luftën kundër tradhtarëve revizionistë hrushovianë, brezhnevianë e gjithë të tjerëve me radhë. Ai vazhdon të kalitet edhe në luftën kundër imperializmit amerikan dhe borgjezisë reaksionare botërore që tani është në unitet me socialimperializmin sovjetik.

Uniteti i udhëheqjes me Partinë, që ka rëndësi vendimtare, është fituar me luftë të drejtë konsekuente, me gjak, prandaj Partia dhe udhëheqja e saj bëjnë të gjitha përpjekjet që ky unitet të kalitet çdo ditë e më shumë. Mjeti më i fuqishëm për ruajtjen dhe për forcimin e mëtejshëm të tij është lidhja sa më e ngushtë e Partisë me masat dhe zbatimin me përpikëri të madhe i ligjeve të diktaturës së proletariatit. Uniteti i Partisë dhe i udhëheqjes me masat gjen shprehjen e vet konkrete në hapjen e zemrës së Partisë dhe të komunistëve para masës, në dëgjimin me kujdes e me vëmendje të zërit të masave dhe në zbatimin e dëshirave të tyre. Partia, si në të kaluarën, edhe tash, duke u bazuar në teorinë marksiste-leniniste, vullnetin e masave e konsideron si ligj. Këtë ajo do ta ketë kurdoherë parasysh, edhe në të ardhmen do ta dëgjojë me vëmendje e me respekt zërin e tyre, pse kështu

pushteti i diktaturës së proletariatit do të jetë i pathyeshëm dhe do ta çojë vendin tonë me siguri në shoqërinë pa klasa, në komunizëm.

Të rrojë Partia!

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

STUDIMET HISTORIKE T'I SHËRBEJNË SQARIMIT TË PROBLEMEVE TË GJENEZËS SË POPULLIT TONË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

3 nëntor 1969

Jam dakord me orientimet dhe me sa thanë para-
folësit, por kisha edhe një vërejtje: Në materialin e
paraqitur janë radhitur një sërë pikash e nënpikash,
domethënë është zbratur tërë bagazhi, duke vënë nga
pesë radhë për çdo çështje, kurse unë do të isha i me-
ndimit që, në vend të kësaj morie gjërash, Byrosë
Politike t'i liheshin për shqyrtim disa nga problemet
më të rëndësishme, që janë me të vërtetë kyç në fu-
shën e shkencave albanologjike dhe që kërkojnë një
ndihmë të veçantë nga Byroja Politike, të cilat të na
paraqiteshin mbasi t'i kishin studiuar thellë specialistët
që merren me këto shkenca. Kështu do të na jepej

1 Në këtë mbledhje u shqyrtua relacioni «Mbi disa pro-
bleme të zhvillimit të mëtejshëm të shkencave albanologjike në
vendin tonë», përgatitur nga Instituti i Historisë dhe i Gju-
hësisë.

edhe neve mundësia të reflektonim, të bënim disa studime e sondazhe, t'u bënim shokëve të ftuar edhe ndonjë pyetje ose vërejtje, po të kishim, që të mund t'i ndihmonim konkretisht.

Shokët që merren me studime albanologjike punojnë dhe kanë arritur rezultate në këtë drejtim, por disa studime për probleme të caktuara, si ato që ngriti shoku Manush [Myftiu], mendoj se ca më vonë mund të na i paraqitin më me hollësi në Byronë Politike.

Përpara se të flas për këtë çështje, dëshiroj të them se punonjësit tanë të kësaj fushe duhet të kenë kurdoherë parasysh që studimet albanologjike (dhe këtu e kam fjalën jo për të tjerët, por për ne) për çdo problem duhet të bazohen në shkencë, në radhë të parë, në shkencën marksiste-leniniste. Çdo studim që bëhet në Shqipëri të jetë i bazuar, të mos ketë në të gjurmë shovinizmi, përkundrazi, çdo gjurmë e tij të luftohet si shfaqje e huaj nga studiuesit tanë. Në studimet tona duhet t'u përgjigjemi në mënyrë shkencore dhe të bazuar atyre që kanë pretendime tokësore ndaj Shqipërisë. Për këto pretendime, natyrisht, duhet t'u përgjigjemi jo vetëm politikisht, por edhe në drejtime të tjera, vetëm se kurdoherë shkencërisht.

Kur themi që studimet tona albanologjike duhet të jenë me baza shkencore, marksiste-leniniste, anti-idealiste, antishoviniste, do të thotë t'i trajtojmë drejt problemet, me qëllim që studimet tona në këtë fushë, si kudo, të jenë kurdoherë superiore ndaj atyre që kryhen jashtë Shqipërisë. Kështu do t'u imponohemi atyre studiuesve të huaj që kanë pikëpamje antishkencore, ndryshe, pavarësisht se jemi vendi për të cilin

bëhen këto studime, nuk mund t'u imponohemi. Të bazuar në shkencën marksiste-leniniste, ne do të bëjmë kurdoherë vëzhgime e kërkime të drejta, të studiuara, me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, do t'i japim rëndësinë e preokupacionin e duhur si anës kombëtare të çështjes, ashtu edhe asaj ndërkombëtare.

Gjenezës së popullit shqiptar, çështjeve të gjuhësisë, formimit të kombit dhe të gjitha problemeve të tjera, akoma në diskutim, do t'u japim rëndësinë e duhur duke i vënë në baza shkencore. Atë që është jona ta mbrojmë me studime të argumentuara. Ne nuk kemi bërë e nuk bëjmë përvetësime, duke paraqitur shqiptare ato që s'janë të tilla. Në asnjë mënyrë nuk mund t'u themi, ta zëmë, dalmatëve të sotëm se, meqë në të kaluarën ilirët kanë qenë shtrirë edhe në vendin tuaj, këtej ne nxjerrim përfundimin se gjithë qytetërimi që ekziston në vendin e tyre qenka yni. As me supozime nuk duhet të shkojmë e të themi, për shembull, se etruskët (që deri tani nuk u ka vënë njeri gishtin çfarë janë, meqenëse kjo është një çështje akoma e panjohur), janë paraardhësit e shqiptarëve. Sa do të vërtetohet kjo hipotezë, është një çështje tjetër, por, përderisa ajo mbetet supozim, nuk mund të udhëhiqemi prej saj në studimet tona. Është fakt që kultura etruske, në krahasim me atë romake, që në atë kohë ishte, si të thuash, akoma barbare, ka qenë shumë më e përparuar, por kjo nuk duhet të na bëjë që, duke u bazuar vetëm në hipoteza, të themi se etruskët janë paraardhësit e shqiptarëve.

Ata që mbrojnë pikëpamjen e origjinës pellazgjike të shqiptarëve kanë mendimin se pellazgët nuk janë

asimiluar kurrë nga grekët, bile shkojnë edhe më tej, duke thënë se është kultura pellazge ajo që ka ndikuar mbi kulturën greke etj. Kjo do të thotë se kultura pellazge duhet të ketë qenë shumë më e zhvilluar nga ajo greke, mirëpo deri tani bota nuk ka të dhëna për këtë kulturë. Në qoftë se dikush pretendon të vërtetojë se kultura greke është ndikuar nga autoktonët, ekzistenca e të cilëve është akoma e diskutueshme, sepse bazohet vetëm në çka thotë Homeri, më parë duhet të rrëzojë me argumente të dhënat e deritanishme të shkencës botërore. Bota e njeh gjerësisht kulturën greke, që, siç e dimë, është ndikuar nga qytetërimi më i hershëm i popujve të Azisë. Kjo dihet fare mirë, ndërsa ndikimi i kulturës së pellazgëve është një supozim, të cilin nuk kemi akoma prova dhe fakte për ta marrë si të vërtetë. Prandaj, për të mos gabuar, në këtë drejtim kërkohet të bëhet një punë serioze dhe të mos ecet me dëshira.

E them këtë sepse, nga sa kam lexuar nëpër gazeta, ndonjëherë disa nga njerëzit tanë që merren me shkencë përpiqen të paraqitin si të kulturës ilire monumentet e kulturës greke, romake ose greko-romake të zbuluara te ne, gjë që nuk është aspak e drejtë, përkundrazi, një punë e tillë është antimarksiste. Dihet që kultura e Apolonisë, sikurse edhe ajo e Durrësit, është një kulturë e përzier greko-romake, prandaj, po të përpiqeshim ta përvetësonim dhe ta shpallnim sikur atë e kanë zhvilluar të parët tanë, nuk do të ishim objektivë. Patjetër mund të themi se atë e kanë përdorur edhe ilirët, se edhe ata kontribuan në të, duke krijuar në këtë stil.

Është e njohur historikisht që Roma ka pushtuar shumë vende të Mesdheut, duke përfshirë edhe Apolinë e Durrësin, ku më parë kishte zënë vend kultura greke, dhe, si kudo që sundoi, ajo çoi atje edhe kulturën e vet. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për kulturën bizantine, e cila u përhap në vendin tonë disa shekuj më vonë. Është e vërtetë që në Shqipëri gjenden plot monumente të ndërtuara prej shqiptarëve. Kështu, për shembull, arkitekti shqiptar që ka bërë kishën e Labovës së Kryqit, është artist i madh, megjithatë stili i kësaj kisha është i frymëzuar nga ai bizantin, mbasi, siç dihet, kisha të tilla janë ndërtuar me shumicë në të gjitha vendet e Mesdheut Lindor. Prandaj mendoj që këto çështje t'i vëmë drejt, që të trajtohen me objektivitet rigorozisht shkencor.

Punonjësit tanë të shkencave albanologjike janë në gjendje të orientohen dhe ta përcaktojnë vetë fushën e studimeve dhe të punimeve që bëjnë, por, sipas mendimit tim, ata duhet ta vënë theksin më shumë tek ilirët, për arsye se faktet, dokumentet dhe të gjitha të dhënat arkeologjike, historike etj. janë më të plota për të vërtetuar prejardhjen e shqiptarëve prej tyre. Veç kjo çështje duhet të studiohet në mënyrë shkencore, me fakte e me dokumente dhe, po e studiuam drejt, një studim të tillë të argumentuar ne ia imponojmë cilitdo.

Edhe në kërkimet arkeologjike duhet bërë më shumë kujdes që çështjet të shtrohen drejt. Natyrisht, për të parë ç'kontribut ka dhënë populli ynë në thesarin e kulturës botërore, është e nevojshme të punojmë për të zbuluar edhe monumentet e antikitetit

romak, greko-romak e të çfarëdolloj qytetërimi tjetër në truallin tonë. Megjithatë, këto gjermime duhen bërë në përpjesëtim të drejtë me gjithë të tjerat, punimet tona arkeologjike duhet të përqendrohen më shumë në zbulimin e monumenteve ilire dhe të të gjitha fiseve e popujve, me të cilët vërtetohen prejardhja dhe kultura e popullit shqiptar. Të tilla gjermime mendoj të vazhdojnë më me intensitet, kurse të tjerat të ecin me një ritëm më të ngadalshëm.

Po përse duhet të zbulojmë ne edhe monumente që s'kanë të bëjnë me kulturën e të parëve tanë? Këtë e bëjmë që t'i shërbejmë kulturës botërore. Të tilla monumente, si Koloseu i Romës, ka edhe në Algjeri, nga ana e Sirisë etj., bile gjurmë të një monumenti të tillë, që nuk është keq ta zbulojmë, gjetëm edhe ne në Durrës. Ose kemi zbuluar statuja të magjistratëve të qytetit dhe i kemi vendosur në vendin përkatës në Apoloni. Natyrisht, me këtë kemi bërë një punë të mirë, pse zbulimi i vlerave të tilla kulturore ka rëndësi të madhe dhe tregon se, si shumë vende, edhe Shqipëria kontribuon në pasurimin e thesarit të kulturës botërore. Të huajt dëshirojnë të vijnë në vendin tonë që t'i shohin, t'i studiojnë dhe të shkruajnë për këto monumente që zbulojmë. Megjithatë, zbulimi i monumenteve të tilla nuk ka shumë rëndësi për ne, përveç faktit që ato kanë ekzistuar si vepra me vlera arkitekturore. Le të shikojmë studimet dhe gjermimet arkeologjike që kanë bërë në të kaluarën në Shqipëri arkeologët dhe historianët e huaj si Rei, Ugolini dhe gjithë të tjerët. Ne e dimë se gjermimet ata nuk i filluan për interesin tonë, po për interesat e tyre.

Gërmimet për zbulimin e monumenteve që kanë të bëjnë me kontributin që japim ne në thesarin e kulturës ndërkombëtare, mendoj se është e nevojshme t'i bëjmë në përpjesëtimin e duhur. Këtë çështje duhet ta shikojmë me kujdes, të mos i hedhim të gjitha forcat që disponojmë për të zbuluar mozaikët e Pojanit etj., por t'i orientojmë ato kryesisht për të zbuluar dhe për të vërtetuar tezat tona që nuk janë shoviniste dhe që shërbejnë për të sqaruar qenien tonë si popull, kulturën tonë të lashtë e të bukur, të cilën na e kanë mohuar ata që në të kaluarën na kanë shtypur. Pra, të dimë të zgjedhim çfarë të studiojmë dhe jo të mburrmi, për shembull, me faktin historik që Belizari ka qëndruar tre muaj në Durrës për të pritur kavalerinë e Justinianit e me trupat ilire që dërgoi ai në Ravenë, kur dimë që ato janë marrë si mercenare. Në qoftë se ekzistojnë të dhëna që tregojnë se këto trupa kanë dhënë njëfarë kontributi, vlen të gërmohet në dokumente për të mësuar më tej ç'ka bërë Belizari e ç'kanë bërë këto trupa, ndryshe s'ka ç'na duhet një studim i tillë. Gjithashtu nga historia dihet mirë se Mark Antoni dhe Cezari kanë ardhur në Shqipëri. Po ç'na duhet neve të nisemi të gërmojmë për të gjetur të dhëna materiale për këtë? Përse t'i hyjmë kësaj pune? Por është me interes po të dimë se lufta civile në Romë dha shkas që ilirët të shfrytëzojnë rastin për të ngritur krye kundër Romës. Forcat shkencore, në radhë të parë, duhet t'i angazhojmë në disa drejtime që na sjellin përfitime. Me këtë nuk dua të them që të mos e ndihmojmë kulturën botërore, po këtë punë, siç thashë, ta bëjmë kurdoherë duke ruajtur përpjesëtimet.

Ju shokë¹ nuk keni qëndruar duarlidhur, përku-ndrazi, keni bërë në këtë drejtim një punë të vlefshme, që ka dhënë rezultate dhe për këtë ju lavdërojmë. Por, në qoftë se dëshironi që Byroja Politike t'ju ndihmojë për çështje që lypin sqarime dhe për të cilat duhen dhënë disa orientime, atëherë këto, kur ta gjeni ju të volitshme, na i paraqitni në studime të veçanta. Te të huajt, për shembull, në gjuhësi, ekzistojnë disa teori, që s'janë mbeturina, po shkolla, koncepte shkollash të tëra. Këto teori janë, si të thuash, pa baza shkencore, por kanë hedhur rrënjë në kokat e njerëzve, të profesorëve të ndryshëm, të cilët, ta kemi mirë parasysh, nuk janë barishte, por lisa të mëdhenj të borgjesisë, që i kanë të argumentuara teoritë e tyre, prandaj këto nuk rrëzohen lehtë. Pra, në qoftë se shihet e nevojshme të japim kontributin tonë në luftën kundër këtyre pikëpamjeve që po përhapen jashtë, dhe kërkohet medoemos ta japim kur është çështja për vendin tonë, duhet të vëzhgojmë me vëmendje e në mënyrë shkencore cilat janë orientimet që kanë të huajt për albanologjinë. Të mos pretendojmë se edhe pa shumë argumente mund t'i rrëzojmë teoritë false që janë përhapur. Mendimi ynë duhet të dominojë dhe t'i rrëzojë shkencërisht e me argumente pikëpamjet e huaja, domethënë t'i bëjë me vete të tjerët, pra, t'i bindë plotësisht ata për vërtetësinë e studi-

1 U drejtohet shokut Kahreman Ylli, ish-ректор i Universitetit të Tiranës dhe shokëve të tjerë nga Instituti i Historisë e i Gjuhësisë e nga Instituti i Folklorit, të cilët merrnin pjesë në këtë mbledhje.

meve tona, ashtu si për një plus një që bëjnë dy.

Për t'ia arritur këtij qëllimi, shkencat tona albanologjike duhet të frymëzohen dhe të udhëhiqen nga shkenca marksiste-leniniste, gjithçkaje t'i japin dozën e duhur, të mos tërhiqen nga orientime, nga praktika ose nga pikëpamje të vjetra në përcaktimin e punës, të mos e harrojnë të kaluarën, po të kenë parasysh edhe aktualen e perspektivën. Nuk do të ishte e drejtë të thoshim se tani s'na duhet studimi i çështjes së pellazgëve ose ajo e ndikimit që ka pasur Molosia tek Aleksandri i Madh mbasi ky paska qenë grek, pse edhe kjo s'është plotësisht e saktë. Aleksandri i Madh nënën e kishte epirote (molose), babain maqedonas dhe vetë për njëfarë kohe u rrit në Molosi. Të gjitha këto ndikuan në formimin e tij, saqë kur shkoi në Persi, ai mori titullin e një perandori kozmopolit. Me studimin e kësaj çështjeje ne nuk synojmë në asnjë mënyrë të nxjerrim përfundimin që Aleksandri ka qenë shqiptar, as për t'u thënë grekëve që nëna e tij ka qenë shqiptare, por për të vërtetuar se kjo pjesë e Ballkanit, ku ai kaloi femininë dhe prej nga kishte nënën, nuk ka qenë aspak greke, por barbare, se në Molosi ka pasë jetuar një popull krejt tjetër dhe, duke qenë kështu, fiset e atjeshme janë zhvilluar në mënyrë të tillë që nuk janë asimiluar dot nga grekët. Këto fise kanë marrë vërtet kulturë dhe disa zakone greke, por në përgjithësi kultura dhe zakonet e tyre kanë qenë krejt të ndryshme nga ato të grekëve. Duke vërtetuar shkencërisht këtë, do të na dalë se molosët nuk kanë qenë një me heletët.

Këto kisha për të thënë, prandaj, po të na jepni

materiale, ne do të përpiqemi edhe vetë të thellohemi në to, që të mundim pastaj t'ju ndihmojmë e t'ju japim orientime dhe sqarime të nevojshme.

Jam i bindur se në të ardhmen ju do të vazhdoni të punoni edhe më mirë nga sa keni punuar deri tani.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

T'I STUDIOJMË ÇËSHTJET IDEOLOGJIKE DHE TË VEPROJMË AKTIVISHT PËR ZGJIDHJEN E TYRE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH*

3 nëntor 1969

Krahas sukseseve të mëdha që kemi arritur në të gjitha drejtimet, duhet të shikojmë drejt e të mos i nënvleftësojmë edhe fenomenet negative, që ekzistojnë akoma në shoqërinë tonë dhe të merremi më seriozisht me to, se pengojnë ecjen tonë përpara. Kur vërtetohen ngjarje si kjo e Tepelenës¹ dhe Partia thellohet në to, u bën analizën dhe i sheh më mirë, atëherë del sa të thella janë akoma të tilla mbeturina.

Ne nuk e zvogëlojmë rrezikshmërinë e ndikimit ideologjik të mbeturinave, por të kemi shumë kujdes që të mos e zvogëlojmë atë as në opinion, që ky t'i vlerësojë ato në masën e nevojshme. Duhet ta kemi të qartë dhe ta kuptojmë seriozisht se, derisa në organizatat-bazë të Partisë dhe në masën e komunistëve, ku

¹ Shih në këtë vëllim f. 44.

më shumë e ku më pak e disa herë edhe në formë të acaruar, shfaqen fenomene të tilla negative dhe udhëheqja kryesore në rreth e neglizhon luftën kundër tyre, domethënë nuk bën përpjekje për t'i analizuar ato e për të kuptuar thellë rrezikshmërinë e tyre dhe nuk gjen metodat e luftës për t'i kapërcyer e për t'ia arritur qëllimit, do të thotë se në bazë nuk e shikojnë si duhet këtë problem.

Jo rastësisht themi që shokët sekretarë të parë ose sekretarët e tjerë të komiteteve të Partisë të rretheve nuk merren sa duhet e seriozisht me problemet ideologjike dhe shoqërore, që janë kyçi i të gjitha problemeve. Këtu nuk është çështja te ndarja e punës, as që këtë punë ta bëjë, ta zëmë, në Gjirokastrë vetëm shoku Sevo Tarifa, si sekretar i Komitetit të Partisë për këtë rreth, megjithëse e vërteta është që ai vetë përpiket dhe, nga sa shoh, shkruan vazhdimisht në gazetën e rrethit, përgatit taliot për luftën kundër mbeturinave, ose Pano Çuka që trajton në shtyp probleme kundër kishës dhe fesë, kurse nga sekretari i parë... nuk shohim në gazetë asnjë artikull ose studim për çështje ideologjike. Vallë nuk interesohet fare ky shok për këto probleme? Këtë nuk mund ta themi, pse si sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit ai merret dhe është në dijeni për çdo gjë që ndodh, di, për shembull, çfarë bëhet në Lazarat apo në Dropull, ç'ka ngjarë në këtë apo atë organizatë-bazë etj., por, me sa duket, nuk e ka në shkallën e duhur preokupacionin për trajtimin teorik të këtyre problemeve dhe, natyrisht, po i mungoi ky, këto çështje, që janë shumë serioze, nuk mund të zgjidhen si duhet.

Si kudo edhe në këtë fushë ne kemi përparime, prandaj s'ka përse të bëhemi pesimistë, por edhe të fluturojmë pa i parë thellë e seriozisht ato që na ngjasin, nuk na lejohet. Këto çështje duhet t'i studiojmë teorikisht dhe jo vetëm kaq, por, pasi t'i zbulojmë, të veprojmë aktivisht për zgjidhjen e tyre, pse kam përshtypjen që nuk veprohet sa duhet aktivisht dhe shumë herë në bazë ekziston sëmundja e frazeologjisë dhe e formave.

Shpesh mendohet se, për të zgjidhur një çështje shoqërore, duhet kaluar medoemos nga format e caktuara, ndryshe duket sikur shkelen rregullat. Format i krijon situata, i krijon lufta, i krijon veprimi. Një formë, që në një rast mund të jetë frytdhënëse, në një rast tjetër mund të jetë e tepruar dhe frenuese, prandaj duhen bërë përpjekje që për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin në jetë të gjendet rruga e përshtatshme dhe të mos mbetemi skllevër të formave të mëparshme, duke këshilluar skema të gatshme se si duhet vepruar. Kjo, më duket mua, nuk është e drejtë.

Mbrëmë pashë pjesën teatrale «Njollat e murrme» të shfaqur nga trupa e teatrit profesionist të Korçës. E vërteta është që pjesës i mungonte çështja esenciale dhe pikërisht për këtë nuk më pëlqeu aspak. Skenën në këtë shfaqje e dominonin mikroborgjezët, mjeku, mësuesja dhe djali i tyre. Këta ishin tri personazhet kryesore, që i luanin mirë rolet përkatëse, qëndronin vazhdimisht në skenë ku shfaqnin ndjenjat e tyre mikroborgjeze, kurse ata që personifikonin Partinë e masat dilnin nga errësira, dilnin nga skutat njëri pas tje-

trit, flitnin pak dhe zhdukeshin. Skena zhvillohej në mënyrë të tillë që Partia, nëpërmjet personazheve që e përfaqësonin, dukej sikur vepronte si prifti, dilte, siç thashë, njëri nga një skutë e errët, lëshonte një batutë dhe ikte, pas tij një i dytë e kështu me radhë, ndërsa elementët mikroborgjezë vepronin aktivisht, ndiqnin rrugën e tyre, bile mjeku arriti derisa ta linte një fëmijë të vdiste dhe asnjëri s'e shqetësoi për këtë. Mësuesja, që paraqitej më e përparuar nga i shoqi, dominohej prej tij dhe mbetej deri në fund një mikroborgjeze e lëkundur, ashtu siç mbeti deri në fund një mikroborgjez dhe njeri i pandreqshëm burri i saj, mjeku. Sa për djalin e tyre, nuk u mor vesh ç'u bë, ndoqi rininë apo vazhdoi në rrugë të keqe.

Në këtë dramë nuk dukej gjëkund ndikimi i punës së Partisë në familje. Vetëm kur djali i mjekut iu sul një vajze për ta kapur, atëherë u dëgjua një zhurmë e madhe, dolën nga një qoshe të rinjtë që i bërtitën dhe ai u largua. Publiku në këtë rast menjëherë duartrokiti, se e ndiente boshllëkun, e priste dhe e donte një gjë të tillë. Në fund fare të të gjithë kësaj pjese doli mësuesja, që deklaroi se këto ferra do t'i shkullim nga rrënjët nga shoqëria jonë, por kjo ishte dhe mbeti vetëm një parullë e lëshuar nga një element me mbeturina të theksuara mikroborgjeze.

Në një kohë që ne bëjmë revolucionarizimin e shkollës, autori, nëpërmjet kësaj drame, përçon pikëpamjen sikur në shkollën tonë sundon dhe vendos elementi mikroborgjez. Kjo del nga diskutimi dhe vendimi i padrejtë që u mor në këshillin pedagogjik për nxënësin revolucionar, i cili përjashtohet nga shkolla. Në

fillim çështjen e këtij nxënësi e mbron gruaja e mjekut, pra një mësuese me ndjenja të forta mikroborgjeze. Në fund të diskutimit në këshillin pedagogjik, shtatë nga pedagogët ishin për dënimin pa të drejtë të nxënësit, kurse gjashtë ishin nga ana e tij. Elementët mikroborgjezë në këtë dramë, duke filluar nga drejtori i shkollës, janë të tërë sulmues. Kur kolegët e pyetën mësuesen, gruan e mjekut, që kishte mbrojtur më parë çështjen e nxënësit, se ç'mendonte e si do të votonte, ajo nuk mbajti qëndrim dhe u përgjigj se abstenonte. Pra, nga gjithë zhvillimi i ngjarjes, del sikur shkolla jonë është në duart e mikroborgjezëve, kurse në fakt nuk është ashtu.

Duke e analizuar në këtë prizëm përmbajtjen e kësaj pjese teatrale, sipas mendimit tim, ajo nuk e meriton çmimin e parë të festivalit kombëtar të teatrove dramatike, dhënia e këtij çmimi është e gabuar, bile shumë ofenduese për inteligjencien tonë. Atje ofendohen mësuesit dhe mjekët tanë, shkolla jonë, punëtorët. Në vend që në skenë të dëgjohej i fortë zëri i punëtorëve, punëtori që ishte anëtar i këshillit të prindërve të kësaj shkolle, kur u ngrit e foli, nuk tha asgjë të rëndësishme, përveç vërejtjes që i bëri mjekut për të birin, që ishte bashkuar me disa njerëz të këqij. Në dramë dominon mjeku me pikëpamjet e tij të shtrembra, që arrin bile të thotë më në fund se «këta» po i harrojnë të mirat që u kam bërë unë.

Analiza e ndjenjave, që autori i quan «Njolla të murrme», në dramë bëhej mirë. Këto shfaqje duheshin vënë në dukje, por njëkohësisht atyre u duhej kundërvënë forca e madhe edukuese e Partisë, që në dramë

as që zihej në gojë. Kjo forcë duhej të dukej qartë dhe kudo e jo të fshihej skutave. Partia duhej të vepronte në mënyrë që elementët intelektualë me mbeturina të theksuara mikroborgjeze gradualisht të korrigjoheshin, të shkonin në rrugën e drejtë të popullit dhe të Partisë dhe jo të liheshin të vazhdonin të vepronin me pikëpamjet e tyre. Në dramë duhej të dukej, gjithashtu, qartë forca e madhe e klasës punëtore. Klasa dhe Partia duhej të vepronin që puna e tyre edukuese të ndikonte pozitivisht mbi elementët negativë, kurse në dramë nuk kishte veprim nga ana pozitive.

Pikëpamjet që trajtohen te «Njollat e murrme» e kanë nxitur autorin të përcaktojë edhe formën, ashtu siç e ka menduar ai. Drama është e dobët edhe nga forma, por rëndësi, sipas mendimit tim, ka çështja e përmbajtjes. Spektatorët, pasi e shohin këtë pjesë, dalin të pasqaruar, pse mjeku dhe gruaja e tij mësuese nuk ndreqen, por vazhdojnë t'i ruajnë lakrat në kokën e tyre. Megjithëse gruaja herë pas here del me disa kundërshtime ndaj burrit, ajo vazhdon të qëndrojë nën ndikimin e pikëpamjeve të tij. Veç kësaj, nuk është e pranueshme që në shkollën tonë të dominojë një grua, për arsye se është e bukur dhe arsimtarët t'ia kenë frikën se e ka burrin me funksione të larta. Realiteti ynë nuk është i tillë, ai nuk mund të paraqitet në këtë mënyrë.

Ose le të shohim si paraqitet çështja e edukimit të rinisë në dramë. Rinia e shkollës vetëm sa kaloi një herë me tambura në skenë, pastaj, gjatë gjithë zhvillimit të ngjarjeve, veprimtaria e saj doli vetëm nëpërmjet gojës së djalit të paedukuar të mjekut dhe fjalë-

ve të mësueses. Kjo e fundit i mburr elementët revolucionarë, kurse personazhet e tjera, që përfaqësojnë zërin e masës ose të Partisë, asgjë nuk thonë në këtë drejtim. Elementët mikroborgjezë bëjnë në këtë dramë edhe «filozofi të lartë».

Batutat vështirë të mbahen mend me një të dëgjuar, prandaj duhen lexuar, megjithatë përshtypja ime është se ato nuk ishin për masën e popullit, së cilës nuk i mbetej gjë në kujtesë prej tyre. A mund të luftohet vetëm me batuta kundër elementëve mikroborgjezë, siç bëhet në këtë pjesë? Unë mendoj që jo, kundër shfaqjeve negative luftohet, në radhë të parë, me veprime, me aksione, me luftë, ndryshe nuk i shërbehet qëllimit. Nuk është i mjaftueshëm vetëm shtrimi i çështjeve, natyrisht, ne duhet të përpiqemi, në radhë të parë, t'i kuptojmë ato drejt ideologjikisht, por, bashkë me këtë, është i domosdoshëm edhe veprimi, aksioni për zgjidhjen drejt e deri në fund të tyre. Ka çështje që kuptohen fare mirë ideologjikisht. Për shembull, dihet që, po t'i shash një komunisti brigadierin, kur ky është i bindur se kjo është e ndershme, nuk ta pranon dhe mban qëndrim. Por kjo s'mjafton. Komunisti nuk duhet të presë sa të bëhet mbledhja që t'ia raportoje këtë çështje organizatës-bazë të Partisë, por të kërkojë që të veprohet menjëherë sipas rastit. Duke vepruar në këtë mënyrë, elementi negativ do të frenohet dhe do të edukohet.

Këto janë probleme që, natyrisht, nuk zgjidhen në një ditë ose me një të thënë dhe as me inat, por kërkojnë kurdoherë gjakftohtësi dhe kujdes, kërkojnë t'u qëndrohet vazhdimisht në kokë që të luftohen me-

njëherë porsa shfaqen, ndryshe trashen dhe na dëmtojnë.

Jam i mendimit se shokët që dërguam në rrethin e Tepelenës për të analizuar shkaqet e ngjarjes tragjike që ndodhi atje, kanë vepruar drejt. Tani mbetet që atyre që gabuan në këtë çështje dhe u shkarkuan nga detyrat që kishin, t'u gjejmë ndonjë punë tjetër. Ata vërtet kanë gabuar, por besoj që tani e kanë kuptuar gabimin, ndoshta teorikisht jo akoma në shkallën e duhur, por e kanë ndier, prandaj të kujdesemi që të edukohen, t'i ndihmojmë të korrigjojnë gabimet dhe të ndregen.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

**TË TILLË HERONJ DO TË MBETEN PËRJETË
PISHTARË QË DO T'U NDRIÇOJNË RRUGËN
BREZAVE TË SOTËM DHE TË ARDHSHEM
TË SHQIPËRISË**

*Letër drejtuar familjes së Heroit të Punës Socialiste
Isuf Plloçi*

14 nëntor 1969

Të dashur Fahrije, Hava, Riza, Sanije dhe Lene,

Akti shembullor i Isufit për mbrojtjen e pasurisë socialiste, si dhe letra që më dërguat me shprehjet e dashurisë e të besimit të madh për Partinë më kanë prekur thellë.

Shoku ynë i dashur, biri i shtrenjtë i Partisë dhe djali, bashkëshorti, vëllai e i dashuri juaj, komunisti Isuf Plloçi, lindur dhe rritur në atë vatër të thjeshtë malësori, njohu që në fëmijëri mjerimin dhe varfërinë, prandaj ai përqafoi pa ngurrim thirrjen e Partisë, rroku pushkën dhe luftoi me trimëri për çlirimin e atdheut nga pushtuesit e nga tradhtarët në radhët e batalionit partizan që udhëhiqte në pyjet dhe në bjeskët tuaja Heroi i Popullit, Baba Faja Martaneshi. Pas Çlirimit, me të njëjtën devotshmëri, Isufi punoi me nder si komunist për ndërtimin e Shqipërisë socialiste, duke mbajtur lart gjer në fund të jetës emrin e anëtarit të Partisë.

I vetëm në mes të pyllit dhe përballë flakëve që i përvëluan trupin, duke përçmuar vdekjen dhe duke vënë mbi çdo gjë tjetër interesat e popullit dhe të Partisë, ai luftoi me guxim prej komunisti, patrioti e luftëtari të papërkulur për të shpëtuar pronën e përbashkët socialiste, pyllin, që ai e vlerësonte lart, si një pasuri me vlerë të madhe për ekonominë popullore. Si një komunist i vendosur dhe me një kuptim të lartë për qenien e tij si anëtar i Partisë së lavdishme të Punës, në ato momente supreme e shumë të vështira, kur rrobat dhe trupi po i digjeshin, ai mendoi me gjakftohtësi dhe mbrojti të paprekur nga zjarri taserën e Partisë, duke treguar me këtë akt tjetër të lartë çfarë komunisti ishte. Isufi luftoi dhe fitoi sepse ishte trim, sepse të tillë e kishin rritur populli dhe familja, të tillë e kishte edukuar dhe e kishte kalitur atë Partia, në gjirin e së cilës militoi për shumë vjet.

Duke çmuar aktin e shokut tonë Isuf Plloçi, Presidiumi i Kuvendit Popullor, me propozimin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë, i akordoi atij titullin e lartë «Hero i Punës Socialiste».

Me të tillë heronj krenohen Partia dhe populli, krenoheni me të drejtë edhe ju. Jeta dhe vepra e Isufit janë të pavdekshme. Ato, bashkë me veprat e heronjve të tjerë, do të mbeten përjetë pishtarë që do t'u ndriçojnë rrugën brezave të sotëm dhe të ardhshëm të Shqipërisë, që, nën udhëheqjen e Partisë, ndërtojnë socializmin dhe më vonë komunizmin.

Mua më gëzoi shumë qëndrimi juaj burrëror. Me gjithë dhimbjen e madhe për humbjen e papritur të të dashurit tuaj, ju nuk e lëshuat veten, përkundrazi, sa

morët vesh lajmin e hidhur, ndiet krenarinë e veprës së lavdishme të Isufit, që, sikurse më shkruani, gjithë pjesëtarëve të familjes suaj ua shtoi kurajën, u shumëfishoi forcat dhe vendosmërinë që edhe ju të gjithë të jeni kurdoherë ushtarë besnikë të Partisë, siç ishte ai. Unë jam i bindur për ato që më shkruani, sepse martaneshasit, me burra e gra, i njoh personalisht për trimërinë, për patriotizmin e për dashurinë e madhe për atdheun dhe për Partinë, pasi në kohët e vështira të Luftës Nacionalçlirimtare kam punuar e kam jetuar në kasollet e tyre.

Me rastin e pranimit të Sanijes në radhët e Partisë, dëshiroj t'i uroj asaj, si komuniste e re, suksese në punë dhe kam besim se, në shembullin e xhaxhait, ajo do të ecë gjithnjë përpara si trimëreshë, do të kapërcejë me sukses çdo pengesë e vështirësi në përpjekjet e përditshme për të zbatuar çfarëdo detyre që do t'i ngarkohet. Sot ajo, nesër fëmijët e shokut tonë të paharruar, Isufit, do të bëhen revolucionarë të vërtetë si babai i tyre.

Ju uroj shëndet dhe ju përqafoj të gjithë me dashuri.

J u a j i

Enver Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 273 (6625), 15 nëntor 1969

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i popullit», nr. 273 (6625), 15 nëntor 1969

**DUKE FITUAR EKSPERIENCË DHE NJOHURI
TEKNIKE, JU DO TË KRYENI DETYRA
TË NDËRLIKUARA**

*Nga biseda me një grup punonjësish të Fabrikës
së Llambave Elektrike të Vlorës*

22 nëntor 1969

Pasi pa llambat e prodhuara për herë të parë në vendin tonë nga punonjësit e kësaj fabrike, shoku Enver Hoxha bisedoi për zemërsisht me përfaqësuesit e kolektivit të saj.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju përgëzoj nga zemra për nxjerrjen e prodhimeve të para të Fabrikës suaj të Llambave Elektrike. Për ne, që po bëjmë tani elektrifikimin e gjithë vendit, ky është një sukses i madh, pse këtej e tutje do të na duhen shumë llamba elektrike për të plotësuar nevojat e popullit për ndriçim. Këto tani nuk do t'i importojmë, por do t'i prodhojmë vetë.

Me këtë rast na shpjegoni pak, ju lutem, si shkojnë punët te ju dhe si po i kapërceni vështirësitë e fillimit.

SHOKU JAZO MALAJ: Deri tani, shoku Enver,

ka filluar nga prodhimi vetëm linja e parë e llambave inkandeshente, ndërsa linja e dytë, ajo e prodhimit të llambave lumineshente, nuk ka filluar akoma, por besojmë se së shpejti do të fillojë.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju kanë ardhur të gjitha pajisjet e nevojshme?

SHOKU JAZO MALAJ: Po, na kanë ardhur.

SHOKU ENVER HOXHA: Si i bëni llambat, me presa apo me fryrje?

SHOQJA OLIMBI MYSHKERI: Me fryrje automatike.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe boshllëkun po ashtu e bëni?

SHOQJA OLIMBI MYSHKERI: Po, me fryrje automatike edhe atë.

SHOKU ENVER HOXHA: Llojet e tjera të llambave, që përdoren për ndriçim, këtu do t'i bëni?

SHOKU MINELLA MONE: Këtu, bile kemi filluar të punojmë në këtë drejtim. Në fabrikën tonë do të punohen në mënyrë automatike edhe tubat e llambave neon.

SHOKU ENVER HOXHA: Si ju kanë dalë provat që keni bërë?

SHOKU JAZO MALAJ: Prodhimet e para pas provave që kemi bërë, kanë dalë të mira.

SHOKU ENVER HOXHA: Po rezistenca e tyre është provuar?

SHOKU MINELLA MONE: Po, është provuar, vetëm se nuk i kemi lënë për një kohë prej 24 orësh, siç i kërkojnë kushtet teknike. Para 15 ditëve ne prodhuam llamba gjysmëfabrikate.

SHOKU ENVER HOXHA: Cili është problemi më delikat gjatë procesit të prodhimit në fabrikën tuaj?

SHOQJA OLIMBI MYSHKERI: Problemi më delikat i procesit të prodhimit është shkrija.

SHOKU ENVER HOXHA: Që të jetë llamba më rezistente, ndoshta duhet treguar kujdes për filamentin dhe për krijimin qind për qind të vakuimit.

SHOKU JAZO MALAJ: Me vakuum të plotë janë llambat 15-20 volt, kurse llambat 20-200 volt mbushen me gaz.

SHOKU ENVER HOXHA: Të gjitha këto, si llambat me vakuum të plotë, edhe ato që mbushen me gaz, duhet të kontrollohen me mjete të posaçme, të kërkohet me këmbëngulje plotësimi i rregullave teknike, sepse shkelja e tyre shkakton djegien e filamentit.

SHOQJA OLIMBI MYSHKERI: Kur ka djegie në kemi aparate të posaçme që e tregojnë këtë. Aparatet na tregojnë, gjithashtu, edhe sasinë e nevojshme të gazit.

SHOKU ENVER HOXHA: Aparatet dhe materialet që sjellim nga jashtë, duhet të jenë patjetër me cilësi të mirë. Vëmë re se llambat që vijnë nga Hungaria nuk janë rezistente. Ç'kanë ato që pëlcasin?

SHOQJA OLIMBI MYSHKERI: Plasja e llambave shkaktohet në dy raste: kur filamentin është i dobët, ose kur brenda në llambë mbetet akoma oksigjen.

SHOKU ENVER HOXHA: Sa lloj volframi ka? Nuk ka volfram me çmime më të ulëta? Ne duhet të përpiqemi që të gjejmë volfram të mirë. Po argoni çfarë gazi është?

SHOQJA OLIMBI MYSHKERI: Argoni është një gaz i rrallë, si oksigjeni. Ai ka veti të mos veprojë në substanca të tjera.

SHOKU ENVER HOXHA: Po, ashtu si për llambat e tjera, edhe për llambat neon argoni ndihmon që fijet të mos digjen shpejt. Neve na duhet që llambat të jenë rezistente, ndryshe njerëzit do t'ju shajnë. Po t'u digjen shpejt, ata do të thonë: «Ama, ç'po na bëjnë këta vlonjatët, atyre u ndez pushka, por jo llambat!». Prandaj kini mendjen në këtë drejtim që llambat jo vetëm të ndizen, por edhe të rezistojnë shumë, kjo ka rëndësi për nderin e kolektivit tuaj në atë fabrikë të re, të bukur.

SHOKU JAZO MALAJ: Edhe furrat e fabrikës sonë janë të mira.

SHOKU ENVER HOXHA: Furrat dhe labororët duhet të shkëlqejnë nga pastërtia.

Sot fabrika juaj e llambave është e vogël, por në të ardhmen e afërt ne duhet të mendojmë që ta rritim kapacitetin e saj, sepse nuk mund të ecet vetëm me tre milionë llamba në vit, apo jo? Prandaj na duhet ta zmadhojmë fabrikën. Perspektivat janë, por janë edhe nevojat, të cilat sa vjen e shtohen dhe jo vetëm për ndriçim, po edhe për llambat e radiove, të televizorëve etj.

Do të vijë shpejt koha që radiot të kthehen në një mjet shumë të zakonshëm, të përdorshëm nga të gjithë njerëzit. Gjatë përdorimit të tyre do të ndodhë që llambat të digjen, prandaj duhen prodhuar këtu në vend pjesët e këmbimit dhe veglat që kërkohen për riparimin e tyre. Te ne, siç dihet, ka radio të

markave të ndryshme. Në qoftë se do të presim të na i sjellin nga jashtë llambat e radiove ose pjesët e këmbimit për to, kjo punë jo vetëm do të kërkojë shpenzime të mëdha në devizë, por ka dhe shumë vështirësi të tjera, prandaj del nevoja që këto të prodhohen në vend. Natyrisht, llamba të tilla kërkojnë makineri më të ndërlikuara dhe një nivel më të lartë teknik e profesional të punonjësve, të cilët duhet të bëjnë përpjekje që t'i zgjerojnë njohuritë dhe t'i vënë në jetë.

Është e qartë se të gjitha llojet e llambave që do të na duhen, nuk bëhen dot brenda një viti, por gradualisht. Rëndësi ka që ne krijuam një herë bazën e nevojshme. Tani në fillim të kënaqemi që po bëjmë llambat elektrike për ndriçim, në të ardhmen do të bëjmë edhe llambat e radiove, duke nisur punën nga ato më të thjeshtat e kështu me radhë të kalojmë në prodhimin e llambave më të komplikuar. Vetë ju, duke fituar eksperiencë gjatë punës dhe duke zgjeruar njohuritë teknike, do të kryeni gjithnjë e më shumë detyra të ndërlikuara. Tash detyra juaj është më e thjeshtë, por më vonë do të komplikohet, puna juaj do t'i ngjasë punës së një koshereje bletësh me procese fizike, kimike etj. Pra, perspektiva është e mirë, shumë e mirë, jo vetëm për fabrikën tuaj, po për gjithë Vlorën, e cila në të ardhmen do të zbukurohet edhe më shumë.

Mund të më thoni, po punohet në Vlorë për ngritjen e Uzinës së Polivinilkloridit?

SHOKU MINELLA MONE: Tash po punohet për projektin e saj.

SHOKU ENVER HOXHA: Më duket se do të ngrihet diku aty afër fabrikës suaj.

SHOKU JAZO MALAJ: Po, pak matanë Fabrikës së Sodës Kaustike.

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe kjo fabrikë ka rëndësi të madhe për vendin tonë.

Çfarë fakulteti ke mbaruar ti, shoqja Olimbi?

SHOQJA OLIMBI MYSHKERI: Kam mbaruar Fakultetin e Shkencave të Natyrës, degën e kimisë industriale.

SHOKU ENVER HOXHA: Ky fakultet nuk është i lehtë, bile është i vështirë, megjithatë gratë e ndjekin shumë. Mund të më thoni si shpjegohet kjo?

SHOQJA OLIMBI MYSHKERI: Sepse edhe grave u pëlqen të marrin pjesë në ngritjen dhe në zhvillimin e industrisë sonë socialiste.

SHOKU ENVER HOXHA: Kimia është një nga shkencat që të pajis me një horizont të gjerë krijues, është shkencë me perspektivë për studime të thella. Femrat e kanë mendjen të zhvilluar, megjithatë ka burra që i nënvleftësojnë, pse janë konservatorë. Këta mendojnë: «Kush është si burri», «ai i di të gjitha», kurse, sipas tyre, «gratë nuk dinë gjë». Po të thuash që gruaja kupton disa gjëra, ka burra që përgjigjen me qesëndi: «Po, po, ashtu është, kupton».

Nga Vlora je ti?

SHOQJA OLIMBI MYSHKERI: Unë kam lindur në Vlorë, kurse babai është nga Ulqini.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë është nga ata kapedanët e dikurshëm që merrej me lundrim?

SHOQJA OLIMBI MYSHKERI: Jo, ai është marrë me peshkim.

SHOKU ENVER HOXHA: Pikërisht për këtë po të pyes edhe unë. Ulqinakët kanë qenë detarët më të shquar të vendit tonë, ata i mbanin për kapëdanë në të kaluarën. Me varkat e tyre me vela ulqinakët shkolin tejpërtej Adriatikut, nuk trembeshin, ata ishin luftëtarë të vërtetë të detit. Babai yt, po ta pyesësh, do të të tregojë me siguri se, në mos ai, gjyshi ose stërgjyshi yt kanë udhëtuar thellë në det. Detarët e Ulqinit, të Shëngjinit, të Himarës, të Pilurit shëtisnin deteve me varkat e tyre, bile ata të Pilurit, kur vinte koha e të qethurit të dhenve, zbarkonin në Korfuz, merrnin lesh atje dhe ktheheshin në Pilur.

Në kohët e para të sundimit turk detarët shqiptarë janë bashkuar me flotën turke që luftonte kundër një ish-perandori spanjoll, që e quanin Karl, djali i të cilit, Filipi i dytë, luftoi kundër turqve në bregdetin e Afrikës, në Algjeri. Midis ushtarëve të ushtrive spanjolle ishte në atë kohë edhe shkrimtari i madh Servantes, të cilin, siç kam kënduar në një libër, shqiptarët e zunë rob. Në këtë luftim fituan turqit. E për-menda këtë histori të shkurtër për të treguar sa detarë të aftë kanë qenë të parët tanë, prandaj ne duhet ta duam fort detin tonë, të cilin e kemi edhe shumë të bukur, edhe të pasur me peshk. Anës detit tonë ngrihen qytete të bukura, si: Vlora, Durrësi, Shëngjini dhe Saranda. Por jo të gjithë e duan detin. Bile ju vlonjatët, megjithëse jeni fare afër, nuk shikoni nga deti, por më shumë nga mali. Kurse tash ka ardhur koha që të shikojmë edhe nga mali, edhe nga deti, sepse, siç

thashë, ai fsheh në gjirin e tij pasuri të mëdha. Sot ka ardhur koha që detin ta shfrytëzojmë vetë, prandaj Vlorën Partia do ta bëjë një port me rëndësi për peshkim. Peshku në sasi të mëdha nuk zihet aty afër, te dera e shtëpisë, siç bëjnë disa peshkatarë që, kur del hëna, kthehen nga peshkimi. Peshkatarët e vendeve të tjera, për të zënë peshq, venë deri në Polin e Veriut.

Peshku është një ushqim shumë i mirë dhe i shijshëm. Duke shtuar sasinë e peshkut, ne do t'i ruajmë më mirë bagëtitë, nga të cilat do të marrim mishin, leshin, qumështin etj. Partia përpiqet tani t'i shtojë bagëtitë dhe të përmirësojë racën e tyre, sidomos të lopëve, nga të cilat duhet të marrim më shumë qumësht. Kërkesat gjithnjë në rritje të popullit tonë duhet të plotësohen me mish, por duhet të plotësohen edhe me peshk. Peshk tani për tani nuk kemi sa duhet. Që ta zëmë atë në sasi të mjaftueshme, nevojiten edhe mjete, si varka e sende të tjera që do t'i sigurojmë. Unë di që peshkatarët tanë i bënin vetë varkat, me dru. Ata venin në pyll, merrnin dru, i zdrugonin, i lyejnë me katran dhe me këtë mënyrë përgatitnin varkat.

Ne tash, natyrisht, nuk mund të peshkojmë në dete të tjera me mjete primitive, prandaj del nevoja të kemi edhe mjete moderne, po kjo nuk do të thotë që, krahas mjeteve moderne, të mos përdorim varkat e thjeshta. Peshkatarët italianë që janë kapur në disa raste nga detarët tanë duke peshkuar në ujërat tona territoriale, kanë pasur edhe varka të thjeshta. Ata vijnë, pra, të kapin peshkun tonë, pse ne nuk i shfry-

tëzojmë të gjitha mundësitë që ekzistojnë për peshkim as në afërsitë e bregdetit tonë.

Për të gjitha këto që thashë del problemi që ta zgjerojmë Portin e Vlorës. Por sukseset që synon të arrijë Partia, si në çdo sektor, edhe në atë të peshkimit, në fund të fundit varen nga puna e mirë e njerëzve, nga realizimi i planeve dhe i akumulimeve. Për ndërtimin me hapa të shpejtë të socializmit në vendin tonë duhet të akumulohet më shumë, sigurisht, pa kapërcyer raportet dhe vendimin e marrë nga Kongresi i 5-të i Partisë, i cili na orienton që nga të ardhurat kombëtare për konsumin shoqëror e vetjak të përdoren 71,8 për qind, kurse për akumulimin 28,2 për qind. Ky përpjesëtim në shpërndarjen e të ardhurave kombëtare ndihmon shumë për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës në vendin tonë.

Ti shoku Jazo në cilin repart punon?

SHOKU JAZO MALAJ: Unë jam mekanik. Më parë kam punuar në organet e punëve të brendshme.

SHOKU ENVER HOXHA: Shumë mirë ke bërë që ke mësuar edhe profesionin e mekanikut.

Po ti Minella ku punon?

SHOKU MINELLA MONE: Edhe unë punoj në një repart, jam edhe sekretar i organizatës-bazë të Partisë të fabrikës.

SHOKU ENVER HOXHA: Kurse ti shoqja Olimbi je inxhinierë. Kështu dukesh vajzë e mirë, po shokun e jetës nuk e ke gjetur akoma. Ti je e re dhe duhet të përpiqesh ta zgjedhësh shokun me të cilin do të krijosh një familje të lumtur socialiste.

Për të rejat dhe për të rinjtë tanë rruga tani

është hapur nga Partia, pse nën udhëheqjen e saj po luftohet me sukses kundër mbeturinave të botës së vjetër. Natyrisht, për shkak të mbeturinave të trashëguara nga e kaluara, ekzistojnë akoma koncepte jo të drejta në ndërgjegjen e njerëzve. Për shembull, kur flitet për dashurinë, njerëzit skuqen, nuk e kuptojnë që kjo është një kërkesë e natyrshme për njeriun. Marksi ka shkruar shumë për këtë çështje, ai ka sulmuar ashpër mendimet e mykura idealiste të kohës së tij. Sidomos në librin «Familja e shenjtë» ose «Kritika e kritikës kritike», që kanë shkruar kundër filozofëve vëllezër Bauer, dy austriakë idealistë që hiqeshin si teoricienë dhe kritikë, të cilët përçmonin ndjenjat e pastra të njerëzve për dashurinë, Marksi dhe Engelsi u bënë një luftë të ashpër pikëpamjeve të tyre. Në këtë vepër flitet se si Bauerët, me qëllim që ta shkëputnin gruan nga realiteti, e quanin dashurinë si çështje kalamanësh. Duke u nisur nga pozita krejt idealiste, ata donin ta zhvishnin njeriun nga ndjenjat e dashurisë, e paraqitnin dashurinë si një perëndi të egër që quhet «Molloh», e cila jo vetëm të vret shpirtërisht, por të dëmton edhe fizikisht. Kjo «teori» injoron të vërtetën dhe njeriun e shkëput nga të gjitha ndjenjat dhe sentimentet e tij.

Me këtë dua të them se ka akoma shumë mbeturina të trashëguara nga e kaluara, nga të cilat ne duhet të ruhem. Kjo arrihet duke pasur gjithmonë parasysh mësimet e Partisë. Të thellohemi në këto mësimet, dhe në një çështje kaq delikate e intime, siç është dashuria, vajza ose djali të mos jenë të shpejtuar, të ruajnë gjykimin e shëndoshë, pse nga disa

hapa të pamatur (dhe gjatë jetës ngjasin lloj-lloj gjërash) shfaqet te meshkujt atavizmi i madh i së kaluarës, ngrihen kuçot e gjyshit dhe i mbërthejnë. Të gjithë njerëzit që jetojnë në kohën e Partisë, qofshin komunistë ose patriotë të paorganizuar në Parti, duhet t'i kuptojnë drejt këto fenomene shoqërore. Kur vajza dashuron një djalë, prindi, si njeri i pjekur dhe me eksperiencë të gjatë në jetë, duhet të interesohet që djali me të cilin do të lidhet vajza e vet të jetë i mirë dhe i përshtatshëm. Edhe kjo nga ana e vet duhet të dëgjojë me kujdes këshillat e mira të prindërve, por të mos lejojë në asnjë mënyrë që liria dhe dinjiteti i saj si femër të merren nëpër këmbë nga konservatorët dhe prapanikët. Në raste të tilla vajza duhet të ngrihet mbi opinionin konservator dhe të mendojë seriozisht për të ardhmen e saj.

U gëzova shumë që erdhët për t'u takuar dhe për të më treguar prodhimet tuaja të para. Më falni që ju mbajta gjatë. Ju falënderoj përzemërsisht për këtë dhuratë, që është kujtim i prodhimit të parë të llambave elektrike në vendin tonë. Dhurata të tilla ne i mbajmë në një muze të vogël të aparatit të Komitetit Qendror, ku kemi mjaft objekte të kësaj natyre.

Ju uroj dhe ju përgëzoj ju dhe gjithë kolektivin tuaj punonjës për sukseset që keni arritur. Kur të ktheheni në Vlorë, u transmetoni shoqeve dhe shokëve, punëtorë dhe punëtore, drejtuesve të fabrikës urimet e mia më të ngrohta dhe më të përzemërta. Kur t'i mbaroni krejt punimet, mund të vij ndonjëherë t'ju shikoj.

SHOQJA OLIMBI MYSHKERI: Nesër, shoku Enver,

kemi inaugurimin e fabrikës. Sa shumë do të gëzonim sikur të na vinit me këtë rast!

SHOKU ENVER HOXHA: Edhe unë kam dëshirë, por nesër nuk kam mundësi të vij. Në inaugurim do të vij në shokë të tjerë.

Për mua është nder i madh që m'u dha rasti të takohem me ju, prandaj edhe një herë dëshiroj që nëpërmjet jush t'u transmetoj shoqeve dhe shokëve tuaj të fabrikës përgëzimet e mia dhe urimet për suksese më të mëdha në punë.

SHOQJA OLIMBI MYSHKERI: Ky takim për ne do të mbetet i paharruar. Shokët dhe shoqet e fabrikës na presin me padurim. Atyre do t'ua transmetojmë të gjitha këto që biseduam me Ju, sidomos këshillat shumë të vlefshme që Ju na dhatë.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

ZEMRA E PARTISË ËSHTE SHUMË MË E MADHE SE ZEMRA E NJË NËNE

*Fjala në takimin me fëmijët dhe me personelin
e shtëpisë së fëmijës «8 Nëntori» të kryeqytetit*

23 nëntor 1969

Në prag të festave të nëntorit, kolektivi i shtëpisë së fëmijës «8 Nëntori» të kryeqytetit dhe ish-nxënës të Strehës Vorfnore i dërguan një letër shokut Enver Hoxha, me të cilën e ftonin për të marrë pjesë në një takim që do të organizonin në Shtëpinë e tyre. Shoku Enver Hoxha ua plotësoi me kënaqësi dëshirën. I pritur me duartrokitje, me brohoritje entuziaste dhe me përqafime të zjarrta të vogëlushëve, ai u foli me ngrohtësi prindërore të pranishmëve në këtë takim emocionues.

E dashura shoqja drejtoreshë,

Të dashur fëmijë,

Të dashur shokë dhe shoqe,

Sa shumë jam i gëzuar sonte që ndodhem këtu në mes jush për t'ju sjellë përshëndetjet më të zjarrta të Komitetit Qendror dhe të të gjithë Partisë juve, bijave

e bijve nga më të mirët e popullit tonë, që diçka shumë e madhe dhe e dhembshur për njeriun, siç janë prindërit, ju ka munguar. Por ajo diçka e madhe dhe e dhembshur, mungesa e prindërve, ju është zëvendësuar juve me diçka tjetër shumë më të madhe, me kujdesin dhe me dashurinë e mëmës Parti, me kujdesin dhe me dashurinë e zjarrtë të mbarë popullit.

Qysh në fillim të vendosjes së pushtetit popullor, Partia dhe populli, me gjithë mundësitë e pakta që kishin në ato kohë të vështira pas Çlirimit (mbasi siç ju kanë treguar mësuesit tuaj, dëme të jashtëzakonshme në njerëz dhe në pasuri pësuar nga lufta), ju rrethuan ju me dashurinë dhe me kujdesin më të madh. Në ato kushte të mjeruara që trashëguam, populli dhe Partia iu përveshën me të gjitha forcat punës së madhe për rindërtimin e atdheut të rrënuar, por njëkohësisht ata menduan edhe për bijtë e bijat jetime si ju, pa asnjë dallim, cilëtdo që ishin, mjaft që ishin djemtë e vajzat e popullit punonjës, të shtypur e të shfrytëzuar deri në palcë në të kaluarën. Mbështetur në vijën e saj të drejtë, Partia nuk pa nëse ky ose kjo ishin djalë apo vajzë e dëshmorit partizan, e fshatarit ose e punëtorit apo e qytetarit, që kishte vdekur normalisht jo në luftë, ose bir apo bijë e një vajze nga të popullit të mjeruar, së cilës i kishte ndodhur një aksident në jetë. Të gjithë këta Partia i mblodhi pa dallim dhe vendosi t'i rritë e t'i edukojë si bijtë dhe bijat e saj, t'i rritë e t'i edukojë me idealet marksiste-leniniste, t'i bëjë luftëtarë të çështjes së saj të madhe, siç i bëri e siç do t'i bëjë edhe në të ardh-

men, ashtu si gjithë të tjerët, edhe ata që do të kalojnë në institucione si ky, njerëz të vlefshëm, shtylla të atdheut tonë socialist.

Në sajë të këtij kujdesi prindëror, nga ky institucion kanë dalë në jetë sa e sa shoqe dhe shokë të shquar, shumë prej të cilëve ndjekin ende shkollat. Djem e vajza të tjera akoma më të vogla vazhdojnë të rriten e të edukohen nëpër befotrofe e shtëpi fëmijësh si kjo juaja, kurdoherë me të njëjtin synim, të përgatiten që nesër edhe ata të japin si të gjitha bijat e bijtë e tjerë të këtij populli heroik, nën udhëheqjen e Partisë, kontributin e tyre të çmueshëm në ndërtimin e shoqërisë sonë socialiste.

Shoh se ju po brohoritni me gjithë shpirt për Partinë tonë të Punës. Është plotësisht e kuptueshme për të gjithë ne kjo dashuri e madhe që shprehni ju për mëmën tonë të madhe. Nënës që më lindi mua asnjë nga ju nuk ia di emrin, kurse emrin e nënës suaj, emrin e nënës së madhe të të gjithë neve, emrin e Partisë së lavdishme të Punës të Shqipërisë, e di e gjithë bota. Nëna që më lindi mua më donte shumë, ajo donte shumë edhe popullin, por zemra e Partisë është një zemër shumë më e madhe se zemra e një nëne të vetme, ajo është një zemër bujare që kujdeset për të gjithë popullin. Nëna ime vdiq, po Partia nuk vdes, pse ajo mishëron idetë e mëdha të materializmit historik, prandaj s'ka e s'do të ketë mortje kurrë. Vepra e Partisë do të rrojë në shekuj, pse çdo furtunë apo stuhë që do t'i dalë Partisë përpara në rrugën e saj, sado e tmerrshme që të jetë, do të mposhtet, do të

thyhet e do të bëhet copë e thërrime përpara forcës së madhe të popullit dhe të Partisë.

Të gjitha sukseset e mëdha të arritura deri sot, që ia kanë ndryshuar faqen Shqipërisë, janë realizuar në sajë të vijës së drejtë të Partisë, që është diçka materiale, e prekshme, konkrete, e lidhur ngushtë me dëshirat e zjarrta të popullit, me mundësitë, me aftësitë krijuese të njerëzve tanë, që ajo di t'i vërë në lëvizje jo jashtë kohës, po brenda saj dhe mbi këtë tokë. Partia di t'i organizojë, t'i kombinojë, t'i drejtojë e t'i sqarojë njerëzit. Me rrezet e zjarrta të dritës së saj, ajo u tregon atyre drejtimin nga duhet të ecin. Varet vetëm nga ne dhe nga askush tjetër që këto që themi të bëhen realitet.

Po të mos ishte e tillë vija e Partisë, masat tona punonjëse nuk do ta ndiqnin dhe nuk do ta zbatonin atë, do ta linin Partinë në rrugë. Por përkundrazi, njerëzit tanë e ndoqën dhe e ndjekin atë me vendosmëri e me besnikëri të madhe, ata lënë kokën për Partinë, sepse ajo është jeta e tyre, jeta e kalamanëve dhe e së ardhmes së atdheut. Prandaj populli shqiptar i thotë Partisë së vet: «Hapna sytë, tregona shtigjet nga duhet të ecim, ç'rrugë të ndjekim, na trego të këqijat që duhet të spastrojmë dhe na sqaro për çdo çështje që s'e kuptojmë. Ka raste, mëma jonë Parti, që ne bijtë e tu bëjmë edhe gabime, po e dimë sa e gjerë, sa e madhe është zemra jote, ajo na i fal gabimet dhe ne ecim drejt përpara, prandaj na trego ç'duhet të bëjmë dhe ne do ta kryejmë gjer në fund çdo porosi tënden, do të ecim kurdoherë në rrugën ku na udhëheq ti!». Dhe Partia na e ka treguar dhe vazhdi-

misht na e tregon rrugën nëpër të cilën duhet të kalojmë, prandaj ne po jetojmë në kohën e një transformimi të paparë të atdheut, transformim kolosal material, ekonomik, në drejtim të mirëqenies së njerëzve, njëkohësisht edhe një transformim i gjithanshëm shpirtëror në drejtim të zbukurimit dhe të rritjes së pandërprerë të ndërgjegjes së njeriut tonë të ri.

Për transformimin e pandërprerë të ndërgjegjes së njeriut tregon kujdes të vazhdueshëm Partia, pse ajo e di që, po të arrijë ta pajisë, ta zbukurojë, ta kalitë çdo orë, çdo ditë, çdo muaj e çdo vit njeriun tonë nga pikëpamja e ndërgjegjes me mësimet e marksizëm-leninizmit, domethënë ta bëjë atë që të ushqejë për shokun, për vëllanë, për të afërmin e tij ndjenjat më të pastra, një dashuri të pafund, po të arrijë që ta bëjë atë të jetë kurdoherë i drejtë, i ndershëm, punëtor, i sakrificës dhe i vendosur për të zhdukur në veten e tij çdo njollë të së kaluarës, atëherë çdo detyrë, qoftë kjo edhe jashtëzakonisht e vështirë dhe e ndërlikuar, do të realizohet me sukses të plotë dhe brenda një kohe rekord. Një njeri që brumoset çdo ditë me mësimet e Partisë, me ideologjinë marksiste-leniniste, me ndjenja të pastra, përvetëson me shpejtësi gjithçka të mirë e pozitive, çdo njohuri shkencore apo normë të moralit tonë të lartë komunist, për t'i vënë ato në shërbim të atdheut tonë socialist dhe të mbarë njerëzimit. Kur të arrijmë ta përgatitim plotësisht njeriun tonë me të tilla virtyte të larta, atëherë do të shohim ç'forcë e madhe do të krijohet në këtë vend, ç'male do të rrëzohen e ç'hidrocentrale të fuqishme e fabrika moderne do të

ndërtohen me shpejtësi, sa shumë pjellore do të bëhen fushat tona, gjëra këto që tani njeriu as që mund t'i marrë dot me mend.

Po kush do t'i realizojë gjithë këto detyra të mëdha? Njerëzit e Shqipërisë, burrat e gratë, vajzat e djemtë, të rinjtë e të rejat si ju që edukon, kalit e frymëzon Partia me vijën e saj të drejtë, me luftën e saj të paepur. Prandaj t'i ndjekim me vëmendje të madhe mësimet e Partisë, fëmijë të dashur, të punojmë me zell çdo ditë, çdo orë dhe minutë, kudo që jemi, të punojmë me zell e me këmbëngulje sidomos për të spastruar nga ndërgjegjja jonë mbeturinat, pse ato na qepen si ferrat që na grisnin trupin. Ato na shfaqen neve në një mijë mënyra e në forma nga më të ndryshmet. Bile, edhe kur mendojmë se i kemi zhdukur, disa prej tyre na dalin përsëri në forma që as i parashikojmë dot. Prandaj, që t'i luftojmë ato me sukses, në çfarëdo forme e mënyre dhe në çdo kohë që të paraqiten, duhet t'i kemi sytë vazhdimisht hapur dhe mendjen kurdoherë te Partia dhe tek ideologjia e saj marksiste-leniniste.

Tani dëshiroj të flas pak me ju për disa çështje që mendoj se është e nevojshme të kuptohen drejt nga të gjithë. Të vegjlit mbase nuk do të më kuptojnë dot, por ju, shoqe dhe shokë të mëdhenj që keni kaluar nga ky institucion, kam bindjen se do të më kuptoni drejt. Ka në mes jush që i njohin prindërit e tyre, por ata u kanë vdekur, ka edhe disa që nuk kanë njohur as nënën as babain dhe kjo është pa dyshim një fatkeqësi. Po mos vallë jeni ju fajtorë për këtë? Në asnjë mënyrë jo, thotë Partia. Aq sa është

fajtor djali im apo i një tjetri, që i ka babain dhe nënën, aq janë fajtorë edhe ata që nuk i njohin nënën dhe babain e tyre. Prandaj në drejtim të tyre ne duhet ta shqelmojmë me neveri pikëpamjen e vjetër borgjeze dhe përcmuese ndaj fëmijëve të kësaj kategorie. Partia na mëson se këta janë kreatyra njerëzore, janë fëmijë si dhe gjithë të tjerët, po aq të vlefshëm, po aq të ndershëm sa bijat dhe bijtë e atyre që kanë prindër, pa asnjë ndryshim. Prandaj nuk lejohet që ata të shihen dhe të cilësohen ndryshe nga të tjerët. Kjo të jetë e qartë për të gjithë.

Ndokush nga ju që nuk e njeh nënën, nuk është aspak e drejtë të quhet «fryti i krimi», siç e konsideron atë borgjezia, që kalamanëve e njerëzve të tillë u atribuon njëqind tituj të këqij, por ju jeni fryti i një dashurie e pasioni të zjarrtë. Ky pasion i prindërve tuaj të panjohur që ju konceptoi ju, për shumë arsye s'e pati të gjatë. Pasioni, siç duan ta paraqesin idealistët borgjezë, nuk është një perëndi e egër që torturon shpirtrat e njerëzve dhe gërryen fizikun e tyre, ai është një ndjenjë e pastër njerëzore, që ekuilibron e zbukuron jetën e njerëzve, kalit familjen, çimenton ndjenjat e çiftit që ka vendosur të rrojë së toku.

Në shumë vepra të tij Karl Marksi i ka dërrmuar të gjithë pseudofilozofët borgjezë, veçanërisht vëllezërit Bauer që kërkonin të ndanin njeriun nga ndjenjat e tij të vërteta. Këndeje dua të vij tani tek ajo që thashë, te mëma e panjohur e ndonjërit nga ju. Mund të quhet ajo fajtorë? I duhet hedhur vallë asaj guri, siç bëjnë borgjezia dhe shoqëria e saj? Në asnjë mënyrë jo!

Prandaj, pavarësisht se ndonjëri nga ju nuk e njeh nënën, në zemrën e tij ai duhet të ushqejë dashuri dhe respekt për të, sepse është ajo që e mbajti nëntë muaj në bark, e ushqeui dhe e rriti me gjakun, me mishin, me lotët e brengat e saj, në luftë të përditshme me opinionin reaksionar dhe me ankthin se mos e dënonin apo edhe e vritnin. Një vajzë e tillë që i bëri ballë opinionit dhe që nuk e prishi fëmijën e vet, nuk mund të mos konsiderohet trime e përparimtare. Partia më ka mësuar ta mbroj këtë mëmë dhe jo babain që hodhi gurin e fshehu dorën. Pikërisht mëma e panjohur duhet të gëzojë dashurinë e fëmijës së vet, që në kushte të vështira e ruajti atë me aq kujdes. Por ndonjëri mund të thotë: «E po mirë, po më vonë ajo pse s'më njohu mua?». Ju kërkoj ndjesë për mëmën tuaj të panjohur, po dëshiroj t'ju them se tash ju jeni rritur dhe i kuptoni gjërat: nëna e mjerë e panjohur nuk mundi të përballonte dot më tej opinionin, ajo arriti deri atje sa t'jua ruajë jetën dhe kjo është kryesorja në kushtet e krijuara në vendin tonë pas Çlirimit. Në këto kushte të vështira për veten e saj dhe për fëmijën, asaj i shkoi mendja drejt, mendoi ta sigurojë krijesën e saj duke ua dorëzuar mëmës Parti dhe diktaturës së proletariatit, e bindur se ato do t'ia rritnin me kujdes të madh, me nder e respekt. Dhe mëma nuk u gabua.

Partia, vëllezër dhe motra, vajza dhe djem, vazhdimisht ka luftuar dhe lufton që çdo gjë të kryhet brenda normave të reja të shoqërisë sonë. Por, siç e dimë, kjo shoqëri trashëgon nga e kaluara shumë njolla. Janë këto që detyruan nënën dhe babain tuaj të panjo-

hur, që pasi mbajtën për një kohë kontakt në mes tyre, më vonë, pas ndodhjes së aksidentit, u ndanë. Shumë faktorë mund të kenë determinuar në këtë ndarje, për ndonjërin pasuria, për ndonjë tjetër thashethemet, për ndonjërin presionet e familjes etj., etj., prandaj t'i njohim dhe t'i kuptojmë drejt këto çështje, sepse vetëm kështu do të luftojmë në rrugë të drejtë në jetë.

Në rrugën e Partisë ne duhet të kuptojmë ç'është dashuria proletare. Kur një djalë i ri e një vajzë e re simpatizohen e më vonë dashurohen, sigurisht shkojnë drejt martesës, prandaj gjatë kësaj kohe ata duhet ta njohin mirë njëri-tjetrin, po, për çimentimin e dashurisë së tyre, me ndjenjat e pasionet duhet të gërshetohet edhe arsyeja. Prandaj shokun e jetës njeriu duhet ta vlerësojë nga shumë pikëpamje, të ketë ndjenja të pastra dashurie për të, ta vlerësojë nga pikëpamja e ndershmërisë, e dashurisë ndaj atdheut, popullit dhe Partisë. Po të gjejnë te njëri-tjetri këto cilësi, vajza dhe djali le të duhen pastaj midis tyre me zjarr e pasion në rrugën e drejtë proletare. Duke gërshetuar logjikën me ndjenjat dhe pasionet, jeta e vajzës dhe e djalit do të jetë e siguar përjetë në unitet dhe nuk do të na ngjasin aksidente si ato që u kanë ndodhur disa mëmave të mjeruara në të kaluarën.

Ne duhet të luftojmë që ngjarje të tilla të mos na ndodhin më. Por kjo do të arrihet kur të bëjmë përpjekje që të edukohemi drejt, të riedukohemi, të zdrukohemi vazhdimisht me mësimet e Partisë, pse kështu do të shmangim sa të jetë e mundur çdo vit e më shumë të tilla ndodhi të padëshiruara. Sa më shpejt të arrijmë që të mos kemi më befotrofe, aq më mirë do

të jetë. Por edhe në rast se ndodh një gabim në konceptimin e jetës së një kalamani në rrugë jo të rregullt, faji i përket burrit e jo gruas dhe ky faj duhet ndrequr kurdoherë në rrugën e ligjit të drejtë proletar.

Siç na mësojnë Partia dhe eksperiencia e jetës, njollat e shoqërisë së vjetër nuk mund të zhduken të gjitha përnjëherësh, prandaj nuk mund të themi se ngjarje të tilla nuk do të ketë më nesër, pasnesër, pas një-viti, pas pesë apo njëzet e pesë vjetësh, por në të ardhmen do të ketë me siguri gjithnjë më pak e kurdoherë shumë më pak dhe faktori kryesor që do të ndihmojë për të arritur aty është edukimi i njerëzve me moralin komunist dhe në veçanti emancipimi i gruas, i cili do të luajë një rol të rëndësishëm edhe në këtë çështje. Hyrja në shkallë të gjerë e vajzave dhe e grave në punë dhe në shkollë do t'i shmangë të tilla ngjarje, sepse gruaja, duke qenë një krijesë më e ndjeshme, më e pjekur, më e logjikshme, është edhe më e matur. Duke e kalitur atë gjithnjë e më shumë në rrugën e Partisë dhe në shkollën e madhe të jetës, ajo do të luftojë më fort për shmangien e gabimeve të kësaj natyre. Emancipimi i gruas, përveç të tjerave, do të luajë një rol kolosal, sidomos në kalitjen dhe në edukimin e njeriut të ri me virtyte të larta.

Për këtë arsye Partia i ka vënë një rëndësi të madhe emancipimit të gruas. Tani duhet që vetë gruaja ta marrë në dorë këtë çështje, pse ajo ka forca të mëdha dhe gjithë shoqëria të mos hezitojë aspak në këtë drejtim, sepse një hezitim, sado i vogël, në zbatimin e drejtë e të plotë të direktivave të Partisë për çështjen e gruas, dëmton shumë.

Ndonjërit mund t'i duket sikur, po t'i lihet gruas në dorë kjo çështje, do të dëmtohet uniteti i familjes, pse gruaja do të dominojë në familje. Kështu arsyetojnë ata burra që duan të ruajnë pushtetin patriarkal. Unë ju siguroj se nuk ka përse të dëmtohet ky unitet, në qoftë se çdo gjë zhvillohet në forma me të vërtetë partie, në rast se midis burrit e gruas diskutimet në familje për çështje shoqërore nuk zhvillohen në platformat e kohëve të kaluara, por në platformën e direktivave aktuale të Partisë. Familja do të forcohet shumë po të veprohet në këtë rrugë. Burri ose gruaja, gjatë diskutimit të një problemi në familje, mund të mos e kuptojnë përnjëherësh arsyetimin e njëri-tjetrit për ndonjë problem dhe kjo ngjet, por pa u zemëruar aspak me njëri-tjetrin, pa hatër të mbetur ndaj njëri-tjetrit, duke menduar se të dy janë shokë jete, edhe po s'u morën vesh me një diskutim, çështjes ata mund t'i rikthehen përsëri të nesërmen në një formë tjetër, t'ia gjejnë më mirë fillin, t'i marrin krahet dhe atëherë problemi që i preokupon, ta zëmë për çështjen e vajzës së tyre të rritur, që e ka zgjedhur vetë me dashuri të fejuarin e saj, do të zgjidhet drejt.

Kur vajza rritet, mëma e ka për detyrë dhe duhet ta pyesë atë për të ardhmen e saj, me cilin dëshiron të martohet etj. Në rast se burri reziston, kur ai nuk lejon që vajza e tij të zgjedhë atë që do, gruaja në asnjë mënyrë nuk duhet t'ia pranojë këtë qëndrim, po as burri nuk ka përse të përdorë forcën, siç e përdorte dikur për ta frikësuar ose për ta goditur, pse këto janë metoda të vjetra të dënueshme që s'duhet të kenë vend

në shoqërinë tonë socialiste. Megjithatë, kur gruaja e di ç'lakra ka në kokë bashkëshorti i saj, është mirë që mendja e saj të punojë në një mijë e një mënyra për t'ia shkukur ato, derisa t'i zhduken. Dhe është e pamundur që gruaja të mos ia zhdukë, po t'i qëndrojë si duhet burrit të vet. Pas një pune të vazhdueshme, me takt e në rrugë partie, ky do të vihet medoemos në vijë, do t'i japë patjetër të drejtë gruas, do të arsyetojë drejt se me të vërtetë duhet të pyetet vajza, se vetë duhet ta zgjedhë bashkëshortin me të cilin do të martohet ajo dhe jo prindërit.

Shumë nga ju që keni kaluar nga ky institucion, jeni të rritur tashmë dhe e kuptoni jetën më mirë nga të tjerët. Ju jeni militantë të shquar të Partisë, që punoni me zell, trimëri e heroizëm në fabrika, në ushtri, në kantiere, në opera, në ara, nëpër zyra e kudo, që jeta e popullit të bëhet gjithnjë më e bukur, më e lumtur. Por të gjithë e kemi për detyrë dhe duhet të përpiqemi që edhe këtyre pëllumbave e pëllumbeshave të vogla që jetojnë këtu, t'ua bëjmë jetën të lumtur e të gëzuar dhe t'i edukojmë e t'i mësojmë si duhet. Kjo varet shumë nga mësuesit e mësueset dhe nga gjithë personeli tjetër që punon në këtë institucion, te të cilët këta fëmijë të vegjël, përveç kujdesit të ngrohtë të mëmës së madhe Parti, duhet të shohin prindërit e tyre. Partia është ajo nënë e madhe që nuk e zëvendëson dot askush, por te mësuesit, mësueset, te kujdestarët e gjithë të tjerët ju fëmijë të dashur duhet të gjeni mëmat e baballarët që disa nga ju s'i kanë njohur. Prandaj është detyrë sa humanitare, aq edhe e domosdoshme që personeli i këtushëm të punojë shumë

më mirë se në të gjitha institucionet dhe qendrat e tjera të punës, të kujdeset shumë më mirë se për fëmijët e vet.

Kur në dimër gjyshes i kthehen fëmija nga shkolla në shtëpi, ajo i pret ata me buzë në gaz, i afron për t'u ngrohur e për t'u çlodhur ndanë zjarrit në oxhak mbi poste, hedh në bragaç misra apo gështenja dhe, në pritje derisa ato të valojnë e të ziejnë për t'ua dhënë t'i hanë, u tregon, sipas moshës, ngjarje nga jeta dhe nga historia e popullit, ndonjë përrallë etj., e, kur çlodhen, i vë të përgatitin mësimet. Prandaj, fëmijët i duan jashtëzakonisht shumë gjyshet e tyre në shtëpi, bisedojnë ngrohtë me to, u hapin zemrën për çështjet e tyre më intime, sepse shohin me prova se ato i duan me gjithë shpirt fëmijët.

Një të tillë dashuri të ngrohtë duhet të ushqejnë edhe mësueset dhe edukatorët e shtëpive të fëmijëve dhe të befotrofeve. Dhe të jeni të sigurt se, po të tregohet kujdes, dhimbsuri e dashuri prindërorë nga ana e tyre, fëmijët do t'i duan me kokë mësueset, edukatorët dhe gjithë personelin që punon këtu. Përse të mos rregullohen edhe këtu një ose dy dhoma, jo me banka e tavolina si në klasë, po si në shtëpi, po të jetë nevoja edhe me oxhak, në rast se nuk ka mundësi të ngrohen ndryshe, në të cilat fëmijët, pasi të kenë përgatitur mësimet e së nesërme, të mblidhen dhe aty mësueset t'u këndojnë këngë nga të heronjve të luftës apo të punës, t'u tregojnë ngjarje nga të trimave partizanë ose nga puna e palodhur e popullit tonë etj. dhe t'u bëhet shpirti mal? Në një ambient të tillë të ngrohtë familjar mund t'u jepen edhe ca gështenja.

apo misra që kuzhinierja ua vë me kohë të ziejnë, recitohen vjersha, mund t'u bihet veglave muzikore nga mësueset apo nga vetë fëmijët që, sipas prirjeve, mund dhe duhet t'i mësojnë në orët e lira, të tjerë ngrihen të kërcejnë etj. Çdo mbrëmje, pas përgatitjes së mësimëve, nën drejtimin e mësuesve të tyre dhe me rregull, duhet të ziejë shtëpia e fëmijës nga gëzimi e hareja dhe jo vetëm një herë në javë, pasdite të shtunave. Mësueset, po të duan, mund të marrin edhe bashkëshortët e fëmijët për të kaluar pasdarken së toku me ju. Kështu do të jetë më mirë edhe për ta, pse në vend që të merren me dy-tri fëmijë, këtu do të kenë të bëjnë me 200-300. E ku ka më mirë se të kesh 300 fëmijë! Shikoni, kur të vini ndonjëherë bragaçin me gështenja, më thërrisni edhe mua!

Dëshiroj t'ju flas tani edhe për diçka tjetër. Këtu afër kam ministrin e Arsimit, dhe, siç e di edhe ai, ne disa herë i kemi bërë vërejtje Ministrisë së Arsimit për shtëpitë e fëmijëve, prandaj mendoj se duhet të kenë marrë masa. Megjithatë, në qoftë se këto masa janë akoma të pamjaftueshme, duhet të merren masa të tjera plotësuese. Në Byronë Politike të Komitetit Qendror kemi vendosur që në befotrofe dhe në shtëpitë e fëmijëve të caktohen pedagoget më të mira të vendit tonë. Kështu duhet të veprohet edhe për gjithë personelin tjetër që parashikohet në këto institucione. Natyrisht, mëmën ato nuk kanë për ta zëvendësuar dot, po duhet të jenë gra me shpirt, që t'i afrohen shumë asaj.

Tani shteti ynë nuk është më i varfër si përpara, prandaj nuk ka arsye për të kursyer disa fonde të vo-

gla për ju, o vajza e djem të vegjël, për t'ju plotësuar nevojat që keni. S'ka dyshim që të gjithë duhet të luftojmë për kursime, po këto të bëhen gjetkë, atje ku nuk është nevoja për shpenzime të pafrytshme. Te ju nuk ka përse të bëhen kursime të paarsyeshme. Prandaj për ndonjë nevojë që mund t'ju dalë, i thoni drejtoreshës të shkojë në ministri për të bërë kërkesën.

Partia dëshiron që te ju të ketë edhe libra më shumë, pse vura re sikur nuk ka sa duhet, sido që drejtoresha më tha se keni plot. Ashtu qoftë, le të ketë, po unë jam mësuar në shtëpinë time që i kam rrafet citë, se jam shumë merak pas librave, prandaj kam frikë se mos nuk ju japin para për të tilla nevoja. Pra, edhe librat juve duhet t'ju plotësohen medoemos.

Veç kësaj, vajzat dhe djemtë, shoqja drejtoreshë, kur të venë në shkollë, duhet të jenë të veshur më mirë e më pastër nga gjithë fëmijët e tjerë. Këtë nuk e them që fëmijëve tani t'u ngrihet mendja, por e kam çështjen se ndërmjet të rejave dhe të rinjve që ndjekin shkollat, pavarësisht se në shumicën e tyre dërrmuese shpirtin e kanë të bardhë si karta, ka edhe nga ata që i ngacmojnë fëmijët pa prindër, prandaj mos lini shteg që ndonjë i edukuar keq t'u thotë atyre me përçmim: «Hë mo ti, se i shtëpisë së fëmijës je!». Të shtëpisë së fëmijës janë këta, po janë djemtë dhe çupat e Partisë dhe të popullit. Për gjithë të tjerët punojnë një baba dhe një mëmë, kurse për këta punojnë një Parti dhe një popull i tërë.

Morët vesh tani, të dashur fëmijë? Prandaj kam bindjen se do t'i viheni me vullnet të madh mësimit, do të tregoheni kurdoherë të sjellshëm e do të ushqe-

ni vazhdimisht dashuri të zjarhtë për Partinë, për mësuësit, për personelin tjetër që shërben këtu, për shoqet e shokët tuaj dhe, me punë të palodhur e sjellje shembullore, do ta meritoni plotësisht kujdesin e madh që tregojnë Partia dhe populli për ju.

Rroftë Partia!

Rroftë rinia!

Gëzuar festat!

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1969-1970», f. 164. Tiranë, 1970

Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1969-1970», f. 164. Tiranë, 1970

JU PUNËTORËT TË JENI NË FRONTIN E PARË TË PRODHIMIT DHE TË LUFTËS IDEOLOGJIKE

*Nga biseda me një grup punonjësish
të Uzinës së Instrumenteve të Precizionit të Korçës*

25 nëntor 1969

Porsa përfundoi së ndërtuari Uzina e Instrumenteve të Precizionit në rrethin e Korçës, kolektivi i saj i ri dërgoi në selinë e Komitetit Qendror të Partisë një grup punonjësish për t'i sjellë shokut Enver Hoxha mostrat e para të disa prej prodhimeve të kësaj vepre. Shoku Enver Hoxha zhvilloi me ta një bisedë të ngrohtë e të gëzuar.

SHOKU ENVER HOXHA: Mirë se na erdhët! Si jeni me shëndet? Po Korça plakë si është?

SHOKU VANGJEL KOLA: Të gjithë mirë jemi. Edhe Korça mirë është, më parë ajo ishte vërtet plakë, po sot Partia e bëri nuse.

Ne erdhëm nga Korça, me qëllim që t'ju sillnim Juve prodhimet tona të para.

SHOKU ENVER HOXHA: Pa të shikojmë një çikë çfarë keni prodhuar. Mundësisht na shpjegoni pak ç'janë këto instrumente.

Të dërguarit e kolektivit të Uzinës së Instrumenteve të Precizionit dhanë shpjegime për llojet e instrumenteve që prodhojnë, si dhe për mjediset e krijuara rreth zonës industriale të qytetit.

SHOKU ENVER HOXHA: Hajde Korçë, hajde! Sa veta punojnë sot në uzinën tuaj? A keni ngritur ndonjë shkollë?

SHOKU VANGJEL KOLA: Tani për tani punojnë 287 veta, por në të ardhmen numri i tyre do të rritet. Kurse shkollën akoma nuk e kemi ngritur, por punëtorët tanë e ndjekin atë në Uzinën Mekanike. Vitin që vjen mendojmë ta ngremë shkollën pranë uzinës së re.

SHOKU ENVER HOXHA: Po ti vajzë e ke mbaruar 8-vjeçaren?

SHOQJA VELERIKA ÇEKREZI: Kam mbaruar 8-vjeçaren dhe një kurs nëntëmujor në Tiranë.

SHOKU ENVER HOXHA: Shkollën e vazhdon?

SHOQJA VELERIKA ÇEKREZI: Unë punoj, njëkohësisht vete edhe në shkollë.

SHOKU ENVER HOXHA: Mëma jote është e kënaqur nga kjo?

SHOQJA VELERIKA ÇEKREZI: Është shumë e kënaqur. Është gjë e mirë edhe të punosh, edhe të vesh në shkollë që të mësosh.

SHOKU VANGJEL KOLA: 47 për qind e punëtorëve në uzinën tonë janë vajza. Ne kemi menduar që ta zgjerojmë më shumë numrin e tyre në uzinë, pse ato janë në gjendje të bëjnë punë të të gjitha mjeshtërive.

SHOKU ENVER HOXHA: Ju duhet t'i tërhiqni vajzat korçare në punë të tilla. Mos harroni ato vajza

që kanë mbaruar 8-vjeçaren, pse do të shikoni që nga duart e tyre do të merrni prodhime shumë të pastra.

Gëzohem shumë që në Korçë është duke u krijuar një klasë punëtores me talent. Partia po bën gjithçka që punëtorët, bashkë me nivelin politik, ideologjik e kulturor, të ngrenë edhe atë profesional. Makinat që sjellim tani nga jashtë, ose edhe ato që bëjmë vetë, janë shumë precize, moderne, por ne nuk duhet të mbetemi vetëm me to, po të bëjmë edhe të tjera. Industria jonë vazhdon të zhvillohet dhe ky zhvillim bëhet tani me mjete moderne, po për shfrytëzimin e mirë të këtyre mjeteve duhet të kesh kulturë, prandaj është e domosdoshme që punëtorët të mbarojnë shkollat. Ne po hapim e do të hapim më shumë në të ardhmen shkolla të tjera në të katër anët e vendit, ku do të mësojnë të gjithë. Më parë shokët tanë filluan të mësojnë andej-këndej nëpër kurse, ndërsa sot Partia ka hapur shkolla teknike me degë të ndryshme dhe universitetin. Është një kënaqësi e madhe për popullin dhe për Partinë tonë që po përgatiten kaq shumë kadro, të cilët do të marrin në dorë drejtimin e ndërmarrjeve të reja që po ngremë.

Ndërtimi i Uzinës së Instrumenteve të Precizionit në vendin tonë ishte shumë i nevojshëm, mbasi blerja e këtyre instrumenteve nuk ishte e leverdishme për disa arsye. Së pari, se ato kërkohen me sasi të madhe dhe duan shumë mjete transporti, së dyti, se vijën nga vende të largëta e nuk arrijnë në kohë dhe, së treti, na kushtojnë shumë, pse kur sjell një mall nga jashtë, në çmimin e tij përfshihen edhe rroga e punëtorit që i prodhon, shpenzimet e tjera, fitimi i ndër-

marrjes dhe transporti. Është krejt ndryshe kur një mall e prodhojmë në vend.

Pra, ka shumë anë të mira prodhimi i mallrave në vend, prandaj Partia na këshillon të mos kënaqemi kurrë me ato që kemi bërë, por të shikojmë ç'mund të bëjmë akoma më shumë e më mirë në të ardhmen. Kur diskutonim për veprat e planit të parë pesëvjeçar që donim të bënim, na dilnin shumë probleme, sepse ato kërkonin investime të mëdha, kuadro, dituri dhe një nivel zhvillimi të forcave prodhuese. Këto ne nuk i kishim. Të mos i bënim veprat, nuk mundej, ato duheshin ngritur medoemos, pse duhej të zhvilloheshin forcat tona prodhuese, po ne kapërcyem çdo vështirësi. Ndërtimi i socializmit në Shqipëri është i domosdoshëm dhe ne duhet të shikojmë gjithnjë e më përpara. Natyrisht, nuk mund të balancohen dot të gjitha, sidoqoftë, është e nevojshme të hedhësh hapin e parë, me qëllim që të krijohen kushte e mundësi të reja për popullin dhe për shtetin. Çdo gjë duhet bërë me llogari dhe kështu është vepruar kurdoherë nga ne. Në qoftë se shikojmë, për shembull, që plani që përgatitni ju kërkon më shumë nga sa janë mundësitë tona reale, ne do të jemi të detyruar «t'i vëmë gërshërën».

Sikur ju të na bënit disa propozime që të rritej kapaciteti i kësaj uzine për të prodhuar këtu të gjitha llojet e instrumenteve, do të na duhej një shpenzim prej, ta zëmë, 200-300 milionë lekësh. Po të fillojnë të gjithë të bëjnë kërkesa të tilla, atëherë duhet të vihet medoemos në përdorim «gërshëra». Kështu maten këto gjëra.

Është kënaqësi kur shikon realizimin e planit aktual dhe të atij pesëvjeçar. Konstatojmë se detyrat e Kongresit të 5-të të Partisë janë realizuar, bile edhe janë tejkaluar, sidomos në shumë zëra të industrisë. Bujqësia s'e ka realizuar plotësisht detyrën e pesëvjeçarit, por i është afruar shumë planit. Në transport, në investimet dhe në ndërtim detyrat i kemi tejkaluar. Ky është një sukses i madh. Rezultate të mira kemi arritur ne edhe në arsim e në kulturë.

Ka akoma gjëra që duhet të vijë nga jashtë, po ne, të dashur shokë, kemi mundësi që disa fabrika, që parashikon plani pesëvjeçar, t'i bëjmë edhe më përpara. Kështu e bëtë ju uzinën tuaj, po si këtë mund ta bëjnë edhe ata të qelqit. Hidrocentrali i Vaut të Dejës do të bëhet, gjithashtu, para afatit¹. Kjo tregon për aftësitë e njerëzve tanë në parashikime dhe në punë; ajo vërteton edhe drejtësinë e vijës së Partisë, forcën organizuese e mobilizuese të saj, duke ngritur kadro nga radhët e klasës punëtore. Zbatimi i vijës së masave i ka mobilizuar të gjithë dhe po bën që të realizohen para afatit gjithë këto vepra madhështore.

Kështu duhet të vazhdoni ju edhe në të ardhmen, që Korça juaj, si tërë Shqipëria, të rritet e të zbukurohet çdo ditë. Uzinën tuaj unë e di vetëm në plan, nuk dija që atje «qenka përmbysur dynjaja». As hotelin e madh të turizmit nuk e kam parë, pallatet e reja, gjithashtu, s'i kam parë akoma. Ju nuk e dini si

¹ Ky hidrocentral u inaugurua më 28 tetor 1971, në prapgun e 30-vjetorit të themelimit të PPSH e të Kongresit të saj të 6-të.

ka qenë Korça më parë, se keni qenë të vegjël, por unë që kam jetuar atje, e mbaj mend mirë si ishte ajo para Çlirimit të atdheut.

SHOKU VANGJEL KOLA: Tani po ndërtohen apartamente të bukura, pazari i vjetër po prishet, se atje po bëhen vepra të reja.

SHOKU ENVER HOXHA: I tërë pazari nuk duhet prishur, duhen ruajtur disa kuriozitete. Të kihet kujdes në këtë drejtim, se po të prishen disa gjëra të vjetra dhe me vlerë, ato nuk rindërtohen më, kurse ndërtimet e reja bëhen shpejt.

Po varrezat e dëshmorëve në anën e depos së ujit i keni ndërtuar? Janë bërë të bukura?

SHOKU VANGJEL KOLA: Po, janë bërë shumë të bukura. Atje është ngritur edhe monumenti i një partizani.

SHOKU ENVER HOXHA: Kush e ka bërë atë monument?

SHOKU VANGJEL KOLA: Tre skulptorë nga Korça¹.

SHOKU ENVER HOXHA: Nga e kanë bërë rrugën për në varrezat, andej nga ish-streha vorfnore?

SHOKU VANGJEL KOLA: Po, andej.

SHOKU ENVER HOXHA: Ne shkonim shpesh nga ajo anë në kohën e rinisë. Domethënë kisha e Shëngjergjit iku. Thonë gjë plakat për të? Ju bëni me kokë «jo», megjithatë unë mendoj se ato e thonë ndonjë gjë fshehurazi midis tyre.

Andej nga ana e Debojës kam parë që janë bërë

¹ Ilia Xhane, Avni Bilbili, Pirro Dollaku.

shumë ndërtesa, pishina, stadiumi, parqet, andej është edhe Shëndëllia. Kur ishim të rinj, të dielave, pasi lustronim këpucët, hekurosdim pantallonat, dilnim nga Shëndëllia, ose bënim shëtitje në bulevard. Punonim tërë javën, pastaj shkonim te Koci Bakoja ose në kinema «Mazhestik»¹.

Ç't'ju them tjetër për Korçën e paraçlirimit? Lumi atëherë kishte një urë të vjetër, atje vinte Vasili i Markos dhe hidhte një kryq në ujë. Disa njerëz, të trullosur nga mashtrimet e fesë, me gjithë të ftohtit e madh, futeshin në ujë për të marrë kryqin dhe plevitoshin. Tani ndryshuan kohët. Korça ka shumë shkolla, kinema, klube, bulevarde të shtruara, hotele, fusha të bukura dhe mbi të gjitha ka punëtorë dhe fabrika. Një punë e madhe politike dhe ideologjike është bërë e po bëhet tani për demaskimin e fesë dhe të mbeturinave fetare. I dërrmuam fare sharlatanët që spekulonin me besimin e një pjese të popullit.

Po me kubënë e madhe të Mitropolisë ç'u bë?

SHOKU VANGJEL KOLA: Atë e shkundi një herë tërmeti, kurse tani e shkulëm fare.

SHOKU ENVER HOXHA: Çështja është të bëjmë një punë të mirë politike dhe ideologjike që t'i bindim njerëzit për kotësinë dhe për dëmin e fesë, se ndërtesat fetare prishen kollaj, kurse që të heqësh mbeturinat nga koka duhen qindra vjet. Për të pasur sukses në këtë drejtim, duhet bërë një luftë këmbëngulëse ideologjike kundër zakoneve të këqija e mbeturinave fetare. Mos mendoni se ju korçarët, meqë jeni të për-

1 Sot kinema «Morava».

paruar, s'keni fare mbeturina. Si kudo, edhe në Korçë ka mbeturina. Ju punëtorët duhet të jeni në frontin e parë si të prodhimit, edhe të luftës ideologjike kundër pikëpamjeve e qëndrimeve mikroborgjeze. Korça ka ndryshuar shumë tani në krahasim me të kaluarën, por nuk mbeten prapa as qytetet e tjera. Megjithatë akoma duhet luftë e madhe, të vazhdojmë të luftojmë politikisht dhe ideologjikisht, pse kur i kemi të qarta të gjitha në kokë, do të bëjmë më shumë punë, ju, për shembull, do të prodhoni më shumë instrumente precizioni, kur nuk do të keni halle në kokë që t'ju shqetësojnë, siç janë thashethemet nëpër rrugë e mëhalla etj. Kështu njerëzit do të venë plot gëzim në punë.

Më gëzuat shumë që erdhët dhe më informuat për këtë sukses të ri që arriti klasa punëtoare e rrethit të Korçës. Për këtë ju uroj nga zemra, prandaj, kur të ktheheni, u transmetoni gjithë shokëve e shoqeve punëtoare e punëtoare urimet më të përzemërta dhe i përshëndetni nga ana e Komitetit Qendror të Partisë dhe nga ana ime me rastin e festës jubilarë të 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut. Juve ju uroj shëndet dhe suksese në të gjitha aktivitetet tuaja!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

**LUFTA KUNDËR IMPERIALIZMIT AMERIKAN
NUK MUND TË FITOHET PA E LIDHUR ATË
ME LUFTËN KUNDËR REVIZIONIZMIT SOVJETIK**

*Nga biseda me një delegacion të Partisë e të Qeverisë
së RD të Vietnamit*

27 nëntor 1969

*Pasi u përshëndet me miqtë vietnamezë, shoku
Enver Hoxha tha:*

Ju falënderoj që erdhët në Shqipëri për t'u gëzuar së bashku me ne me rastin e festës sonë, 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe të fitores së revolucionit popullor. Me këtë rast, të dashur shokë, dëshiroj edhe një herë të ngushëlloj drejtpërdrejt nëpërmjet jush partinë dhe popullin vietnamez për hidhërimin e madh që ju shkaktoi humbja e shokut Ho Shi Min...

Populli ynë e do popullin vietnamez, ka respekt për të dhe është deri në fund solidar me luftën e tij të drejtë kundër imperializmit amerikan dhe revizionizmit modern. Populli shqiptar është kundër të gjitha koalicioneve borgjeze reaksionare që drejtohen kundër popullit të Vietnamit, si atij të Veriut, ashtu edhe atij të Jugut.

Si gjithnjë, edhe sot do t'jua themi haptazi ato që mendojmë. Kjo është rruga marksiste-leniniste. Populli i Vietnamit ka bërë dhe vazhdon të bëjë sakrificat të mëdha dhe luftën e popullit tuaj ne e konsiderojmë si luftën tonë. Besnikëria dhe dashuria e një partie dhe e një qeverie ndaj çështjes së madhe të Vietnamit nuk mund të shprehen kurrë vetëm me disa ndihma materiale që mund t'i jepen vendit tuaj, sado të mëdha që të jenë ato, pse ndihma që ju vjen nga jashtë, në krahasim me sakrificat e pallogaritshme që bën populli juaj, me luftën e tij të drejtë kundër imperialistëve amerikanë, është diçka fare e vogël. Edhe ne ju japim një ndihmë të vogël materiale, pse nuk kemi mundësi për më shumë, por ndihma jonë morale dhe ideologjike është më e madhe, ne jemi plotësisht dhe gjer në fund me ju.

Ne jemi të bindur, dhe për këtë nuk tërhiqemi nga mendimi ynë, se «ndihma» e revizionistëve sovjetikë, megjithëse nga ana materiale e si sasi mund të duket e madhe është e rreme, pse është sabotuese në ideologji. Prandaj ne dëshirojmë t'ju themi: Mos u zini besë revizionistëve sovjetikë, shokë vietnamezë, ata janë armiqtë tuaj.

Jemi shumë të kënaqur kur në Shqipëri na vijnë shokë nga Vietnami, ose kur shokë tanët shkojnë në vendin tuaj. Ata që kemi dërguar në Vietnam me raste të ndryshme, kanë përfituar shumë nga eksperiencia e madhe e luftës suaj. Ne shqiptarët e vlerësojmë sinqerisht këtë eksperiencë. Në qoftë se ndokush dëshiron të luftojë seriozisht kundër imperializmit amerikan, kundër mjeteve e metodave që përdor ai

në luftë, nuk mund të mos e marrë dhe të mos e përpunojë këtë eksperiencë të pasur në kushtet e vendit të vet.

Le të bërtasë sa të dojë Niksoni nga Uashingtoni se tani gjoja nuk po përdor në Vietnam as bomba me gaz helmues, as lloje të tjera armësh për shfarosjen në masë të popullit vietnamez. Në fakt, këto lloje armësh imperialistët amerikanë i kanë përdorur dhe vazhdojnë t'i përdorin kundër popullit tuaj, kundër fëmijëve e mijëra njerëzve të tjerë të pafajshëm që dita-ditës digjen e vriten nga bombat amerikane. Kështu që deklaratat e Niksonit bëhen vetëm për të mashtruar popujt, prandaj të gjithë duhet të jenë vigjilentë dhe të përgatitur për të luftuar kundër çdo kërcënimi nga bishat imperialiste.

Duke e pasuruar eksperiencën e vet gjatë luftës, populli juaj trim ka shfrytëzuar të gjitha mundësitë dhe ka përdorur çdo mjet rrethanor: barëra, ilaçe e gjithfarë mjetesh që ka në dispozicion, me qëllim që t'u bëjë ballë metodave të egra e shfarosëse të luftës që zhvillojnë kundër tij imperialistët amerikanë. Prandaj ne kemi një admirim të madh për popullin tuaj, për rezistencën e tij heroike.

Ne ua kemi thënë mendimin tonë edhe shokëve të tjerë, me të cilët kemi biseduar, tani po jua themi edhe juve se me imperialistët amerikanë vetëm lufta i qëron hesapet. Imperializmi amerikan nuk e lëshon vullnetarisht fushën e luftës, duhet mundur ai që të detyrohet të tërhiqet nga Vietnami. Këtë të vërtetë na e mëson historia. As Hitleri nuk i dorëzoi armët pa u mundur në luftë. Gjithashtu në fushën e betejës u

mundën Napoleoni, Musolini dhe të gjithë agresorët e tjerë.

Ne duhet të bëjmë një politikë të vendosur edhe për demaskimin politik të agresorëve imperialistë dhe të bashkëpunëtorëve të tyre, të hapët e të maskuar. Partia jonë nuk e ka fshehur dhe kurrë nuk e fsheh mendimin e vet se lufta kundër imperializmit amerikan nuk mund të përfundojë me fitore të plotë, po nuk u lidh njëkohësisht me luftën kundër revizionizmit modern. Aktualisht kjo luftë është mjaft e ndërlikuar. Në qoftë se Partia e Punës e Shqipërisë do të lejonte që në gjirin e saj të zinin vend trockizmi, revizionizmi, si dhe agjentët e Titos, të Hrushovit, të Brezhnjev, të Kosiginit e të tjerë, ajo, sigurisht, do të ishte krimbur, po ne i demaskuam pa mëshirë të gjithë renegatët, i luftuam dhe vazhdojmë t'i luftojmë, prandaj u forcuam. Ne e vumë Partinë tonë që në fillim në pozitë e mbrojtjes së marksizëm-leninizmit, dhe vetëm duke u nisur nga këto pozita mundëm që radhët e saj t'i bënim gjithnjë e më të shtrënguara e të pastra. Ju i dini mirë ngjarjet. Është fakt që edhe koreanët, kur ishin në luftë me imperialistët amerikanë, filluan të bisedojnë me ta, por të mos harrojmë që në atë kohë në krye të Bashkimit Sovjetik ishte Stalini, që mbronte me guxim çështjen e lirisë së popujve, kurse tani atje është në krye një klikë, krerët e së cilës i kanë tradhtuar interesat e popujve dhe janë lidhur ngushtë me imperializmin. Revizionistët sovjetikë nuk janë aspak për çlirimin e popujve. Këtë e themi me bindje në bazë të eksperiencës sonë, se e kemi hequr në kurriz.

Rëndësi të madhe ka fakti që vietnamezët nuk i dorëzuan armët. Ne shqiptarët mendojmë se edhe bisedimet e Parisit do të dështojnë. Lufta duhet të vazhdojë deri në fitore, gjersa të largohet edhe amerikani i fundit nga Vietnami.

Ç'kërkojnë të arrijnë revizionistët sovjetikë me përçapjet që bëjnë për t'i dhënë fund luftës në Vietnam? Ata përpiqen të vendoset një qeveri koalicioni në Vietnamin e Jugut, gjë që do të thotë që përfaqësuesit e Frontit të Çlirimit Kombëtar të bien në ujdi me kuislingët. Sipas mendimit tonë, Niksoni nuk dëshiron të largohet nga Vietnami pa forcuar pozitat e imperializmit amerikan atje, prandaj, po të arrihet ndonjë kompromis siç dëshirojnë revizionistët sovjetikë, shokët e Vietnamit të Jugut rrezikojnë të gjenden të rrethuar nga një forcë solide kuislinge. Ne mendojmë se, po të ndiqet kjo rrugë, nuk do t'i shpëtohet dot luftës civile. Është e pamundur të jetohet në miqësi me Kao Kinë dhe me bandat e tij tradhtarë. Historia na i ka mësuar këto gjëra. Le të përmendim dy shembuj nga dy shtete fqinje me Shqipërinë.

Në Jugosllavi Titoja bëri njëfarë aleance me Shubashiçin, përfaqësues i Drazha Mihajloviçit¹, duke e marrë në shërbim si ministër të Punëve të Jashtme në qeverinë e tij. Shubashiçi atëherë nuk kishte asnjë fuqi, nuk kishte as forca të armatosura, as fuqi eko-

1 Agjent i imperializmit anglez, ministër i Luftës më 1942 në qeverinë kukull jugosllave në Londër, i cili bashkëpunoi me pushtuesit fashistë gjermanë kundër lëvizjes nacionalçlirimtare jugosllave.

nomike. Por Titoja, i cili gjer në atë kohë nuk ishte demaskuar si tradhtar, kishte filluar miqësi me Çërçillin e me Ajzenhauerin dhe, për të mos e tradhtuar këtë miqësi, pranoi Shubashiçin në gjirin e qeverisë. . .

Gjatë luftës, pasi morën propozim nga reaksioni grek për bisedime, udhëheqësit e Luftës Nacionalçlirimtare Greke bënë be e rufe se, duke vajtur në tryezën e bisedimeve, nuk do të dorëzoheshin. Të nisur nga këto konsiderata, ata shkuan në Kazerta të Italisë, ku filluan bisedimet «për të formuar një qeveri të përbashkët». Nga Kazerta shkuan pastaj në Kajro dhe, më vonë, në Varkizë, në një kohë që kishin në dispozicion një ushtri të madhe partizane, të cilën ua dorëzuan atyre që «do të formonin qeverinë». Ngjarjet e hidhura të mëvonshme për fatet e kësaj ushtrie dhe të revolucionit popullor grek dihen. Një përfundim i tillë ndodhi ngaqë në lëvizjen nacionalçlirimtare greke dhe në udhëheqjen e saj kishte hyrë krimbi.

Komunistët dhe populli vietnamez e kanë të qartë g'është imperializmi amerikan dhe luftën që duhet të bëjnë kundër të gjitha manovrave të tij e të kuislingëve. Partia e Punës e Shqipërisë dhe populli shqiptar kanë bindjen e plotë se lufta e popullit vietnamez do të triumfojë, kurse agresioni i imperializmit amerikan do të dështojë, pse ndërhyrja e tij në Vietnam është e padrejtë. Për këtë dëshmojnë edhe demonstratat e mëdha që bëhen në vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës kundër luftës në Vietnam. Këto demonstrata janë pasojë e luftës së rreptë që bën populli juaj për mbrojtjen dhe për bashkimin e atdheut të vet.

Ju vietnamezët keni fituar shumë eksperiencë në

luftën kundër tij, prandaj edhe politikën dinake të Niksonit e kuptoni qartë. Në këtë drejtim, natyrisht, sipas gjykimit tonë, demaskimi që i bëhet «vietnamizimit të luftës» duhet të vazhdohet, sepse politika e imperializmit amerikan përpiqet të krijojë forma të reja lufte për ta mbajtur të pushtuar Vietnamin. Ne kemi bindjen e thellë se populli vietnamez kurrë nuk do të mposhtet.

Më lejoni ta ngre këtë doli për popullin heroik të Vietnamit, për udhëheqjen tuaj, për shëndetin e të gjithë shokëve të delegacionit!

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

FITORET TONA I DETYROHEN EDHE LUFTËS SË PROLETARIATIT BOTËROR E TË PARTIVE MARKSISTE-LENINISTE

*Nga përshëndetja në pritjen e delegacioneve të partive
marksiste-leniniste¹*

27 nëntor 1969

Në fillim shoku Enver Hoxha u takua përzemërsisht me të gjithë anëtarët e delegacioneve dhe pastaj tha:

Ju falënderojmë nga zemra për ardhjen tuaj në Shqipëri me rastin e festës së madhe të popullit dhe të Partisë sonë. Është një nder i madh që na bëjnë partitë tuaja duke dërguar me këtë rast shokë si ju, përfaqësues të partive dhe të popujve tuaj.

Këto ditë të gëzuara që jetojnë populli dhe komunistët shqiptarë, u arritën në sajë të luftës heroike të popullit tonë, të udhëhequr nga Partia e Punës e Shqipërisë, dhe të luftës së komunistëve të të gjithë botës, të proletariatit ndërkombëtar dhe të popujve që

¹ Këto delegacione kishin ardhur në vendin tonë për të marrë pjesë në festimet me rastin e 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe të fitores së revolucionit popullor.

luftuan me heroizëm kundër fashizmit dhe nazizmit, kundër imperializmit italo-gjermano-japonez.

Fitoret tona në ndërtimin e socializmit u detyrohen, në radhë të parë, forcave tona të brendshme, por njëkohësisht edhe luftës që bëjnë popujt, proletariati dhe partitë tuaja marksiste-leniniste, të cilët, në kushte të vështira, luftojnë me vetëmohim dhe të përkulur. Për këtë ndihmë që u jepet Shqipërisë, popullit dhe Partisë sonë të Punës, ne u jemi mirënjohës përjetë popujve dhe partive tuaja marksiste-leniniste. Ja përse kjo festë është e përbashkët, juaja dhe jona. Për të mbrojtur këtë Shqipëri të vogël kemi luftuar ne, por keni luftuar edhe ju, prandaj, këto ditë që ju kemi pranë, konsiderojeni veten si në shtëpinë tuaj, të dashur shokë.

Natyrisht, në vendin tonë ne kemi arritur suksese, por kemi edhe të meta e vështirësi. Ju jeni miqtë tanë dhe e dini, siç thotë populli ynë, «ku na pikon çatia». Jemi të bindur dhe të sigurt që realizimet tona ju do t'i shikoni me zemër të çiltër, duke pasur parasysh gjendjen nga jemi nisur ne, mund të themi bile nga hiçi, megjithatë diçka kemi bërë. Por ne jemi të ndërgjegjshëm se kemi akoma shumë punë për të bërë. Në radhë të parë, detyra jonë kryesore është ta formojmë dhe ta kalitim njeriun e ri me virtyte komuniste, sepse duke arritur suksese në këtë drejtim, atëherë edhe malet rrëzohen, lumenjtë devijohen e realizohet çdo gjë tjetër, sado e vështirë të jetë. Dhe njeriun e ri me botëkuptim e me pikëpamje të reja e formojnë dhe e kalitin ideologjia marksiste-leniniste e praktika revolucionare. Është vetëm kjo ideologji që,

duke u ndeshur me trashëgimet negative të botës së vjetër, pastron ndërgjegjen e njeriut nga mbeturinat e ideologjisë borgjezo-revizioniste.

Ato që na mëson Partia, ne përpiqemi t'i vëmë në jetë. Natyrisht, jemi të bindur se edhe ju do të na ndihmoni me këshillat dhe me vërejtjet tuaja të vlefshme. Propagandën që bëni ju për popullin shqiptar dhe për ndërtimin e socializmit në Shqipëri me anën e botimeve që nxirrni, qofshin ato të vogla ose të mëdha, Partia jonë e çmon si një ndihmë të madhe e të vazhdueshme. Në kolona dhe në faqe të tëra të shtypit që nxirrni, i cili mban vulën e djersës dhe të gjakut të shokëve tuaj që bien në barrikada, ne shohim të flitet me zell e me vullnet për luftën e popullit shqiptar dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë, gjë që na prek thellë në zemër dhe na jep më shumë kurajë për suksese të mëtejshme.

Për gjithçka që keni bërë për popullin dhe për Partinë tonë ne ju falënderojmë nga zemra ju, gjithë komunistët e partitë marksiste-leniniste të Evropës, të Azisë dhe të Afrikës, të Oqeanisë dhe të Amerikës Latine.

Më lejoni, shokë, ta ngremë këtë gotë për shëndetin tuaj, për lavdinë e marksizëm-leninizmit!

Gëzuar të gjithë!

Pastaj shoku Enver Hoxha kaloi te çdo delegacion e bisedoi me ta në grupe. U takua e qëndroi pak edhe me pjesëtarët e delegacionit të Partisë Komuniste të Brazilit, me të cilët zhvilloi këtë bisedë të shkurtër:

SHOKU ENVER HOXHA: Si keni kaluar? Si janë shokët? Po shoku Amazonas si është?

MIKU BRAZILIAN: Të gjithë janë mirë. Edhe shoku Amazonas është mirë me shëndet.

SHOKU ENVER HOXHA: Lufta në Brazil po vazhdon.

MIKU BRAZILIAN: Gjendja që paraqitet sot në Brazil na hap perspektiva të mëdha për luftën tonë. Vetë diktatura fashiste me masat e saj të dhunës bën që lufta jonë të zgjerohet. Lufta e armatosur popullore në Brazil zhvillohet nga partia jonë. Megjithëse në këtë drejtim kemi suksese, partia mendon se përpara kemi një punë shumë të madhe për të bërë. Në punën tonë, sigurisht, kemi edhe vështirësi, por dihet se nuk ka revolucion pa vështirësi.

SHOKU ENVER HOXHA: Udhëheqja e Partisë Komuniste të Brazilit dhe komunistët e vërtetë brazilianë kanë tradita luftarake. Në gjithë punën, siç mendojmë ne, rëndësi të dorës së parë ka çështja e vijës së Partisë, e cila duhet ndërtuar në mënyrë që nga njëra anë të shfrytëzohen të gjitha mundësitë e punës legale dhe ilegale dhe, nga ana tjetër, asnjëherë të mos mbivlerësohet apo të nënvleftësohet armiku. Këto, sipas mendimit tonë, janë çështje kryesore për partitë marksiste-leniniste, sepse armiku përdor metoda, manovrime e sulme të ndryshme, me anën e të cilave mundohet të likujdohet forcat revolucionare dhe partitë marksiste-leniniste. Ne mund të themi se ju, shokë të Brazilit, në veprimtarinë tuaj revolucionare keni një përvojë të mirë. Prej saj mund të mësojnë edhe parti të tjera, disa nga të cilat nuk e kuptojnë si duhet rëndësinë e punës ilegale dhe për organizimin e saj kanë shumë iluzione. Në disa vende kapitaliste

borgjezia ka lejuar ndonjë mundësi dhe formë pune legale, por ajo nëpërmjet tyre kontrollon punën që bëjnë shokët e partisë marksiste-leniniste dhe, kur e shikon se veprimtaria e tyre bëhet e rrezikshme për ekzistencën e saj, menjëherë i arreston ose i zhduk ata. Sigurisht, mundësitë për punë legale doemos duhen shfrytëzuar, por në asnjë mënyrë nuk duhet t'i kush-tojmë kësaj gjithçka dhe të mos lëmë mënjanë punën ilegale. Disa janë shumë sektarë, harrojnë se partia duhet të bëjë një luftë masash në ilegalitet, pavarësisht se ajo është legale, pse pa bërë luftë masash, nuk mund të fitojë revolucionin.

Në përgjigje të fjalës së mikut për punën e partisë në fshat dhe për dërgimin e komunistëve nga qyteti në fshat, shoku Enver Hoxha tha:

Vështirësitë tuaja ne i kuptojmë, sepse edhe në Shqipëri, që është një vend socialist, kur vjen puna për të kaluar nga qyteti në fshat, hasen vështirësi. Merrret me mend që te ju ky problem paraqitet akoma më i vështirë. Pa dyshim, shumë shkojnë me dëshirë, pse e kuptojnë drejt politikën e Partisë, por ka edhe nga ata që ngurrojnë. Çështja është që secili ta kuptojë se duhet të shkojë atje ku ka nevojë partia dhe, që të arrihet kjo, duhet të punohet me shokët për t'i bërë të ndërgjegjshëm, me qëllim që punëtori i San-Paulos, për shembull, për hir të revolucionit, të shkojë me dëshirë në fshat, pse ky përbën një forcë të madhe për punën e partisë dhe për luftën.

Ajo që bëni ju është një eksperiencë e mirë për të gjithë marksistë-leninistët, një zbatim e një zhvillim krijues i marksizëm-leninizmit në kushtet e Brazilit.

Zbatimi i eksperiencës së partive të tjera nuk duhet bërë në mënyrë dogmatike, duke menduar, për shembull, për të vepruar njëjloj siç kanë bërë në Bashkimin Sovjetik. Natyrisht, edhe ju në Brazil, edhe ne në Shqipëri do të përpiqemi të përfitojmë shumë nga eksperiencia e partive të tjera, por çdo gjë duhet parë dhe duhet marrë në përputhje me kushtet konkrete të vendit. Rëndësi të madhe ka fakti që parimet të jenë të qarta dhe t'u qëndrojmë besnikë atyre, kështu puna do të ecë patjetër përpara.

Në fund shoku Enver Hoxha i falënderoi edhe një herë delegacionet e partive marksiste-leniniste për ardhjen në Shqipëri dhe u nda me to për zemërsisht.

Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim që gjenden në AQP

25 VJET LUFTË E FITORE NË RRUGËN E SOCIALIZMIT

*Fjalim i mbajtur në mbledhjen solemne me rastin
e 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe të fitores
së revolucionit popullor*

28 Nëntor 1969

Të dashur shokë dhe shoqe,

Vëllezër dhe motra,

Të dashur miq,

Mbarë populli ynë, i madh e i vogël, feston sot me gëzim të thellë e madhështi jubileun e lavdishëm — 25-vjetorin e Çlirimit të vendit nga pushtuesit fashistë dhe të vendosjes së pushtetit popullor në Shqipëri. Bashkë me ne këtë festë të madhe e festojnë edhe shqiptarët patriotë jashtë atdheut, si dhe gjithë bashkëluftëtarët e popullit tonë, miqtë e shumtë të Shqipërisë së re.

Më lejoni që, në këtë ditë feste të madhe, në emër të Komitetit Qendror të Partisë, të Presidiumit të Kuvendit Popullor, të Këshillit të Ministrave dhe të Kë-

shillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik, t'ju sjell juve, si dhe gjithë vëllezërve tanë shqiptarë patriotë, kudo që jetojnë, përshëndetjet dhe urimet më të mira, të falënderoj gjithë miqtë e vërtetë të Shqipërisë socialiste për dashurinë, për përkrahjen dhe për solidaritetin vëllazëror ndaj vendit tonë.

Më lejoni, gjithashtu, që nga kjo tribunë të përshëndes nxehtësisht klasën tonë të lavdishme punëtore, shtyllën e çeliktë të diktaturës së proletariatit dhe të ndërtimit të socializmit në Shqipëri, fshatarësinë punonjëse e patriote, inteligjencien popullore, rininë heroike, nënat e motrat tona të mrekullueshme për punën e tyre titanike, për vetëmohimin e për sakrificat e panumërta, për kontributin madhështor që kanë dhënë në ndërtimin e socializmit. Gëzuar festën, shokë e shoqe, gëzuar Shqipërinë e re, që ju e ndërtuat me gjakun e me djersën tuaj, rrofshin e u shtofshin nderi, begatia dhe lavdia e atdheut tonë të dashur socialist!

Në këto momente të veçanta gëzimi e hareje, kur festojmë të lirë, të pavarur e sovranë jubileun e lavdishëm të Çlirimit, ne kujtojmë dhe nderojmë me respektin më të thellë të gjithë ata heronj partizanë e partizane që derdhën gjakun për këto ditë të lumtura që jetojmë sot, të gjithë ata që në Luftën e lavdishme Nacionalçlirimtare dhe në punën për ndërtimin e socializmit shkrinë jetën e tyre për të çimentuar themelet e patundura të Shqipërisë së re socialiste. Atyre u drejtohet mirënjohja e thellë dhe e përjetshme e mbarë popullit shqiptar.

Rrënjët e popullit tonë në këtë truall shkojnë në thellësitë e shekujve, por ditë të bardha ai ka parë

vetëm në këta 25 vjet të jetës së lirë socialiste e të pushtetit popullor.

Më 1912, pesëdhjetë e shtatë vjet si sot, populli patriot shqiptar pati arritur një fitore të madhe — Shpalljen e Pavarësisë, e cila kurorëzonte luftërat e tij të gjata kundër pushtuesve shekullorë. Shqipëria për herë të parë, që nga koha e Skënderbeut, doli në arenën ndërkombëtare si shtet i pavarur e sovran. Ne sot përkujtojmë me nderim dhe respekt luftën heroike të patriotëve të Rilindjes, shpirtin e tyre të vetëmohimit dhe dashurinë e pafund për atdheun.

Por borgjezia dhe feudalët që erdhën në fuqi, e lanë në gjysmë të rrugës dhe e tradhtuan veprën e ndritur të patriotëve të Rilindjes Kombëtare. Shqipëria mbeti në varfëri e injorancë dhe u shit te të huajt.

Lufta Nacionalçlirimtare, revolucionin popullor, bashkë me dëbimin e pushtuesve dhe me përmbysjen e klasave shfrytëzuese, plotësoi edhe ëndrrën e bukur të patriotëve tanë të mëdhenj, e bëri Shqipërinë me të vërtetë të lirë e të pavarur, e vuri në rrugën e përparimit e të mirëqenies.

Lufta Nacionalçlirimtare ishte një luftë e vërtetë popullore, që bëhej nga populli dhe për interes të tij. Ajo përfundoi me fitoren mbi armiqtë e jashtëm e të brendshëm, pasi nga gjiri i popullit, në momentin vendimtar, kur përcaktoheshin ekzistenca dhe e ardhmja e tij, lindi Partia Komuniste e Shqipërisë, pararoja revolucionare e klasës punëtore, udhëheqësja e sigurt dhe e urtë e gjithë masave punonjëse. Krijimi i Partisë, vënia e saj në krye të popullit kryengritës dhe të luftës së tij çlirimtare ishte një kthesë rrënjë-

sore në fatet historike të Shqipërisë. Ajo i dha atij një program të qartë veprimi dhe i tregoi rrugën e vetme të drejtë për ta vënë atë në jetë.

Nën udhëheqjen e Partisë, në ndeshjen legjendare me armiqtë më të egër të njerëzimit, me fashistët italianë e nazistët gjermanë, u shfaqën me një forcë të dhjetëfishuar dhe u ripërtëritën mbi një bazë të re trimëria dhe heroizmi i popullit shqiptar, shpirti i tij i pamposhtur liridashës, urrejtja e madhe për shtypësit e skllavëruesit, guximi dhe vendosmëria për të luftuar pa marrë parasysh asnjë sakrificë dhe për të fituar mbi armiqtë.

Nga lartësitë e 25 vjetëve ne shohim më qartë lavdinë e Luftës Nacionalçlirimtare, veprën heroike të Partisë sonë, rëndësinë historike të fitores së revolucionit tonë popullor. Ato hodhën bazat e çeliktat të Shqipërisë së re socialiste, hapën epokën e ndritur të socializmit e të komunizmit për popullin shqiptar.

Lavdi partizanëve e partizaneve, bijve e bijave shqiptare që, me armë në dorë, shkrep më shkrep e mal më mal, luftuan me heroizëm të pashembullt, i dhanë popullit lirinë, pavarësinë, pushtetin popullor dhe i hapën atij rrugën për në socializëm!

Shteti ynë i ri socialist, që lindi nga pushka partizane, ua mbylli fort dhe përgjithmonë derën ujqve imperialistë dhe regjimeve antipopullore. Shqipëria e shumëvuaajtur, e shtypur nga bejlerët e agallarët, një vend gjysmëkolonial dhe plaçkë tregu e fuqive të mëdha, është sot një vend i lirë socialist, i pavarur dhe sovran, zot i fateve të tij dhe i pathyeshëm.

Qëllimi historik i proletariatit, i popullit puno-

njës, i përfaqësuesve të tyre revolucionarë — komunistëve — është të përmbysin në vendin e vet çdo rend shtypës antipopullor, të zhdukin çdo shfrytëzim të njeriut prej njeriut, të ngrenë një shoqëri të re, ku punonjësit të gëzojnë të gjitha të drejtat e të jenë zotër të fateve të veta, ku gjithçka të jetë në interes e në shërbim të popullit. Populli dhe Partia jonë vijnë me ballin lart në këtë jubile të madh, sepse e kryen me nder këtë mision të lavdishëm historik.

Synimi i revolucionarëve proletarë është të bëjnë gjithçka varet prej tyre për triumfin e çështjes së madhe të socializmit, jo vetëm në vendin e vet, por edhe në mbarë botën. Partia dhe populli ynë kurdoherë kanë mbajtur fort dhe kanë ngritur gjithnjë më lart flamurin e internacionalizmit proletar, flamurin e përkrahjes pa rezerva të luftës revolucionare e çlirimtare në vendet e tjera, flamurin e luftës së papërkulur kundër imperializmit e revizionizmit modern.

25 vjetët që kanë kaluar nga dita e Çlirimit janë një dëshmi e gjallë e dritës jetëdhënëse të marksizëm-leninizmit, e forcës së pamposhtur të regjimit socialist, janë një vërtetim i madh i drejtësisë së vijës së përgjithshme të Partisë sonë, i unitetit të çeliktë politik të popullit shqiptar, i punës dhe i vendosmërisë së tij për të ecur me guxim gjithnjë përpara në rrugën që i hapi revolucioni popullor.

Ne kemi plotësisht të drejtë të krenohemi për sukseset e arritura dhe për betejat e fituara në të gjitha fushat. Shqipëria nuk është më ai vend i prapambetur i parmendës prej druri dhe i kasolleve me kashtë, i pishës dhe i kandilit me vajguri, i analfabetizmit dhe

i malarjes. Shqipëria e re socialiste po marshon sot me hapa gjigantë dhe me një hov të papërmbajtshëm revolucionar drejt ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Ne kemi një industri të pajisur me makineritë më moderne, një bujqësi socialiste të zhvilluar, një sistem të plotë arsimor shumë të përparuar. Vendi i dikurshëm i barinjve të varfër, i bujqve të cflitur e i hakmarrjes së egër është sot një vend me kulturë e art të zhvilluar, përmbajtjen e të cilit mund t'ia kenë zili edhe ata që qytetërimin e tyre e matin me shekuj.

Në përpjekjet vigane që ka bërë populli ynë që nga fillimi i Luftës Nacionalçlirimtare e deri sot, i është dashur të derdhë shumë gjak e shumë djersë, të luftojë e të punojë i rrethuar nga armiq të egër e dinakë, ta mbajë pushkën kurdoherë të ngrehur pranë kazmës. Jo vetëm armiqtë, por edhe ata që nuk i njihnin popullin e Partinë tonë, kanë predikuar e kanë deklaruar shpesh se Shqipëria popullore «nuk do ta kishte të gjatë». Por të tërë realiteti i ka zhgënjyer keq. Populli ynë, nën udhëheqjen e urtë e largpamëse të Partisë, i ka përballuar me sukses të gjithë armiqtë, ka kapërcyer me guxim të gjitha vështirësitë, ka thyer me vendosmëri të gjitha pengesat.

Ne vijmë në jubileun e madh të Çlirimit më të fortë se kurrë. Rendi shoqëror më i përparuar — socializmi — në Shqipëri është vendosur mbi themele të patundura. Ne vijmë në 25-vjetorin e lavdishëm të bashkuar si një trup i vetëm rreth Partisë së Punës dhe pushtetit popullor. Populli ynë, punëtorët, fshatarët e inteligjencia popullore, e feston 25-vjetorin e triumfit të revolucionit i mbushur me optimizëm re-

volucionar, i bindur për të ardhmen edhe më të bukur, edhe më të lumtur që e pret atdheun tonë socialist, i vendosur për të punuar e për të luftuar me të gjitha forcat që Shqipëria socialiste të rrojë e të lulëzojë në shekuj, që në atdheun tonë të valojë kurdoherë krenar flamuri i lirisë, flamuri i komunizmit.

29 Nëntori i 1944-ës shënon ditën e madhe të rilindjes së vërtetë të popullit tonë

Të dashur shokë e shoqe,

29 Nëntori i 1944-ës, dita kur partizanët tanë trima i sollën atdheut çlirim, shënon ditën e madhe të rilindjes së vërtetë të popullit tonë, kufirin ku mbaron për të bota e vjetër dhe ku fillon bota e re, epoka e shkëlqyer e socializmit.

Rruga që kemi përshkuar në gjatë këtyre 25 vjetëve ka qenë një luftë e vazhdueshme në fushat dhe në format më të ndryshme për ndërtimin e Shqipërisë socialiste, për triumfin e plotë të botës së re mbi botën e vjetër dhe mbeturinat e saj. Në këtë rrugë na është dashur të luftojmë me armiqtë e klasës, me pengesa e vështirësi të shumta, të luftojmë kundër armiqve imperialistë dhe miqve të rremë, revizionistëve titistë e hrushovianë, kundër sabotimeve e bllokadave të tyre të urryera. Por ashtu si në Luftën Nacionalçlirimtare, edhe në luftën për ndërtimin e socializmit populli ynë, me një shpirt të lartë sakrifice e-heroizmi, me një vullnet të hekurt e guxim shembullor, i udhëhequr

me urtësi nga Partia, ka dalë gjithnjë faqebardhë dhe ka arritur fitore pas fitoreje.

Me Çlirimin e vendit dhe me vendosjen e pushtetit popullor përpara popullit dhe Partisë u shtruan detyra historike të mëdha e të ndërlikuara, nga zgjidhja e të cilave vareshin e ardhmja e vendit dhe fati i socializmit në Shqipëri.

Duhej përmbysur tërë struktura dhe superstruktura e vjetër feudalo-borgjeze, duheshin transformuar rrënjësisht marrëdhëniet e prodhimit të vogël të mallrave dhe duhej kaluar në sistemin e socializmit shkenzor në qytet e në fshat, në ekonomi e në kulturë. Por duhej transformuar rrënjësisht edhe bota e brendshme e njerëzve sipas botëkuptimit marksist-leninist, ideologjisë socialiste, moralit komunist. Ishte e domosdoshme dhe e ngutshme, gjithashtu, të rindërtohej vendi i shkatërruar nga lufta dhe të kapërcehej me ritme sa më të shpejta prapambetja shekullore ekonomike e kulturore e trashëguar nga e kaluara.

Partia jonë mbështetej në mësimet e Leninit dhe të Stalinit, në eksperiencën e çmuar të ndërtimit socialist në Bashkimin Sovjetik, por ajo nuk mund ta kopjonte e ta zbatonte atë në mënyrë mekanike. Kjo eksperiencë dhe parimet marksiste-leniniste duheshin zbatuar në mënyrë krijuese në truallin tonë konkret, me veçoritë e tij historike, gjeografike, ekonomike, klasore, politike, ideologjike etj. Vështirësitë dhe rreziqet ishin të mëdha. Mund të thyeje qafën në çdo kthesë, në çdo vendim themelor që përcaktonte drejtimin strategjik, po ashtu edhe në qëndrimet taktike për zbatimin e këtyre vendimeve.

Por Partia jonë, për nderin e lavdinë e saj, i zgjidhi drejt si detyrat strategjike, ashtu edhe ato taktike.

Brenda një kohe shumë të shkurtër u likuiduan shkatërrimet e luftës dhe energjitë e klasës punëtore e të të gjitha masave punonjëse u përqendruan në betejën jetike për zhvillimin e vrullshëm të forcave prodhuese, për ngritjen dhe përparimin e shpejtë të të gjithë ekonomisë. Në këtë drejtim Partia ndoqi me konsekuencë e me vendosmëri të patundur kursin e industrializimit socialist, të prioritetit të industrisë në zhvillimin e ekonomisë sonë të re socialiste, duke e konsideruar këtë si faktor vendimtar të zhvillimit të vendit në të gjitha fushat.

Industrializimi socialist i vendit filloi në vitet e para me ritme të ngadalta dhe u zhvillua me një luftë këmbëngulëse nga ana e Partisë, e klasës punëtore dhe e mbarë popullit, duke kapërcyer vështirësi e pengesa të shumta. Kjo kishte arsyet e veta. Ne nuk trashëguam gati kurrfarë industrie, ndërsa edhe ajo pak që ekzistonte u dëmtua rëndë nga lufta. Pseudoaleatët jugosllavë jo vetëm nuk ndihmuan, por edhe sabotuan me të gjitha mjetet zhvillimin industrial të vendit tonë. Ndihma sovjetike në drejtim të industrializimit erdhi me vonesë dhe në fillim qe e kufizuar, për shkak të gjendjes së vështirë të krijuar në Bashkimin Sovjetik nga shkatërrimet e tmerrshme të luftës. Më pas kjo ndihmë u shtua, por me ardhjen në fuqi të revizionistëve hrushovianë, ajo filloi të ngadalësohet e të sabotohet, gjersa u ndërpre dhe u zëvendësua me bllokadën armiqësore.

Partia, klasa punëtore, gjithë populli ynë, me

luftë të guximshme, pa marrë parasysh vështirësitë dhe sakrificat, ecën përpara. Ato nuk u mashtruan nga predikimet e revizionistëve hrushovianë për të ashtuquajturat ndarje socialiste ndërkombëtare të punës, specializim e kooperim të prodhimit midis vendeve socialiste etj., të cilat kanë për qëllim nënshtrimin ekonomik e politik të vendeve të tjera dhe synonin ta bënin vendin tonë një shtojcë të tyre agrare. Partia dhe populli ynë vazhduan pa lëkundje rrugën e drejtë të industrializimit socialist, që nuk vonoi e dha rezultate të shkëlqyera, të cilat ia kanë ndryshuar krejtësisht faqen atdheut tonë.

Nga një vend i prapambetur bujqësor, Shqipëria është shndërruar tani në një vend të përparuar bujqësor-industrial. Më 1938 prodhimi industrial zinte vetëm 8 për qind të të gjithë prodhimit industrialo-bujqësor, kurse në vitin 1968 ai arriti në 61,5 për qind. Tani vetëm prodhimi i Kombinatit të Tekstileve në Berat është më i madh se prodhimi i gjithë industrisë së vendit më 1938.

Në të katër anët e Shqipërisë janë ngritur me qindra vepra të mëdha të industrisë së rëndë e të lehtë, nxjerrëse e përpunuese. Oxhakët e fabrikave e të uzinave duken në të gjitha qytetet tona të vjetra e të reja, të cilat janë kthyer sot në qendra të rëndësishme industriale. Dikur qyteti i Fierit kishte 4 800 banorë. Popullsia e tij merrej vetëm me tregti, me artizanat dhe me bujqësi. Sot Fieri është bërë një nga qendrat më të mëdha industriale të vendit. Atje janë ngritur Uzina e Plehrave Azotike dhe Rafineria e Naftës, Termocentrali me kapacitet prej afro 100 000 kilovatësh, Fa-

brika e Zhveshjes së Pambukut, e tullave etj. Në qytetin e Fierit, i cili është zgjeruar e është mbushur me ndërtesa të bukura, punojnë sot mbi 7 500 punëtorë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Lushnjën, Kavajën, Beratin, Kukësin, Gjirokastrën, pa folur për qytete të tilla, si: Tirana, Shkodra, Durrësi, Korça, Vlora etj.

Industrializimi socialist i vendit nuk ka sjellë vetëm ndryshime sasiore, ai ka sjellë edhe ndryshime të mëdha cilësore. Zhvillimi me prioritet i degëve që shërbejnë për prodhimin e mjeteve të prodhimit, që në vitin 1968 zinte 55,5 për qind të të gjithë prodhimit industrial, ka siguruar një shfrytëzim gjithnjë e më efektiv të pasurive tona natyrore, ka çuar drejt forcimit të pavarësisë ekonomike të vendit dhe ka siguruar kushte gjithnjë më të favorshme për zhvillimin e shpejtë të ekonomisë. Ndërsa në të kaluarën industria te ne përbëhej kryesisht nga disa fabrika të vogla e primitive të industrisë së lehtë ushqimore, nga artizanati dhe nga ndonjë minierë e vogël, tani janë krijuar degë të reja e moderne, si industria e naftës, e kromit apo e hekur-nikelit, industria kimike, mekanike dhe elektrike, industria e materialeve të ndërtimit etj., të cilat ndodhen në rritje të shpejtë dhe përbëjnë një bazë të shëndoshë për krijimin dhe për zhvillimin e degëve të reja në pesëvjeçarët e ardhshëm.

Vepra të tilla të mëdha, të pajisura me një teknike moderne, si uzinat e plehrave azotike dhe të superfosfatit, uzinat mekanike, si ajo e veglave të ndërrimit për traktorë, kombinatet e tekstileve, ndërtimi i hidrocentraleve të mëdha, si Hidrocentrali i Vaut të Dejës apo i termocentraleve të fuqishme si ai i Fierit,

fabrikat e çimentos apo ndërtimi i hekurudhave, ngri-tja e kombinatit të metalurgjisë së zezë e shumë e shumë të tjera, flasin qartë për nivelin e përparuar të ekonomisë sonë, për rezultatet e arritura dhe për perspektivat e mëdha që hapen përpara ekonomisë sonë.

Elektrifikimi i vendit, si një ndër faktorët vendimtarë për zhvillimin e shpejtë e të sigurt të të gjithë ekonomisë, është një tregues tjetër me rëndësi që flet qartë për rezultatet e mëdha të politikës së industrializimit socialist që ka ndjekur Partia në këta 25 vjet. Sot në afro 4 ditë prodhohet aq energji elektrike sa prodhohej gjatë gjithë vitit 1938. Vetëm rrethi i Krujës konsumon 3 herë e gjysmë më shumë energji elektrike nga sa konsumonte gjithë Shqipëria para Çlirimit. Elektrifikimi i të gjitha fshatrave që po kryhet tani me sukses të plotë, në një kohë kur në shumë vende të Evropës as që bëhet fjalë akoma për një ndërmarrje të tillë, dëshmon më së miri për forcën e rendit tonë socialist, për rritjen e mundësive ekonomike të vendit, për kujdesin e madh të Partisë e të pushtetit popullor për përparimin dhe për mirëqenien e vazhdueshme materiale e kulturore të masave popullore.

Politika e Partisë për industrializimin e vendit ka fuqizuar gjithë ekonominë. Ajo ka bërë që të arrihen fitore të mëdha jo vetëm në fushën e industrisë e të minierave, por edhe në ndërtim, në komunikacion, në tregti etj.

Në këta 25 vjet të Shqipërisë së re, bashkë me zhvillimin dhe me përparimin e degëve të ndryshme të ekonomisë, është arritur edhe një fitore tjetër e

madhe me rëndësi historike e vendimtare për fatet e vendit. Fjala është për krijimin dhe për rritjen e klasës së re punëtore, shtyllës së diktaturës së proletariatit, flamurtarës dhe udhëheqëses së ndërtimit të socializmit në Shqipëri. Ne kemi sot një klasë punëtore të madhe në numër, me ndërgjegje të lartë politike klasore, me aftësi dhe talente të mrekullueshme. Ajo po bëhet gjithnjë e më e ndërgjegjshme për rolin e saj si klasë në fuqi. Klasa punëtore kalitet vazhdimisht në kudhrën e revolucionit, po e thotë gjithnjë e më me forcë fjalën e saj vendimtare, po zgjeron kontrollin e saj të drejtpërdrejtë mbi këdo e mbi gjithçka. Me ideologjinë, me punën dhe me luftën e saj ajo i jep sot tonin gjithë jetës së vendit, prin në lëvizjet revolucionare, me shembullin e saj frymëzon gjithë punonjësit e tjerë.

Industrializimi ynë socialist, duke pasur kurdoherë parasysh edhe veçoritë e tij që rrjedhin nga kushtet konkrete të Shqipërisë, si edhe nga rrethanat historike nëpër të cilat kemi kaluar, është zhvilluar e zhvillohet në rrugë të drejtë marksiste-leniniste.

Në kushtet e vendit tonë të vogël, vija e patundur e Partisë ka qenë dhe mbetet që, duke ecur me ritme të shpejta në rrugën e industrializimit socialist, njëkohësisht edhe të zhvillimit intensiv të bujqësisë, ta bëjmë ekonominë tonë më të pavarur, gjithnjë e më të aftë të ecë me këmbët e veta, të ruajmë e të konsolidojmë kështu edhe pavarësinë politike të atdheut socialist, të forcojmë pareshtur fuqinë mbrojtëse të tij nga çdo atentat i armiqve imperialistë e revizionistë që na rrethojnë, të përmirësojmë vazhdimisht mirë-

qenien e popullit, të plotësojmë gjithnjë e më mirë nevojat e tij.

Zhvillimin dhe thellimin e vazhdueshëm të revolucionit tekniko-shkencor, futjen sa më të gjerë të shkencës, të teknikës e të agroteknikës moderne, përhapjen e eksperimentimit shkencor në çdo fushë, Partia i ka shtruar si një ndër problemet e detyrat më të rëndësishme të zhvillimit të ekonomisë socialiste, të ndërtimit të plotë të socializmit në vendin tonë.

Ky revolucion është pjesë përbërëse e revolucionit tonë socialist dhe zhvillohet në unitet me revolucionin ideologjik e kulturor. Qëllimi i tij themelor është ta vërë gjithë ekonominë mbi një bazë më të lartë shkencore e teknike, për të siguruar një rendiment më të lartë në punë, një zhvillim më të vrullshëm të forcave prodhuese, për të lehtësuar punën e njerëzve dhe për të ngritur më lart nivelin e tyre të jetesës. Përpyekjet kryesore duhet të përqendrohen në kalimin kudo nga format artizanale në prodhimin industrial modern, në futjen e teknikës e të teknologjisë së re, në zbatimin e një disipline të rreptë shkencore në të gjitha proceset e punës e të prodhimit, në organizimin dhe në drejtimin shkencor të ekonomisë, në përgjithësimin e në përhapjen e eksperiencës së përparuar. Kushti vendimtar për ta çuar përpara revolucionin tekniko-shkencor është mobilizimi i të gjitha forcave të gjalla e krijuese të masave punonjëse dhe të specialistëve, edukimi i tyre i gjithanshëm politik, ideologjik, teknik e shkencor, forcimi i vazhdueshëm i bashkëpunimit të tyre në format më të ndryshme e më frytdhënëse.

Rruga jonë për industrializimin socialist, e plek-

sur ngushtë edhe me zhvillimin e gjerë të revolucionit tekniko-shkencor, nuk ka asgjë të përbashkët dhe ësh-të në kundërshtim të plotë me predikimet e ndrysh-me teknokratike që po përhapin me të madhe në ko-hën e sotme borgjezia dhe revizionistët modernë.

Ideologët e borgjezisë monopoliste përpiqen t'i mashtrojnë punonjësit se revolucioni tekniko-shkencor që po zhvillohet sot në botë, po i zhduk gjoja pla-gët e kapitalizmit, se ai po e reformon atë, po zhduk klasat dhe antagonizmin klasor, po i zëvendëson pro-narët kapitalistë me administratorët teknokratë. Mbi këtë bazë ata e shpallin të kapërcyer sistemin e vjetër kapitalist të shfrytëzimit, luftën e klasave dhe nevo-jën e revolucionit proletar.

Në të vërtetë, prapa së ashtuquajturës shoqëri in-dustriale, apo shoqëri teknokratike fshihet shtypja e egër e punonjësve nga monopolet kapitaliste dhe nga kapitalizmi monopolist shtetëror. Revizionistët mo-dernë, që kanë tradhtuar plotësisht e përfundimisht marksizëm-leninizmin dhe janë vënë në shërbim të bor-gjezisë, i kanë shpallur «shoqërinë teknokratike» dhe progresin tekniko-shkencor, që çon në forcimin e zgje-rimin e kapitalizmit monopolist shtetëror, si «futje të elementëve të socializmit në transformimin gradual të kapitalizmit».

Në vendet revizioniste teknokratizmi, krahas buro-kratizmit dhe si një shprehje e stërholluar e tij, është bërë një ndër mjetet kryesore për të spostuar nga udhëheqja klasën punëtore dhe për të restauruar ka-pitalizmin. Ekonomia e këtyre vendeve, të cilën revi-zionistët vazhdojnë ta quajnë «socialiste», nën preteks-

tin se është e shtetëzuar apo e kolektivizuar, në të vërtetë s'është tjetër veçse ekonomi kapitaliste e një tipi të posaçëm. Ajo është në duart, në shërbim e në interes të klasës së re borgjeze të burokratëve e të teknokratëve, që është krijuar e vazhdon të konsolidohet. Teoricienët borgjezë në Perëndim e quajnë atë që përdodh në vendet revizioniste «liberalizim e demokratizim të socializmit». Pra, që të dyja palët, si borgjezia, ashtu edhe revizionistët, dalin në një qafë, ata kërkojnë të mbajnë gjallë kapitalizmin dhe të likuiojnë socializmin.

Por revolucioni tekniko-shkencor, dhe lidhur me të zhvillimi i teknokratizmit, nuk e shpëtojnë dhe nuk mund ta shpëtojnë kapitalizmin dhe as revizionizmin modern nga shembja dhe nga shpartallimi i pashmangshëm. Ata nuk mund të ndryshojnë ligjet objektive të zhvillimit shoqëror, në radhë të parë ligjin e luftës së klasave e të revolucionit. Futja në shkallë të gjerë e shkencës dhe e teknikës në prodhim, që monopolet kapitaliste në Perëndim dhe borgjezia e re e vendeve revizioniste janë të detyruara ta bëjnë për shkak të konkurrencës së egër të brendshme e ndërshtetërore dhe për të siguruar fitime maksimale, nuk i sheshon aspak kontradiktat ekonomike e klasore, të brendshme e të jashtme të kapitalizmit të vjetër e të ri, nuk e shpëton atë nga kriza e pashërueshme dhe gjithnjë më tronditëse. Përkundrazi, kjo i acaroi më tej kontradiktat dhe krizat, ngre në një shkallë gjithnjë e më të lartë valën e luftës klasore dhe çon, në fund të fundit, kur edhe faktori subjektiv është në lartësinë e duhur, në revolucionin socialist ngadhënjimtar.

Populli shqiptar ecën i patundur në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste

Sukseset që ka arritur vendi ynë gjatë këtyre 25 vjetëve në industrializimin e tij, kanë krijuar bazën materiale që lejon të synohet për ta transformuar Shqipërinë në një të ardhme jo të largët nga një vend bujqësor-industrial në një vend industrialo-bujqësor. Për të arritur këtë objektiv është e domosdoshme që si detyrë kryesore e zhvillimit industrial edhe në të ardhmen të mbetet zgjerimi e përmirësimi i strukturës së prodhimit industrial, mbështetur mbi një teknikë të përparuar. Për këtë duhet krijuar një bazë e qëndrueshme e brendshme e lëndëve të para dhe, çka është më e rëndësishme, të arrijmë të bëjmë një shfrytëzim sa më racional dhe me efektin më të mirë ekonomik të pasurive të ndryshme natyrore. Kjo do të bëjë të mundur të sigurohen plotësimi i nevojave gjithnjë e më të mëdha të ekonomisë popullore, ngritja sistematike e mirëqenies së popullit dhe shtimi i fuqisë mbrojtëse të vendit.

Ne me siguri do t'i arrijmë këta objektiva, sepse kemi një popull heroik, punëtor dhe të vendosur, kemi një klasë punëtore të lavdishme e të talentuar, kemi Partinë tonë që, me politikën e saj të urtë e largpamëse marksiste-leniniste, na udhëheq me siguri drejt fitoresh të reja.

Transformime rrënjësore kanë pësuar gjatë këtyre 25 vjetëve edhe fshati e fshatarësia jonë. Të gjithë ne

i kemi akoma përpara syve kasollet prej kashte dhe bujqit e shtypur të Myzeqesë, malësorët e uritur të Pukës e të Dukagjinit, gjithë fshatarësinë tonë të munduar e të shumëvujtur. I mbajmë mend kënetat e moçalet që mbytnin fushat më të mira të Shqipërisë që nga Buna deri në Jug, në Vurgun e Delvinës.

Por të gjitha këto i përkasin historisë, së kaluarës. Sot fshati i ri kooperativist shkëlqen tejmbanë nga drita e socializmit. Fshatari ua la kujtimeve të hidhura kultin shekullor të krodhes së bukës, që e persekutonte me tmerr që nga lindja deri në varr. Kooperativa bujqësore, që është shtrirë plotësisht në të gjitha fshatrat, është sot një njësi e fuqishme e prodhimit të gjerë e të gjithanshëm bujqësor e blegtoral, e integruar rrënjësisht në ekonominë e përgjithshme kombëtare dhe bazë e shëndoshë e saj. Me forcat e veta dhe me ndihmën e madhe të pushtetit popullor, kooperativat po zbatojnë sot gjithnjë e më shumë një bujqësi intensive, me një nivel gjithnjë e më të lartë agroteknik.

Mbi tri herë më shumë është rritur prodhimi bujqësor në krahasim me atë të paraluftës dhe dy herë sipërfaqja e tokave të punuara. Në sajë të veprave bonifikuese e ujitëse të ndërtuara deri sot, janë përfituar e janë përmirësuar rreth 200 000 hektarë tokë dhe aftësia ujitëse në fund të vitit 1968 ka arritur në më shumë se 240 000 hektarë, nga 29 000 që ishte në vitin 1938. Në fushat tona punojnë tani 10 500 traktorë (të kthyer në 15 kuaj fuqi), nga 30 që kishte gjithsej para Çlirimit. Shqipëria ka hyrë në rrugën e vendeve të zhvilluara për sa i përket përdorimit të plehrave ki-

mike, të cilat para luftës as që njiheshin fare në vendin tonë. Në vitin 1968 te ne u përdorën mesatarisht 79 kilogramë plehra kimike në lëndë aktive për një hektar tokë të punuar, ndërsa në vitin 1967 Greqia ka përdorur 68 kilogramë, Spanja 36,8, Jugosllavia 60,4, Hungaria 66,8 dhe Italia 72,6 kilogramë.

Socializmi në fshat ka sjellë përparime të pakrahueshme me të kaluarën edhe në jetën e vetë fshatarësisë. Fshatari ynë sot banon në shtëpi të re. Fëmijët e tij venë në shkollë. Spitalin, ambulancën e farmacinë i ka në prag të derës. Në shumë fshatra janë ngritur kopshtet e çerdhet e fëmijëve, banjat, lavanderitë, shtëpitë e vatrat e kulturës. Rruga e automobilit e ka afruar fshatin me qytetin dhe radioja e shtypi i sjellin kooperativistit përditë në vatrën e tij gjithë vendin dhe gjithë botën.

Sukseset dhe fitoret e arritura janë të lidhura ngushtë me vijën e Partisë për zgjidhjen e drejtë të problemit fshatar, i cili është ndër problemet më të rëndësishme e më të ndërlikuara për çdo vend që hyn në rrugën e ndërtimit të socializmit. Partia, që në ditët e para të Çlirimit e vazhdimisht, i ka kushtuar vëmendjen kryesore këtij problemi jetik e të vështirë, sidomos për kushtet e vendit tonë, ku përqindja dërmuese e popullsisë ishte fshatare, ku fshati, i varfëruar e i rrënuar nga lufta, duhej rimëkëmbur në një rrugë të re, të panjohur për të. Duhej të ngulej fshatari në tokat, të mos i braktiste ato nga vështirësitë e kohëve të para, gjë që do t'i frynte qytetet me të papunë dhe do të krijonte një krizë ushqimore. Duhej shkëputur fshatarësia nga prangat e pronës private

dhe të futej në rrugën e socializmit. Duhej kapërcyer prapambetja e trashëguar dhe duheshin zhvilluar me ritëm të shpejtë forcat prodhuese në fushën e bujqësisë.

Partia e zgjidhi drejt këtë problem jetik. Ajo ngriti në këmbë dhe udhëhoqi fshatarësinë punonjëse në luftën kundër pushtuesve të huaj dhe kundër bashkëpunëtorëve të tyre — bejlerëve e agallarëve latifondistë, që i kishin rrëmbyer fshatarit tokën dhe e kishin skllavëruar. Në këtë luftë u farkëtua aleanca e madhe e fshatarësisë me klasën punëtore, baza shoqërore kryesore e revolucionit popullor dhe e diktaturës së proletariatit.

Kryerja konsekuente e Reformës Agrare, vendimi i parë i madh i Partisë e i pushtetit popullor për zgjidhjen e problemit fshatar, që u bë menjëherë pas Çlirimit, solli një transformim të thellë në marrëdhëniet shoqërore dhe në ndërgjegjen e fshatarësisë, e cila pa të realizohej ëndrra e saj shekullore për tokë e për të flakur tej zgjedhën e rëndë të beut e të çifligarit. Dhënia e tokës nga Partia proletare e nga diktatura e proletariatit konsolidoi më tej aleancën e fshatarësisë me klasën punëtore. Le të kujtojmë për një çast privacionet e fshatarësisë dhe detyrimet e rënda të fillimit. Fshatarësia i kuptoi ato si një detyrë të sajën. Qëndrimi korrekt e i papërkulur ndaj vendimeve që merrnin Partia dhe pushteti popullor, ishte dëshmi e besnikërisë së fshatarësisë punonjëse ndaj Partisë së proletariatit, ndaj klasës punëtore, dëshmi e aleancës me klasën punëtore, të cilën e pranonte në udhëheqje, sepse shihte rrugën e drejtë të zhvillimit, parashikonte

perspektivën e jetës së lumtur që po ndërtohej me luftë e me sakrifica.

Të gjitha këto përgatitën kushtet materiale e shpirtërore për të hedhur hapin tjetër vendimtar, për të kaluar në procesin e transformimit socialist të fshatit. Krahas punës së gjerë për bonifikimet, për mekanizimin e bujqësisë, për zhvillimin e llojeve të bimëve, të blegtorisë etj., u zhvillua lufta e madhe për kolektivizimin e bujqësisë, i cili, sipas orientimeve konsekuente e njëkohësisht të matura të Partisë, u përhap gradualisht në tërë vendin, duke përfshirë, më në fund, edhe malësitë.

Nga eksperiencia e jetës dhe në sajë të punës së madhe sqaruese të Partisë, fshatarësia u bind për epërsitë e rendit kooperativist, i vetmi që mund ta nxjerrë atë nga skamja e ta shpëtojë nga çdo shfrytëzim. Ndryshoi rrënjësisht botëkuptimi i fshatarësisë. Psikologjia e punës së veçuar, e pronës së vogël private dhe e interesit të ngushtë personal filluan t'ua lëshojnë vendin gjithnjë e më shumë ndjenjës dhe ndërgjegjes së pronës së përbashkët, të punës së bashkuar dhe të prodhimit të zgjeruar socialist.

Në këto situata filloi zhvillimi i procesit të bashkimit të kooperativave në kooperativa të mëdha, filloi në shkallë të gjerë eksperimentimi shkencor dhe zhvillimi i revolucionit tekniko-shkencor edhe në bujqësi, shpërtheu lufta për rendimente të larta, përhapja në masë e agroteknikës dhe shtimi i kuadrove të kualifikuara të fshatit etj. Fshati i ri socialist sot ndodhet në një proces të hovshëm zhvillimi e transformimi, që prek si fushën e prodhimit, ashtu edhe atë shoqërore e kulturore.

Shtimi i mekanizimit, punimet e mëdha të bonifikimeve e të ujitjes, përdorimi i gjerë i lëndëve kimike, zbatimi gjithnjë e më mirë i agroteknikës së përparuar, zgjerimi i rrjetit të komunikacionit, i ndërlydhes etj., rritja e numrit të kuadrove të specializuar dhe përgjithësisht e nivelit arsimor të fshatarit kanë krijuar kushte të përshtatshme materiale për një bujqësi intensive moderne, të zhvilluar në gjerësi e në thellësi, për të ngritur nivelin kulturor e jetësor të masave kooperativiste, për afrimin gjithnjë e më shumë të prodhimit e të jetës së fshatit me atë të industrisë e të qytetit.

Ky proces revolucionar i zhvillimit të vrullshëm të forcave prodhuese në bujqësi dhe i përsosjes së marrëdhënieve socialiste në fshat do të vazhdojë derisa kooperativat bujqësore, nga pronë e grupit, të shndërrohen në pronë të të gjithë popullit, të zhduken dallimet midis kooperativave e ndërmarrjeve bujqësore, për të arritur kështu ndërtimin e plotë të socializmit në fshat, për të ngushtuar gradualisht dhe pastaj për të zhdukur dallimet esenciale midis fshatit dhe qytetit, midis fshatarësisë dhe klasës punëtore etj. Kjo është rruga marksiste-leniniste që të çon drejt shoqërisë komuniste pa klasa.

Drejtesia e vijës së Partisë ndaj fshatit, si dhe fitoret madhështore të arritura në këta 25 vjet, dalin akoma më në pah kur shikojmë gjendjen e rëndë e kritike të bujqësisë në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revizioniste.

Revizionistët modernë, kush më parë e kush më pas, e braktisën rrugën marksiste-leniniste të zhvilli-

mit socialist të fshatit. Ata kanë likuiduar e po likuindojnë fitoret e socializmit në fshat. Rruga e tyre është ajo e kthimit në kapitalizëm nën etiketa gjoja socialiste.

Kapitalizmi dhe revizionistët modernë, nën pretekstin e «superindustrializimit», të krijimit të «shoqërisë industriale», të «mekanizimit kompleks» të bujqësisë etj., varfërojnë fshatin, e detyrojnë fshatarësinë të braktisë ekonomitë bujqësore, duke e futur në darën e koncerneve agrare, e shpopullojnë fshatin dhe hedhin në rrugë miliona të papunë, krijojnë rezervën e skllëvërve, e përdorin këtë për të rritur shfrytëzimin edhe në qytet.

Ne ndjekim një rrugë krejt të kundërt në shoqërinë tonë socialiste. Duke u dhënë një rëndësi të dorës së parë industrializimit dhe mekanizimit të punës, në të njëjtën kohë nuk nënvleftësojmë aspak fshatin dhe nuk ecim në rrugën e shpopullimit të tij, por zhvillojmë në harmoni me ata edhe bujqësinë. Duke luftuar për rendimente të larta në zonat fushore, ne nuk harrojmë zhvillimin e shpejtë të bujqësisë në zonat kodrinore e malore. Ruajtja e përpjesëtimeve të drejta në këto drejtime është shumë e rëndësishme për çështjen e ndërtimit socialist në vendin tonë, për çdo situatë që mund të krijohet, ndërsa lejimi i krijimit të shpërpjesëtimeve është i mbarsur me çrregullime e me pasoja të rënda ekonomike, politike, klasore e ideologjike.

Përpara bujqësisë dalin sot probleme e detyra shumë të rëndësishme, nga zgjidhja e të cilave varet në mënyrë të drejtpërdrejtë mbarë zhvillimi i ekonomisë.

Për zhvillimin e forcave prodhuese në fshat në kushtet e tanishme të vendit tonë është e domosdoshme që të synojmë kryesisht në rritjen e rendimenteve të bimëve bujqësore e të produktivitetit të blegtorisë, në shtimin e sipërfaqes së tokave të punuara dhe në përmirësimin e përsosjen e strukturës së prodhimit bujqësor.

Fshatarësia jonë punonjëse e patriote, e udhëhequr nga Partia dhe duke pasur, si gjithnjë, ndihmën dhe përkrahjen e klasës punëtore, do t'i realizojë me sukses këto detyra të mëdha, do ta bëjë me siguri jetën e saj më të lulëzuar e më të begatshme.

Fitorja më e madhe e kësaj periudhe është krijimi i njeriut të ri me veti të larta revolucionare

Të dashur shokë,

Fitoret e mëdha historike të arritura nga Shqipëria e re në këta 25 vjet të pushtetit popullor në të gjitha frontet e luftës për ndërtimin dhe për mbrojtjen e socializmit, dëshmojnë për heroizmin, për patriotizmin dhe për shpirtin e lartë revolucionar të njerëzve tanë të mrekullueshëm, të frymëzuar e të edukuar me kujdes të veçantë nga Partia. Në qoftë se vendi ynë ka mundur të kapërcejë me vetëmohim të rrallë brenda një kohe të shkurtër vështirësitë dhe pengesat e panumërta të shkaktuara nga prapambetja shekullore e trashëguar dhe nga veprimtaria e tërbuar armiqësore

e imperialistëve, e revizionistëve dhe e forcave reacionare, në qoftë se populli ynë ka ndërtuar një shoqëri socialiste të zhvilluar dhe atdheu ynë qëndron fortesë e pamposhtur dhe fener ndriçues i socializmit në brigjet e Adriatikut, kjo, në një shkallë të madhe, i detyrohet faktit që Partia ka mundur të krijojë e të kalitë njeriun e ri, të pajisur me ndërgjegje të lartë socialiste dhe me veti të shquara revolucionare.

Ne krenohemi me të drejtë me klasën heroike punëto-re, me fshatarësinë punonjëse trime, me rininë tonë revolucionare, me gratë e mrekullueshme, me inteligjencien popullore, me tërë popullin tonë, që, si një trup i vetëm, i bashkuar rreth Partisë, marshon përpara pa u trembur nga asnjë furtunë e stuhi. Heroizmi i luftës u përtëri gjatë gjithë periudhës së ndërtimit të socializmit dhe po ngrihet më lart në ditët e sotme. Ai është bërë një tipar dallues i shoqërisë sonë.

T'i ruajmë, t'i zhvillojmë e t'i rritim përditë e më shumë këto veti të larta që Partia ka kalitur te njerëzit tanë!

Veçanërisht këto vitet e fundit, qysh nga Letra e Hapur dhe nga Kongresi i 5-të historik i Partisë, në lidhje të ngushtë me tërë procesin e revolucionarizimit të jetës së vendit, është në zhvillim një hop i ri cilësor për formimin e njeriut të ri të shoqërisë socialiste.

Procesi i madh revolucionar që po ndodh sot, është vazhdim dhe thellim i revolucionit tonë socialist. Ai është një sulm i përgjithshëm kundër të gjitha njollave e mbeturinave të botës së vjetër që po varrosim, është një luftë e madhe dhe e gjithanshme për t'i prerë rrugën rivendosjes së kapitalizmit sot e në të ardh-

men, nga brenda apo nga jashtë, është një luftë e ashpër klasore për ta çuar vazhdimisht përpara revolucionin, për të siguruar fitoren e plotë e përfundimtare të rrugës socialiste mbi rrugën kapitaliste.

Ky proces i madh revolucionar, që zhvillohet nën udhëheqjen e Partisë dhe me pjesëmarrjen e gjerë të masave punonjëse, ka përfshirë të gjitha fushat e jetës dhe të veprimtarisë politike e ideologjike, ekonomike e kulturore, organizative e ushtarake. Ai ka vënë në lëvizje çdo gjë, çdo njeri, duke bërë një përmbysje rrënjësore në konceptet, zakonet, traditat, në mënyrën e jetesës, në sjelljet dhe në qëndrimet e njerëzve, në gjithë punën dhe jetën e tyre. Revolucionarizimi ka krijuar një frymë luftarake të lartë, një mobilizim të madh në punë, një shpirt novatorizmi të pashembullt, një unitet të çeliktë të popullit e të Partisë. Ai ka nxitur si kurrë ndonjëherë iniciativën, vetëveprimin e guximin revolucionar të masave, të cilat kanë gjetur shprehjen e tyre të fuqishme në një sërë lëvizjesh të thella revolucionare me karakter ekonomik, politik e ideologjik. Kjo është një dëshmi e gjallë e drejtësisë së vijës së Partisë dhe një fitore e shkëlqyer e saj.

Në luftën për revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës së vendit Partia po çan me guxim në rrugë të pashkelura, me përvojën e saj ajo po jep një kontribut të rëndësishëm në teorinë dhe në praktikën e socializmit, në pasurimin e eksperiencës historike të diktaturës së proletariatit. Rëndësia e kësaj përvoje qëndron në faktin se ajo tregon si të sigurohet vazhdimësia e revolucionit, si të ndërtohet shoqëria e plotë socialiste

e të kalohet në komunizëm, si të mos lejohet kthimi prapa apo ndërprerja e procesit revolucionar.

Për formimin e njeriut të ri, punonjës të ndër-gjegjshëm të ndërtimit socialist, një rol të madh kanë luajtur zhvillimi dhe thellimi i revolucionit në fushën e arsimit e të kulturës, si pjesë e pandarë dhe e lidhur ngushtë me tërë zhvillimin e revolucionit tonë. Zgjidhja e kësaj detyre paraqitej edhe më e ngutshme, në qoftë se kemi parasysh prapambetjen që trashëguam nga e kaluara. Partia e bëri të qartë qysh në fillim se socializmi nuk mund të ndërtohej me analfabetë, se për të përparuar vendi duhej ngritur niveli arsimor e kulturor i punëtorëve e i fshatarëve.

Gjithë Shqipëria është mbuluar nga një rrjet i gjerë shkollash të shumëllojta. Në çdo 7 veta 2 mësojnë. Është realizuar plotësisht arsimi i detyruar 8-vjeçar jo vetëm në qytet, por edhe në të gjitha fshatrat. Kjo ndodh në një kohë kur akoma sot në Itali mbeten analfabetë mbi 100 000 fëmijë çdo vit, ndërsa në Jugosllavi 20 për qind e popullsisë dhe në Greqi 27 për qind është analfabete. Në gjithë sistemin tonë arsimor tani shërbejnë rreth 23 000 arsimtarë, nga afro 1 700 që kishte para Çlirimit. Vetëm shkollat e mesme të Delvinës e të Konispolit kanë sot më shumë nxënës nga sa kishin të gjitha gjimnazet e Shqipërisë më 1938, ndërsa një nga paralelet e klasës së dhjetë të shkollës së mesme «Qemal Stafa» në Tiranë ka më shumë vajza nga sa kishin të gjitha gjimnazet e vendit para luftës. Për sa i përket arsimit të lartë, i cili më parë nuk ekzistonte fare, ne kemi sot 113 studentë në 10 000 bano-rë, duke lënë prapa në këtë fushë vende të tilla të

zhvilluara si Anglia, Gjermania, Italia e Zvicra. Shkollat tona të larta diplomojnë sot rreth 2 000 kuadro në vit, ose mbi 5 herë më shumë nga sa kishte gjithsej specialistë të lartë Shqipëria më 1938.

Aktualisht Partia dhe populli ynë janë angazhuar në një punë e luftë të madhe për revolucionarizimin e shkollës. Tani kemi një program të qartë e të plotë veprimi në këtë fushë. Detyra është që vendimet e Plenumit të 8-të të Komitetit Qendror të Partisë të kuptohen thellë dhe të merren të gjitha masat për zbatimin e tyre në jetë. Duke i dhënë prioritet edukimit marksist-leninist të rinisë, shkolla jonë, nëpërmjet kombinimit shkencor të mësimit me punën prodhuese e me përgatitjen fizike e ushtarake të nxënësve e të studentëve, duhet të përgatitë kuadro të aftë, luftëtarë besnikë e të vendosur për çështjen e komunizmit, të gatshëm për të përballuar çdo detyrë e çdo vështirësi.

Në lëmin e kulturës e të artit kanë ndodhur gjithashtu ndryshime kaq të mëdha sa asnjë krahasim nuk mund të bëhet me të kaluarën. Vetëm 17 kinema, 2 muze, 5 biblioteka dhe botimi i rreth 180 000 ekzemplarëve librash përbënin tërë bazën e kulturës të vitit 1938. Kurse sot kemi rreth 1 750 shtëpi e vatra kulture, rrjeti i kinemave është shtrirë jo vetëm në të gjitha qytetet e mëdha e të vogla, por edhe në shumë kooperativa bujqësore. Njëzet e pesë teatro e estrada profesioniste, dhjetëra biblioteka shtetërore, muze e shtëpi-muze ndihmojnë për edukimin kulturor e revolucionar të masave. Gjatë vitit 1968 vetëm nga ndërmarrja e shtypshkronjave «Mihal Duri» u botuan 590 libra me një tirazh të përgjithshëm prej afro 7 milionë

ekzemplarësh. Radioja po futet thujtë në të gjitha familjet dhe tani po punohet për ngritjen e qendrës së televizionit, që shënon një hap tjetër të rëndësishëm për përhapjen e ideologjisë e të kulturës proletare.

Një aktivitet i gjithanshëm kulturoro-artistik me pjesëmarrjen aktive të punëtorëve, fshatarëve, të rinjve e të rejave zhvillohet sot në të katër anët e atdheut. Qindra shkrimtarë e artistë të talentuar militojnë me veprat e tyre për idealet e Partisë dhe të socializmit.

Këto suksese në të ardhmen do të zhvillohen edhe më tej. Por, si deri tani, ne duhet të kujdesemi që arsimit dhe kultura të mbeten të pastër nga depërtimi në ta i influencave të huaja borgjeze e revizioniste, që ata të jenë kurdoherë armë të fuqishme në luftën që bën populli për mbrojtjen e atdheut dhe për ndërtimin e socializmit.

Puna e madhe dhe e përditshme e Partisë dhe e organizatave të masave për edukimin komunist të njerëzve, zhvillimi i gjerë i arsimit e i kulturës socialiste kanë bërë që të ngrihet në një nivel më të lartë ndërgjegjja revolucionare e punonjësve. Por do të ishte gabim të vetëkënaqeshim e të qetësoheshim. Duhet të jemi të ndërgjegjshëm se lufta për edukimin e njeriut të ri është lufta më e gjatë, më e vështirë, më e ndërlikuar e më delikate, sepse pikërisht në këtë fushë rezistenca e botës së vjetër është më e madhe, më këmbëngulëse e më e thellë. Lufta midis dy rrugëve, socialiste dhe kapitaliste, kalon nëpër ndërgjegjen e njerëzve. Prandaj spastrimi i ndërgjegjes së punonjësve nga të gjitha gjurmët e ndikimit e shoqërisë së vjetër e të botës kapitaliste e revizioniste që na rrethon, brumos-

ja e punonjësve me botëkuptimin marksist-leninist, me normat e moralit komunist, me virtyte revolucionare është kusht i domosdoshëm dhe pjesë e pandarë e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Nënveftësimi dhe boshllëqet në këtë fushë, siç e tregon edhe përvoja negative e Bashkimit Sovjetik dhe e disa vendeve të tjera, janë të mbarsur me pasoja të rënda.

Veçanërisht në etapën e sotme, kur në plan të parë qëndrojnë problemet dhe detyrat e luftës në frontin ideologjik, lufta këmbëngulëse dhe shkencore e Partisë dhe e diktaturës së proletariatit për edukimin e njeriut të ri të shoqërisë socialiste duhet të zhvillohet frontalisht, në të gjitha drejtimet. Këtij qëllimi duhet t'i shërbejë gjithë zhvillimi ekonomiko-shoqëror i vendit, i strukturës dhe i superstrukturës, i arsimit dhe i kulturës.

Në çështjen e edukimit të njerëzve një vijë e thellë demarkacioni qëndron midis nesh dhe renegatëve revizionistë modernë, të cilët përpiqen me të gjitha mjetet për degjenerimin shpirtëror, ideologjik, politik e moral të tyre, për t'i shndërruar ata në vegla të verbra të politikës së tyre antimarksiste e tradhtare, në skllëvër të bindur të kundërrevolucionit revizionist.

Partia jonë edukimin komunist revolucionar të punonjësve nuk e ka parë kurrë si një proces thjesht iluminist, aq më pak si një proces spontan e pasiv, por si një proces aktiv të luftës së klasave në gjirin e popullit, i cili kryhet nga Partia, nga shteti i diktaturës së proletariatit e nga organizatat e masave, me pjesëmarrjen e gjithë punonjësve. Partia ka theksuar e thekson se edukimi komunist i njerëzve është i pan-

darë nga lufta aktive e pamëshirshme e parimore kundër të gjitha njollave e ndikimeve të ideologjive të huaja feudale, patriarkale, borgjeze, mikroborgjeze apo revizioniste qofshin, të cilat në mënyrë të pashmangshme do të vazhdojnë të ekzistojnë edhe për një kohë shumë të gjatë, në këtë ose atë shkallë, në ndërgjegjen e punonjësve tanë. Çdo lëshim, zbutje, kompromis e oportunitizëm kundrejt shfaqjeve e ndikimeve të ideologjive të huaja do të ishte fatal për çështjen tonë.

Kjo luftë frontale për edukimin komunist të punonjësve, me rëndësi jetike për fatet e revolucionit e të socializmit, shtron detyra të mëdha përpara Partisë, organizatave shoqërore e shtetërore, shkollës e familjes, letërsisë dhe arteve tona, përpara të gjitha organizatave e institucioneve që formojnë opinionin shoqëror. E gjithë kjo punë duhet të përsoset më tej, të bëhet më e thellë, më bindëse, më luftarake, duke kombinuar kurdoherë drejt teorinë me praktikën, punën ideopolitike sqaruese me aksionin revolucionar masiv, edukimin me vetedukimin, masat edukative me ato ekonomike e organizative etj. Studimi i vëmendshëm e i vazhdueshëm i veprave të pavdekshme të klasikëve të marksizëm-leninizmit, i dokumenteve dhe i Historisë së Partisë sonë të lavdishme të Punës, do t'i ndihmojë gjithë punonjësit që të përvetësojnë më mirë botëkuptimin materialist dhe teorinë tonë pararojë, do t'i bëjë ata më të aftë në luftën e madhe që kemi përpara për ndërtimin e plotë të socializmit dhe të shoqërisë komuniste.

Vija e Partisë për industrializimin e vendit dhe për zhvillimin e pandërprerë të bujqësisë kooperati-

viste, përpjekjet e vazhdueshme për zgjerimin e arsimit e të kulturës, puna e palodhur për revolucionarizimin e mëtejshëm të të gjithë jetës së vendit nuk kanë qenë dhe nuk do të jenë kurrë një qëllim në vetvete. Të gjitha këto i shërbejnë një qëllimi të madh — çlirimit të gjithanshëm fizik e shpirtëror të masave punonjëse, ngritjes së nivelit të mirëqenies së tyre.

Ne ndërtojmë socializmin duke u mbështetur në forcat tona

Fitorja më e madhe e korrur nga Partia dhe nga pushteti popullor gjatë këtyre 25 vjetëve në vendin tonë, është likuidimi i shfrytëzimit të njeriut nga njeriu. Fshatari e punëtori, nëpunësi e intelektual, të gjithë sigurojnë jetesën me punën e tyre dhe ndihmojnë për ndërtimin e socializmit. Gruaja shqiptare, kjo forcë kolosale revolucionare, që dikur ishte e përbuzur dhe e destinuar vetëm për punët e shtëpisë, merr pjesë gjerësisht në jetën politike të vendit, në prodhimin shoqëror, në fabrikë, në arë, në arsim, në kulturë, në tregti etj. Kjo është një tjetër fitore historike e Partisë dhe e pushtetit popullor.

Përpara luftës njerëzit në Shqipëri vdisnin për një kokërr kininë. Si rrjedhim i punës prej skllavi dhe i varfërisë, jeta e tyre mesatare nuk i kalonte të 38 vjetët. Sot edhe në zonat më të thella, si në atë të Dukagjinit, ka spitale e shtëpi lindjeje. Shtrirja e shërbimit mjekësor në gjithë vendin, ngritja e spitaleve, e klinikave, e ambulancave, e infermierive, shërbimi mje-

kësor e kurimi falas për gjithë popullsinë dhe përgjithësisht rritja e mirëqenies së punonjësve e kanë bërë jetën e tyre të lumtur e të sigurt. Tani jeta mesatare e njeriut te ne është zgjatur dhe ka arritur 66 vjet.

Rritja e prodhimit bujqësor e industrial, rritja e të ardhurave kombëtare dhe shpërndarja e drejtë e tyre kanë bërë të mundur shtimin e fuqisë blerëse të punonjësve. Në vitin 1968 u përdorën më shumë për frymë të popullsisë, në krahasim me vitin 1938, sheqer e prodhime sheqeri mbi 2,5 herë, yndyrna mbi 2 herë, perime e prodhime të tyre 2,3 herë, stofa të ndryshëm 10 herë, këpucë gjithfarësh 4,3 herë etj.

Gjatë këtyre 25 vjetëve, me fondet e shtetit, me ndihmën e tij dhe nga vetë punonjësit, janë ndërtuar rreth 185 000 apartamente e shtëpi banimi në qytet e në fshat. Kjo do të thotë se më se gjysma e popullsisë së tanishme të të gjithë vendit është sistemuar në shtëpi të reja banimi.

Ulja e re e çmimeve që u bë në prag të këtij jubileu, është një dëshmi tjetër që tregon se Partia dhe pushteti popullor ecin në mënyrë të patundur e konsekuente në rrugën e ngritjes së vazhdueshme të nivelit të jetesës së punonjësve. Një provë tjetër e madhe e këtij realiteti është edhe fakti se Shqipëria është i vetmi vend në botë ku nuk ekziston asnjë taksë e tatum i drejtpërdrejtë mbi popullsinë.

Ndryshimet kolosale që kanë ndodhur që nga Çlirimi i vendit e deri sot, janë fryt i punës vetëmohuese të punonjësve tanë, janë fryt i politikës së drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë të Punës. Për realizimin e këtyre fitoreve ne kemi pasur edhe ndih-

mën e përkrahjen internacionaliste të vëllezërve të klasës.

Renegatët revizionistë sovjetikë, megjithëse e shohin se bllokada e tyre barbare u bë copë e thërrime dhe ata nuk mundën ta gjunjëzonin Shqipërinë socialiste, i qajnë hallin popullit shqiptar se gjoja qenka ngushtë dhe ka ngecur në vend që kur nuk merr më kredi e ndihma nga Bashkimi Sovjetik! Por ne u themi atyre: Mos i qani hallin kalorësit se i varen këmbët! Ne nuk i duam të ashtuqajturat ndihma tuajat, që janë helm dhe kurthe për të robëruar e për të skllavëruar popujt. Ne kemi pasuritë e mëdha të tokës sonë, kemi djersën, forcën, vullnetin e paepur dhe aftësitë e popullit tonë të talentuar, i cili me zotësi i nxjerr e i shfrytëzon këto pasuri për të mirën e tij e të çështjes së socializmit. Ne kemi Partinë tonë të lavdishme të Punës, që e udhëheq vendin me urtësi e me guxim marksist-leninist në rrugën e ndërtimit të socializmit. Ne u themi revizionistëve: Bllokada juaj, prishja brutale e marrëveshjeve ekonomike, ndërprerja e plotë e furnizimeve të pajisjeve industriale, grabitja e projekteve, lënia në mes e punimeve të filluara etj. mundet që e penguan në fillim zbatimin e planit të tretë pesëvjeçar, por ekonomia jonë nuk e ndali për asnjë çast marshimin e saj fitimtar, ajo doli ngadhënjyese mbi bllokadën tuaj të turpshme.

Ne u themi atyre: Ju «shqetësoheni» për naftën tonë e për nxjerrjen e mineraleve? Mos na e qani hallin. Në krahasim me vitin 1960, tani në Shqipëri nxjerrja e naftës është rritur 80 për qind, ndërsa mineral bakri prodhohet 4 herë më shumë e kështu me

radhë kromi, qymyrguri etj. Ligësia, mania e shpifjeve ju kanë errësuar logjikën e shifrave. Ju trilloni se energjetika në Shqipëri paska mbetur prapa. Por shifrat tregojnë se, në krahasim me 1960-n, prodhimi i energjisë elektrike sot është 4,1 herë më i madh. Vetëm Termocentrali i Fierit, i ndërtuar këto vitet e fundit, është katër herë më i fuqishëm se Hidrocentrali i Ulzës. Ju «shqetësoheni» për përgatitjen e kuadrove me arsim të lartë? Atëherë mësoni se më 1960 ne kishim vetëm 4 245 specialistë me arsim të lartë, kurse sot i shërbejnë popullit afro 14 000 të tillë. Ju i qani hallin bujqësisë sonë? Por ne ju themi se kurrë ndonjëherë nuk kemi pasur suksese kaq të mëdha në bujqësi sesa në këta dhjetë vjet. Në krahasim me vitin 1960, rendimenti i grurit është rritur 90,5 për qind, pra gati është dyfishuar, ndërsa ai i misrit është shtuar 2,2 herë.

Ç'tregojnë këto të dhëna? Ato flasin për dështimin e plotë të komplotit revizionist dhe për fitoren e madhe edhe në lëmin ekonomik të Partisë sonë heroike të Punës, për fitoren e marksizëm-leninizmit. Shpartallimi i bllokadës ekonomike, e cila është një mjet brutal nënshtrimi, dëshmon se populli shqiptar është i pamposhtshëm, ai nuk gjunjëzohet nga presionet e këtij lloji, ashtu si nuk frikësohet nga kërcënimet e nga vringëllimet e armëve.

Eksperiencia historike përgjithësisht, realiteti dhe lufta e vendit tonë në mënyrë të veçantë, sukseset madhështore që ka arritur Shqipëria socialiste gjatë këtyre 25 vjetëve, vërtetuan edhe një herë drejtësinë e parimit të madh leninist se faktori i brendshëm në

revolucion dhe në ndërtimin e socializmit është vendimtar, se në çdo veprim populli duhet të mbështetet në forcat e veta. Kjo nuk përjashton, natyrisht, ndihmën internacionaliste, të sinqertë e pa interes të vendeve socialiste, të proletariatit ndërkombëtar, të partive të vërteta marksiste-leniniste dhe të popujve përparimtarë të botës.

Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, duke u mbështetur në këtë parim, Partia ngriti në këmbë mbarë popullin, sepse për ne ishte e qartë se liria nuk dhurohet, por fitohet me pushkë, me gjak e me sakrifica. Ne demaskuam pa mëshirë manovrat mashtruese të tradhtarëve ballistë e zogistë dhe të imperialistëve anglo-amerikanë se gjoja lufta që po bënte dhe gjaku që po derdhte populli ynë ishin të panevojshëm, se lirinë do të na e sillnin të gatshme «aleatët». Përkundrazi, ishte pikërisht lufta heroike e vetë popullit që i dha atij mundësinë të marrë në dorë fatet e tij dhe të vendosë pushtetin e vet, që bëri të mundur t'i mbylleshin të gjitha shtigjet ndërhyrjes imperialiste në punët e brendshme të vendit tonë për të sjellë në fuqi një regjim antipopullor e proimperialist.

Por duke luftuar me forcat tona në këto male, Partisë sonë kurrë nuk i kishte shkuar ndër mend të bënte një luftë të izoluar, të shkëputur nga fronti i përgjithshëm antifashist. Prandaj ajo e lidhi Luftën Nacionalçlirimtare të popullit tonë me atë të Bashkimit Sovjetik, të udhëhequr nga Stalini, dhe me atë të të gjithë popujve të botës që luftonin kundër nazifashizmit. Ne nuk nënvleftësojmë aspak, siç gënjejnë renegatët revizionistë sovjetikë, rolin e rëndësishëm që

luajti për çlirimin e Evropës dhe të atdheut tonë lufta e madhe heroike çlirimtare e Ushtrisë së Kuqe të Stalinit, e cila u dha goditjen dërrmuese hordhive fashiste dhe krijoi kushte shumë të favorshme edhe për zhvillimin e luftës çlirimtare antifashiste të popullit tonë.

Parimin e mbështetjes në forcat e veta Partia e zbatoi me vendosmëri e me konsekuencë edhe pas Çlirimit. Ne kërkuam ndihmën e Bashkimit Sovjetik e të Stalinit për zhvillimin e vendit tonë në rrugën e ndërtimit socialist. Kërkesa jonë ishte e drejtë, e pastër, normale e internacionaliste. Dhe derisa që gjallë Stalini, ndihmat Shqipërisë i jepeshin në frymë internacionaliste. Por Partia dhe populli ynë nuk qëndruan duarkryq, sepse asnjëherë nuk mendonin se socializmin do të na e ndërtojnë miqtë nga jashtë. Ne i vumë gjoksin punës dhe, me forcat tona, që ishin faktori kryesor, ia ndryshuam krejt faqen atdheut tonë të shumëvuajtur.

Kjo që shpëtimtare dhe historia e tregoi se sa i drejtë e jetik ishte orientimi i Partisë për mbështetjen në forcat e veta. Me të ardhur në fuqi hrushovianët në Bashkimin Sovjetik, të ashtuquajturat kredi dhe disa fabrika që na dhanë, ndryshuan në thelb qëllimin e tyre. «Ndihma» e tyre nuk ishte më internacionaliste, por kishte karakter skllavërues. Renegatët hrushovianë janë përpjekur ta bënin vendin tonë krejtësisht të varur ekonomikisht e politikisht prej tyre. Ata kërkonin që, për hir të të ashtuquajturave ndihma, ne të hiqnim dorë nga sovraniteti ynë, të bëheshim dua-xhinj të bindur e servilë të tyre, të aprovonim pa as

më të voglin kundërshtim çdo fjalë e qëndrim të tyre antimarksist e antisocialist. Por ata s'i njihnin mirë shqiptarët. Jo ne, por ata shiten me pare. Kur tradhtia e revizionistëve hrushovianë doli sheshit dhe Partia jonë filloi luftën e hapur kundër saj, jo vetëm u prenë plotësisht të gjitha ndihmat e kreditë, por vendi ynë u detyrua të përballojë edhe bllokadën e egër ekonomike e politike revizioniste. Ai i theu me sukses të plotë sulmet revizioniste dhe vazhdon të ecë i patundur në rrugën e ndërtimit socialist pikërisht sepse Partia jonë ka ndjekur me konsekuencë parimin e mbështetjes në forcat e veta dhe e ka vënë ekonominë tonë mbi baza të shëndosha për të ecur me këmbët e saj.

Udhëheqësit revizionistë sovjetikë dhe shërbëtorët e tyre të bindur e sulmojnë me tërbim Shqipërinë, sepse i përmbahet këtij parimi. Ata e konsiderojnë këtë nacionalizëm të ngushtë dhe na quajnë mosmirënjohës, sepse paskemi harruar gjoja ndihmën e Bashkimit Sovjetik në luftën për çlirim dhe në ndërtimin socialist, sepse guxuam të ngrihemi kundër tradhtisë së tyre, sepse guxojmë të ecim në rrugën marksiste-leniniste. Ata përsëritin orë e çast nga Radio Moska sikur vetëm ata kanë luftuar, sikur me ndihmën e tyre ekonomike na kanë mbajtur frymën gjallë, sikur pa këtë ndihmë ne do të ishim shuar. Me paturpësinë më të madhe ata mohojnë dhe përçmojnë luftën e popullit tonë dhe të popujve të tjerë për shkatërrimin e fashizmit.

Këtu nuk ka asnjë fije internacionalizmi, nuk ka asgjë të përbashkët me mësimet e Leninit e të Stalinit,

me mësimet e doktrinës së madhe të marksizëm-leninizmit se të gjithë popujt, të mëdhenj apo të vegjël, japin kontributin e tyre në çështjen e përbashkët të revolucionit, se ndihma dhe përkrahja internacionaliste midis popujve janë reciproke dhe jo të njëanshme.

Pikëpamjet e urrejtshme shoviniste të revizionistëve sovjetikë i ngrenë akoma më lart gjykimet objektive, të drejta dhe internacionaliste të Partisë dhe të shtetit tonë socialist, që kurdoherë dhe në kohën e vet kanë përcaktuar si duhet karakterin e çfarëdo ndihme që na është dhënë. Karakterin e ndihmës nga internacionaliste në shoviniste, skllavëruese e kolonialiste e kanë ndryshuar ata që e kanë dhënë dhe jo ne që e kemi marrë, pasi ata tradhtuan marksizëm-leninizmin dhe internacionalizmin proletar e jo ne.

Ne marksistë-leninistët shqiptarë nuk do të pajtohemi kurrë me revizionizmin modern, me tradhtarët e Moskës, por do të luftojmë deri në shkatërrimin e plotë të tyre. Me ne miqësi dhe unitet kanë e do të kenë popujt vëllezër sovjetikë dhe bolshevikët e vërtetë sovjetikë të Lenin-Stalinit.

Partia jonë edhe në të ardhmen do të ndjekë me besnikëri kursin marksist-leninist të mbështetjes në forcat e veta, e bindur se në zbatimin e drejtë të këtij parimi qëndron garancia për suksese akoma më të mëdha, si për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së vendit, ashtu edhe për ndërtimin e socializmit dhe për ngritjen e vazhdueshme e të sigurt të mirëqenies së punonjësve.

Diktatura e proletariatit në Shqipëri qëndron si shkëmb graniti

Shokë dhe shoqe,

Vendosja e pushtetit popullor në gjithë vendin më 29 Nëntor 1944 është fitorja më e madhe në historinë shumëshekullore të popullit shqiptar. Pushteti popullor, diktatura e proletariatit është arma e tij më e fuqishme në luftën për jetën e re, të lirë e të lumtur — për socializmin dhe komunizmin.

Merita e shquar e Partisë është se ajo i lidhi ngushtë e i shkriu në një të vetme luftën për çlirimin kombëtar dhe luftën për shkatërrimin e pushtetit të vjetër, antipopullor e reaksionar, për ngritjen e pushtetit të popullit. Partia nuk lejoi kurrë që borgjezia dhe çifligarët t'i rrëmbenin popullit pushtetin dhe që gjaku i derdhur prej tij të shkonte kot. Me vendosmërinë më të madhe ajo i preu rrugën ndërhyrjes së imperialistëve anglo-amerikanë në punët e brendshme të vendit tonë. Kjo vijë konsekuente bëri që, qysh të nesërmen e Çlirimit të atdheut, në Shqipëri të ekzistonte e të vepronte vetëm pushteti i ri, pushteti i popullit, që filloi të kryejë funksionet e diktaturës revolucionare të proletariatit.

Çështjen e pushtetit popullor, të ruajtjes, të konsolidimit e të përsosjes së tij të pareshtur Partia e ka pasur kurdoherë në qendër të vëmendjes gjatë tërë periudhës 25-vjeçare. Ajo është udhëhequr me konse-

kuencë nga mësimi i madh i Leninit se është më lehtë ta marrësh pushtetin sesa ta mbash atë. Eksperienca historike e ka vërtetuar plotësisht këtë mësim, si me shembuj pozitivë, ashtu edhe me negativë. Ajo ka treguar se diktatura e proletariatit mund të vendoset si rezultat i revolucionit socialist ngadhënjimtar, por më pas mund të likuidohet, qoftë nëpërmjet kundërrevolucionit të armatosur, qoftë me anën e kundërrevolucionit revizionist «paqësor». Mundet gjithashtu që, pasi të ketë triumfuar, diktatura e proletariatit të rrezikohet seriozisht, të uzurpohet pjesërisht pushteti nga elementët kundërrevolucionarë, por më pas, me rrugë revolucionare, të përmbysen e të shpartallohen uzurpatorët dhe ideologjia e tyre helmuese, të rivendoset plotësisht diktatura e proletariatit dhe të mbrohet ajo me sukses. Por humbja e plotë ose e pjesshme e diktaturës së proletariatit nuk është aspak një fatalitet. Eksperienca historike ka vërtetuar, gjithashtu, se është plotësisht e mundur që, pasi të jetë vendosur, diktatura e proletariatit të ruhet kurdoherë e pastër, e paprekur dhe e patundur në të gjitha hallkat e drejtmet, duke u zhvilluar e duke u përsosur vazhdimisht.

Kjo eksperiencë historike e shumanshme e diktaturës së proletariatit është një thesar i çmuar për gjithë marksistë-leninistët dhe popujt, për të gjitha vendet që futen në rrugën e socializmit. Ajo duhet studiuar me kujdesin më të madh, në prizmin e pagabueshëm të marksizëm-leninizmit, për të nxjerrë mësimet të vlefshme se si të çohet përpara në rrugë të sigurt dhe me sa më pak zigzage e sakrifica çështja e socializmit në të gjitha vendet.

Nuk ka qenë aspak e sheshtë rruga që ka kaluar diktatura e proletariatit në këta 25 vjet edhe në vendin tonë. E tërë kjo periudhë është përshkuar nga një luftë e pamëshirshme klasash me armiqtë e brendshëm e të jashtëm, që nga çifligarët e tregtarët e gjer te kulakët dhe tek elementët e ndryshëm antisocialistë, që nga bandat e armatosura të diversantëve dhe nga organizatat tradhtarë të spiunëve e të sabotatorëve gjer te deviatorët në radhët e Partisë, që nga imperialistët e ndryshëm dhe monarko-fashistët grekë gjer te revizionistët modernë titistë e hrushovianë. Lufta e klasave është zhvilluar pa ndërprerje edhe në gjirin e popullit, kundër të gjitha ndikimeve të huaja që helmojnë ndërgjegjen e punonjësve. Kjo luftë klasash kundër armiqve e në gjirin e popullit është zhvilluar në të gjitha fushat dhe me mjetet më të ndryshme: politike dhe ekonomike, ideologjike dhe kulturore, ushtarake dhe administrative, me metodat e detyrimit dhe të bindjes. Por në çfarëdo fushe që është zhvilluar lufta e klasave, ajo ka qenë, në analizë të fundit, luftë për çështjen e pushtetit shtetëror. Në procesin e kësaj lufte të ashpër klasore diktaturës sonë të proletariatit i janë kanosur plot rreziqe, të hapëta e të fshehta, që nga orvatjet për ta përmbysur me forcë të armatosur e gjer te rreziku i burokratizimit të saj. Por ne i patëm sytë kurdoherë hapur, i goditëm pa mëshirë dhe në kohën e duhur të gjitha orvatjet e armiqve dhe shmangëm rreziqet. Diktatura e proletariatit te ne qëndroi e qëndron si shkëmb graniti.

Partia ka marrë, merr e do të marrë edhe në të ardhmen të gjitha masat e nevojshme për forcimin

dhe përsosjen e gjithanshme e të vazhdueshme të shtetit tonë të diktaturës së proletariatit. Ajo ka forcuar e forcon pareshtur organet e luftës kundër armikut, në radhë të parë Ushtrinë Popullore dhe forcat e Sigurimit të Shtetit, armët më të fuqishme të diktaturës së proletariatit. Eksperiencia historike ka vërtetuar në mënyrë të pakundërshtueshme se pushteti i klasës punëtore lind nga gryka e pushkës dhe mbrohet po me pushkë. Pa një ushtri të fuqishme revolucionare, diktatura e proletariatit nuk mund të qëndrojë në këmbë e të ekzistojë. Prandaj Partia dhe Qeveria jo vetëm i kanë pajisur forcat e armatosura me mjetet më moderne të luftës, por, mbi të gjitha, kanë treguar e tregojnë kujdesin më të madh për kalitjen e tyre ideologjike e politike, si armë të ndërgjegjshme të revolucionit dhe të diktaturës së proletariatit. Orientimet dhe masat e Partisë për vendosjen e raporteve të drejta midis njeriut dhe armës në ushtri, duke vënë në plan të parë njeriun, si faktorin vendimtar në luftë; midis punës politike dhe ushtarake, duke vënë politikën në komandë; midis ushtarëve dhe oficerëve, për forcimin e marrëdhënieve të tyre dhe të unitetit të brendshëm të ushtrisë; midis pushkës, kazmës dhe librit në ushtri, duke i dhënë prioritet së parës, — këto, si dhe masat konkrete për krijimin e komiteteve të Partisë dhe për vendosjen e komisarëve politikë, për heqjen e gradave dhe për forcimin e lidhjeve të ushtrisë me popullin, kanë një rëndësi të madhe parimore dhe u shërbejnë forcimit dhe revolucionarizimit të mëtejshëm të Ushtrisë sonë Popullore. Këto masa janë vendimtare për të mos lejuar degjenerimin e Ushtrisë Popullore, të Ar-

mës së Sigurimit të Shtetit, për të mos lejuar shndërrimin e tyre në vegla të verbra në duar të kundërrivolucionit, siç ndodhi në Bashkimin Sovjetik dhe në disa vende të tjera, ku ato përdoren për të ushtruar dhunën revizioniste e socialfashiste mbi popullin e pakënaqur, apo për qëllimet ekspansioniste të imperializmit revizionist sovjetik.

Krahas forcimit të gjithanshëm të Ushtrisë Popullore dhe të Armës së Sigurimit të Shtetit, Partia dhe pushteti popullor, ashtu siç na mëson Karl Marksi, kanë ecur me vendosmëri në rrugën e përgatitjes ushtarake dhe të armatosjes së të gjithë popullit. Kjo jo vetëm e ka bërë Shqipërinë socialiste një shkëmb graniti të patundur përballë çfarëdo agresioni imperialisto-revizionist, por ka edhe një kuptim të thellë politik e ideologjik, sepse përbën një përsosje të mëtejshme të sistemit të diktaturës së proletariatit, përfaqëson një nga shprehjet më të thella të demokracisë proletare në veprim, dëshmon për karakterin thellësisht popullor të pushtetit, për përkrahjen e pakufishme të tij nga gjithë populli. Kjo është një ndër rrugët më efektive për edukimin patriotik dhe klasor-revolucionar të masave të gjera të punonjësve. Kjo do të thotë se mbrojtja e atdheut dhe e rendit tonë socialist është bërë e po bëhet çdo ditë e më shumë çështje jetike e të gjithë popullit.

Veçanërisht e rëndësishme për ruajtjen dhe për forcimin e diktaturës së proletariatit është lufta që ka zhvilluar e zhvillon Partia për çrrënjosjen e shtrembërimeve burokratike, që, siç dihet, shërbyen si një ndër bazat kryesore të lindjes dhe të përhapjes së revi-

zionizmit në Bashkimin Sovjetik. Lufta kundër burokratizmit synon në lidhjen e ngushtë të pushtetit me popullin, në vënien e tij nën kontrollin e drejtpërdrejtë, efektiv e të vazhdueshëm të masave të gjera punonjëse, në zhvillimin e gjithanshëm, në thellimin dhe në përsosjen e pandërprerë të demokracisë socialiste. Ajo përbën gjithashtu një garanci të madhe që diktatura e proletariatit të mos degjenerojë kurrë në një diktaturë antipopullore revizioniste e borgjeze, që ajo të jetë kurdoherë arma e fuqishme e revolucionit dhe e ndërtimit të socializmit.

Të gjithë revizionistët e kanë në majë të gjuhës fjalën «demokraci socialiste» dhe spekulojnë shumë me të. Ky është një mashtrim i madh dhe një demagogji e paturpshme. Atje ku sundojnë revizionistët, nuk ka dhe nuk mund të ketë demokraci për punonjësit. Vetë revizionizmi modern në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera ish-socialiste bazohet në burokratizimin e gjithë jetës së vendit, domethënë në mohimin e demokracisë. Shikoni ç'bëhet në vendet revizioniste! Me rritjen e rezistencës së masave popullore ndaj kursit revizionist, diktatura «liberale» revizioniste po përdor gjithnjë e më tepër metodat e dhunës së hapur fashiste. Në Çekosllovakia e ashtuquajtura demokraci e Husakut dhe e padronëve të tij moskovitë shfaqet në formën e raprezaljeve më të egra kundër popullit patriot çekoslllovak.

Partia jonë kurrë nuk e ka parë demokracinë socialiste me syrin e një sentimentalizmi të zbrazët dhe as si një stoli të kotë ose si një të drejtë formale të popullit punonjës. Duke iu përmbajtur me konsekuen-

cë parimit të centralizmit, si një parim themelor i pashmangshëm i çdo diktature të vërtetë proletare, ajo, në të njëjtën kohë, e konsideron demokracinë socialiste më të gjerë e më të plotë për punonjësit, si një kusht të domosdoshëm e vendimtar për ekzistencën e diktaturës së proletariatit, për ruajtjen dhe për forcimin e saj të vazhdueshëm. Çdo qëndrim i njëanshëm në këtë çështje të madhe parimore, shkelja qoftë e parimit të centralizmit proletar, qoftë e demokracisë socialiste janë tepër të rrezikshëm për rendin socialist.

Masat që janë marrë për çrrënjosjen e koncepteve e të praktikave të dëmshme burokratike, kanë forcuar shumë diktaturën e proletariatit, kanë zgjeruar demokracinë socialiste, kanë rritur iniciativën krijuese të punonjësve në të gjitha fushat. Të tilla janë ato për forcimin e marrëdhënieve të drejta midis kuadrove e punonjësve, për luftën kundër shfaqjeve të centralizmit burokratik që mbyt iniciativën e vetëveprimin e bazës, për rritjen e rolit e të kompetencave të organeve dhe të njerëzve të zgjedhur të pushtetit, tërheqja aktive e mendimit të punëtorëve e të fshatarëve dhe pjesëmarrja e tyre në zgjidhjen e problemeve shtetërore, spastrimi i legjislacionit nga influencat e huaja e nga gjërat e tepërta dhe, përmbi të gjitha, forcimi i kontrollit të drejtpërdrejtë të klasës punëtore mbi çdo gjë e mbi këdo.

Por ne nuk mendojmë dhe nuk duhet të mendojmë aspak se është arritur kulmi, se nuk ka më vend për zhvillimin dhe për thellimin e mëtejshëm të vijës së masave e të demokracisë socialiste, se janë zgjidhur të gjitha problemet dhe janë zhdukur tanimë të gjitha

vështirësitë e pengesat në këtë fushë, se lufta kundër burokratizmit ka marrë fund. Na mbetet akoma shumë e shumë për të bërë. Duke u mbështetur në mësimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, ne duhet të thellojmë më tej shumë parime të drejta e forma demokratike që janë futur tanimë në jetën tonë. Të jemi kurdoherë në kërkim për të gjetur forma e mjete të reja, më të përsosura, të demokracisë socialiste. Duhet, sidomos, që të gjitha këto të mos mbeten formale, në teori, por të zbatohen plotësisht në jetë, në praktikë, të bëhen pjesë e pandarë e jetës shoqërore të përditshme, të futen në shpirtin dhe në gjakun e gjithë punonjësve. Kjo kërkon që lufta kundër koncepteve e pengesave burokratike, që janë armiku i rrezikshëm i demokracisë proletare dhe që, fatkeqësisht, ekzistojnë dhe do të vazhdojnë të ekzistojnë akoma për një kohë të gjatë, të mos ndërpritet për asnjë çast, por të vazhdojë e ashpër e pa lëkundje nga lart, dhe sidomos nga poshtë, me pjesëmarrjen aktive të masave të gjera punonjëse.

Mbi të gjitha, duhet ruajtur kurdoherë e pacenuar dhe të forcohet pareshtur udhëheqja e pandarë e Partisë në shtetin socialist. Ky është një parim bazë i paturdur i diktaturës së proletariatit, kusht i domosdoshëm e themelor i ekzistencës së saj. Predikimet e revizionistëve të ndryshëm për «pavarësinë» e shtetit socialist nga partia proletare janë largimi më flagrant prej pozitave të marksizëm-leninizmit dhe kanë për qëllim të justifikojnë likuidimin e diktaturës së proletariatit. Ne edhe në të ardhmen do të ecim në rrugën e forcimit të mëtejshëm të udhëheqjes së Partisë në

çdo qelizë të pushtetit e të tërë jetës sonë shoqërore, të përsosjes së saj të vazhdueshme, duke luftuar e duke flakur tej çdo shfaqje të formalizmit e të burokratizmit.

Populli shqiptar, Partia dhe Qeveria e tij kanë ndjekur e ndjekin një politikë të jashtme thellësisht parimore e konsekuente

Shokë e shoqe,

Gjatë 25 vjetëve të jetës së lirë populli shqiptar, Partia dhe Qeveria e tij, të udhëhequr nga mësimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar, kanë ndjekur një politikë të jashtme thellësisht parimore e konsekuente. Në çdo etapë dhe në çdo fazë të zhvillimit të marrëdhënieve ndërkombëtare ajo u është përgjigjur plotësisht mbrojtjes së lirisë e të pavarësisë së atdheut, të sovranitetit dhe të integritetit të tij, ruajtjes së fitoreve të revolucionit popullor. Politika jonë e jashtme ka qenë kurdoherë në shërbim të çështjes së madhe të popujve që luftojnë për socializmin, për lirinë e për pavarësinë e tyre kombëtare, për vetëvendosjen dhe sigurimin e një bashkëpunimi me të vërtetë të barabartë ndërkombëtar.

Shqipëria e re popullore, që me krijimin e saj dhe vazhdimisht, është ndeshur në një luftë të ashpër me imperialistët dhe me veglat e tyre, që kërkonin ta copëtonin dhe ta robëronin. Por Partia dhe populli ynë, të bashkuar në një unitet të çeliktë revolucionar, i

thyen njërën pas tjetrës valët e sulmeve të tërbuara dhe komplotet kriminale që imperialistët amerikanë, anglezë e këlyshët e tyre shpërthyen kundër vendit tonë.

Ata mbrojtën me vetëmohim e me trimëri lirinë e pavarësinë e fituar, pushtetin popullor dhe punën ndërtime; ata u bënë ballë me guxim orvatjeve të imperializmit dhe të reaksionit ndërkombëtar për të ndërhyrë në punët tona të brendshme, për të na imponuar diktatin e tyre dhe për të na nënshtruar. Shqipëria, e dalë nga revolucioni popullor, nuk u tremb dhe nuk u zbraps përpara intrigave, shantazheve dhe fushatave shpifëse e denigruese që armiqtë imperialistë dhe veglat e tyre ndërmorën pa pushim kundër saj. Ajo i dërrmoi me grushtin e vet të fuqishëm provokacionet e armatosura në kufi dhe orvatjet për të organizuar e për të nxitur reaksionin e brendshëm kundër pushtetit popullor. Me urtësi e me guxim vendi ynë bëri të dështojnë të gjitha përpjekjet e ndërmarra nga imperialistët dhe nga reaksioni ndërkombëtar për të na rrethuar dhe për të na izoluar nga bota e jashtme, me qëllim që të na mbytnin dhe të na shkatërronin pastaj më lehtë.

Republika Popullore e Shqipërisë mundi t'u bëjë ballë gjithë këtyre rrebesheve dhe të marshojë fitimtare, e lirë dhe e pavarur në rrugën e socializmit, pasi ndiqte një politikë parimore revolucionare të brendshme e të jashtme, pasi mbronte një çështje të drejtë në rrugë të drejtë.

Qëndrimi, lufta jonë parimore kundër imperializmit dhe reaksionit botëror përbëjnë një eksperiencë të

vlefshme, e cila dëshmon se liria dhe pavarësia e fituar e çdo populli, e aq më tepër e një populli të vogël, mbrohen vetëm me një luftë të vazhdueshme e pa kompromis në çdo situatë e rrethanë. Ajo dëshmon gjithashtu se vetëm duke luftuar kundër imperializmit dhe reaksionarëve të tjerë, mund të garantohen ekzistenca e pavarur e shtetit socialist dhe ndërtimi i jetës së re.

Lufta jonë kundër imperializmit ka qenë një luftë aktive, pjesë e pandarë e luftës së përbashkët antiimperialiste të popujve. Partia dhe Qeveria kanë dënuar dhe kanë demaskuar në çdo kohë e në çdo hap politikën dhe veprimtarinë agresive e luftënxitëse të imperializmit, me atë amerikan në krye, qëllimet e tij shtypëse e skllavëruese, duke dhënë kështu kontributin e vet për mbrojtjen e paqes e të sigurimit ndërkombëtar.

Krahas luftës kundër imperializmit dhe reaksionit, Partia dhe populli ynë kanë bërë një luftë të vendosur e parimore kundër revizionizmit titist, kësaj rryme të tërbuar antimarksiste, si dhe kundër revizionizmit hrushovian, armikut më të madh të komunizmit ndërkombëtar. Kjo luftë përbën një epope të lavdishme në historinë e Partisë dhe të popullit shqiptar. Edhe pse të vegjël e vetëm në fillim, ne nuk patëm frikë të ngriheshim në një luftë të pabarabartë kundër armiqve të egër e të fuqishëm, kur ishte çështja për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit e të komunizmit, dhe të dëlnim fitimtarë mbi ta.

Vendosmëria dhe guximi ynë në këtë përleshje me rëndësi historike botërore nuk janë as pasojë e gjak-

nxehtësisë, as aventurizëm, as shprehje e njëfarë karakteri të veçantë të shqiptarëve, siç shpifin revizionistët. Ata janë pasojë e virtyteve të larta revolucionare të Partisë sonë, e besnikërisë së saj të pafund ndaj popullit të vet e proletariatit botëror, e pjekurisë së saj marksiste-leniniste. Partia dhe populli ynë i dolën përpara dhe i vunë gjoksin rrymës kundërrevolucionare revizioniste, duke qenë të bindur se në këtë luftë ne mbronim jo vetëm interesat tanë kombëtarë të socializmit në Shqipëri, të kërcënuar seriozisht, por edhe interesat e proletariatit e të revolucionit botëror. Vësh-tirësitë e sakrificat që kemi përballuar gjatë këtyre 25 vjetëve në luftën e pandërprerë kundër revizionizmit, nuk kanë qenë të vogla. Por ne e ndërморëm këtë luftë për hir të së tanishmes dhe të së ardhmes sonë socialiste, për hir të së ardhmes së revolucionit e të komunizmit në të gjithë botën.

Jeta, fitoret e arritura në luftën kundër revizionizmit modern e kanë vërtetuar plotësisht qëndrimin e vendosur e parimor të Partisë sonë ndaj rrymës më të rrezikshme oportuniste e tradhtare që ka njohur ndo-njëherë komunizmi ndërkombëtar. Pa luftën kundër revizionizmit nuk do të kishte qenë kurrë e mundur që ne të zhvillonim me sukses edhe luftën kundër imperializmit, të mbronim lirinë e pavarësinë kombëtare, t'i çonim përpara fitoret e revolucionit popullor.

Eksperiencia botërore ka vërtetuar tanimë fare qartë se kush ndjek një politikë oportuniste, lëshimesh e kapitullimi në çështjet kyç të politikës së jashtme e të marrëdhënieve ndërkombëtare, siç është qëndrimi ndaj revizionizmit, ai nuk mund të mos bjerë në pozita

oportuniste e revizioniste brenda vendit, nuk mund të mos shtypet herët ose vonë nga forcat regresive dhe kundërrevolucionare.

Historia e gjatë e përlëshjeve tona me revizionistët, midis mësimëve të tjera shumë të vlefshme, ka vërtetuar në mënyrën më të qartë dhe më të kuptueshme të vërtetën e njohur leniniste se në luftën kundër oportunitizmit, si brenda ashtu edhe jashtë, i vetmi qëndrim i drejtë është qëndrimi parimor, e vetmja rrugë e drejtë për të arritur fitoren e sigurt është lufta konsekuente pa kompromis dhe pa asnjë lëshim.

Partia e Punës e Shqipërisë, populli shqiptar, në luftën kundër revizionizmit modern nuk do të ndalen kurrë në mes të rrugës. Ata, si deri sot, të ndërgjegjshëm për detyrat e tyre të larta kombëtare e ndërkombëtare, do të luftojnë deri në fund kundër tradhtisë revizioniste, deri në triumfin e plotë të çështjes së lavdishme të marksizëm-leninizmit e të revolucionit botëror.

Në sajë të luftës heroike e parimore kundër imperializmit e revizionizmit modern, të politikës dhe të qëndrimeve të drejta në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, Republika Popullore e Shqipërisë ka siguruar miq të fuqishëm dhe dashamirë në të gjithë botën. Ajo gëzon sot simpatinë, respektin dhe përkrahjen e komunistëve e të revolucionarëve të vërtetë, të të gjithë popujve përparimtarë e të vendeve paqedashëse. Shqipëria e re socialiste po hyn në çerekshekullin e dytë të jetës së saj të lirë e të pavarur me një prestigj e autoritet të madh ndërkombëtar. Ajo kontribuon me të gjitha forcat dhe luan një rol pozitiv në pro-

cesin e zhvillimit botëror. Ne e shikojmë me optimizëm zhvillimin e gjendjes ndërkombëtare, kemi bindjen e patundur në fitoren përfundimtare të revolucionit botëror, kemi besim të plotë në të ardhmen e ndritur të njerëzimit.

Analiza e ngjarjeve të sotme botërore vërteton në mënyrën më bindëse se revolucionin është kudo në ngjijtje, situata ndërkombëtare zhvillohet në favor të tij dhe në dëm të imperialistëve e të revizionistëve.

Valët e fuqishme të lëvizjes revolucionare botërore po ngrihen tani në të gjitha kontinentet dhe po tronditin nga themelet sistemin e kalbur të shfrytëzimit kapitalist, të shtypjes kombëtare dhe të zgjedhës koloniale. Lufta çlirimtare antiimperialiste e popujve të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine po merr përpjesëtime gjithnjë e më të gjera. Një shembull i shkëlqyer është lufta e popullit vietnamez, e cila i ka shkaktuar disfata të mëdha imperializmit amerikan dhe e ka përmbysur një herë e përgjithmonë mitin e pathyeshmërisë së fuqisë së madhe dhe të armatimeve moderne. Flakët e luftës revolucionare çlirimtare janë nderur të fuqishme në Laos e në Tajlandë, në Birmani e në Indi, në Angola e në Mozambik, në Kolumbi e në Venezuelë etj. Popujt arabë po i bëjnë një rezistencë të fuqishme agresionit izraelito-imperialist dhe partizanët palestinezë luftojnë me heroizëm për çlirimin e vatrave të tyre të robëruara.

Në Evropë, në Amerikën e Veriut dhe në vendet e zhvilluara kapitaliste kohët e fundit vihet re një ngritje e hovit revolucionar, i cili paralajmëron për beteja edhe më të mëdha klasore në të ardhmen. Grevat

e mëdha të punëtorëve e të studentëve në të gjitha vendet kapitaliste të Evropës, përleshjet e tyre klasore kanë tronditur sistemet e vjetra borgjeze dhe kanë forcuar ndërgjegjen revolucionare të masave punonjëse. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kështjella e imperializmit, po tmerrohen nga revolta e gjerë e zezakëve.

Me dhjetëra parti dhe organizata marksiste-leniniste janë krijuar e po krijohen në të gjitha vendet e botës. Ky proces i pandalshëm revolucionar dëshmon për krijimin e një gjendjeje të re në gjirin e klasës punëtore ndërkombëtare, për fillimin e shkëputjes së saj nga vargonjtë që i kanë hedhur përsipër partitë socialdemokrate e revizioniste, dëshmon se idetë e marksizëm-leninizmit po pushtojnë gjithnjë e më shumë mendjet dhe zemrat e masave të gjera punonjëse.

Imperialistëve, revizionistëve dhe gjithë reaksionarëve të tjerë po u fundoset toka nën këmbë. Të mbërthyer në vend nga goditjet e fuqishme revolucionare të popujve, ata po demaskohen dhe po izolohen gjithnjë e më shumë. Kontradiktat, përçarjet dhe grindjet midis tyre zgjerohen e thellohen. Vështirësi të mëdha dhe të pakapërcyeshme u kanë dalë imperialistëve amerikanë dhe revizionistëve sovjetikë për të mbajtur nën kontrollin e vet satelitët e tyre. Tendencat centrifugale, policentriste e separatiste që vihen re në të dy kampet, kanë krijuar një kaos të vërtetë. Përpjekjet e dy «të mëdhenjve» për t'i shkëputur njëri-tjetrit aleatët, e kanë shtuar edhe më tepër konfuzionin.

Tanimë nuk ka forcë në botë që të ndalë marshimin fitimtar të popujve, nuk ka forcë që të mund ta

evitojë disfatën e pashmangshme të imperializmit e të revizionizmit.

Megjithëkëtë, ne marksistë-leninistët, në kundërshtim me revizionistët që përpiqen të ngjallin iluzione pacifiste dhe t'i vënë masat në gjumë, nuk harrojmë për asnjë çast se politika antipopullore e kundërrevolucionare e imperializmit jo vetëm që s'ka ndryshuar, por është intensifikuar edhe më shumë. Imperializmi bën çmos dhe vë të gjitha forcat e tij për të mbytur revolucionin e socializmin, për të mbajtur e për të konsoliduar kudo pozitat e reaksionit.

Në skenën botërore tani ka dalë një imperializëm i ri, ai revizionist sovjetik, i cili pretendon për hegjemoninë botërore. Kjo nuk mund të mos e keqësojë situatën dhe të mos e vështirësojë luftën e popujve për çlirimin kombëtar e shoqëror.

Në krye të të gjitha forcave regresive e reaksionare të kohës sonë qëndron imperializmi amerikan, i cili është armiku dhe shfrytëzuesi më i madh i të gjithë popujve, kështjella e kolonializmit dhe xhandari ndërkombëtar i reaksionit botëror. Në bazën e gjithë politikës dhe të veprimtarisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës qëndron synimi për të nënshtuar gjithë botën, duke vënë nën zgjedhë, në radhë të parë popujt e Azisë, të Afrikës e të Amerikës Latine dhe duke i imponuar sundimin ekonomik, politik e ushtarak të imperializmit amerikan mbarë botës kapitaliste. Mbi të gjitha, objektivi kryesor i imperializmit amerikan mbetet shtypja e lëvizjeve revolucionare e çlirimtare të popujve, shkatërrimi i socializmit.

Nga vetë natyra e tij, imperializmi amerikan nuk

mund të jetojë gjatë pa shtypjen e popujve të tjerë, pa tregje, pa grabitjen e lëndëve të para. Për t'i siguruar këto, ai ka shtrirë bazat ushtarake dhe ka dërguar trupat e tij në të katër anët, kurdis komplete dhe kryen agresione të hapëta ushtarake. Pangopësia e tij nuk ka kufi. Me dollarin ai blen tek aleatët e tij edhe ndërgjegen dhe mendjen e njerëzve, duke i varfëruar ata nga kuadrot e inteligjencies teknike dhe duke krijuar kështu kushte të tjera për t'i nënshtruar më tej.

Në këtë situatë, midis imperializmit amerikan dhe politikës së tij globale agresive, nga njëra anë, dhe popujve e luftës së tyre çlirimtare e antiimperialiste, nga ana tjetër, ekziston një kontradiktë e thellë e papajtueshme, që përshkon tërë politikën e sotme botërore. Për këtë arsye edhe qëndrimi ndaj imperializmit, e në radhë të parë ndaj atij amerikan, përbën gurin e provës për të gjitha forcat politike të botës. Jashtë luftës që zhvillohet midis imperializmit dhe forcave revolucionare praktikisht nuk mund të mbetet asnjë. Çështja e vetme që shtrohet për çdo forcë politike është se cilën anë do të mbajë, se cilën rrugë do të zgjedhë. Popujt dhe revolucionarët e vërtetë e kanë përcaktuar tanimë qartë qëndrimin e vet. Drejtimi kryesor strategjik i tyre është lufta e gjithanshme, e papajtueshme dhe deri në fund konsekuente kundër imperializmit amerikan dhe shërbëtorëve të tij.

Popujt e botës po bashkohen në një front të gjerë kundër imperializmit, me atë amerikan në krye. Forcimi i pareshtur i këtij fronti është sot një detyrë historike me rëndësi jetike për të gjithë revolucionarët. Por që ai të konsolidohet dhe të sigurojë fitoren për-

fundimtare, nuk mund të mos e zhvillojë luftën e tij njëkohësisht në të dy drejtimet: kundër imperializmit amerikan dhe kundër aleatit të tij, revizionizmit sovjetik. Lufta kundër imperializmit amerikan dhe lufta kundër imperializmit revizionist sovjetik sot janë të pandara, ato janë shkrirë në një të vetme. Do të ishte shumë e dëmshme dhe mjaft e rrezikshme në qoftë se ndokush ushqen akoma iluzione për revizionistët hrushovianë dhe gabohet nga demagogjia e tyre «anti-imperialiste».

Një nga tiparet dalluese të situatës së sotme ndërkombëtare është kalimi i revizionizmit sovjetik në socialimperializëm, shtimi i agresivitetit dhe intensifikimi i përpjekjeve të tij ekspansioniste. Kjo është pasojë e natyrshme dhe e pashmangshme e shndërrimit të Bashkimit Sovjetik nga një vend socialist në një vend kapitalist, e braktisjes së politikës leniniste internacionaliste dhe e rikthimit në politikën e vjetër cariste, shoviniste, rusomadhe. Sistemi kapitalist i rivendosur nuk mund të mos impononte ligjet e tij barbare, jo vetëm në jetën e brendshme të vendit, por edhe në fushën e politikës së jashtme. Fashistizimit brenda i ka korresponduar kurdoherë agresioni përjashta.

Rruga që kanë zgjedhur revizionistët sovjetikë për të realizuar synimet e tyre grabitqare, është rruga e vjetër e carëve dhe e imperialistëve të tjerë, rruga e mashtrimit dhe e dhunës së armatosur. Rublat dhe tanket, gënjeshttrat dhe shantazhet, demagogjia dhe kërcënimet ecin paralel. Por sa më shumë që krerët e Kremlinit shtyhen përpara në planet e tyre ekspansioniste, sa më të vështira bëhen gjendja e tyre e bre-

ndshme dhe marrëdhëniet me satelitët, aq më shumë shtohet edhe aventurizmi i tyre ushtarak, aq më tepër në plan të parë del agresioni i armatosur si mjet për kapërcimin e vështirësive dhe të kontradiktave. Jeta vërtetoi me fakte të pakundërshtueshme se Partia jonë kishte shumë të drejtë kur, qysh në fillim, zbuloi botërisht natyrën imperialiste të udhëheqjes renegate sovjetike. Pushtimi i Çekoslovakisë është një shembull që zbulon gjithë kalbëzimin dhe degjenerimin e klikës sunduese në Bashkimin Sovjetik, që nxjerr në pah fytyrën e saj të vërtetë imperialiste, armike të betuar të lirisë dhe të pavarësisë së popujve.

Agresioni kundër Çekoslovakisë nuk ishte një rast i veçantë, as një ngjarje unike e papërsëritshme, por shfaqja e parë e zbatimit praktik të një politike agresive e shoviniste të stilit fashist, pikënisja për aventura edhe më të mëdha kundër lirisë e pavarësisë së popujve të tjerë. Njëkohësisht me pushtimin e Çekoslovakisë u krye në heshtje edhe përforcimi i pushtimit ushtarak të Polonisë, të Hungarisë, të Republikës Demokratike Gjermane, të Bullgarisë e të Mongolisë, ku u vendosën trupa të reja sovjetike për të ruajtur rendin perandorak të revizionistëve të Moskës. Fakt është se tani kërcënimet revizioniste sovjetike ndaj pavarësisë së Rumanisë kanë marrë një karakter mjaft konkret dhe nuk mbahen më të fshehta planet dhe qëllimet për të sulmuar Jugosllavinë e Shqipërinë.

Mjaft qartë politika ekspansioniste rusomadhe e imperialistëve revizionistë sovjetikë shprehet edhe në provokacionet e armatosura që kanë ndërmarrë në kufijtë me Kinën. Tani ata kanë përqendruar në Lindje

trupa të shumta, kanë shtuar arsenalin ushtarak dhe përgatiten për luftë agresive kundër Republikës Popullore të Kinës. Se deri ku do të shkojë çmenduria e aventurierëve që tani sundojnë në Krenlin, kjo nuk dihet.

Për të realizuar qëllimet e tyre ekspansioniste, udhëheqësit sovjetikë po vënë tani në përdorim Traktatin e Varshavës, të cilin e kanë kthyer në një instrument shtypjeje dhe agresioni. Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë e denoncoi Traktatin e Varshavës për arsye politike, ushtarake e ideologjike, sepse ndryshuan karakteri dhe qëllimi i tij. Nga një traktat për mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë së shteteve socialiste, për mbrojtjen e popujve dhe të paqes, ai u shndërrua në një traktat për skllavërimin e vendeve pjesëmarrëse në të dhe në një mjet të politikës imperialiste të rrezikshme sovjetike kundër popujve dhe sigurimit ndërkombëtar.

Në këto kushte të qëndronim në Traktatin e Varshavës do të thoshte t'i përlegjnim veprimet dhe qëllimet agresive të këtij traktati, të përkrahim dhe të bëheshim ortakë të një fuqie imperialiste, t'i aprovonim agresionin kundër Çekosllovakisë dhe planet e tjera grabitqare të revizionistëve sovjetikë. Po të qëndronim në këtë traktat, ne nuk do të ishim më marksistë. Leninizmi na mëson se komunistët nuk duhet të mashtrohen kurrë nga parullat «socialiste», me të cilat mbulohen agresorët, nuk duhet të bëhen kurrë mbrojtës të imperializmit, nën çdo ngjyrë e formë që ai të paraqitet. Të veprosh ndryshe do të thotë të biesh në pozitat oportuniste të tradhtarëve të Internacionales

së Dytë, të cilët nuk vonuan shumë të kalojnë nga përhapës të iluzioneve për imperializmin në bashkëpunëtorë të hapur të tij dhe në socialshovinistë. Të pajtohesh me revizionistët sovjetikë në emër të luftës gjoja kundër imperializmit amerikan, do të thotë të bëhesh përkrahës i një imperializmi po aq të egër e barbar sa edhe tjetri, do të thotë të bëhesh bashkëpunëtor i një imperializmi kundër një imperializmi tjetër në luftën që ata bëjnë për epërsi, për zona influence e për sundim botëror.

Në përpjekjet që bëjnë për të sunduar popujt dhe për të grabitur pasuritë e tyre, revizionistët sovjetikë mundohen që politikën e shovinizmit të shtetit të madh ta justifikojnë edhe «teorikisht», ta paraqitin si marksiste-leniniste, si kulmin e internacionalizmit proletar. Me një fjalë, ata kërkojnë t'i veshin ujku lëkurën e deles. E tillë është teoria famëkeqe e «sovrانيتit të kufizuar» e shpallur nga kryerevizionisti Brezhnjev, me të cilën revizionistët sovjetikë kërkojnë t'i sigurojnë vetes të drejtën e ndërhyrjes dhe të pushtimit të vendeve të tjera. Me anë të kësaj teorie reacionare ata kërkojnë t'i detyrojnë të tjerët të tradhtojnë dhe të hedhin poshtë një nga ndjenjat më të pastra e më të larta që ka çdo komb e popull, ndjenjën e lirisë dhe të mbrojtjes së sovranitetit të vet, të kapitullojnë dhe t'i hapin rrugën pushtimit revizionist sovjetik. Duke e lyer me bojë marksiste këtë teori imperialiste, revizionistët sovjetikë synojnë që ta shtrijnë edhe në lëvizjen komuniste, për t'i detyruar partitë e tjera të heqin dorë nga pavarësia e tyre dhe t'i binden për çdo

gjë shkopit të dirigjentit të Moskës, të shndërrohen në një bisht të politikës së jashtme sovjetike.

Por të tilla teori të urryera fashiste nuk pinë ujë. Mbrojtja e sovranitetit të vendeve socialiste, si dhe e gjithë vendeve të tjera, nga imperializmi apo nga çdo armik qoftë, bëhet jo duke e kufizuar atë apo duke e lënë në duart e ujqve revizionistë, por duke ruajtur pavarësinë dhe sovranitetin e plotë, kurdoherë dhe në të gjitha çështjet, në luftë të paprerë kundër imperializmit dhe revizionizmit. Nuk mund të jetë kurrë sovran një vend, e aq më tepër socialist, kur është i skllavëruar plotësisht ose gjysmë i pushtuar nga një fuqi e madhe imperialiste ose shoviniste. Sovranitetin dhe pavarësinë ai i gëzon vetëm atëherë kur zbaton një vijë të vendosur për mbrojtjen e parimeve të drejta të lirisë, të pavarësisë e të sovranitetit, duke u mbështetur në forcat e veta dhe në solidaritetin internacionalist të klasës punëtore ndërkombëtare e të popujve revolucionarë.

Një përgjegjësi e madhe bie tani mbi popullin sovjetik. Ai nuk duhet ta lejojë veten të mashtrohet nga propaganda fashiste, me anë të së cilës renegatët revizionistë mundohen të helmojnë ndërgjegjen e tij. Udhëheqësit hrushovianë kërkojnë t'i prishin mendjen duke fryrë ndjenjat më të ulëta nacionaliste e shoviniste, për ta kthyer në një masë të bindur që të plotësojë në mënyrë të verbër planet e tyre adventureske. Ne shpresojmë se populli sovjetik nuk i ka harruar mësimet e pavdekshme të Leninit e të Stalinit, se në zemrën e tij jetojnë gjithnjë të gjallë fryma e komunizmit dhe solidariteti internacionalist. Ne shpresojmë se

ushtari sovjetik, i cili përshkoi Evropën, luftoi atje dhe në Azi për të shkatërruar fashizmin dhe për t'u sjellë popujve lirinë, nuk do ta përshkojë këtë rrugë për t'u grabitur lirinë popujve të tjerë dhe për të vendosur fashizmin e ri revizionist. Armët që i japin atij për të skllavëruar të tjerët, ai duhet t'i drejtojë kundër klikës uzurpatore, për t'i kthyer vendit të tij lavdinë e mëparshme, emrin dhe nderin e marrë nëpër këmbë nga tradhtarët e renegatët.

Liria dhe pavarësia e të gjithë popujve, paqja dhe sigurimi ndërkombëtar sot po rrezikohen keqas nga blloku imperialist sovjeto-amerikan. Ky bllok paraqet sot reaksionin më të zi, forcën më të madhe e më të rrezikshme kundërrevolucionare që ka njohur deri sot njerëzimi.

«Aleanca e shenjtë» sovjeto-amerikane po zhvillohet tani në përpjesëtime të papara në të gjitha fushat — ekonomike, politike, ushtarake etj. Të dyja fuqitë e mëdha që kanë nevojën e njëra-tjetrës për realizimin e synimeve të tyre hegjemoniste e dominuese, koordinojnë vazhdimisht planet dhe bashkërendojnë veprimtarinë konkrete në përputhje me strategjinë globale për sundimin e botës. Ato përgatitin dhe zhvillojnë luftëra të ndryshme grabitqare, me anë të të cilave kërkojnë t'i mbajnë popujt nën robërinë e tyre, të shtypin revolucionin.

Sigurisht, si fuqi imperialiste dhe të pangopura që janë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik revizionist kanë edhe kontradikta të mëdha midis tyre, luftojnë njëri me tjetrin dhe planifikojnë t'i hanë kokën njëri-tjetrit. Sistemi i aleancës sovjeto-

-amerikane, duke qenë thellësisht kundërrevolucionar, jo vetëm nuk i përjashton, por i përmban në esencën e tij përçarjet, grindjet e kontradiktat që nuk i lejojnë ata të veprojnë në harmoni dhe në unitet. Kur këto arrijnë kulmin, kur çështja shtrohet për rindarjen e zonave të influencës të njëri-tjetrit, ato mund të çojnë edhe në konflikte me armë midis tyre. Por aktualisht aleanca kundërrevolucionare ndodhet në fazën e konsolidimit e të ekspansionit të saj. Ajo që i bashkon sot është më e rëndësishme për ta se ajo që i ndan. Në radhë të parë të dyja palët, për të mbijetuar, për të ruajtur perandoritë e tyre të mëdha, për të konservuar pozitën e superfuqive, janë të detyruara të afrohen e të bashkëpunojnë dhe luftën kundër revolucionit, socializmit e përpjekjeve çlirimtare të popujve ta bëjnë bazën e mbrojtjes së sistemit të tyre, shpresën themelore për realizimin e strategjisë së tyre ekspansioniste e skllavëruese.

Në koniunkturat aktuale imperializmi amerikan dhe revizionizmi sovjetik përpiqen gjithsecili, pa e trazuar njëri-tjetrin, të bien në ujdi për të ruajtur secili domenet e veta, t'i mbajnë mirë në zap satelitët e tyre në Evropë, të shuajnë grindjet e kontradiktat imperialiste midis tyre, që pastaj t'u krijohet fushë e lirë e të hidhen me të gjitha forcat për të shtypur lëvizjet revolucionare e çlirimtare të popujve e, çka është më kryesorja, ta drejtojnë t'atun e luftës së tyre të për-bashkët kundër Kinës.

Një nga veçoritë e gjendjes së sotme ndërkombëtare është fakti se proletariati botëror po fiton ndërgjegjen e forcës së tij. Masat punonjëse që vuajnë nën

zgjedhën kapitaliste e revizioniste, çdo ditë e më mirë zbulojnë e kuptojnë shkaqet e gjendjes së tyre të mjerueshme dhe hedhin poshtë me përbuzje demagogjinë dhe cinizmin e klasave sunduese. Marksizëm-leninizmi, ideologjia fitimtare e socializmit shkencor, frymëzon çdo ditë e më shumë proletariatin botëror, u ndriçon masave të shtypura rrugën drejt revolucionit.

Imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë përpiqen të ruajnë qetësinë, statukuonë dhe aleancat. Por popujt, revolucionarët, gjithë ata që i urrejnë shtypjen e shfrytëzimin, nuk e duan qetësinë që kërkojnë t'i imponojnë botës imperialistët e revizionistët, nuk e duan statukuonë reaksionare, që ngurtëson ndarjen e botës midis dy fuqive të mëdha imperialiste, ata janë kundër aleancave kundërrevolucionare që synojnë skllavërimin e popujve, grabitjen e lirisë e të pavarësisë së tyre.

Imperialistët dhe revizionistët reklamojnë shumë të ashtuquajturën bashkekzistencë paqësore të tyre, por popujt, revolucionarët hedhin poshtë me përbuzje këtë mashtrim monstruoz, që ka për qëllim të legalizojë sundimin imperialist në botë, të shuajë luftërat revolucionare dhe të lejojë zhvillimin e luftërave agresive, grabitqare të tyre. Popujt dhe revolucionarët janë për bashkekzistencën paqësore të shpallur nga Lenini, e cila nuk mund të shtrihet kurrë në sferën e ideologjisë, të luftës klasore dhe të revolucionit e të luftërave çlirimtare. Ata hedhin poshtë me vendosmëri, gjithashtu, blofin e «çarmatimit të përgjithshëm» që reklamojnë imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë, i cili ka për qëllim çarmatosjen e të tjerëve

përpara agresorëve imperialisto-revizionistë, ruajtjen e monopolit bërthamor dhe shtimin e armatimeve për veten e tyre.

Shfrytëzimi i egër kapitalist, qoftë ky imperialist amerikan apo revizionist sovjetik, është njëloj i padurueshëm për popujt, të cilët luftojnë dhe do të luftojnë akoma më me vendosmëri për ta hequr qafe. Antagonizmi më i madh klasor i kohës sonë është ai që ekziston midis imperialisto-revizionistëve, nga njëra anë, dhe popujve, nga ana tjetër. Ai sa vjen e po ashpërsohet dhe shprehet në luftërat e mëdha klasore në platformë kombëtare e ndërkombëtare që zhvillohen me shumë sukses dhe në favor të popujve.

E ardhmja, pavarësisht nga zigzaget e zhvillimit të sotëm botëror, i takon revolucionit, socializmit. Fakt është se proletariati botëror, nga eksperiencia e luftës së tij të përditshme, po bindet se, për të ndërtuar botën e re pa shtypës e pa shfrytëzues, duhet më parë të shkallmojë që nga themelet botën e vjetër, gjë që mund të bëhet vetëm me rrugë revolucionare, me dhunën e armëve.

Sigurisht, revolucioni botëror nuk do të shpërthejë dhe as do të fitojë brenda një dite. Lufta do të jetë e gjatë, e vështirë dhe do të kërkojë mjaft sakrifica, por ideja e revolucionit dhe e vendosjes së diktaturës së proletariatit do të ndjekë rrugën e saj të pandalshme përpara. Nën udhëheqjen e partive marksiste-leniniste, proletariati botëror do ta kryejë me siguri misionin e tij të lartë historik, ai do të dijë t'u bëjë ballë me trimëri sulmeve të hapëta e të fshehta të borgjezisë dhe të lakenjve të saj socialdemokratë e revizionistë,

do të dijë të çojë deri në fund çështjen e socializmit e të komunizmit.

Triumfi i revolucionit dhe i socializmit në të gjitha vendet është i pashmangshëm

Populli shqiptar, Partia dhe Qeveria e tij, duke punuar pa u lodhur për ndërtimin e socializmit në vendin e tyre, ndjekin me vëmendje dhe me vigjilencë të mprehtë zhvillimin e situatës së sotme botërore. Njëkohësisht, ata zhvillojnë një veprimtari të gjerë aktive në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare, në përputhje me parimet e drejta revolucionare të politikës sonë të jashtme.

Shqipëria e re përfaqëson sot një faktor të rëndësishëm paqeje dhe përparimi në botë. Ajo ka zbatuar e zbaton në mënyrë parimore dhe me këmbëngulje politikën e fqinjësisë së mirë dhe të marrëdhënieve normale midis shteteve me sisteme të ndryshme shoqërore, në bazë të parimeve të mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit dhe të respektimit të pavarësisë, të sovranitetit dhe të integritetit tokësor.

Populli shqiptar ka qenë dhe do të jetë kurdoherë në anën e popujve dhe do t'i përkrahë në mënyrë të patundur të gjitha forcat revolucionare që luftojnë për çlirimin kombëtar e shoqëror, për ndërtimin e një bote të re pa kapitalistë e pa kolonialistë, gjithë ata që luftojnë për çështjen e shenjtë të lirisë, të pavarësisë e të progresit shoqëror.

Kanë kaluar më se 10 vjet që vazhdon agresioni

imperialist amerikan kundër popullit heroik të Vietnamit. Edhe pse praktikisht imperialistët amerikanë e kanë humbur luftën në fushën e betejës dhe janë diskredituar në sytë e gjithë opinionit publik ndërkombëtar, ata nuk kanë hequr dorë nga përpjekjet e tyre për ta gjunjësuar e për ta skllavëruar popullin vietnamez dhe për ta kthyer vendin e tij në një bazë për agresione të reja në Azinë Juglindore e kundër gjithë popujve aziatikë.

Të ndihmuar edhe nga revizionistët sovjetikë, të cilët kanë bërë të gjitha përpjekjet për të shpëtuar aleatët e tyre amerikanë nga disfata e pashmangshme, dhe si kompensim edhe për qëndrimin «korrekt» ndaj pushtimit të Çekoslovakisë, agresorët amerikanë tani po bëjnë çmos që të arrijnë në tryezën e bisedimeve atë që nuk e arritën dot me anën e armëve.

Por populli vietnamez, i cili me guximin, me urtësinë dhe me qartësinë e tij ka kapërcyer situata më të vështira se këto të tanishmet, do të dijë t'u bëjë ballë mashtrimeve të imperialistëve dhe presioneve të atyre që i hiqen si miq, por që i futën thikën prapa krahëve. Ai nuk është përgjunjur kurrë dhe eksperiencia e tij e gjatë e luftës revolucionare e ka mësuar se fitorja e plotë dhe e sigurt mbi agresorët arrihet me luftë të armatosur dhe dhëmb për dhëmb me armiq të.

Populli shqiptar ka qenë e do të jetë kurdoherë solidar me luftën e drejtë revolucionare çlirimtare të popullit vietnamez, ai ka përkrahur e do të përkrahë me vendosmëri aspiratat e tij të ligjshme për lirinë e për pavarësinë kombëtare dhe për bashkimin e atdheut të tij të copëtuar arbitrarisht.

Çekosllovakia po vuan nën pushtimin e rëndë të revizionistëve sovjetikë. Me zjarr e me hekur pushtuesit e rinj po shtypin vullnetin dhe përpjekjet e popullit çekosllovak për të fituar lirinë e pavarësinë kombëtare të marrë nëpër këmbë, për të ruajtur nderin e dinjitetin e tij të shkelur e të përdhunuar. Por Çekosllovakia është bërë gangrenë për pushtuesit revizionistë sovjetikë, ajo është bërë shtylla e turpit ku është lidhur klika renegate e Brezhnjev-Kosiginit, që sundon sot në Kremlin. Qeveritarët tradhtarë çekosllovakë dhe zotimet e tyre prej skllavi që ata marrin ndaj pushtuesve, vizitat e pambarim Pragë-Moskë e anasjelltas të mareshalëve e të kuislingëve nuk mund ta shpëtojnë situatën.

Ashtu siç dënuam pushtimin e 21 gushtit të Çekosllovakisë, po me të njëjtën vendosmëri i shfaqim solidaritetin dhe simpatinë tonë të thellë vëllazërore popullit çekosllovak. Ne kemi qenë dhe do të jemi kurdoherë përkrah tij në luftën e ligjshme çlirimtare që ai bën kundër pushtuesve revizionistë dhe tradhtarëve vendës.

Populli shqiptar ka përkrahur e do të përkrahë luftën e drejtë të popujve vëllezër arabë kundër agresionit izraelito-imperialist. Me gjithë vështirësitë e mëdha që u kanë lindur popujve arabë, jo vetëm si rezultat i pushtimit të tokave të tyre nga ana e Izraelit dhe i vazhdimit të agresionit, por edhe nga përzierja në këtë konflikt e imperialistëve amerikanë dhe e revizionistëve sovjetikë, ne kemi besimin e patundur se fitorja përfundimtare u takon popujve arabë.

Dy fuqitë e mëdha imperialiste, që kërkojnë t'i ja-

pin vetes të drejtën e arbitrit në Lindjen e Mesme, janë armiqtë më të egër të popujve arabë. Ato duan ta futin konfliktin që po zhvillohet në këtë zonë në kuadrin e pazarllëqeve të tyre për ndarjen e sferave të influencës, për të shtënë në duart e tyre pasuritë e mëdha të Lindjes së Mesme dhe pozitat strategjike të kësaj zone. Ato përpiqen t'u imponojnë gjithë arabëve dhe popullit palestinez, lufta e armatosur e të cilit është një faktor i rëndësishëm për rivendosjen e të drejtave të tij dhe për çlirimin e tokave të pushtuara nga Izraeli, zgjidhje që janë në kundërshtim me interesat kombëtarë të popujve arabë dhe që krijojnë kushtet për të humbur lirinë e pavarësinë dhe për t'u vënë nën zgjedhën e neokolonializmit.

Popujt arabë janë vetë në gjendje t'i zgjidhin problemet e tyre dhe t'i tregojnë vendin Izraelit. Dhe këtë ata mund ta arrijnë me siguri duke u mbështetur në radhë të parë në forcat e veta dhe në përkrahjen e miqve të tyre të vërtetë, të popujve revolucionarë, të gjithë forcave antiimperialiste e antirevizioniste.

Kohët e fundit revizionistët sovjetikë dhe disa krerë të vendeve të Evropës Perëndimore, prapa të cilave qëndrojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, bëjnë zhurmë dhe hartojnë plane për njëfarë sigurimi evropian. Që ekziston nevoja për një sigurim të vendeve të kontinentit tonë, kjo është e vërtetë. Por më parë duhet sqaruar kush duhet të sigurohet dhe nga kush. «Sigurimi evropian» që kërkojnë revizionistët sovjetikë dhe që e mbështetin imperialistët amerikanë, do të thotë sigurim i zonave të tyre të influencës në Evropë, sigurim i bazave ushtarake dhe i së drejtës së flotave të

tyre të kontrollojnë brigjet evropiane, do të thotë që popujt e Evropës t'u njohin ligjërisht e zyrtarisht të drejtën Moskës e Uashingtonit të ruajnë privilegjet e veçanta me karakter imperialist e kolonizator që kanë në vende të ndryshme të Evropës. Një sigurim i tillë do të thotë, më në fund, që në Evropë të ruhet e të përjetësohet statukuojat e sundimit sovjeto-amerikan, të sigurohet qetësia në këtë kontinent, me qëllim që revizionistët sovjetikë dhe imperialistët amerikanë t'i kenë duart e zgjidhura e të veprojnë lirisht në Azi, në Afrikë e kudo gjetkë për të nënshtruar e për të skllavëruar popujt, për të forcuar regjimin shfrytëzues kapitalist si brenda, ashtu edhe në perandoritë e tyre.

Një «sigurim» të tillë popujt e Evropës e urrejnë dhe nuk e pranojnë kurrë. Ata nuk mund ta lënë veten të bien në kurthet djallëzore që përgatitin fuqitë e mëdha imperialiste, nuk mund t'i lënë fatet e tyre në mëshirën e krerëve amerikanë e sovjetikë, nuk mund të bëhen mish për top për të zbatuar planet e sundimit botëror sovjeto-amerikan. Ata kërcënohen nga imperializmi amerikan e nga socialimperializmi sovjetik dhe pikërisht kundër këtyre duhet të drejtohet sigurimi i vërtetë evropian.

Populli shqiptar, Partia dhe Qeveria e tij, që u kanë qëndruar me burrëri dhe në mënyrë revolucionare furtunave të sulmeve imperialiste e revizioniste, janë të bindur se as imperializmi amerikan, as revizionizmi sovjetik, as të dy bashkë, me gjithë përpjekjet që bëjnë, nuk janë në gjendje të ndryshojnë kursin e përgjithshëm të historisë botërore, që, në mënyrë të pash-

mangshme, do të çojë në disfatën e plotë të imperia-
lizmit e revizionizmit dhe në triumfin e revolucionit e
të socializmit në të gjitha vendet.

Nën udhëheqjen e Partisë e ardhmja e popullit dhe e atdheut tonë është e ndritur

Shoqe dhe shokë,

Të gjitha fitoret e mëdha historike që ka arritur
populli ynë në këta 25 vjet, ia detyron udhëheqjes së
drejtë, të urtë e të vendosur marksiste-leniniste të
Partisë së tij të lavdishme të Punës.

Ishte Partia ajo që ngriti në këmbë popullin në
Luftën Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve fashistë
e tradhtarëve, që e udhëhoqi atë në fitoren vendimta-
re, që bëri të mundur të përmbyseshin klasat shfrytë-
zuese reaksionare dhe të vendosej në Shqipëri pushteti
popullor. Në sajë të vijës së drejtë e të qëndrimit të
vendosur të Partisë, u ruajt e u forcua liria e fituar, iu
mbyllën portat ndërhyrjes imperialiste, u sigurua zhvi-
llimi i pavarur ekonomik, politik e shoqëror i vendit
në rrugën e socializmit. Partia qëndroi kurdoherë në
krye të përpjekjeve titanike të popullit për kapërcimin
e prapambetjes së tmerrshme që trashëguam nga e ka-
luara, e orientoi dhe e udhëhoqi drejt atë në luftën për
ndërtimin e socializmit. Udhëheqjes së drejtë të Partisë
së Punës, besnikërisë së saj të patundur ndaj doktrinës
revolucionare të proletariatit, marksizëm-leninizmit, i
detyrohet dështimi i orvatjeve të të gjithë armiqve, të

hapët e të fshehtë, veçanërisht të revizionistëve modernë titistë e hrushovianë, për ta larguar popullin tonë nga rruga e ndritur e socializmit.

Bilanci i shkëlqyer i fitoreve, me të cilin populli ynë vjen në këtë jubile të madh, është njëkohësisht bilanci i luftës, i punës dhe i veprimtarisë së Partisë së Punës të Shqipërisë. Ai është dëshmia më e qartë e vijës kurdoherë të drejtë marksiste-leniniste që ajo ka ndjekur në të gjitha etapat.

Prandaj populli ynë është i lidhur me Partinë e tij të Punës si mishi me kockën. Në udhëheqjen e Partisë ai sheh burimin e të gjitha fitoreve të tij, mbrojtjen e interesave jetësorë dhe garancinë më të sigurt të fitoreve të ardhshme, gjer në triumfin e plotë e përfundimtar të socializmit e të komunizmit.

Në unitetin monolit rreth Partisë qëndrojnë forca dhe pathyeshmëria e popullit tonë përballë të gjitha provave të historisë, sado të rënda qofshin ato. Në lidhjet e pandara me popullin, në mbështetjen e pakufishme që ajo ka në popull, qëndrojnë forca dhe pathyeshmëria e Partisë në çdo situatë. Në këtë unitet të çeliktë Parti-popull qëndrojnë forca dhe pathyeshmëria e atdheut tonë socialist përballë çdo rreziku. Ta ruajmë si sytë e ballit dhe ta forcojmë përditë e më shumë këtë unitet luftarak!

Fitoret madhështore të këtyre 25 vjetëve, veçanërisht përfundimet shumë të mira që po arrihen gjatë pesëvjeçarit të katërt, kanë krijuar një bazë të shëndoshë për suksese të reja edhe më të mëdha në rrugën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Një hap të rëndësishëm në këtë rrugë do të shë-

nojë pesëvjeçari i ri 1971-1975, objektivat kryesorë të të cilit në vija të përgjithshme janë kristalizuar tanimë nga Partia dhe Qeveria.

Pesëvjeçari i pestë do të jetë pesëvjeçari i një ngritjeje të re cilësore në zhvillimin e përgjithshëm të forcave prodhuese të vendit. Ai do të jetë pesëvjeçari i zhvillimit në thellësi dhe i intensifikimit të mëtejshëm të industrisë nëpërmjet përpunimit të thellë të mineraleve e të naftës, të zgjerimit dhe të forcimit të të gjitha degëve të saj, veçanërisht të degëve mekanike, kimike, të energjisë elektrike, të materialeve të ndërtimit etj. Do të krijohen degë të reja të industrisë, siç janë industria e metalurgjisë së hekur-nikelit, industria e prodhimit të çeliqueve dhe degë të tjera të industrisë kimike, të cilat kanë një rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e pavarur të ekonomisë, për shfrytëzimin më të mirë e më të plotë të pasurive tona natyrore. Do të rritet kështu më tej roli i industrisë në zhvillimin e të gjitha degëve të tjera të ekonomisë.

Ky pesëvjeçar do të jetë njëkohësisht pesëvjeçari i intensifikimit më të madh të bujqësisë, i rritjes së mëtejshme të prodhimeve bujqësore-blegtorale, ai do të ngrejë në një shkallë më të lartë mekanizimin e bujqësisë, do të rritë shumë rendimentin e punës, do të jetë pesëvjeçari i ndërtimit të veprave të mëdha e të shumta ujitëse, në mënyrë të veçantë në zonat kodrinore-malore, me qëllim që në një të ardhme jo të largët të vihet nën ujë pjesa dërrmuese e sipërfaqes së tokës së punuar.

Mbi bazën e zhvillimit të gjithanshëm e të shpejtë

të ekonomisë socialiste dhe të zgjerimit e të thellimit të revolucionit ideologjik e kulturor, do të sigurohet një rritje e ndjeshme e nivelit të jetesës së masave punonjëse.

Me planin e pestë pesëvjeçar do të hidhet një hap tjetër i rëndësishëm përpara në rrugën e ngushtimit gradual të dallimeve esenciale midis qytetit e fshatit, klasës punëtore e fshatarësisë, industrisë e bujqësisë, punës mendore e fizike, drejt ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste.

Perspektivat janë të qarta, e ardhmja e popullit dhe e atdheut tonë është e ndritur. Ne që sot shohim të pikturohen me ngjyra të gjalla konturet e së ardhmes sonë më të lumtur.

Sukseset madhështore që kemi arritur dhe perspektivat e shkëlqyera që hapen përpara vendit tonë, na mbushin me optimizëm revolucionar dhe dhjetëfishojnë besimin në forcat tona.

Të frymëzuar nga kjo gjendje e mrekullueshme, nën udhëheqjen e sprovuar e të patundur marksiste-leniniste të Partisë së lavdishme të Punës, le të mbajmë kurdoherë lart krenar flamurin e kuq të revolucionit e të socializmit në atdheun tonë të dashur dhe ta çojmë atë përpara, kurdoherë përpara, drejt majave të reja të socializmit e të komunizmit!

Rroftë 25-vjetori i lavdishëm i Çlirimit të Atdheut dhe i triumfit të revolucionit popullor!

Të rrojë në shekuj populli ynë i mrekullueshëm, që marshon sypatrembur në rrugën e socializmit!

Lavdi Partisë së Punës të Shqipërisë, udhëheqëses së dashur dhe organizatores të të gjitha fitoreve të popullit tonë!

Lavdi marksizëm-leninizmit ngadhënjimtar!

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 285 (6637), 29 Nëntor 1969

Botohet me ndonjë shkurtim sipas librit: Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1969-1970», f. 179. Tiranë, 1970

TË JEMI KURDOHERË VIGJILENTË NDAJ REVIZIONISTËVE SOVJETIKË

*Nga biseda me një delegacion të Frontit
të Çlirimit Kombëtar dhe të Qeverisë së Përkohshme
Revolucionare të Republikës së Vietnamit të Jugut*

30 nëntor 1969

*Shoku Enver Hoxha, pasi u takua me miqtë dhe u
uroi mirëseardhjen, tha:*

Në emër të popullit shqiptar, të Frontit Demokra-
tik të Shqipërisë, të Qeverisë së Republikës Popullore
të Shqipërisë dhe të Komitetit Qendror të Partisë sonë
dëshiroj t'u shpreh falënderimet më të nxehta popu-
llit tuaj heroik, Frontit të Çlirimit Kombëtar dhe Qe-
verisë së Përkohshme Revolucionare të Republikës së
Vietnamit të Jugut që ju kanë dërguar për të marrë
pjesë bashkë me ne në festat tona.

Ne kemi një simpati të veçantë për popullin tuaj
dhe për luftën heroike e të pashembullt që bën ai kun-
dër armikut më të egër të popullit tuaj dhe të mbarë
njerëzimit, imperializmit amerikan, i cili, i armatosur
deri në dhëmbë, përpiqet të shuajë rezistencën që bëj-

në popujt e botës për lirinë dhe për pavarësinë e tyre, me qëllim që t'i kthejë në skllëvër.

Sukseset tuaja të mëdha ne i konsiderojmë si fitoret tona, prandaj bëjmë gjithçka kemi mundësi për t'ju ndihmuar. Ne e dimë që ndihma jonë materiale, në krahasim me sa kemi dëshirë, është e vogël. Të jeni të sigurt se, edhe në të ardhmen, me aq sa do të na lejojnë mundësitë, luftën e popullit tuaj do të vazhdojmë ta ndihmojmë hap pas hapi. Ne jemi kurdoherë me ju. Me ato mjete që kemi në dispozicion, edhe ne në Shqipëri luftojmë për çështjen e çlirimit të popullit të Vietnamit të Jugut nga imperialistët amerikanë. Këtë luftë e zhvillojmë me propagandë, në radhë të parë përbrenda vendit, për të rrënjosur në zemrën e popullit shqiptar urrejtjen e pakufishme ndaj përbindshave imperialistë amerikanë dhe shërbëtorëve të tyre, që përgjakin popujt për t'i vënë nën zgjedhën e tyre të rëndë; atë ne e zhvillojmë edhe në planin ndërkombëtar.

Megjithëse populli juaj është i vogël, konstatojmë se lufta dhe fitoret tuaja janë të shkëlqyera. Edhe Shqipëria është, gjithashtu, një vend i vogël, që armiqtë vazhdimisht janë përpjekur ta zhdukën nga harta e botës, po këtë nuk kanë mundur ta bëjnë dot as përpara, as në kohën e Luftës së Dytë Botërore, as tani dhe s'do të arrijnë ta bëjnë as në të ardhmen. Armiqtë janë përpjekur të na bëjnë keq edhe pas Çlirimit, për të përmbysur pushtetin tonë popullor, por më kot. Guximi dhe vendosmëria e popullit shqiptar, të udhëhequr nga Partia e tij e Punës, kanë bërë që komplotet e gjithë armiqve të Shqipërisë të dështojnë vazhdimisht.

Populli shqiptar e ka fituar lirinë dhe është bërë zot i fateve të tij. Megjithatë armiqtë e Shqipërisë s'lënë gur pa luajtur për të na skllavëruar. Prandaj ne dhe popujt e mbarë botës e kemi për detyrë të jemi vigjilentë, se liria aq e shtrenjtë për të gjithë jo vetëm nuk dhurohet e nuk fitohet pa luftë, pa gjak e pa sakrifica, por edhe kur e ke fituar, ajo duhet të mbrohet me çdo kusht. Për këtë nuk duhet humbur asnjë çast vigjilenca, ndryshe do të duhet të derdhen përsëri rrëke të mëdha gjaku.

Ne jemi preokupuar dhe mendojmë si internacionalistë për motrat dhe për vëllezërit luftëtarë vietnamezë, që nuk po e kursejnë jetën për t'i sjellë ditën e çlirimit atdheut të vet. Ne e vlerësojmë lart se lufta juaj nuk bëhet vetëm për çlirimin kombëtar, për të mbrojtur nderin, dinjitetin dhe të ardhmen e popullit tuaj; ajo është, njëkohësisht, një kontribut edhe në luftën që bëjnë popujt për dobësimin dhe për shkatërrimin e imperializmit, për fitoren e çështjes së madhe të popujve, për lirinë e pavarësinë e tyre kombëtare, për revolucionin proletar dhe socializmin. Sot popujt e shtypur po e kuptojnë se si duhet luftuar dhe fituar liria, e cila nuk fitohet me fjalë, me parulla; ata po e kuptojnë se imperializmi askujt nuk ia dhuron atë, prandaj është domosdoshmëri historike që populli i çdo vendi të luftojë vetë me armë në dorë. Pa luftë nuk fitohet liria, nuk i merret pushteti borgjezisë.

Lufta juaj çlirimtare nuk ka marrë fund akoma, kjo do të thotë se, për të arritur lirinë e dëshiruar, kërkohen sakrifica të tjera të mëdha. Edhe ne që kemi pushtetin në dorë, e kemi të qartë se as lufta jonë nuk

ka mbaruar, mbasi armiqtë tanë nuk kanë hequr dorë nga synimet e tyre; ata na luftojnë me të gjitha mjetet për të na i rrëmbyer fitoret. Për këtë arsye ne qëndrojmë kurdoherë vigjilentë dhe luftojmë të dështojnë të gjitha orvatjet e manovrat e armiqve, qoftë edhe kur janë shumë të stërholluara, pse ka edhe nga ata që e mbulojnë veprimtarinë e tyre kundër nesh me sheqer. Armiqtë janë kurdoherë dinakë dhe ne duhet t'i demaskojmë vazhdimisht. Gjatë luftës që bëjmë ne dallojmë ata që nuk na duan, që na këshillojnë të veprojmë kundër vullnetit, dëshirës dhe interesave tanë.

Ne jemi me ju deri në fund për fitoren, jemi me luftën që bëni kundër imperializmit dhe shërbëtorëve të tij. Për këtë ju admirojmë dhe jemi krenarë e gjithmonë pranë jush, pse kemi besim të plotë që populli i Vietnamit nuk do t'i lëshojë armët.

Eksperiencia na mësoi ne shqiptarët të ndiqnim me vigjilencë e me gjakftohtësi prej komunisti veprimtarinë minuese, punën armiqësore të revizionistëve hrushovianë në drejtim të Shqipërisë, dhe jo vetëm kundër nesh. Ju lutem, këto që do të them, mos na i merrni si ofendim. Edhe ne e kemi dashur shumë Partinë Bolshevike dhe vazhdojmë ta duam akoma popullin sovjetik, ndërsa tradhtarët revizionistë që kanë ardhur në fuqi në Kremlin i urrejmë me gjithë zemër. Kur nuk i njihnim, i kemi respektuar, po kur na u bënë të qarta poshtërsitë e tyre të panumërta kundër marksizëm-leninizmit, kur vumë re tradhtitë e tyre të njëpasnjëshme kundër vetë Bashkimit Sovjetik, Leninit dhe Stalinit, filluam të dyshojmë dhe të mendojmë: Gjersa ata bëjnë poshtërsi kundër atdheut e po-

pullit të tyre, si të mos bëjnë pastaj kundër nesh e popujve të tjerë? Dhe atëherë filluam t'i demaskojmë pa mëshirë. Revizionistët sovjetikë e shikojnë gabimin që kanë bërë ndaj Shqipërisë, prandaj tani vijnë rrotull të na gënjejnë, orvaten të lidhin marrëdhënie diplomatike me ne, por ne nuk gënjehemi, nuk duam të kemi të bëjmë me tradhtarë kaq të poshtër dhe themi se s'na prish ndonjë punë po të mos kemi lidhje me ta. Ka rreth 25 vjet që as imperializmi amerikan dhe as ai anglez nuk mbajnë lidhje me Shqipërinë, megjithatë atdheu ynë ecën e do të ecë përpara edhe pa këto lidhje.

Ne jemi thellësisht të bindur që në Kremlin ka armiq që nuk e duan lumturinë e popujve e të komunistëve të vetë Bashkimit Sovjetik, pa lëre pastaj të mbarë botës. Për këtë arsye i luftojmë e do t'i luftojmë ata gjer në fund. Ju jeni në rrethana lufte dhe për qëndrimet që mbani ndaj tyre, këtë e dini vetë ju, unë ju thashë që në fillim se Partia e Punës e Shqipërisë është e do të jetë me ju, me luftën tuaj heroike, por ju themi si shokë: Jini vigjilentë ndaj revizionistëve sovjetikë!

Pikëpamja jonë është se bisedimet e Parisit nuk do të sjellin asgjë të mirë për popullin vietnamez. Çdo gjë e mirë, liria dhe pavarësia e atdheut tuaj do të zgjidhet vetëm në fushën e luftës. Vetëm kur imperialistët janki dhe shërbëtorët e tyre në Sajgon do të përgjunjen, atëherë do të mblidhet me siguri një konferencë, në të cilën ju do të jeni fitimtarë. Edhe tani fitimtarët jeni ju në Paris, por lufta s'ka përfunduar akoma, armiqtë përpiqen të përfitojnë nga situata, të

lehtësohen ca, se janë në gjendje të keqe, prandaj revizionistët sovjetikë përpiqen t'i ndihmojnë për të dalë nga kjo gjendje dhe për këtë që themi jemi të sigurt. Imperialistët amerikanë dhe revizionistët e Moskës kanë mundësi tani të organizojnë së bashku shumë manovra kundër luftës heroike të popullit tuaj, të cilat e dimë ku synojnë. Vetëm lufta e popullit tuaj, e popullit tonë dhe e gjithë të tjerëve, duke përfshirë edhe popullin amerikan, do të bëjë që të dështojnë manovrat e tyre.

Nuk mund të thuash se populli amerikan është i keq, por ai është përpunuar shumë nga propaganda shfrenuese e imperializmit janki, prandaj është i çoroditur. Megjithatë jo vetëm familjet amerikane të cilat kanë bijtë e tyre në Vietnam, që u vuajnë e po u vriten dita-ditës, por edhe shumë të tjera si ato nuk e duan luftën në Vietnam, pse nuk dëshirojnë të dërgojnë në të ardhmen djemtë t'u vriten atje. Prandaj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës shohim të rritet një lëvizje kundër ndërhyrjes në Vietnam dhe faktor me rëndësi nxitës është lufta e vendosur që bëni ju. Kjo do të thotë se nuk duhet t'i lësh pushim armikut, nuk duhet t'i japësh kohë ta marrë veten, po të goditet vazhdimisht, pa mëshirë, që t'i bëhet e vështirë situata, t'i bëhet i padurueshëm qëndrimi në Vietnam; ndërsa revizionistët sovjetikë bëjnë të kundërtën, ata përpiqen t'ua lehtësojnë gjendjen këtyre armiqve të egër të popujve, lidhin gjithfarë marrëveshjesh të paturpshme me ta, luftojnë që ju ta zbutni luftën kundër tyre.

Te ne të keni besim, shokë, ju do të na keni kurdoherë shokë marksistë-leninistë besnikë deri në fund.

Ne jemi nga ata që nuk e hamë fjalën. Gjithashtu jua themi hapur atë që mendojmë. Në ndonjë çështje mund edhe të gabojmë, koha do t'ua bëjë të qarta të gjithëve pikëpamjet tona, por për revizionistët sovjetikë jemi të bindur se nuk kemi bërë gabim, përkundrazi, çdo gjë që kemi thënë kundër tyre, e ka vërtetuar koha.

Ne dëshirojmë me gjithë zemër që ju të fitoni dhe realiteti tregon se ju e cni vazhdimisht përpara nga fitorja në fitore, pavarësisht se armiku ka shumë epërsi në numër dhe në armatime. Kjo nuk është vetëm një dëshirë e thjeshtë. Lufta juaj frenon agresorët, nuk i lë ata të hapin vatra të reja zjarri e të përgjakin popuj të tjerë. Edhe ne kemi luftuar dhe, megjithëse kemi qenë më të vegjël se ju, fituam mbi armiqtë.

Armiqtë janë gjithnjë të pabesë. Ne kurrë s'kemi ushqyer iluzione për ta. Fitorja mbi armiqtë arrihet duke i mposhtur në fushën e luftës, duke i goditur pa pushim, duke mos u lënë kohë të marrin frymë.

Në kohën që populli amerikan bën demonstrata kundër krimeve monstruoze të ushtrisë imperialiste amerikane në Vietnam, Niksoni po përdor një demagogji tjetër. Ai deklaroi sikur në Vietnam gjoja nuk po përdoren më lëndë helmuese dhe bomba të llojeve të ndryshme që i dënon opinionin publik botëror. Ky është një bluf, pse në fakt ai po i përdor ato në vendin tuaj dhe këtë e bën se ushtria e imperializmit amerikan në Vietnam është vënë në kushte shumë të vështira. Niksoni hiqet sikur e do popullin vietnamez. Ç'hipokrizi! Ai po përpiqet të peshkojë në ujëra të turbullta, por ju në asnjë mënyrë nuk do ta ndërpritni luftën, qoftë edhe për pak. Taktika juaj kërkon që ta

goditni atë sa më fort që të jetë e mundur, pse sa më fort ta goditni, aq më shumë në vështirësi e vini administratën amerikane dhe atë të Sajgonit në Vietnam. Ata kanë bërë kudo krime të mëdha, prandaj nuk është fjala për ta goditur vetëm në një rajon, po kudo.

Iluzione ne nuk kemi ushqyer as për armiqtë e brendshëm, veçanërisht për ata që vënë maska e hiqen si patriotë. Në gjirin e Qeverisë Provizore që ne krijuam në fillim, hynë edhe elementë patriotë që nuk ishin komunistë: patëm bile edhe disa ministra nacionalistë nga ata elementë që nuk kishin luftuar, por që kishin njëfarë influence në disa rrethe. Por kurrë nuk pranuan ndarjen e pushtetit me klasat e pasura, me reaksionarët, me gjithë synimet, presionet dhe përpjekjet e këtyre në këtë drejtim. Çështja është, dhe këtë ju e dini mirë, që pushteti të mos u dorëzohet e të mos ndahet kurrë me kuislingët. Në asnjë mënyrë s'udhet lënë klikave të mbajnë qoftë edhe një pozitë sado të vogël në pushtetin e ri popullor.

Në qoftë se nuk gaboj, çështjen e «vietnamizimit të luftës» në Vietnam ne e kuptojmë njëlloj si ju. Amerikanët kanë për qëllim që luftën ta vazhdojnë kukuullat e Sajgonit, megjithatë të gjithë e kemi të qartë që ato vetëm nuk e mbajnë dot situatën pa ndihmën direkte të imperialistëve. Ne në vendin tonë i likuiduam tradhtarët, krerët e «Ballit», i bindëm ato masa të thjeshta që ishin mashtruar dhe i hoqëm kështu reaksionit të jashtëm mundësinë për të pasur mbështetje brenda vendit. Amerikanët dhe reaksionarët e Sajgonit e shohin gjendjen e tyre të vështirë, prandaj këshillojnë që një pjesë të forcave të tyre reaksionare vendëse

ta fshehin në organizatat politike dhe në forcat e armatosura të Frontit të Çlirimit Kombëtar. Kështu që, po të pësojnë disfatë, kur të bëhen zgjedhjet për ngritjen e qeverisë provizore, fajtorët kryesorë vërtet do të arratisen në Zvicër apo në vende të tjera, po një pjesë të njerëzve të tyre ata do të përpiqen ta lënë në Vietnam për ta pasur mbështetje për qëllimet e tyre të mëvonshme. Lufta më e fortë këtyre synimeve u bëhet kur sigurohet një unitet i çeliktë i popullit.

Uniteti politik i popullit rreth Frontit dhe lufta e përditshme e pandërprerë janë faktorët vendimtarë për arritjen e fitores. Por ky unitet qëndron i pathyeshëm po të jemi në çdo moment konsekuentë e vigjilentë.

Nuk dua të bëj krahasime, të më kuptoni drejt, po dihet nga historia se komunistët grekë gjatë Luftës së Dytë Botërore organizuan Frontin Nacionalçlirimtar dhe luftuan kundër pushtuesve italianë e gjermanë. Ne kemi pasur herë pas here kontakte me udhëheqësit e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Greke që nga fillimi e deri në fund të luftës. Në parim, udhëheqësit e komunistëve grekë ishin për luftën, por kur takoheshin me ne, atë që na thoshte Zahariadhisi, nuk na e thoshte Markosi, atë që na thoshte ky, nuk na e thoshte Barxotasi e kështu me radhë. Ata na thoshin se e kishin organizuar shumë mirë luftën, se në malin e Vicit nuk ndienin asnjë rrezik, se vendet ku kishin zënë pozicione ishin të papushtueshme nga armiku, se ushtrinë e gjeneralit anglez do ta bënë copë e thërrime etj., po në fakt, me një sulm të ushtrisë armike e reaksionare, u likuiduan brenda një kohe çuditërisht të shkurtër.

Pas disfatës, midis këtyre udhëheqësve pati grindje dhe pikërisht për shkak të mungesës së unitetit janë katandisur tani në gjendje të vajtueshme, janë shkoqur në 5-6 grupe dhe secili e heq veten si «Partia Komuniste e Greqisë». Kjo është një histori e trishtuar. Po te ju ndryshon puna. Sidoqoftë, duhen pasur parasysh manovrat e imperializmit amerikan se është dinak. Ju keni besim në forcat tuaja, të popullit dhe në forcat e tij të armatosura. Ne e kemi për detyrë t'ju ndihmojmë me çdo mundësi dhe singërisht. Armët, ndihmat e tjera në barna e ushqime etj., që ju vijnë nga jashtë, janë për ju, por ju keni të drejtë të ruani mendimin tuaj dhe të vendosni vetë në çdo gjë në interes të popullit tuaj.

Keni pasur një humbje të madhe me vdekjen e shokut Ho Shi Min. Ai ishte një shok i mirë, i zoti dhe i singërtë, ishte nga ata që e thoshte hapur atë që mendonte. Duhej të jetonte ai deri në fitore, sepse kishte ëndërruar dhe kishte luftuar shumë vjet për këtë. E gjithë jeta e tij ishte një jetë luftarake, por nuk arriti, ai mbylli sytë para kohe, megjithatë ju la pas porositë e veta.

Është e domosdoshme, pra, të ecim përpara në bazë të mësimëve të marksizëm-leninizmit, edhe kur rrethanat mund të jenë shumë të disfavorshme për ne. Mund të ndodhë, e ndodh shpesh, që gjatë luftës sonë të kemi momente të vështira, por marksizëm-leninizmi na jep forcë, idetë e tij na ndihmojnë të kemi pikëpamje të qarta për ta parë situatën drejt, për të menduar dhe për të vepruar si duhet. Për këto arsye Partia jonë organizon vazhdimisht një punë të madhe

politike dhe një veprimtari të gjerë teorike e praktike me komunistët dhe me masat, sepse të mësosh thjesht marksizëm-leninizmin nga librat, nuk të mbeten shumë gjëra në kokë, po të mos i lidhësh parimet me jetën, me luftën; t'i mësosh, pra, e njëkohësisht t'i zbatosh në jetën e gjallë, t'i bësh të kuptueshme parimet për të gjithë dhe jo të rënda. Ne mendojmë se duke vepruar në këtë mënyrë do të mundim të ngremë një brez që të kuptojë më mirë nga ne ç'është marksizëm-leninizmi, çfarë duhet të bëjë revolucionari dhe çfarë nuk duhet të bëjë, çfarë duhet luftuar e hedhur poshtë dhe çfarë duhet ruajtur. Te njerëzit e brezit të vjetër ka mbeturina, kundër të cilave bëhet gjithmonë luftë, kurse rinia, na mëson marksizëm-leninizmi, është si një letër e bardhë mbi të cilën mund të shkruash mendime të pastra, heroike. Është detyra jonë të punojmë që rinia në vendet tona të dojë partinë, punën, popullin, të punojë tërë jetën për lumturinë e këtij. Misioni ynë është të punojmë edhe për kalitjen e njeriut të ri, gjë që nuk mund të arrihet aq shpejt, vetëm duhet filluar dhe duhet ecur me këmbëngulje për qëllimin e caktuar, duhet, pra, të bëjmë shumë punë dhe luftë në këtë drejtim.

Ju uroj gjithë luftëtarëve dhe mbarë popullit tuaj heroik shëndet, suksese në luftë e në punë dhe kurajë në luftën kundër imperializmit amerikan, kundër shërbëtorëve të tij dhe kundër gjithë armiqtë të tjerë, qofshin ata të hapët apo të maskuar. U thoni shokëve vietnamezë dhe gjithë popullit vietnamez që te shqiptarët ata kanë miq nga më besnikët. Shqipëria me të gjitha forcat e saj, materiale dhe morale, do t'i ndih-

mojë; ajo do të jetë me ata deri në fitore në të gjitha rastet, sido që të jetë koha, e mirë apo e keqe.

Ne shqiptarët ju jemi mirënjohës për luftën që bëni dhe kjo nuk është thjesht një shprehje dashurie apo simpatie sentimentale. Ju luftoni për një çështje të madhe. Lufta juaj na jep forca në luftën tonë kundër armiqve të përbashkët.

Ju do shkoni; ne do të dëshironim të qëndronit diçka më gjatë në Shqipëri, megjithatë, kur t'ju bjerë rasti të vini përsëri në Evropë, do të gëzoheshim po të vizitonit edhe vendin tonë.

Le ta pimë këtë gotë për fitoren dhe për sukseset e popullit tuaj!

Të gjithë shokëve u çoni të fala nga ne. Ju falënderoj për bisedën.

*Botuar për herë të parë
në librin: Enver Hoxha.
«Kundër revizionizmit modern
(Përmbledhje veprash)
1968-1970», f. 523*

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Kundër revizio-
nizmit modern (Përmbledhje
veprash) 1968-1970», f. 523*

NJOHJA E KONTRADIKTAVE NË BOTËN KAPITALISTO-REVIZIONISTE U SHËRBEN MARKSISTË-LENINISTËVE PËR LUFTËN E TYRE

*Nga biseda me një delegacion të Partisë Komuniste
të Australisë (marksiste-leniniste)*

8 dhjetor 1969

*Pas shkëmbimit të përshëndetjeve e mori fjalën
shoku Enver Hoxha:*

Ju keni folur shumë për dashurinë që ushqeni për Partinë dhe për popullin tonë, prandaj ju falënderojmë me gjithë zemër, sepse te dashuria dhe te besnikëria e shokëve tanë e te partitë marksiste-leniniste ne gjejmë një pjesë të madhe të forcës së Partisë dhe të shtetit tonë socialist. Midis marksistëve nuk ka komplimente, prandaj ju themi sinqerisht se të njëjtat ndjenja të pastra ushqejmë edhe ne për ju.

Ju thatë se, duke ardhur këtu, dëshironi të përfitoni nga eksperiencia e Partisë sonë, por edhe ne, gjithashtu, dëshirojmë të përfitojmë shumë nga eksperiencia e partive të tjera. Këtë përfitim e sigurojmë vazhdimisht edhe nëpërmjet leximit e studimit me kujdes të shtypit të partive marksiste-leniniste.

Por për të shkëmbyer mendimet dhe eksperiencën, për të përcaktuar bashkërisht disa pika të përgjithshme orientimi, për të korigjuar disa pikëpamje jo të drejta që mund të duken për një çështje ose për një tjetër, ne mendojmë se kanë rëndësi të madhe pikërisht takimet që bëjmë me njëri-tjetrin. Si marksistë që jemi, duke u takuar, bëjmë debate për t'i gjykuar bashkërisht e në mënyrë dialektike problemet që na interesojnë, pse situatat nuk zhvillohen kudo njësoj.

Do të ishte absurde t'u thoshim të tjerëve që të veprojnë siç bëjmë ne për një problem. Secila parti e njeh më mirë se kushdo tjetër situatën në vendin e vet. Ju, për shembull, i njihni më mirë situatën e vendit tuaj, gjendjen shpirtërore të popullit, mundësitë tuaja, format, metodat dhe kohën kur duhet të vepron për këtë ose për atë problem. Në qoftë se një parti mund ta kryejë një detyrë në pesë vjet në vendin e vet, një partie tjetër mund t'i duhen shtatë, por nga kjo askujt nuk i lejohet të nxjerrë konkluzionin se ky apo ai nuk punon, nuk lufton, se po gabon, apo nuk ecën drejt. Si shokë që jemi ne duhet t'ia themi hapur mendimet tona njëri-tjetrit, të mblidhemi e të diskutojmë për këtë ose për atë problem që ka lindur.

Duke luftuar për zbatimin e vijës marksiste-leniniste të Partisë sonë, edhe në nxjerrim përfitime nga eksperiencia e partive të tjera. Për shembull, për disa çështje që mendojmë se janë bazë themelore dhe koincidojnë me pikëpamjet e Partisë sonë, kur na kërkohet mendim nga shokët e partive e të grupeve marksiste-leniniste, për të argumentuar pikëpamjen tonë, sjellim

si shembull veprimtarinë e partive të tjera marksiste-leniniste.

Le të marrim çështjen se si duhet të ndërtohet partia në kushtet kur borgjezia kapitaliste është në fuqi. Ka parti të reja marksiste-leniniste në kontinentin tonë, këtu në Evropë, që nuk e kuptojnë si duhet rëndësinë e kësaj çështjeje, kurse parti të tjera japin një shembull me të vërtetë marksist-leninist në kupimin e drejtë të luftës revolucionare që duhet bërë kundër armikut kryesor, borgjezisë kapitaliste. Kjo e fundit, edhe në rast se për një kohë të lejon të zhvillosh një veprimtari legale, këtë lëshim e bën përkohësisht për interesat e saj momentale, për të njohur bazat dhe kuadrot e partisë, me qëllim që, më vonë, kur dëshiron dhe gjen kohën e përshtatshme, ta godasë dhe ta likujdijë partinë marksiste-leniniste. Prandaj eksperiencia e disa partive në ndërtimin e partisë për të punuar me sukses në kushtet e ilegalitetit, është shumë e domosdoshme dhe ka rëndësi të madhe edhe për partitë e reja, si kudo, edhe këtu në Evropë.

Një çështje tjetër parimore është që qëndrimi i partisë ndaj parlamentarizmit të bazohet në mësimet leniniste. Eksperiencia dhe pikëpamjet e drejta të disa partive për këtë çështje shërbejnë si shembull për partitë dhe për grupet e reja marksiste-leniniste, prandaj kjo eksperiencë ndihmon për të qartësuar qëndrimet që duhen mbajtur sipas kushteve e situatave konkrete.

Një diçka tjetër pozitive që kemi konstatuar te disa parti është veprimtaria që zhvillojnë ato nëpërmjet shtypit të tyre në lidhje me nevojën e ndarjes

me revizionistët. Çështja nuk është të shkëputesh vetëm organizativisht nga këta armiq, por, në radhë të parë, nga pikëpamja ideologjike, pse ndarja organizative vjen pastaj vetvetiu. Pra, ndarja ideologjike me ta është kryesore dhe në këtë drejtim, mendojmë ne, duhen vënë mirë pikat mbi i. Shkëputja nga revizionistët ndihmon për konsolidimin e radhëve të partisë, për spastrimin e pikëpamjeve jo të drejta tek anëtarët e saj.

Po me shkëputjen nga revizionistët janë spastruar vallë të gjitha pikëpamjet e tyre? Jo, në asnjë mënyrë. Edhe ne zhvillojmë një luftë të vendosur parimore kundër pikëpamjeve revizioniste, pse akoma kemi për të spastruar, prandaj vazhdon revolucionarizimi i Partisë sonë në fushën ideologjike. Pikërisht në këtë drejtim e kemi përqendruar luftën tani. Pikëpamjet borgjezo-revizioniste spastrohen, në radhë të parë, duke spastruar ndërgjegjen dhe kjo është një çështje shumë e rëndësishme.

Duke shprehur e duke mbrojtur interesat e klasës punëtore, partia marksiste-leniniste, me vijën e me luftën e saj të drejtë, përpiqet që ta bëjë atë për vete. Për këtë qëllim ajo kërkon të gjejë rrugët më të mira, format dhe vijën më të mirë sipas situatave e kushteve konkrete të vendit. Në këtë drejtim ka rëndësi qëndrimi ndaj sindikatave reformiste, socialdemokrate apo revizioniste dhe ndaj udhëheqësve të tyre sindikalistë, domethënë ndaj bosëve. Qartësia në këto çështje tregon seriozitetin e partisë marksiste-leniniste, forcën e luftës së saj, e cila nesër me siguri do të rritet edhe më shumë.

Përveç këtyre që përmenda, ka edhe shumë probleme të tjera, si problemet e gruas, të rinisë, të fshatarësisë, që janë shumë të gjera. Sikurse e patë vetë, edhe në këto drejtime ne kemi arritur rezultate, si në të gjitha fushat. Sipas eksperiencës sonë, çdo gjë varet, në radhë të parë, nga konsolidimi i partisë, domethënë nga rrënjosja tek ajo e ideologjisë marksiste-leniniste dhe nga brumosja e të gjithë anëtarëve të saj me këtë ideologji. Partia jonë bën një punë të madhe që marksizëm-leninizmin ta përvetësojnë të gjithë komunistët dhe të jenë në gjendje ta aplikojnë konkretisht në jetë për të gjitha problemet. Ne përpigemi që parimet e marksizëm-leninizmit t'i zbërthejmë, t'ua paraqitim sa më qartë shokëve komunistë, që t'i kuptojnë sa më thellë.

Por mendojmë se as kjo nuk është e mjaftueshme. Ne përpigemi që këto parime t'i kuptojnë edhe masat, pse vija e Partisë sonë është vija e masave. Në goftë se Partia nuk i udhëheq masat si duhet, këto nuk do ta kuptojnë vijën e saj në nivelin që kërkohet dhe ne nuk do t'i arrijmë dot objektivat e caktuar. Prandaj, në kuadrin e revolucionarizimit të madh që ka përfshirë tërë jetën e vendit, ne i vëmë rëndësi punës jo vetëm në radhët e Partisë së klasës punëtore, por edhe në gjirin e fshatarësisë dhe të të gjithë punonjësve të tjerë, për të shkruar të tërë përpara, frontalisht.

Në këtë drejtim kemi marrë masa të shumanshme, duke filluar që nga shkollat, në programet dhe në tekstet e të cilave është futur teoria marksiste-leniniste e lidhur ngushtë me punën prodhuese. Teoria dhe puna prodhuese janë të lidhura, gjithashtu, edhe me edu-

kimin fizik e atë ushtarak, si edhe me kulturën e përgjithshme. Në shkollat tona, që janë ngritur në të katër anët e vendit, marksizëm-leninizmi mësohet veçanërisht si teori, por lidhet edhe me kulturën e përgjithshme. Për këtë qëllim tani po bëhet një përpunim i thellë i të gjitha teksteve, në mënyrë që në fizikë, në kimi, në biologji, në histori, në gjeografi etj., nxënësit të shikojnë doktrinën tonë në zhvillim, pastaj të ndjekin zbatimin e saj edhe në punën praktike e prodhuese, qoftë në industri, në bujqësi, në ndërtim e kudo. Të gjitha këto bëhen të koordinuara. Sistemi ynë i ri shkollor, natyrisht, ka nevojë të perfeksionohet vazhdimisht dhe të gjitha përpjekjet tona janë përqendruar në këtë drejtim.

Lidhur me këto i kushtojmë rëndësi edhe përgatitjes fizike e ushtarake të rinisë shkollore dhe të mbarë popullit. Çdo qytetar te ne përgatitet ushtarakisht dhe politikisht. Kjo nuk pengon njeri në punë, përkundrazi, ndihmon më mirë për realizimin dhe për tejkalimin e planit. Ata që nuk janë marksistë, thonë: «Ku e gjejnë kohën njerëzit, si është e mundur të bëhen gjithë këto gjëra te ju?». Por për ne marksistët është e qartë se të gjitha këto bëhen dhe bile bëhen mirë.

Natyrisht, ne hasim edhe vështirësi, sidomos në luftën kundër mbeturinave të së kaluarës në ndërgjegjen e njerëzve. Rininë e kemi të mirë dhe, me gjithë sukseset që kemi arritur në edukimin e në kalitjen e saj revolucionare, po vazhdojmë të ngulim këmbë në këtë drejtim, se ajo është si letra e bardhë. Varet kush shkruan mbi këtë letër.

Prandaj rininë ta shohim ashtu siç është dhe ta përgatitim për të marrë në duart e saj stafetën e revolucionit. Ka edhe mbeturina e koncepte të huaja në radhët e saj, por në fillim duhet të spastrojmë nga mendja e saj ato më të këqijat. Brezi tjetër që vjen do të duhet të spastrojë mbeturinat e tjera, që, natyrisht, do t'i ketë më të pakta se ne, e kështu me radhë, gjersa të bëhet spastrimi i plotë. Çdo marksist e ka të qartë se për t'i spastruar mbeturinat e ideologjisë së huaj duhet kohë dhe luftë e gjatë dhe e vazhdueshme.

Një ndryshim i madh revolucionar ka ndodhur në vendin tonë sidomos në çështjen e emancipimit të gruas. Për ne kjo gjë ka rëndësi të madhe, se më parë gruaja shqiptare ka qenë e shtypur, ndërsa tani ajo është ngritur, po edukohet dhe kryesorja është se merr pjesë në punë, në shkollë, në veprimtarinë politike e kulturore. Gruaja po bën revolucion edhe në familje, ku më parë e kishte pushtetin burri, pse ai mbante edhe paratë. Por pas Çlirimit, kur gratë filluan të futen në punë, ndryshoi shumë edhe roli i tyre. Me punën e vazhdueshme edukuese të Partisë u arrit që të ardhurat nga puna t'i administronin së bashku gruaja dhe burri, buxhetin familjar ta hartonin së bashku. Kjo duket si një gjë e thjeshtë, por ka rëndësi të madhe për emancipimin e gruas. Sot në mjaft raste gratë marrin edhe rrogat e burrave dhe administrojnë mirë të gjitha të ardhurat nga puna e përbashkët, se e vërteta është që janë më ekonomet. Duke ia marrë paratë burrit, gruaja i mori atij edhe pushtetin në familje. Kështu burri u lidh më shumë me familjen.

Përse e bëri Partia jonë këtë? Për të luftuar pikë-

pamjet e epërsisë së burrit mbi gruan, e cila në të kaluarën blihej dhe shitej, kur ishte çështja për ta fejuar ose për ta martuar. Bile kishte edhe raste që vajzat i fejonin që në vogëli. Këto fenomene janë likuiduar tani te ne, jo me dekrete, por me punë bindëse politike. Kështu kemi arritur të shkatërrojmë shumicën e mbeturinave, në shumë raste deri edhe te pleqtë. Bëhen vallë akoma gjëra të tilla? Natyrisht edhe bëhen, por fshehurazi dhe me frikë të madhe, jo se ne i dënojmë njerëzit, por se i tremben opinionit, masës së lagjes apo të fshatit, që i thërret të tillë njerëz me mbeturina dhe i kritikon kur veprojnë kështu dhe shkulin vijën e Partisë. Te ne ka probleme shoqërore të tilla. Kjo është një luftë e ndërlikuar, por aq madhështore, sa edhe pleqtë i bën të rinj. Këtë e them se shumë pleq e plaka janë përfshirë tani në luftë për këto çështje, bile ka nga ata që edhe pse gjer dje kanë qenë shumë fanatikë dhe besonin te feja, sot dalin dhe flasin në popull se si mendonin gabim më parë. Kjo është një fitore për Partinë tonë, megjithatë kemi akoma shumë për të bërë.

Të gjitha këto zhvillohen te ne në situata të vështira të rrethimit të gjithanshëm nga armiq të shumtë. Armiqtë tanë në Evropë dhe në kontinentet e tjera na luftojnë, po ne dëshirojmë t'u themi miqve dhe shokëve tanë të dashur, kudo që janë, se pozitat e Republikës Popullore të Shqipërisë janë të forta ideologjiksht, politikisht dhe ushtarakisht. Ushtrinë e kemi të fortë, të organizuar dhe të armatosur mirë, ajo është tashmë një ushtri popullore e frymëzuar nga ideologjia marksiste. Mbarë populli ynë është i armatosur dhe mbrojtjen e

atdheut e konsideron si detyrën e tij numër një. Pa-
rulla jonë «Në njërën dorë kazmën dhe në tjetrën pu-
shkën» është bërë një realitet i gjallë. Veç këtyre ne
kemi edhe miq të shumtë në botë. Vendi ynë ndihmo-
het shumë politikisht dhe ideologjikisht nga të gjitha
partitë marksiste-leniniste, si dhe nga miqtë e gjithë
popujt përparimtarë të botës, duke gëzuar simpatinë e
tyre, prandaj do të rrojë në shekuj i lirë dhe flamuri
i socializmit në Shqipëri do të valojë kurdoherë fi-
timitar.

Në kontinentin tonë ka turbullira. Borgjezia impe-
rialiste dhe ajo revizioniste janë në kalbëzim dhe në
kontradikta të thella me njëra-tjetrën. Natyrisht, në
Evropë, sipas mendimit tonë, rrezikun kryesor e për-
bëjnë dy superfuqitë, që janë në aleancë e në rivalitet
midis tyre, por nuk mund të lihen pas dore dy shtete
të tjera të fuqishme kapitaliste, që luajnë një rol të
rëndësishëm në këtë kontinent, në kontradikta të më-
dha me dy të parat dhe që krijojnë rrezikshmëri për
luftë, siç janë Gjermania Perëndimore dhe Franca.

Sipas mendimit tonë, dy fuqitë më të mëdha im-
perialiste sundojnë sot mbi një sërë shtetesh në Evropë:
Bashkimi Sovjetik mbi vendet e Traktatit të Var-
shavës dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbi ato
të Paktit të Atlantikut Verior. Bashkimi Sovjetik ka
vendosur një sundim ushtarak fashist me anë të Trak-
tatit të Varshavës mbi vendet e tjera revizioniste të
Evropës. Këto mbahen të bashkuara nëpërmjet forcës
ushtarake. Klikat që janë tani në fuqi në to, kanë te-
ndencë shkëputjeje nga Bashkimi Sovjetik. Traktati i
Varshavës është, pra, një instrument shtypjeje për ve-

ndet revizioniste në duart e revizionistëve sovjetikë, prandaj ekzistojnë kontradikta midis pjesëmarrësve në të.

Kontradikta të hapëta ekzistojnë midis Bashkimit Sovjetik dhe Rumanisë. Udhëheqësit rumunë thonë se nuk dëshirojnë të qëndrojnë në Traktatin e Varshavës, por janë të detyruar të qëndrojnë atje nga frika. Megjithatë, ata orvaten të mos zhvillohen manovra ushtarake brenda në Rumani, se mendojnë që, po ta lejojnë këtë, Jakubovski me trupat që komandon do t'u mbeten brenda. Për t'i shpëtuar kësaj, rumunët bëjnë zhurmë se po organizohen, po armatosen etj. dhe këto, në fakt, i bëjnë, por jo nga pozita të drejta, sepse udhëheqja rumune është revizioniste. Rrugën më të përshtatshme për të shpëtuar nga një ndërhyrje sovjetike rumunët e gjejnë te lidhjet e tyre të ngushta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Anglinë, me Gjermaninë Perëndimore, me Francën, me një fjalë, me Perëndimin.

Kurse për Çekoslovakinë çështja është e qartë. Dubçeku ishte dhe është një revizionist, Svoboda gjithashtu. Kursi i tyre ishte të bashkoheshin sa më shpejt me Perëndimin. Husaku është njeri i sovjetikëve, që në rrugën shtetërore Çekoslovakinë ua ka nënshtruar plotësisht atyre, duke vënë në zbatim terrorin kundër popullit të vet. Ekonomikisht Çekoslovakia është në gjendje shumë të rëndë. Por pozitiv është fakti se populli atje reziston. Sipas mendimit tonë, tani lufta e popullit çekoslovak kundër revizionizmit sovjetik është më e fortë se në çdo vend tjetër revizionist. Gjatë këtyre 15-16 muajve që kanë kaluar nga koha e pushtimit të Çekoslovakisë, kemi konstatuar se

te populli çek janë rritur fryma luftarake dhe guximi. Nëpër fabrika e kudo ka pakënaqësi e rezistencë ndaj pushtuesve sovjetikë.

Është fakt se, kur hynë forcat e armatosura të revizionistëve sovjetikë për të pushtuar Çekosllovakinë, atje nuk u hodh asnjë pushkë kundër tyre. Sovjetikët bile nga kjo kishin frikë të madhe, për arsye se, po të kërciste pushka, politikisht do të humbitnin shumë më tepër nga sa humbën me pushtimin e këtij vendi. Megjithatë, me okupimin e Çekosllovakisë ata prapë humbën shumë politikisht, por edhe fituan diçka, ngaqë çekët nuk hodhën asnjë pushkë. Sidoqoftë, tani Çekosllovakia është bërë një gangrenë dhe, siç po zhvillohen situatat, është e zorshme që populli i këtij vendi të pranojë përgjithmonë okupacionin, prandaj revizionistët sovjetikë atje do të jenë vazhdimisht në vështirësi të mëdha.

Tani një kontradiktë e re që ka lindur në kampin revizionist, sipas mendimit tonë, është ajo midis Gjermanisë Lindore, me grupin e Ulbrihtit në krye, nga njëra anë, dhe Bashkimit Sovjetik e Polonisë, nga ana tjetër. Revizionistët polakë duan t'i shpejtojnë lidhjet miqësore me Bonin në kurriz të Republikës Demokratike Gjermane. Mjafton për ta që Republika Federale e Gjermanisë të njohë kufirin Oder-Najse, pale të mos e njohë Republikën Demokratike Gjermane si shtet sovran. Këtë tendencë ka edhe Bashkimi Sovjetik, i cili dëshiron ta afrojë Gjermaninë Perëndimore në dëm të Gjermanisë Lindore, por pa i hequr trupat që ka atje. Ulbrihti nuk e pranon një situatë të tillë, prandaj kanë lindur kontradikta të forta midis revizionis-

tëve. Duke u afruar me Republikën Federale të Gjermanisë, Bashkimi Sovjetik ka për qëllim të dobësojë aleancat amerikane në Evropë dhe njëkohësisht t'u japë të kuptojnë Shteteve të Bashkuara të Amerikës se afrimi me Gjermaninë Perëndimore ndihmon që kjo e fundit të mos bëhet e rrezikshme për revizionistët sovjetikë, të cilët mendojnë se, duke qenë plotësisht të lirë në Evropë, do të kenë duar të lira për të goditur Kinën në Azi. Do të shohim më vonë se si do të zhvillohen këto situata.

Në të ardhmen revizionistët e Moskës do të kenë kontradikta dhe me Poloninë, për arsye se kjo, po të lidhë marrëdhënie të ngushta me Gjermaninë Perëndimore, me siguri do t'i dobësojë lidhjet me Bashkimin Sovjetik. Një gjë e tillë do të bëjë që të shtohen kontradiktat midis tyre dhe një ditë Cirankieviçin, që nuk ka qenë kurrë marksist dhe që është një nga miqtë më të ngushtë të Krupit, mund ta shohim të vejë në Bon për marrëveshje.

Kontradikta kanë e do të kenë revizionistët sovjetikë edhe me revizionistët e tjerë. Socialimperializmi sovjetik ndodhet e do të ndodhet në një vullkan kontradiktash të pandërprera me vendet e Traktatit të Varshavës dhe me vetë popullin brenda vendit.

Në këto situata Bashkimi Sovjetik po zhvillon në fshehtësinë më të madhe bisedime në Helsinki me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Thuhet se, po të bien në ujdi, të dyja palët do të kenë për objekt kryesor luftën kundër Kinës, kurse parulla e «Sigurimit evropian», e hedhur nga Bashkimi Sovjetik, ka për qëllim të ruajë statukuonë në Evropë, domethënë su-

ndimin sovjeto-amerikan nëpërmjet Traktatit të Varshavës dhe NATO-s. Mirëpo Roxhersi nuk e pranoi dhe e hodhi poshtë këtë propozim të revizionistëve sovjetikë.

Edhe midis vendeve kapitaliste ekzistojnë kontradikta të mëdha. Cila është kontradikta kryesore midis tyre sipas mendimit tonë? Gjermania Perëndimore sot është në aleancë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe midis këtyre dy fuqive akoma nuk duket ndonjë çarje serioze. Tendenca e Gjermanisë Perëndimore është të rrethojë Gjermaninë Lindore, të lidhet me Poloninë, t'i buzëqeshë edhe Bashkimit Sovjetik, t'u japë kredi Rumanisë e Hungarisë, dhe në fakt u ka dhënë, ndërsa Bullgaria lëpin buzët, mbasi ka dëshirë të përfitojë edhe ajo ndonjë kockë. Në këtë rrugë Bonin e shtyjnë Shtetet e Bashkuara, me qëllim që të dobësojnë sundimin sovjetik mbi vendet revizioniste të Evropës. Megjithatë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë edhe frikë nga Gjermania Perëndimore, se, po të arrijë të bashkojë Gjermaninë Lindore, forcat e revanshizmit gjerman forcohen shumë.

Gjermania Perëndimore tani është në favor të futjes së Anglisë në Tregun e Përbashkët Evropian, pra, është dakord me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që janë përkrahëset kryesore të Anglisë për të zënë vend në këtë organizatë. Gjersa ka akoma interesa aleance me Amerikën, Gjermania Perëndimore hëpërhë nuk e sheh të rrezikshme futjen e Anglisë në gjashtëshe. Por ne vërejmë se, pas largimit të Dë Golit nga skena politike, as Franca nuk u reziston si më parë Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Pardon, në Konferencën e Ha-

gës, përfaqësuesi i Pompidusë u tërhoq në favor të amerikanëve dhe në parim e pranoi futjen e Anglisë në Tregun e Përbashkët Evropian. Kjo do të thotë se Franca është duke e zbutur politikën e vet ndaj Anglisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për arsye se ka shumë frikë nga një Gjermani revanshiste e bashkuar plotësisht. Në Konferencën e Hagës u duk edhe një shenjë tjetër që shpjegon këtë ndryshim të politikës franceze: Gjermania Perëndimore u bashkua me Italinë kundër Francës. Kështu gradualisht po nxjerr kokë krijimi i aleancave të kohës përpara Luftës së Dytë Botërore.

I tillë është gjykimi ynë për këto situata që po zhvillohen. Këto deduksione i nxjerrim në bazë të analizës që i bëjmë zhvillimit politik të gjendjes aktuale. Njohja e kontradiktave në botën kapitalisto-revizioniste u shërben marksistë-leninistëve për luftën e tyre. Ne shqiptarëve, si komunistë dhe si shtet evropian, na intereson shumë për luftën tonë zhvillimi i ngjarjeve në vendet evropiane. Lufta e Partisë dhe e shtetit tonë mendojmë se duhet të zhvillohet sidomos në Evropë, natyrisht, me aq sa kemi mundësi ne, si në drejtim të ndihmës që duhet t'i japim luftës revolucionare të popujve, të partive, të grupeve marksiste-leniniste dhe të elementëve demokratë progresistë, domethënë për krijimin në secilin vend të një fronti antiimperialist dhe për forcimin e vazhdueshëm të këtij fronti, ashtu edhe për demaskimin e politikës ekspansioniste e agresive të shteteve imperialiste. Ne mendojmë se e tillë duhet të jetë politika e çdo vendi socialist dhe e partive e grupeve të reja marksiste-leniniste. Gjykojmë se ka mu-

ndësi të mëdha për ta zhvilluar drejt e me konsekuencë këtë luftë jo vetëm në Evropë, por në të gjithë botën, për arsye se lëvizja revolucionare është vazhdimisht në ngjitje. Të tërë ne, marksistë-leninistët, në koordinim të plotë luftarak, të godasim me të gjitha forcat dhe mjetet që kemi, se për imperializmin dhe revizionizmin ekzistojnë kudo pika të dobëta.

Një pikë e zjarrtë në botën e sotme është Vietnami dhe gjithë gadishulli i Indokinës, pastaj India, Lindja e Afërt, kontinenti afrikan, Amerika Latine etj. Edhe në vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës grevat dhe protestat e popullit kundër luftës janë të përditshme. Nuk është për t'u nënvleftësuar edhe lufta e masave punonjëse në Japoni e në Australi. Shihni, pra, sa pika të dobëta ka imperializmi dhe ç'forca të mëdha kanë revolucioni dhe socializmi, sa suksese mund të kemi ne, po ta ndjekim, po ta organizojmë dhe po ta bashkërendojmë si duhet luftën kundër armiqve të demokracisë, të revolucionit dhe të socializmit.

Në Evropë situata zien si në një kazan të madh. Në Itali me miliona punëtorë po bëjnë greva çdo ditë. Marksistë-leninistët mësojnë si të veprojnë nga eksperiencia dhe nga lufta revolucionare e klasës punëtore dhe jo nga reformistët, te të cilët nuk duhet pasur asnjë besim. Prandaj është e domosdoshme t'i forcojnë lidhjet me të, të mos jenë sektarë dhe maksimalistë, por të futen në radhët e masave shumëmilionëshe dhe borgjezisë t'i jepen goditje të pareshtura hap pas hapi, deri në përmbysjen e saj të plotë. Ky është qëllimi i proletariatit, por edhe borgjezia ka mjete të fuqishme të diktaturës së saj, të cilat i përdor për t'u mbrojtur

dhe për të goditur. Në këto kushte, partitë marksiste-leniniste punojnë në ilegalitet, duke shfrytëzuar format legale dhe ato ilegale të veprimtarisë revolucionare. Por ka në Evropë edhe ndonjë parti legale. Policia i njeh të gjithë anëtarët e saj, e di ku ndodhen dhe ku punojnë. Kjo i bën ata të jenë të ekspozuar përpara rreziqeve.

Dëshiroj t'ju them tani pak fjalë për fqinjët tanë. Titoja dhe klika e tij kanë falimentuar, jo vetëm se janë një agjunkturë e sprovuar e imperializmit ndërkombëtar, por sepse regjimi i tyre tashmë po mbahet me zor, me paterica. Në politikën e jashtme Titoja nuk di nga t'ia mbajë, se i bëjnë presion të madh imperialistët amerikanë, nga njëra anë, dhe revizionistët sovjetikë, nga ana tjetër. Ai përpiqet të mbajë një pozitë gjoja asnjëse, por është diskredituar kokë e këmbë. Brenda në Jugosllavi, me format kapitaliste më të degjeneruara që ka vendosur dhe me reformat që ka bërë, Titoja ka shkatërruar gjithçka. Atje gjendja ka arritur në atë shkallë që kush të mundë të vjedhë më përpara. Çështja nacionale, gjithashtu, është bërë atje një lëmsh i pazgjidhshëm, nacionalitetet janë ngritur kundër njëri-tjetrit. Atje ka edhe mbi një milion shqiptarë, të cilëve Titoja ua ka shumë frikën. Prandaj, në gjendjen që është katandisur, u detyrua t'u japë disa të drejta, si, për shembull, për të ngritur flamurin shqiptar, për të hapur më shumë shkolla shqipe, për përdorimin e gjuhës shqipe. Ne e njohim mirë jo vetëm politikën e revizionistëve jugosllavë ndaj popullit shqiptar që jeton në trojet e veta në Jugosllavi, por edhe ndaj Shqipërisë socialiste. Për vendin tonë që-

ndron kurdoherë rreziku i Jugosllavisë titiste, prandaj jemi vazhdimisht vigjilentë.

Sikurse dihet, revizionistët sovjetikë pushtuan ushtarakisht Çekoslllovakinë, por në planet e tyre ata synonin edhe më tej, Jugosllavinë dhe Shqipërinë. Për këtë qëllim kishin përqendruar forcat në Hungari dhe në Bullgari. Njëkohësisht anije të shumta të flotës sovjetike lëvrinin pa pushim në Mesdhe. Në këto situata ne u vumë në gatishmëri të plotë nga të katër anët, por jo vetëm kaq, i bëmë edhe një demaskim të rreptë pushtimit ushtarak të Çekoslllovakisë nga trupat e Traktatit të Varshavës, demaskuam njëkohësisht planet e përqendrimit të forcave sovjetike në Bullgari dhe e paralajmëruam këtë të fundit. Këtë e njoftuam publikisht, që ta merrte vesh populli bullgar. Ne i dërguam një notë edhe presidentit të Egjiptit, Naserit, duke i vënë në dukje se në portet egjiptiane është duke u përqendruar flota agresive sovjetike, që ka për qëllim të sulmojë edhe Shqipërinë. Prandaj, si miq të popujve arabë dhe për arsye se kauzën e tyre Shqipëria e ka përkrahur kurdoherë, kërkuam të merren masa që të mos lejohet flota sovjetike e përqendruar në portet egjiptiane të sulmojë Shqipërinë.

Ne bëmë deklarata publike se, pavarësisht që me regjimin titist kemi kontradikta ideologjike të pazgjidhshme, në qoftë se Jugosllavia do të sulmohej nga agresorët sovjetikë, do të mbanim anën e popujve të saj. Po kështu thamë edhe për Rumaninë, pavarësisht nga mosmarrëveshjet ideologjike që kemi me udhëheqjen e saj. Në këtë kohë denoncuam edhe Traktatin e Varshavës. Këto ishin disa nga masat që morëm ne. Pra-

ndaj mendojmë se kërcënimi që patën përgatitur sovjetikët kundër vendit tonë, për shumë arsye, por edhe nga qëndrimet tona, u shmang.

Është zhdukur vallë tani kërcënimi ndaj vendit tonë? Unë mendoj se jo. Revizionistët sovjetikë janë fashistë, ata po përgatiten për sulme të reja, por në koniunkturat aktuale, hëpër hë politikisht nuk janë në gjendje të bëjnë një agresion ndaj nesh. Më parë duhet të presin të rregullohen koniunkturat në favor të tyre, pastaj të realizojnë sulmin. Megjithatë barutina e mbajmë kurdoherë të thatë, punën përgatitore për mbrojtjen e kemi në kulm, si në ushtri, ashtu edhe në popull, me rininë, me gratë etj. Në kushtet aktuale udhëheqësit sovjetikë po bëjnë të gjitha përpjekjet për të marrë kontakt me ne, por ua kemi prerë të gjitha urat, pse me ta nuk na lidh asgjë.

Nga Jugu, Greqia gjendet në vështirësi të mëdha si brenda vendit, ashtu edhe me aleatët e vet, të cilët dëshirojnë që në këtë vend të ketë një regjim më të moderuar. Kohët e fundit udhëheqësit e juntës ushtarake greke na kanë propozuar të bëjnë tregti me vendin tonë. Ne u jemi përgjigjur pozitivisht, por më parë ata duhet të tërheqin deklaratat për gjendjen e luftës që pretendojnë se ekziston midis Greqisë dhe Shqipërisë qysh në kohën kur Greqinë e sulmoi Italia fashiste, e cila kishte pushtuar edhe vendin tonë dhe tani është aleate e saj në kuadrin e NATO-s.

Me Italinë dhe me Francën marrëdhëniet tona janë normale, me to zhvillojmë tregti.

Kjo është, në përgjithësi, situata te ne.

Ju falënderoj për vlerësimin e lartë që u bëtë su-

kseseve të arritura nga vendi ynë në ndërtimin e socializmit dhe kontributit modest të Partisë sonë në lëvizjen marksiste-leniniste ndërkombëtare. Të jeni të sigurt se te Partia jonë do të keni kurdoherë një parti besnike deri në fund ndaj marksizëm-leninizmit. Sa për mua, ju siguroj, gjithashtu, se unë jam vetëm një anëtar i vendosur i Partisë sime dhe një luftëtar i vendosur i lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

*Botohet për herë të parë sipas
shënimeve të mbajtura në
këtë takim që gjenden në AQP*

PERËNDOI AJO KOHË QË E DETYRONTE SHQIPTARIN TË MERRTE RRUGËN E KURBETIT

*Nga biseda me përfaqësuesit e kolonive shqiptare
në vende të huaja¹*

9 dhjetor 1969

Shokët e mi dhe unë, të dashur motra dhe vëllezër të mërguar, jemi shumë të lumtur që takohemi me ju këtu në gjirin tonë. Takimi me ju na jep forca të reja në luftë për të mirën e popullit dhe të atdheut tonë të përbashkët. Pavarësisht se ju jetoni në vende të huaja, ne e kuptojmë dhe e ndiejmë që zemrat tuaja rrahin me mall e me dashuri për Shqipërinë dhe për popullin shqiptar. Si ne, ashtu edhe ju që jetoni në dhe të huaj, nuk e gjejmë të drejtë formulën e vjetër të latinëve, sipas së cilës «Atdheu është atje ku je

¹ Shoku Enver Hoxha priti në selinë e Komitetit Qendror të PPSH përfaqësuesit e kolonive shqiptare me banim në SHBA, në Argjentinë, në Turqi, në Francë, në Bullgari, në Rumanë e në Australi, që morën pjesë në festimet me rastin e 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe të fitores së revolucionit popullor.

mirë». Shqiptari e ndien veten mirë vetëm në atdheun e tij. Këtë ndjenjë të lartë atdhedashurie e ka shprehur bukur në vargjet e tij edhe patrioti e poeti revolucionar i Rilindjes sonë Kombëtare Andon Zako Çajupi, kur thotë: «Ku na duket balta m'e ëmbël se mjalta? — Në Shqipëri».

Për këtë vend të shtrenjtë e të dashur kanë luftuar me një heroizëm të shquar stërgjyshërit, gjyshërit dhe baballarët tanë, për këtë truall luftoi mbarë populli ynë; vëllezërit dhe motrat tuaja gjatë Luftës Nacionalçlirimtare të udhëhequr nga Partia. Edhe ju vetë, pavarësisht nga vendi ku banoni, keni luftuar me çdo mjet që keni pasur në dispozicion, sepse, siç thotë një fjalë e urtë e popullit tonë, «Gjaku kurrë nuk bëhet ujë».

Përpjekjet shekullore të shumë brezave të popullit tonë nuk shkuan kot. Sa luftëra të përgjakshme dhe heroike janë bërë në të kaluarën në Shqipëri për mbrojtjen e truallit amtar dhe të kombit tonë! Dhe një nga qendrat më të lavdishme të kryengritjeve shqiptare për liri e pavarësi ka qenë edhe Kosova heroike e martire.

Për interesat e lartë të atdheut luftuan shqiptarët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, veteranët e «Vatrës» me Nolin në krye, shumë shqiptarë të tjerë, si në Argjentinë, në Turqi, në Australi, në Francë e gjetkë. Kudo që kanë qenë, shqiptarët kanë dhënë kontributin e tyre për këtë tokë, për këtë Shqipëri, e cila më 1912 fitoi pavarësinë.

Fitorja e pavarësisë kombëtare ishte një ngjarje e shënuar për mbarë popullin tonë, po ai prapë ra në

një zgjedhë të dyfishtë, nga njëra anë të feudalëve me Ahmet Zogun në krye, dhe të të huajve, nga ana tjetër. Qëndrimi tradhtar i satrapit Zog, siç e dini, çoi përsëri në pushtimin e Shqipërisë nga Italia fashiste. Ky pushtim bëri që të piqeshin të gjitha kushtet për shpërthimin e luftës ngadhënjimtare të popullit shqiptar për çlirimin kombëtar dhe shoqëror, të udhëhequr nga Partia Komuniste, sot Partia e Punës e Shqipërisë. Kjo luftë do të ndizej dhe do të përfundonte patjetër me fitore, pavarësisht nga forcat e armikut, pse ishte një luftë popullore që udhëhiqej nga një Parti e përbërë prej bijve e bijave të popullit fukara, që luftonin kundër fashizmit, por në të njëjtën kohë edhe kundër bejlerëve, agallarëve, fajdexhinjve e gjakpirësve të tjerë, të cilët, duke shfrytëzuar deri në palcë popullin fukara, bënë që shumë nga ju ose nga prindërit tuaj të linin tokën amtare, nënën e fëmijët e të merrnin rrugën e kurbetit për të siguruar bukën e gojës.

Populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë, luftoi i bashkuar në aleancën antifashiste me Bashkimin Sovjetik, me Anglinë, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me të gjithë popujt e tjerë që luftonin kundër fashizmit italian dhe nazizmit gjerman. Forca e këtij populli të vogël, që u tregua i madh në luftën përkrah aleancës antifashiste, përballoi me sukses dhe i mundi të gjithë armiqtë e jashtëm e të brendshëm. Më duket se nuk është e nevojshme t'ju shpjegoj juve, motrave e vëllezërve tanë të mërguar, arsytet e fitores, pse si shqiptarë që jeni i kuptoni drejt hovet e mëdha të shpirtit, ndjenjat e larta të dashurisë së popullit tonë që luftoi me të gjitha forcat

për lirinë dhe për pavarësinë e atdheut. Këto ndjenja të larta arritën kulmin me Luftën Nacionalçlirimtare. U ngrit në këmbë dhe u hodh në luftë i madh e i vogël, plak dhe i ri, burrë dhe grua, pa marrë parasysh vdekjen, gjakun që derdhej, shtëpitë dhe krahinat e tëra që u bënë shkrumb e hi, vetëm e vetëm që të çlirohej atdheu dhe populli të dilte në dritë. Këtë barrë të rëndë populli shqiptar ishte i vendosur ta mbante në kurriz, me qëllim që, pasi të fitonte lirinë aq të dëshiruar, të vendoste pushtetin e tij dhe çdo gjë ta rindërtonte vetë.

Të huajt nuk luftuan përkrah popullit tonë brenda në Shqipëri. Kjo ndodhi se populli shqiptar, pa mohuar aspak ndihmën e aleatëve si faktor i rëndësishëm për shkatërrimin e armiqve të përbashkët, nazifashistëve, luftoi vetë, me thonj e me dhëmbë, mbathur e zbatthur, veshur e zhveshur, me armë dhe me çdo mjet tjetër që kishte në dorë. Në fushën e betejës ne u armatosëm me armët që i rrëmbyem armikut dhe kështu i bëmë atij varrin kudo që e gjetëm, pa e lënë rehat për asnjë çast, gjersa çliruam Shqipërinë, dhe jo vetëm kaq, por e ndoqëm atë këmba-këmbës edhe në Jugosllavi, ku luftuam dhe korrëm fitore mbi armikun krah për krah me vëllezërit tanë atje.

Pas Çlirimit ne dëshironim dhe u përpoqëm të rronim si miq me të gjitha shtetet që ishin aleate gjatë luftës së madhe. Disa e deshën miqësinë tonë, prandaj edhe ne u miqësua me to. Në radhë të parë, lidhëm miqësi me Bashkimin Sovjetik dhe me shumë shtete të tjera të Evropës, që e njohën Qeverinë tonë. Ju, të dashur vëllezër e motra, sigurisht i dini këto fakte histo-

rike që pasqyrohen në dokumentet e Qeverisë sonë pas Çlirimit. Në atë kohë ne u sollëm shumë korrektë edhe me administratën amerikane, pse dëshironim të kishim marrëdhënie të mira me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, megjithëse e dinim që gjatë luftës se, duke vepruar nën rrogë, amerikanët thurnin komplete kundër nesh. Këtu nuk e kam fjalën për popullin amerikan, po për udhëheqësit reaksionarë të të dyja partive të mëdha të borgjezisë kapitaliste amerikane, qofshin ata demokratë apo republikanë. Por, pavarësisht nga qëndrimet e tyre armiqësore gjatë luftës, ne nuk e shkëlëm aleancën me ta. Edhe pas Çlirimit u treguam përsëri zemërgjerë. Ne menduam të kishim marrëdhënie të drejta e të sinqerta, siç e ka zakon shqiptari, por ata nuk deshën. Dhe jo vetëm që s'deshën, por bënë edhe një mijë e një të zeza kundër nesh, sepse e kuptonin që u shpëtoi nga duart Shqipëria e dikurshme, së cilës donin t'i impononin ligjet e robërisë. Qeveria Demokratike Shqiptare, që lindi nga gryka e pushkës së popullit tonë heroik, nuk mund të vihej nën diktat. Me Shqipërinë e vogël të pasluftës ose mund të merreshe vesh miqësisht dhe duke u nisur nga pozitë e barazisë e të mosndërhyrjes, ose përndryshe ajo të tregonte vendin. Dhe ne ua vumë kufirin te thana edhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, edhe Anglisë, si dhe gjithë të tjerëve që nuk deshën ta njihnin formën e organizimit shtetëror që vetë populli ynë kishte zgjedhur — Republikën Popullore të Shqipërisë.

Ne, si për çdo popull në botë, kemi pasur dhe kemi respekt të madh edhe për popullin amerikan,

nga gjiri i të cilit po ngrihen me qindra mijë njerëz kundër luftës së shpërthyer nga imperialistët në Vietnam dhe kundër politikës së tyre raciale. Ne kemi, gjithashtu, respekt edhe për popullin anglez. Prandaj kurrë nuk kemi hedhur e nuk do të hedhim gurë kundër tyre, përkundrazi ne kemi njohur dhe kemi folur mirë për sakrificat që kanë bërë ata në kohën e Luftës së Dytë Botërore dhe këtë e bëjmë sepse nuk ngatërrojmë udhëheqjet reaksionare me popujt. Veç duhen njohur drejt faktet historike. Shqipërinë nuk e kanë çliruar Shtetet e Bashkuara të Amerikës, as Anglia, as ish-presidenti Uilson, siç pretendon Departamenti Amerikan i Shtetit. Historinë e dimë të gjithë. Uilsonin e heqin si «babain e demokracisë», por pikërisht në kohën e tij nënshkruheshin traktatet e fshehta për të copëtuar Shqipërinë dhe për këtë shkak një milion e gjysmë shqiptarë po vuajnë prej një kohe të gjatë nën robëri, jashtë kufijve shtetërorë. Populli shqiptar di të dallojë shumë mirë kush është përparimtar dhe kush është reaksionar.

Juve, motra e vëllezër të dashur, ju bëjnë një propagandë shpifëse, sikur Qeveria Shqiptare bijave e bijve të këtij trualli, që janë në mërgim, nuk u jep viza për të ardhur në Shqipëri e plot trillime të tjera të kurdisura me qëllime armiqësore. Ne nuk e kemi ndaluar dhënien e vizave për motrat dhe për vëllezërit tanë, por veç qeveria amerikane duhet të dijë se ne jemi shtet dhe nuk mund të lejojmë që, nën maskën e turistëve, të na futin këtu agjentët e tyre, në një kohë kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës të dërguarit tanë në Organizatën e Kombeve të Ba-

shkuara nuk i lejojnë të dalin asnjë çap nga territori i selisë së OKB-së, dhe, për demagogji, nga ana tjetër, bëjnë deklarata që tani po i lejojnë shqiptarët që jetojnë atje të shkojnë në Shqipëri. Siç dihet, këto probleme zgjidhen me marrëveshje të dyanshme, që ne i kemi dashur fill pas Çlirimit. Kjo do të thotë se për këto çështje që na takojnë edhe neve, nuk mund të vendosin vetëm Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe kur t'u leverdisë atyre. Ne nuk mund të mos përcaktojmë qëndrimin tonë të drejtë ndaj veprimeve të ulëta që ata kanë bërë dhe po vazhdojnë të bëjnë kundër nesh.

Kohët ndryshuan. Me Shqipërinë e sotme nuk mund të luhet lehtë. Edhe Titoja, që për njëfarë kohe hiqej si mik i Shqipërisë, nuk mundi të luante aq lehtë me popullin tonë. Ne me Jugosllavinë patëm marrëdhënie miqësore derisa Titoja qëndronte i maskuar, por edhe kur ai nuk ishte demaskuar akoma, i patëm thënë se ne nuk i harrojmë vëllezërit kosovarë, pse ata janë gjaku ynë. Këtë Titos ia përsëritim edhe tash. Ne s'përzihemi në punët e brendshme të Jugosllavisë, por, në qoftë se Titoja paska të drejtë të interesohet për padrejtësitë që i bëhen një qytetari jugosllav qoftë edhe në një skutë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të Australisë etj., si nuk paskemi ne të drejtë të interesohemi për të drejtat e një milion e gjysmë vëllezërve tanë, bija dhe bij të një nëne në Kosovë?! Jo, askush nuk do të mund të na e mohojë këtë të drejtë. Ne jemi interesuar dhe do të interesohemi për ta. Kur Titoja u duk se ç'ishte, ne ia çorëm maskën, sepse pavarësia e Shqipërisë, liria e popullit dhe so-

cializmi në Shqipëri janë mbi të gjitha. Populli derdhi gjakun, ai nuk vuajti e derdhi gjak që të rrojë përsëri nën zgjedhë, por që të jetë i lirë.

Me Bashkimin Sovjetik ne patëm, gjithashtu, marrëdhënie shumë të mira, kishim dashuri të madhe për këtë vend, pse, sa ishte gjallë Stalini, e respektonte pavarësinë dhe lirinë e Shqipërisë. Ne ruajmë ndjenjën e dashurisë për Stalinin, se ai ishte njeri i madh. Tash armiqtë vërtet po i hedhin baltë atij, por në zemrat e popujve Stalinin kurrë nuk mund të njolloset. Do të vijë dita që figura e tij do të ndritë në botë, ajo edhe sot qëndron e do të qëndrojë kurdoherë e ndritur në mendjet dhe në zemrat e njerëzve përparimtarë.

Revizionistët sovjetikë vunë «boritë» se gjoja Shqipëria qenka shitur, por tërë bota e di, bile dhe vetë armiqtë e kanë mësuar, se Shqipëria nuk shitet. Shqipëria është mike me miqtë dhe e sinqertë me të gjithë ata që janë të sinqertë, por sytë i ka gjithnjë të hapët. Po nuk dredhove, po mbete besnik, Shqipëria s'leviz, por veç, po u përpoqe t'i bësh keq, ajo të godet fort, prandaj armiqtë le t'i bëjnë mirë llogaritë me vendin tonë, le të maten jo 7, po 17 herë, pa të presin një herë. Shqipëria ka treguar me prova se nuk mundet kollaj. Populli shqiptar nuk është mposhtur me qindra vjet gjatë rrebesheve të historisë, aq më tepër nuk mund të mposhtet tash që ka një eksperiencë të madhe luftërash e fitoresh dhe ka marrë fuqinë në dorë.

Kur erdhën në fuqi tradhtarët revizionistë sovjetikë, ne ishim ndër të parët që u ngritëm me guxim kundër tyre. Sot u jemi bërë ferrë në këmbë dhe nuk do t'i lëmë rehat, derisa të shkatërrohen përfundimisht.

Natyrisht, ka e do të ketë njerëz që, duke mos njohur forcën e pamposhtur të popujve, do të thonë: «More, ç'thonë kështu këta shqiptarët, mos vallë janë të marrë? Mos maten me hijen e diellit të mëngjesit?». Jo, motra dhe vëllezër, ne nuk jemi të marrë dhe nuk matemi me hijen e diellit të mëngjesit, por matemi me forcat e revolucionit dhe të popujve që janë më të mëdha nga ato të imperializmit dhe të revizionizmit të marra së bashku. Ne jemi thellësisht të bindur për fitoren tonë. Nuk është kjo një bindje e njerëzve ëndërrues, por realistë, sepse, po të ishte ndryshe, me siguri do të na ishin marrë këmbët dhe do të ishim rrokullisur në greminë. Kush na i jep neve këtë forcë logjike, këtë kurajë revolucionare, këtë qartësi të perspektivës? Na i japin pikërisht mendimi dhe zemra e madhe e popullit, lidhjet e ngushta me popullin, ideologjia e klasës punëtore, marksizëm-leninizmi, që ne bashkë me popullin e përvetësojmë, e zbatojmë në mënyrë krijuese në kushtet tona dhe e pasurojmë kurdoherë e më shumë.

Komunistët shqiptarë janë njerëz të thjeshtë e të sakrificës. Armiqtë ata i shajnë, i quajnë «barbarë», «kriminelë», e çfarë nuk thonë për ta. Ata shpifin kështu për komunistët, se këta janë njerëz të popullit, që ia ndërruan faqen asaj Shqipërie të prapambetur që shumë prej jush e mbajnë mend mirë si ishte para 30-40 vjetësh.

Sa shumë ka ndryshuar tani kjo Shqipëria jonë! Koha vërtet ka qenë e shkurtër dhe ne nuk mburremi me përparimet që kemi arritur, po e vërteta është që ndryshimet janë të mëdha. Sidomos ju i kuptoni shu-

më drejt këto ndryshime, sepse i krahasoni me gjendjen që ka qenë më parë te ne. Natyrisht, ato nuk i krahasoni me pallatet që shikoni, për shembull, në qendër të Ankarasë, në Shans-Elize të Parisit, ose me grataçielet e Nju-Jorkut, që nuk janë bërë për 25 vjet, po kanë shekuj që kanë filluar të ndërtohen me djer-sën, me gjakun dhe me vuajtjet e punëtorisë për të përfiturat manjatët, pasanikët, milionerët. Duke e vështruar Shqipërinë në këtë prizëm të drejtë, ndryshimet brenda 25 vjetëve duken si nata me ditën. Nga një vend që gjatë luftës u bë hi, ku u shkatërruan bujqësia, ekonomia, rrugët, shtëpitë e gjithçka, tani ju bashkatdhetarët tanë e shikoni Shqipërinë siç është sot.

Duke qenë i plotfuqishëm dhe zot në vendin e vet, populli ynë bëri mrekulli të mëdha gjatë këtyre 25 vjetëve. Ai ngriti me qindra fabrika e uzina, sistemoi fusha e hapi toka të reja, bëri hapa të mëdhenj përpara në zhvillimin e arsimit e të kulturës etj. Pushteti popullor ka hapur kudo shkolla, në të gjitha fshatrat. Të gjithë fëmijët e Shqipërisë mbarojnë detyrimisht shkollën 8-vjeçare. Partia dhe Qeveria jonë synojnë që jo shumë larg të gjithë të arrijnë të mbarojnë edhe shkollën e mesme. Universiteti ynë çdo vit mbushet me studentë të ardhur nga të gjitha viset e Shqipërisë. Megjithëse kuadrot me arsim të lartë shtohen çdo vit, nevojat gjithnjë në rritje të ekonomisë dhe të kulturës sonë, që zhvillohen në mënyrë të shpejtë e të vrullshme në të gjitha drejtimet, kërkojnë përherë e më tepër njerëz të ditur. Tani gati në çdo fshat ka ambulancë, mjek, infermierë e mami. Shërbimi mjekësor në të gjitha format është falas. Ju e kuptoni shumë

mirë ç'gjë e madhe është kjo për popullin, pse në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose në Argjentinë e kudo në vendet kapitaliste doktori do dollarët në dorë, ndryshe të lë të vdesësh. Ne luftojmë tani që çdo fshat të ketë mjekun e tij. Cilido që sëmuret, shtrohet në spital, shërohet dhe s'pagan asnjë qindarkë, dhe, në bazë të ligjit, punëtori ose nëpunësi përfiton edhe nga sigurimet shoqërore shtetërore sigurimin për paaftësi të përkohshme në punë. Çmimet e ilaçeve kohët e fundit u ulën akoma, sa gati nuk kushtojnë hiçgjë. Shkollat gjithashtu ndiqen falas, në çerdhet dhe në kopshtet e fëmijëve prindërit paguajnë një kuotë fare të vogël. Shqipëria është i vetmi vend në botë që i ka hequr taksat.

Me qëllim që të mëkëmbej bujqësia, fshatarëve u janë dhënë kredi nga shteti për të blerë farëra, kafshë pune e prodhimi e të tjera, por shpesh, sidomos me raste festash jubilarë, kreditë shteti ua ka falur. Traktorët punojnë kudo dhe me çmime të arsyeshme. Çdo vit shteti investon miliona lekë për ta bërë bujqësinë tonë me të vërtetë moderne e të përparuar, dhe tani po merren rendimente më të larta në grurë, në misër etj.

Të gjitha investimet që bëhen synojnë rritjen çdo vit e më shumë të mirëqenies së popullit. Në këtë drejtim, në krahasim me të kaluarën, ne kemi pasur përparime shumë të mëdha. Mjafton të përmendim se në Shqipëri jeta mesatare e njeriut nga 38 vjet që ishte dikur, tani ka arritur në 66-67 vjet. Ne po synojmë që shpejt jeta mesatare të ngrihet në 70 vjet, më vonë në 80 e kështu t'i ngjitim shkallët një nga një.

Populli ynë e di se jeta nuk zgjatet me lutjet apo me nuskat e fetarëve, por me përpjekje dhe me punë, që janë burimi i mirëqenies dhe i begatisë së atdheut.

Për veprat që kemi ngritur e po ngremë, është e vërtetë se kemi marrë kredi nga Bashkimi Sovjetik i kohës së Stalinit dhe nga Kina, por ju dhe gjithë bota duhet ta dini se kredia e vlefshme dhe e nevojshme që na është dhënë është diçka jashtëzakonisht e vogël përpara investimeve në miliarda lekë dhe forcës së madhe ekonomike që ka krijuar populli shqiptar me punën e me djersën e tij. Po ta vlerësojmë, për shembull, me shifrën dhjetë kredinë për makineritë e Hidrocentralit të Vaut të Dejës, afër Shkodrës, që patë, në raport me këtë shifër investimet e popullit shqiptar do të ishin njëqind e dhjetë. Dhe këta miliarda lekë dalin nga vetë puna, nga djersa dhe nga forca e popullit, nga ekonomizimi, nga planifikimi dhe nga organizimi në mënyrë të drejtë i ekonomisë, që lëku i popullit të mos harxhohet kot, por të shfrytëzohet në interesin e tij. Këto suksese të Shqipërisë ju, të dashur motra dhe vëllezër, pjesërisht i patë, prandaj ju ftojme të qëndroni edhe ca që të shihni më shumë, se kështu do të bindeni më mirë për realitetin shqiptar dhe do të gëzoheni.

Bijtë e popullit tonë, kudo që janë, i shikojnë qartë këto suksese, me gjithë veprën tradhtare që bëjnë Abaz Kupi me të tjerë, që ka grumbulluar nga janë e nga s'janë qeveria amerikane. Ka nga ata patriotë të vjetër e njerëz të ndershëm që duan Shtetet e Bashkuara të Amerikës, po duan edhe Shqipërinë, që u grumbulluan e milituan rreth «Vatër» së moçme, dhe sot

rezistojnë për të drejtat e tyre demokratike. Tradhtarët e atdheut, që s'janë tjetër veçse njerëz të shitur të kapitalistët, mundohen të komandojnë «Vatrën», po në të vërtetë s'janë ata që bëjnë ligjin në radhët e shqiptarëve të Amerikës, pse atje punojnë e luftojnë edhe patriotët e organizatës «Shqipëria e lirë».

Populli ynë ka mundur të arrijë këto përparime vetëm për faktin se sot është i lirë, se nuk sundohet më nga të tjerët, por sundon vetë. Pikërisht këtu qëndron thelbi i çështjes. Ne që jemi në udhëheqje, nuk qëndrojmë në këto vende se na mban policia, sigurimi apo ushtria, siç thonë disa gazeta në Perëndim, por na mbajnë puna, populli. Po të mos na donte populli, do të na kritikonte një herë, dy e tri herë, pastaj, po të mos ndreqeshim, do të na thoshte: «Shkoni atje ku duhet, sepse nuk keni vend këtu, ka të tjerë që punojnë më mirë për Partinë dhe për popullin!». Në një rast të tillë, cilido, po të jetë i ndershëm e i ndërgjegjshëm, duhet të vejë të punojë atje ku populli do ta mësojë si mund të punohet më mirë. Situata e krijuar në vendin tonë, që populli kritikon lirisht dhe vlerëson drejt punën e kuadrove, është një gjë e madhe që ka krijuar Partia. Në këtë drejtim ne jemi 100 vjet më përpara nga të gjitha ato vende ku rroni ju. Ato mund të jenë më përpara për sa i përket zhvillimit teknik, industrisë etj., por për sa i përket zhvillimit të demokracisë e ndërgjegjes së njerëzve, janë 100 vjet pas nesh. Jemi të bindur se një ditë edhe ato vende do të arrijnë me siguri këtu ku kemi arritur ne. Ky është ligj i domosdoshëm i zhvillimit shoqëror, po atëherë ne do të jemi përsëri 100 vjet përpara. Por as ne, as

brezat tanë të ardhshëm nuk do të jemi fodullë përpara tyre, përkundrazi, do të qëndrojmë kurdoherë, siç na mëson Partia, njerëz të thjeshtë dhe shërbëtorë të popullit tonë dhe të vëllezërve tanë të klasës në vendet e ndryshme. Ne nuk jemi mendjemëdhenj, po e vërteta është se në revolucionin botëror për të ardhmen e njerëzimit kemi vënë edhe ne një gur.

Për shtetin tonë ka rëndësi të madhe demokracia e vërtetë. Ajo për të cilën bëjnë kaq shumë zhurmë në vendet kapitaliste, s'është demokraci e vërtetë. Atje demokraci ka vetëm për një grusht njerëzish, për të pasurit, ndërsa në Shqipëri për të pasurit s'ka demokraci, te ne demokraci ka vetëm për shumicën, për popullin. Këtu qëndron ndryshimi. Atje ka kërbaç për të varfërit, këtu ka kërbaç për të pasurit. Por, siç dihet, shumica në botë janë të varfrit, në kurrizin e të cilëve jetojnë të pasurit, prandaj demokracia për të varfrit është demokracia më e mirë, demokracia e vërtetë. Që të jetë e garantuar kjo demokraci, duhen qëruar armiqtë e saj, ish-të pasurit dhe parazitët, të cilët duhet të punojnë atje ku prodhohen me mund e me djersë të mirat materiale, që të edukohen dhe të mësojnë nga klasa punëtore dhe nga fshatarësia. Ne kemi shembuj që tregojnë se prej tyre janë bërë «lule», janë korrigjuar në punë, pse u bindën më së fundi se «Shkoi vapa me gushtin», ose si themi ne andej nga Gjirokastra, «Harro mushkë Valarenë!». Ka 25 vjet që në Shqipëri u zhduk «Valareja» e agallarëve dhe e bejlerëve. Tashti, pasi i kanë humbur shpresat, duke parë edhe fëmijët e tyre që kanë bërë shkollë, janë bërë anëtarë të bashkimit të rinisë dhe ndjekin rrugën e

Partisë, ish-shfrytëzuesit po mendojnë një çikë më mirë dhe shumë prej tyre po punojnë kokulur.

Partia e bën mirë dallimin e njerëzve që s'kanë faj nga fajtorët. Në qoftë se biri i një keqbërësi punon dhe sakrifikon për popullin, atë askush nuk e pengon të shkojë përpara, mjafton të njohë mirë ligësitë e të atit dhe ta dënojë sinqerisht veprimtarinë që ka zhvilluar ai në dëm të popullit. Kjo politikë e drejtë që zhvillohet nën dritën e marksizëm-leninizmit, është një shfaqje e demokracisë që po lulëzon në vendin tonë. Ju mund të merrni vetë pjesë në ndonjë mbledhje të popullit dhe do të vini re se si vlon kritika nga punëtorët dhe nga masat e gjera punonjëse deri edhe për kuadrot drejtues, dhe pikërisht kjo është një tjetër shfaqje e rëndësishme e demokracisë. Populli ynë nuk të lë rehat, ai i kërkon llogari cilitdo, kur kjo ose ajo punë nuk shkon mirë ose nuk është kryer si duhet. Është kjo demokracia e vërtetë që gëzon sot populli ynë. Po të mos ekzistonte një demokraci e tillë, vëllezër dhe motra, ky pushtet, kjo vijë politike kundër reaksionit të brendshëm dhe të jashtëm nuk do të kishin fituar, kjo Shqipëri nuk do ta kishte ndryshuar faqen e saj.

Disa armiq jashtë shtetit thonë se komunistët gjoja nuk i rëspektojnë të vjetrit, zakonet e tyre etj. Kjo është një propagandë krejt mashtruese. Jo, ne kurrë s'i harrojmë të vjetrit, sepse jemi bijtë e baballarëve tanë, gjaku ynë prej tyre ka rrjedhur, ne nuk e ndajmë të kaluarën nga e tashmja. Të parët tanë na kanë mësuar si të luftojmë, si të sakrifikohemi për Shqipërinë dhe si ta duam atë. Me mundësitë që kishin dhe me mënyrat e tyre, ata na kanë futur në

shpirt dashurinë për atdheun e për popullin dhe ne, bijtë e tyre, po ecim në rrugët e lashta të Skënderbeut, të Ismail Qemalit, të Bajram Currit, të Avni Rustemit e të mijëra patriotëve të tjerë.

Por në Shqipëri, krahas zakoneve shumë të mira e të nderuara, kishte edhe gjëra të këqija, që na kishin lënë trashëgim pushtesit e huaj dhe që ishin përqa-fuar me zell sidomos nga tradhtarët vendës. Një nga këto ishte çështja e trajtimit të gruas shqiptare. Ajo më parë nuk gëzonte të drejta si njeri. Jeta për të ishte një skëterrë, pse ishte e shtypur. Pushteti patriarkal në familje, i babait ose i vëllait, shtrihej gjer atje sa vajzat shiteshin me para, nuk përfillehin aspak dëshirat e tyre për martesë, në disa vende i fejonin që në djep dhe, çka është akoma më keq, mund edhe t'i vritnin pa i dhënë llogari asnjërit.

Lufta Nacionalçlirimtare dhe vendosja e pushtetit popullor krijuan mundësi që gratë shqiptare të ngrihen në vendin që meritojnë. Në këtë luftë, duke përkrahur aktivisht thirrjen e Partisë, femrat shqiptare luftuan si trimëresha. Dhe tash gruaja është me të vërtetë e barabartë me burrin, nga i cili nuk varet më ekonomikisht, pse u fut në punë. Edhe në vende të tjera ka gra e vajza në punë, por atje puna për femrën është skllavëri, ajo shfrytëzohet, ndërsa te ne punon për vete jo vetëm në kuptimin thjesht personal, por në një kuptim shumë më të gjerë. Ajo është e ndërgjegjshme se kontribuon njëkohësisht edhe për gjithë Shqipërinë. Gruaja shqiptare, që është gjysma e popullsisë së vendit, e ndien se Partia i ka ngarkuar një detyrë shumë të madhe. Tani që gratë marrin pje-

së aktive në punë dhe në jetën politike e shoqërore, Partia u ka shtruar detyrën e rëndësishme të ndjekin edhe shkollat dhe, me të vërtetë, të gjitha shkollat 8-vjeçare, të mesme dhe universiteti janë mbushur me vajza e me gra. Sot në tregti, në shëndetësi, në arsim, në kulturë e kudo punojnë gra. Në shumë sektorë të ekonomisë dhe të kulturës ato kanë marrë në dorë drejtimin e institucioneve, të ndërmarrjeve dhe të organizatave shoqërore. Partia po i ndihmon gratë të marrin kudo drejtimin e punëve. Dhe atje ku ka burra me mendime konservatore, që i pengojnë, Partia del në mbrojtje të femrës, me qëllim që ajo të ecë përpara me guxim dhe të zhduken mbeturinat në ndër-gjegjen e njerëzve.

Në botën kapitaliste paraja është çdo gjë. Kush ka paranë, ka në dorë fuqinë. Edhe në Shqipëri kështu ka qenë. Në familje vetëm burri pyetej, ai kishte edhe paranë, kuletën, apo jo, Hulo¹? Për ta çliruar nga varësia ekonomike gruan që futej në punë, Partia i tha të mos ia japë paratë burrit, por t'i bashkojnë dhe të administrojnë së toku buxhetin familjar. Dhe kështu u veprua. Kjo bëri që burri të humbë pushtetin ekonomik mbi gruan. Kuptohet se me këtë masë Partia përpiqej të luftonte mentalitetin e mbizotërimit të burrit ndaj gruas, ajo synonte të godiste pikëpamjet krejt të shtrembra, të vjetra dhe përçmuese ndaj gruas.

Duhet pranuar në mënyrë të ndershme, motra dhe vëllezër, se gruaja është më e drejtë nga ne burrat dhe më shumë ekonomë. Sa padrejtësisht thoshin më parë

1 Hulusi Kavo, shok i fëmijërisë i shokut Enver Hoxha.

që «Gruaja është leshgjatë e mendjeshkurtër»! Koha te ne ka provuar të kundërtën. Kur janë të çliruara, gratë mendjen e kanë top, kokën plot dhe nuk bien aspak më poshtë se burrat për çdo punë. Në luftën kundër zakoneve të egra e prapanike Partia ka për qëllim të mos lidhen më martesë me forcë, pa dashuri të sinqertë dhe me shpërblim, që është një variant i shitjes së femrës, i cili praktikohej nën ndikimin e ligjeve të kishës e të shariatit, të fesë përgjithësisht. Zakoni fetar i detyronte gratë të rrinin mbyllur brenda katër mureve të shtëpisë dhe të mos dilnin në punë. Më parë burri mund ta ndante gruan me një pusullë në dorë, duke i vënë bohçenë e teshave personale në kokë. Burri nuk e kishte për gjë që sot të dëbonte gruan dhe nesër të merrte një tjetër. Në këtë drejtim ne, të dashura motra, kemi arritur një sukses shumë të madh, që ka një rëndësi të jashtëzakonshme, dhe ky sukses u arrit me një luftë të vështirë e me durim kundër pikëpamjeve të botës së vjetër.

Emancipimi i gruas te ne u bë me një përmbajtje krejt të re e të shëndoshë, që s'është bërë gjatë. Ju, në vendet ku jetoni, shikoni shumë gra «të lira», që dalin e shëtisin etj., etj., por ato nuk e kanë kurrë shpirtin luftarak dhe ndërgjegjen e lartë të gruas shqiptare, ato nuk e kanë as shpirtin dhe as ndërgjegjen tuaj, që, edhe pse jetoni jashtë atdheut prej një kohe të gjatë, prapë jeni shqiptare, pse gjaku juaj është shqiptar.

Në bazë të planeve tona pesëvjeçare ekonomia do të përparojë më tej. Do të marrë një zhvillim më të madh industria, bujqësia, gjithashtu, do të moderni-

zohet më shumë, që fushat e atdheut tonë të bëhen më pjellore e më të bukura. Po merren masa që të ujiten jo vetëm fushat e mëdha, por edhe të gjitha tokat pjellore të malësisë, në Veri e në Jug, si në Dibër, në Kukës, në Tepelenë, në Përmet, në Mallakastër etj.

Ju jeni tani në dijeni për vendimin e Partisë për elektrifikimin e gjithë Shqipërisë gjer në nëntor 1971. Me masat e vrullshme që janë marrë, ne kemi besim se kjo detyrë do të realizohet para këtij afati; deri edhe në fshatrat më të largëta të malësisë do të vejë në çdo shtëpi drita elektrike. Kjo gjer sot nuk po ndodh në asnjë vend të botës. Le të shpifin ç'të duan armiqtë për Shqipërinë, ky është një tjetër sukses madhështor, një hap shumë i madh përpara drejt ngushtimit të dallimeve midis qytetit dhe fshatit, midis punës mendore e punës fizike. Lenini, siç dihet, ka thënë që komunizmi është «pushteti i këshillave plus elektrifikimi». Energji elektrike ka shumë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Francë, në Itali dhe në vende të tjera. Por në thellësi të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për shembull, ka njerëz, siç janë indianët, që përdorin akoma për ndriçim vajin e terpentinën, bile edhe pishën. E njëjta gjë ndodh edhe gjetkë. Vallë s'kanë mundësi Shtetet e Bashkuara të Amerikës me atë fuqi të madhe industriale t'i japin energji elektrike çdo skaji të vendit? Kanë, po nuk i japin, se Rokfeleri s'ka leverdi, nuk kanë leverdi koncernet, mbasi investimet atje synojnë në radhë të parë për shtimin e fitimeve të kapitalistëve dhe jo për mirëqenien e masave. Le të vriteshin me qindra mijë amerikanë në Kore, le të vriten makar edhe në Vietnam,

mjafton të sigurohen bazat ushtarake të përhapura në të gjithë botën, të shiten sa më shumë armë, të ruhen pasuritë dhe interesat ekonomikë të kapitalistëve. Natyrisht, këto pasuri nuk i gëzon tërë populli amerikan, ato në radhë të parë u përkasin kapitalistëve të mëdhenj, kurse një pjese të popullit i jepet diçka vetëm si lëmoshë. Ne e dimë që niveli i jetesës në Amerikë është më i ngritur, por kjo nuk është për tërë amerikanët. Le të marrim, për shembull, popullsinë e mjerruar zezake. Ju, si dhe ne, e dini se jeta për ta është bërë skëterrë, ata janë të privuar nga shumë të drejta dhe mbi të gjitha i shtrohen diskriminimit të egër racial. Edhe të bardhët vuajnë nga padrejtësitë shoqërore, nga pabarazia e theksuar ekonomike dhe nga shfrytëzimi kapitalist. Pra, as në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, as në Argjentinë e as në vende të tjera s'i bëjnë dot këto që bëhen në Shqipëri, pse ato janë vende ku sundon klasa e kapitalistëve, ndërsa këtu populli bën shumë gjëra, se është në fuqi, këtu udhëheq klasa punëtore.

E ardhmja e Shqipërisë është e ndritur, prandaj punohet kudo me besim e me kurajë revolucionare. Kështu do të punohet te ne vazhdimisht. Patjetër do të derdhet akoma më shumë djersë e do të bëhen sakrifica, pse populli e kupton që me «frymën e shenjtë» asgjë nuk bëhet. Edhe në qoftë se tani, për shembull, nuk arrijmë të hamë tri pjata në vakt, do të kënaqemi duke ngrënë një ose dy, megjithatë do të punojmë që brezat e ardhshëm të hanë tri. Pastaj, tani hamë të tërë nga një, kurse më parë hanin një pakicë e vogël me bollëk dhe shumica s'hante gjë hiç.

Ashtu si çdo familje që bën buxhetin dhe parashikon të ardhmen, edhe shteti ynë parashikon të ardhmen e atdheut, harton plane për të mirën e popullit, ndërton dhe zhvillon ekonominë, lufton për të ngritur gradualisht nivelin e jetesës e të kulturës së tij. Ky zhvillim progresiv i ekonomisë dhe i jetës sonë, që bëhet në mënyrë të vazhdueshme, të pandalshme e të sigurt, garanton pavarësinë e vendit tonë, sepse rrit aftësinë mbrojtëse të Republikës sonë Popullore.

Populli ynë e di se shpenzimet për ato që konsumon dhe ndërton, burojnë nga djersa, nga mundi dhe nga zotësia e tij. Ai është i ndërgjegjshëm dhe, si një trup i vetëm, gjykon sa duhet të shpenzojë sot për konsum, me qëllim që pjesën tjetër ta ruajë për nesër, pse mund t'i vijë ndonjë rrezik, pasi rreth e rrotull ka armiç që shpatat i mbajnë zhveshur. Për këtë arsye populli i ka vënë detyra vetes të krijojë rezerva për rast rreziku. Nuk është ndonjë sekret t'ju them se Shqipëria, si çdo shtet, ka rezervat e saj. Ne bëjmë llogari për të ardhmen, pse nuk mund të ecim «me lugë në brez» si dervishët e moçëm.

Puna e madhe që bëhet te ne për mobilizimin e masave të gjera të popullit, kalit dhe forcon moralisht e fizikisht çdo njeri. Para Çlirimit prefekti, nënprefekti e çdo nëpunës ishin të privilegjuar, po të shkëputur nga populli, pse ishin padronë që e shtypnin atë. Tash Partia i mëson komunistët, kuadrot dhe tërë nëpunësit që të jetojnë me popullin dhe ta ndiejnë veten shërbëtorë të tij. Për këtë arsye një muaj në vit çdo nëpunës bën punë në prodhim, punon me kazmë ose me çekiç bashkë me punëtorët e me fshatarët. Edhe ata

që gabojnë në punë e sipër, Partia i dërgon për t'u riedukuar në gjirin e masave, i fut në mengenenë e klasës punëtore, që «të lajnë» një herë kokën, pastaj të kthehen prapë atje ku kanë qenë ose në ndonjë vend tjetër; jo të shtrihen në kolltuk, po të shkrihen në punë. Puna e zyrës tani në Shqipëri ka për qëllim t'i shërbejë bazës, popullit. Puna në zyrë është, si të thuash, «sa për të marrë zjarr», siç thoshim gjatë llodrave kur ishim të vegjël, i kujtohet Hulos. Udhëheqja e Partisë dhe e shtetit është edhe ajo kurdoherë në punë bashkë me popullin. Këto forma pune dhe lidhjet me popullin i kalitin njerëzit, edhe pleqtë i përtërijnë.

Ju motra e vëllezër duhet të dini se Shqipëria qëndron e fortë edhe ushtarakisht. Në qoftë se armiqtë do të guxojnë të na godasin, do ta pësojnë keq; ata do të thyhen me siguri, pse, siç e kemi treguar gjatë gjithë historisë, ne jemi një popull i fortë, kurse tash, sikurse e përmenda në fillim, jemi akoma më të fortë sesa përpara, sepse nuk jemi vetëm, po kemi edhe shumë aleatë, me ne janë popujt e tërë botës. Ne dimë se qeveria e Argjentinës ose e Brazilit nuk na duan, po populli dhe komunistët argjentinës ose brazilianë janë me ne; edhe pse administrata amerikane, me Niksonin, Hiksonin ose Uiksonin në krye, është imperialiste, po të na ngjasë gjëkafshë neve në Shqipëri, populli demokrat amerikan do të jetë me ne, do të mbajë anën e popullit tonë që lufton për mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë së tij. Vendi ynë sot nuk është më një vend i tillë që mund të merret nëpër këmbë, siç merrej më parë. Aftësia e tij mbrojtëse është e madhe dhe kjo i detyrohet popullit dhe Partisë.

Në këtë 25-vjetor të Çlirimit të Atdheut dhe të fitores së revolucionit tonë popullor, që festuam së bashku, ju i patë vetë rezultatet e luftës sonë të madhe popullore.

U gëzuam shumë që na erdhët për festë, motra dhe vëllezër. Ne nuk do t'i harrojmë kurrë luftën, ndihmën, vështirësitë, shpresat dhe dëshirat tuaja të zjarrta për mëmëdheun, kudo që jeni. Ka disa nga ju që rrojnë në mërgim e nuk kthehen dot në atdhe, për shkak të lidhjeve familjare etj., që kanë krijuar atje; ka të tjerë, që mund dhe dëshirojnë të kthehen, po atje ku jetojnë u nxjerrin pengesa. Ne i kuptojmë të gjitha shkaqet, por jemi të bindur se një ditë drejtësia e shqiptarëve patriotë jashtë atdheut do të fitojë me doemos. Këtë bindje e kemi shprehur edhe në momente të vështira, kur vetë horizonti i Shqipërisë ishte akoma i errët dhe shumë qeshnin me ne «kalamanët». Atëherë ne i kërkonim botës të na besonte, duke shpjeguar arsyet ku i bazonim parashikimet që shpejt u vërtetuan. Tash jemi të sigurt se kauza e shqiptarëve që vuajnë jashtë atdheut do të fitojë edhe ajo. Në këtë drejtim është vendimtare vetë lufta e tyre.

Të dashur shokë, më thanë që disa nga ju do të largohen. Na vjen keq që largoheni kaq shpejt, sepse dëshironim të rrinit akoma për t'i parë të tëra krahinat e atdheut. Megjithatë Shqipëria është atdheu juaj, kthehuni përsëri kur të gjeni kohën e volitshme; të tjerëve, që do të qëndrojnë akoma më shumë dhe do të na nderojnë edhe më me praninë e tyre, do t'u japim mundësi të bëjnë shëtitje të tjera.

Me këtë rast ju uroj juve, familjeve tuaja e gjithë vëllezërve, motrave, shokëve e miqve shqiptarë në

vendet ku jetojnë, shëndet të mirë! U çoni atyre të fatat dhe dashurinë e madhe të popullit, të Qeverisë, të Partisë sonë dhe të miat personalisht. Ju ftoj ta ngremë këtë doli për shëndetin tuaj, për shëndetin e popullit shqiptar, për shëndetin e Partisë së Punës të Shqipërisë!

Këtë shokun¹ e kemi një patriot të shquar nga Kosova, nga vëllezërit tanë heroikë që rrojnë e luftojnë në Jugosllavi. Populli kosovar, siç e dini, nuk ndahet nga Shqipëria në sa ndahet mishi nga thoi.

E Jakup², si t'u duk Shqipëria?

JAKUP MAHMUTI: Faleminderit për gjithçka, shoku Enver. Unë nuk mund t'i tregoj dot ato që kam parë. Kam 49 vjet që jam larguar nga Shqipëria, po ato që pamë me sy janë me të vërtetë mrekulli që janë bërë në sajë të Partisë dhe Tuajën, shoku Enver. Me ato që kanë bërë rinia dhe populli, është e sigurt që Shqipëria do të ecë përpara. Ata që na kanë inat, le të vijnë të shikojnë, po të duan.

SHOKU ENVER HOXHA: Ashtu është, Shqipëria ecën dhe do të shkojë edhe më përpara. Ju faleminderit shumë për ato që na thatë.

Po ti, Hulo, sa vjet kanë shkuar që s'ke qenë në Shqipëri?

HULUSI KAVO: Kam 33 vjet, që në vitin 1936.

ASIM LULO³: Unë kam gjysmë shekulli, shoku Enver.

1 Rexhep Duraku, që ishte ulur pranë shokut Enver Hoxha.

2 Përfaqësues i kolonisë shqiptare në Francë.

3 Emigrant ekonomik në SHBA.

SHOKU ENVER HOXHA: O, sa shumë! Domethënë ke parë ndryshime të mëdha.

ASIM LULO: Përveç disa maleve që njoh, çdo gjë tjetër ka ndryshuar, por ndryshime unë shoh edhe në njerëzit, s'është më ai popull që lashë njëherë, të tërë janë të gëzuar, të qeshur, të vendosur.

SHOKU ENVER HOXHA: Domethënë, ato që thashë janë të vërteta. (*Duartrokitje nga të gjithë të pranishmit.*)

Po ju, sa vjet ka që s'keni qenë në Shqipëri?

ILJAS SADIKU: Kam 33 vjet. Unë jam nga Matohasanaj i Tepelenës. Shqipërinë e gjetëm shumë mirë, shumë të pasur, ndryshe nga ç'dëgjonim jashtë. Shpatet e maleve të Tepelenës, për shembull, që dikur ishin plot me driza e ferra, tani janë sistemuar e janë pyllëzuar. U habita kur pashë dritë elektrike në Matohasanaj, ku më parë për ndriçim përdornim pishën ose kandilin. Kur dëgjonim jashtë për përparimet e mëdha të Shqipërisë, habiteshim, bile nuk na besohej, por tani që i pamë me sytë tanë, jemi mjaft të gëzuar. Rrofshi Ju në krye të popullit, rroftë edhe populli shqiptar! Vërtet jemi larguar me trup, por me shpirt dhe me zemër jemi kurdoherë pranë jush.

SHOKU ENVER HOXHA: Faleminderit shumë. Ju jeni nga shqiptarët e mërguar në Argjentinë?

OSMAN KASEMI¹: Po. Gëzohemi shumë për ato që po shohim në atdheun tonë. Unë jam larguar nga Shqipëria në vitin 1928, që kur isha 16 vjeç. Ju e dini

¹ Përfaqësues i shoqërisë «Skënderbeu» të Argjentinës.

përse kemi vajtur ne në mërgim. Tani që erdhi rasti të marrim pjesë në këtë festë madhështore, jemi shumë të gëzuar për të gjitha këto ndryshime që pamë në atdheun tonë dhe ju premtojmë se do të punojmë si patriotë me gjakun tonë, dhe kurdoherë, deri në vdekje, do të jemi me atdheun tonë të shtrenjtë, me Republikën Popullore të Shqipërisë.

SHOKU ENVER HOXHA: Faleminderit shumë, ju na jepni forca me ndjenjat tuaja kaq të pastra e të larta.

HULUSI KAVO: Shoku Enver, ato që pamë këtu mendoj që s'është nevoja t'i përsëritim, se ju i keni bërë vetë. Rëndësi ka që këto t'i themi atje ku jetojmë.

ELPINIQI FRASHËRI: Shoku Enver, të them edhe unë dy fjalë.

Në radhë të parë, ju falënderojmë nga zemra për nderin e madh që na bëtë, duke na ftuar përsëri në atdheun tonë të dashur; mandej ju falënderojmë për të gjitha këto gjëra të mëdha dhe madhështore që janë ndërtuar këtu, të cilat, po të mos i shikonim me sy, nuk do t'i besonim. Janë bërë gjëra të tilla që as mund të ëndërroheshin të bëheshin për shumë kohë e jo më për 25 vjet, bile as 25 vjet nuk janë, sepse vitet e para të Çlirimit kaluan me punët për rindërtimin e shkatërrimeve të luftës, pra këto janë vetëm 12-20 vjet pune, prandaj është me të vërtetë diçka e mrekullueshme kjo që është bërë në Shqipëri.

Unë largohem këtë radhë jo vetëm me kënaqësi për veprat që pashë në atdheun tonë, të cilat janë shumë të mëdha, por edhe me disa koncepte të reja që më kanë bërë përshtypje të madhe në mendjen time. Kon-

ceptet e reja me të cilat unë largohem nga Shqipëria këtë radhë, janë:

E para, për fjalën «punë», e cila, siç e kuptoj unë, është fjala më e nderuar në gjuhën shqipe. Sigurisht, me anën e punës janë krijuar të gjitha këto vepra që nuk mund t'i numërosh dot një nga një.

E dyta, mbase nuk po i radhit mirë, për emancipimin e gruas. Habitem që gruaja shqiptare ka arritur gjer në këtë shkallë zhvillimi që shohim. Më parë numëroheshin me gisht ato gra që merrnin pjesë në punë, kurse sot shikojmë gratë të jenë mjeke e inxhinierë, ato marrin pjesë në çdo hap të jetës, prandaj na mbushet zemra me krenari për ato që ka arritur gruaja shqiptare. Dhe ajo që më bëri përshtypje të madhe është modestia e shquar e tyre. I pashë gratë dhe vajzat shqiptare inxhinierë të afta, të cilat shpjegonin me zotësi të madhe teknike proceset e ndryshme të prodhimit. Modestia vihet re që te shoqja Nexhmije Hoxha, të cilën e pashë në mes të popullit. Po të mos më kishte thënë një shoqe «Kjo është shoqja Nexhmije», unë nuk do ta dalloja, sepse ajo ecte midis të tjerave. Kur e takova, bisedova me të dhe, siç u kam thënë edhe tjetër herë shokëve, më vinte nga një anë krenari dhe, nga ana tjetër, qëndrimi i saj ishte një mësim për ne, një mësim shumë i vyer dhe këtë e shikojmë te gratë e vendit tonë, të cilat shkojnë përpara me një qartësi e zotësi të madhe.

E treta, për luftën kundër zakoneve prapanike. Kur shkuam në Hekurudhën Elbasan-Përrenjas, na bënë përshtypje shumë të madhe ato që pamë atje. Midis të tjerave, të rinjtë thërritnin: «Rini heroike,

zhduk zakonet prapanike!». Përgjithësisht këtu vihet re se njeriu është transformuar. Të gjitha këto, rrugët, shtëpitë etj., ndërtohen, po për të ndërtuar njeriun e ri është një punë e vështirë. Dhe në këtë drejtim është bërë një punë shumë e madhe, prandaj njerëzit kanë ndryshuar. Ju keni bërë një punë shumë të madhe për të lartësuar gruan dhe rininë shqiptare. Po të flasim në mënyrë simbolike, unë do të thosha se Shqipëria në të kaluarën i përngjante një gjiganti të madh që kishte rënë në gjumë të thellë dhe në errësirë, i lidhur me zinxhirë, kurse sot ai është zgjuar, ka këputur zinxhirët e po ecën dhe është i sigurt se do të marshojë përpara.

Ju falënderojmë që neve, të mërguarve, na keni dhënë shkak të mburremi me këto që janë bërë dhe po bëhen në atdheun tonë.

Rroftë sa malet populli heroik shqiptar së bashku me Ju në krye, shoku Enver!

TALAT SHEHU: I dashur shoku Enver, do të them shok jo vetëm se kështu përdoret kjo fjalë në Shqipëri, por edhe pse bashkë kemi qenë shokë të vjetër. Unë kam ardhur tri herë në Shqipëri. Herën e parë pashë gjëra të mira, kurse herën e dytë pashë gjëra edhe më të mira, ndërsa sot po shikoj gjëra akoma edhe më të mira se dy herët e tjera. Këto na bëjnë të afrohem me shumë me vendin tonë, me njerëzit tanë, me Ju si udhëheqës të këtij vendi, prandaj them: Ju lumtë juve që po bëni punë kaq të mëdha! Unë kam besim se frytet që po mblidhni sot, në të ardhmen do të jenë shumë më të mëdha, prandaj nga zemra them:

Rroftë Partia e Punës! Rrofshi Ju, shoku Enver!
Rroftë populli shqiptar!

Në fund, midis duartrokitjesh të zjarrta, shoku Enver Hoxha u përqaftua përzemërsisht me vëllezërit e mërguar dhe u nda me ta.

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 533

Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 533

**ARDHJA NË JETË E NJË NJERIU TE NE SHTON
GËZIMIN PËR MËMËN, PËR FAMILJEN,
PËR GJITHË SHOQËRINË**

*Letër drejtuar punëtores së ndërmarrjes bujqësore
«Gjergj Dimitrov», Lije Xhaja*

11 dhjetor 1969

E dashur shoqja Lije,

Mua dhe Nexhmijen na gëzoi shumë lajmi i lindjes së fëmijës suaj, por pasi kam qenë mjaft i zënë me rastin e festave të mëdha, më fal për përgjigjen me vonesë. Me këtë rast vijmë të dy t'ju sjellim urimet tona më të nxehta!

Ardhja në jetë e një njeriu te ne shton gëzimin në radhë të parë për mëmën që lind dhe përtërin jetën, ndjenjë kjo që ti, shoqja Lije, ke pasur kënaqësinë ta provosh për të dymbëdhjetën herë, por njëkohësisht lindja gëzon familjen dhe gjithë shoqërinë tonë socialiste. Aq më i madh bëhet ky gëzim në rastin tënd, që i ke dhënë atdheut dymbëdhjetë filizë të rinj, të cilët nesër, si pasardhësit e denjë të brezit që po çelikos Partia, do ta çojnë edhe më përpara çështjen e ndërtimit të socializmit dhe të komunizmit në Shqipëri.

Dëshirojmë, me këtë rast, të të përgëzojmë me gjithë zemër edhe për faktin se ti, shoqja Lije, megjithëse nënë e shumë fëmijëve, nuk u mbylle brenda katër mureve të shtëpisë, por ke vazhduar të japësh

kontributin si qytetare e republikës edhe në frontin e madh të ndërtimit të socializmit, duke qëndruar në ballë të punës në prodhim, si dhe në kryerjen mirë të detyrave shoqërore që të janë ngarkuar, pa lënë pas dore detyrën e madhe si nënë dhe si një amvisë e mirë. Të lumtë, motër e dashur, që me vullnetin tënd të fortë i ke përballuar me sukses të gjitha punët që të janë ngarkuar, duke vënë kështu në jetë si duhet mësimet e Partisë sonë të dashur!

Megenëse na ke nderuar me kërkesën për t'ia vënë emrin birit tuaj të vogël, mendojmë që ai të mbajë emrin e djalit tonë më të madh, Ilirit, prandaj, po të jeni dakord me bashkëshortin dhe me fëmijët, bashkë me Nexhmijen ju urojmë që ta gëzojë dhe të bëhet, sig na e do zemra të gjithëve, një qytetar i ndershëm dhe ushtar besnik i Partisë, ashtu si dhe prindërit e tij! Si kujtim po ju dërgojmë për vogëlushin edhe një dhuratë të thjeshtë.

Duke përfunduar, shoqja Lije, të urojmë ty edhe një herë gëzim e lumturi në familje, shëndet, suksese gjithnjë e më të mëdha në punë dhe si aktiviste shoqërore! Gjithë të mirat u urojmë, gjithashtu, bashkëshortit tënd dhe të dymbëdhjetë fëmijëve!

T u a j t

Enver Hoxha
Nexhmije Hoxha

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 298 (6650), 14 dhjetor 1969

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i popullit», nr. 298 (6650), 14 dhjetor 1969

TË MBROHEN ME VENDOSMËRI INTERESAT SOVRANË TË REPUBLIKËS DEMOKRATIKE GJERMANE

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

14 dhjetor 1969

Krijimi në zemër të Evropës i të parit shtet të punëtorëve dhe të fshatarëve gjermanë, i Republikës Demokratike Gjermane, është një nga ngjarjet më të rëndësishme të periudhës pas Luftës së Dytë Botërore. Ajo shënoi një kthesë në historinë e Evropës, sepse iu dha një grusht i rëndë forcave reaksionare, kundërrivolucionare të militarizmit e të revanshizmit agresiv gjerman dhe imperializmit në përgjithësi. Populli shqiptar, Partia dhe Qeveria e tij kanë vlerësuar kurdoherë lart krijimin e Republikës Demokratike Gjermane. Ata kanë parë në të realizimin e aspiratave e të përpjekjeve të forcave të shëndosha të popullit gjerman për zhvillimin e tyre të lirë demokratik, përparimtar e socialist dhe kanë mbrojtur kurdoherë çështjen e saj të drejtë kundër kompleteve të forcave militariste e revanshiste të Gjermanisë Perëndimore, të

përkrahura e të nxitura nga imperializmi amerikan dhe nga reaksioni ndërkombëtar.

Populli shqiptar, Partia dhe Qeveria e tij gjithnjë kanë përkrahur me guxim të drejtat e RD Gjermane. Ata qëndruan të vendosur e konsekuentë në vendimet e drejta, të marra dikur bashkërisht nga vendet socialiste, për zgjidhjen e çështjes gjermane e të Berlinit Perëndimor dhe kanë qenë gati ta nënshkruanin traktatin e paqes, qoftë edhe vetëm me RD Gjermane, si domosdoshmëri për garantimin e Republikës Demokratike Gjermane, të kufirit Oder-Najse dhe të paqes në Evropë. Krejt i kundërt ka qenë dhe është qëndrimi i revizionistëve sovjetikë dhe i pasuesve të tyre. Vendimet e përbashkëta u harruan. Deklaratat për gatishmërinë e firmimit të traktatit të paqes që bënte dikur Hrushovi, janë kthyer në anekdota. Kurse veprimet kundër interesave sovranë të RD Gjermane po kryhen sistematikisht. Akti i parë i pabesë i klikës revizioniste sovjetike, me N. Hrushovin në krye, ishte vendosja më 1955 e marrëdhënieve diplomatike midis Bashkimit Sovjetik dhe Gjermanisë Perëndimore të Adenauerit. Ky akt u pasua edhe nga veprime të tjera, u pasua nga marrëveshje ekonomike, tregtare, kulturore me Bonin, që kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit. Grupi i Brezhnjev-Kosiginit dhe krerët revizionistë të vendeve të tjera evropiane në politikën e tyre ndaj Gjermanisë Perëndimore gjithnjë e më tepër injorojnë interesat e Republikës Demokratike Gjermane.

Tani ndodhemi para komplotesh e pazarllëqesh të reja, akoma më të rrezikshme, që kërcënojnë seriozisht

fatet e Republikës Demokratike Gjermane. Udhëheqësit revizionistë sovjetikë, klika e Gomulkës dhe shokët e tyre, po e lënë përfundimisht në baltë popullin gjerman dhe interesat sovranë të Republikës Demokratike Gjermane po i përdorin si kapar për t'u afruar me Bonin dhe për të marrë kredi prej tij.

Manovrat e reja politike të revizionistëve kanë lidhje me të ashtuquajturën politikë të re të kancelarit V. Brand për «afrimin me Lindjen». Ç'është kjo politikë? Ajo s'është tjetër veçse politika e vjetër e imperializmit gjermanoperëndimor, që ka për qëllim të gllabërojë RD Gjermane dhe të hapë rrugën për realizimin e qëllimeve të veta revanshiste. Por këto veprime ajo përpiqet t'i arrijë duke ia marrë krahët RD Gjermane, duke hyrë në bisedime me Poloninë, me Bashkimin Sovjetik, me Çekoslovakinë etj., duke i forcuar marrëdhëniet e gjithanshme me këto vende. Këtë «politikë të re», «demokratike» duhej ta drejtonte edhe një kancelar i ri «demokrat». Kështu erdhi në fuqi qeveria e Brandit, që është në mëshirën e 9 votave të liberalëve. Ajo është një vegël e monopoleve gjermanoperëndimore, të cilat do ta mbajnë në fuqi aq kohë sa u nevojitet dhe do ta rrëzojnë kur t'ua dojë puna.

Politika e shpallur nga Brandi për «afrimin me Lindjen» u prit me entuziazëm nga krerët revizionistë sovjetikë e të tjerë. Menjëherë filluan buzëqeshjet dhe politika e Bonit u reklamua nga personalitetet politike dhe nga shtypi revizionist si pozitive e realiste. Udhëheqësit revizionistë sovjetikë hynë të parët edhe në bisedime për pazarllëqe politike. Më 8 dhjetor filluan në Moskë bisedimet sovjeto-gjermanoperëndimore, si

një hap i ri drejt forcimit të lidhjeve midis dy vendeve. Klika e Brezhnjev-Kosiginin u dha kaq rëndësi këtyre bisedimeve, sa që caktoi shefin e diplomacisë sovjetike, ministrin e Jashtëm A. Gromiko, si partner të një ambasadori gjermanoperëndimor. Revizionistët sovjetikë përpiqen ta paraqitin çështjen sikur po bisedojnë me Bonin për të neutralizuar rrezikun e imperializmit amerikan e gjerman në Evropë. Kjo perde u duhet atyre edhe për të justifikuar lëshimet që u bëhen gjermanoperëndimorëve në këto bisedime, koncesionet që u japin në dëm të sovranitetit të RD Gjermane.

Krerët revizionistë të Moskës, duke mbajtur Republikën Demokratike Gjermane nën tutelën e hekurt të tyre, hiqen sikur e mbrojnë atë nga një rrezik eventual i revanshistëve gjermanë. Ata kërkojnë t'i japin përshtypjen popullit të Republikës Demokratike Gjermane se tratativat që zhvillojnë me Bonin kanë për qëllim uljen e tensionit dhe janë preludi i «një të ardhmeje të lulëzuar» të Republikës Demokratike Gjermane, të një bashkimi hipotetik marksist-leninist të të gjithë Gjermanisë. Natyrisht, kjo manovër kup-tohet nga komunistët dhe nga populli i Republikës Demokratike Gjermane, jo vetëm se ata janë të ngritur politikisht dhe ideologjikisht, por edhe se e shikojnë në praktikë që, nën një tutelë të tillë patriarkale të revizionistëve sovjetikë, Republika Demokratike Gjermane jo vetëm politikisht është bërë apendiks i revizionizmit sovjetik, por edhe ekonomikisht ky vend, me një potencial industrial e bujqësor të zhvilluar, është katandisur në një shtojcë, që vepron sipas dëshirave

dhe direktivave të Brezhnjevitet, të Kosiginetit dhe të klifikës së tyre. Kështu janë shkelur ligjet e shenjta të sovranitetit të Republikës Demokratike Gjermane, pavarësia dhe liritë e saj. Në fakt, kur Republika Demokratike Gjermane dëshiron të veprojë në përputhje me dëshirat dhe me interesat e popullit të vet, nga ana e revizionistëve sovjetikë, nga Traktati i Varshavës dhe nga KNER-i i bëhen lloj-lloj presionesh e kërcënimesh të turpshme, të cilat mund të thyhen vetëm me një rezistencë të vendosur në unitet të plotë të një udhëheqjeje të pavarur me popullin përparimtar të Republikës Demokratike Gjermane. Kush orvatet të kërcënojë popullin e Republikës Demokratike Gjermane, siç po bëjnë revizionistët sovjetikë dhe polakë, shpejt ose vonë do të ketë deziluzione të tmerrshme, se populli i Gjermanisë Demokratike nuk është një kope delsh. Ai, i frymëzuar nga mësimet e Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit, me siguri do t'u tregojë vendin të gjithë këtyre matrapazëve të marksizëm-leninizmit dhe të sovranitetit të Republikës Demokratike Gjermane.

Pazarllëqet që po zhvillojnë revizionistët në kurriz të Gjermanisë Demokratike duken sheshit edhe në qëndrimin e revizionistëve polakë ndaj Bonit. Gomulka, në politikën e vet të afrimit me Gjermaninë Perëndimore, tani vë si kusht vetëm njohjen e kufirit Oder-Najse. Por ç'do të thotë të merren garanci për kufirin Oder-Najse pa u nënshkruar traktati i paqes me Gjermaninë dhe pa kërkuar njohjen e RD Gjermane? Kjo do të thotë të tradhtosh interesat sovranë të RD Gjermane. Është e çuditshme për gjithë nje-

rëzimin kur dëgjohet nga këta tradhtarë të marksizëm-leninizmit, që llototitin për mbrojtjen e paqes, se «të nënshkruash një traktat paqeje me Gjermaninë do të thotë të nënshkruash fillimin e luftës së tretë botërore». Në të vërtetë, klikat revizioniste jo vetëm s'janë për paqen, por përgatitin luftën, dhe popujt, siç është rasti i popullit të Republikës Demokratike Gjermane, kërkojnë t'i mbajnë nën thundrën e tyre. Në këtë çështje kaq të rëndësishme vihet pyetja: A duhet të lejohet që, nga njëra anë, të mos njihet Republika Demokratike Gjermane si shtet sovran në gjithë botën dhe, nga ana tjetër, të rritet kredia politike e një shteti revanshist, siç është ai i Bonit? A duhet të shtohet në botë forca e atyre që luftojnë kundër revanshizmit gjerman apo duhet dobësuar? Komunistët e vërtetë dhe gjithë njerëzit përparimtarë që janë kundër luftës, luftojnë me të gjitha forcat që të njihet Republika Demokratike Gjermane si shtet sovran me të gjitha të drejtat, që të nënshkruhet traktati i paqes, qoftë edhe vetëm me Republikën Demokratike Gjermane, nëse qeveritarët e Bonit nuk duan, sepse kjo është në interes të paqes botërore dhe pengesë për revanshizmin gjerman. Ndërsa pseudomiqve të Republikës Demokratike Gjermane, revizionistëve sovjetikë, polakë e të tjerëve, që mendojnë vetëm për interesat e klikave të tyre borgjezo-imperialiste, aq u bëjnë njohja e vërtetë e Republikës Demokratike Gjermane dhe mbrojtja e interesave të saj jetikë.

Politikës «demokratike» të Brandit po i buzëqeshin edhe Husaku i Çekosllovakisë, revizionistët hungarezë e bullgarë. Të gjithë synojnë të përfundojnë marrëve-

shje bilaterale për të siguruar kredi nga monopolet gjermanoperëndimore, të gjithë po turren drejt kësaj koshereje me mjaltë të helmuar. Deri dje revizionistët sovjetikë, ata polakë e të tjerë e akuzonin Republikën Popullore të Rumanisë se po bënte një «krim të madh» që zhvillonte marrëdhënie politike e ekonomike me Gjermaninë Perëndimore. Është e qartë se këto kritika synonin t'u hiqnin të drejtën rumunëve për të zhvilluar vetë bisedime me Bonin, sepse këtë të drejtë duhej ta kishte monopol vetëm patriarku revizionist moskovit, i cili të tjerëve do t'u hidhte ndonjë krodhë. Klika e Brezhnjev-Kosiginit ua ka frikën kontakteve të drejtpërdrejta të satelitëve të saj me Bonin, të cilat mund të çojnë në dezintegrimin e forcave në Traktatin e Varshavës. Dollarët amerikanë dhe markat gjermanoperëndimore kryejnë funksionin e korrupsionit dhe të gërryerjes. Pra, në të gjithë veprimtarinë e revizionistëve sovjetikë e të tjerë nuk ka asgjë marksiste-leniniste, parimore, siç pretendojnë ata, për të mbuluar politikën e tyre tradhtare. Thelbi i politikës së tyre është antimarksist e imperialist. Për ta nuk kanë as rëndësinë më të vogël interesat e popujve. Mos vallë ka rëndësi më të madhe njohja e kufirit Oder-Najse ose hedhja poshtë e Traktatit të Munihut, vepër e gjakatarëve hitlerianë, nga nënshkrimi i traktatit të paqes me Gjermaninë dhe njohja e Republikës Demokratike Gjermane si shtet sovran nga gjithë bota? Ne mendojmë se duke e njohur dhe duke e mbrojtur rëndësinë e dy çështjeve të para, njohja e Republikës Demokratike Gjermane dhe nënshkrimi i traktatit të paqes me Gjermaninë janë të dorës së parë, prandaj

më kot revizionistët sovjetikë, ata polakë dhe Husakët kërkojnë t'i hedhin ujë verës.

Partia jonë ka vënë në dukje me kohë dhe jeta po vërteton rrezikun që paraqitin për paqen dhe për sigurimin në Evropë komplotet imperialisto-revizioniste dhe inkurajimin që u bëhet revanshistëve gjermanoperëndimorë. Ajo ka theksuar më se një herë se kundër këtyre forcave duhet bërë një luftë e vendosur, pa lëkundje. Imperializmi amerikan, imperializmi revizionist sovjetik dhe militarizmi gjermanoperëndimor janë tri kokat e kuçedrës që përpiqet të përpijë popujt dhe vendet e tjera evropiane, t'i robërojë e t'i skllavërojë.

Tratativat e fshehta sovjeto-gjermanoperëndimore janë të lidhura ngushtë me aleancën sovjeto-amerikane, e cila synon të fuqizojë politikisht Gjermaninë Perëndimore, me shpresë se këto dy superfuqi do të mund ta mbajnë këtë deri në fund nën zarin e tyre. Por kjo vështirë të ngjasë dhe imperializmi amerikan e sovjetik, si dhe i gjithë njerëzimi, do të deziluzionohen keq. Nga ana tjetër, nëpërmjet kësaj politike të dyja superfuqitë u bëjnë presion dhe shantazh shteteve të tjera kapitaliste, sidomos në Evropë, por edhe në vise të tjera, që të gjunjëzohen para politikës së tyre të dominimit dhe të heqin dorë nga politika e vet e pavarur. Ja përse këto pazarllëqe e komplete me të drejtë shqetësojnë dhe ka pse të shqetësojnë jo vetëm popullin e RD Gjermane dhe popujt e tjerë revolucionarë, por edhe shtete perëndimore borgjeze, të cilave, megjithëse janë lidhur me relata miqësore me Bonin, nuk u pëlqejnë akrobaci të tilla, që i hapin rrugën re-

vanshizmit gjerman dhe e nxitin atë për aventura të reja.

Të gjithë popujt liridashës, revolucionarët e vërtetë duhet të ngrihen në mbrojtje të Republikës Demokratike Gjermane, të interesave të saj sovranë. Populli shqiptar, Partia e Punës e Shqipërisë, megjithëse kanë divergjenca ideologjike të papajtueshme me udhëheqësit aktualë të RD Gjermane, do ta mbrojnë si gjithnjë e deri në fund çështjen e drejtë të RD Gjermane kundër të gjithë ujqve imperialistë që i vijnë asaj rrotull, që duan ta çojnë në kapitullim e ta gllabërojnë. Populli ynë ka bindjen se populli i RD Gjermane ka nxjerrë mësim nga zhvillimi i ngjarjeve, se ai ka një eksperiencë të hidhur dhe e di mirë ç'është nazizmi gjerman, ç'janë revanshistët e Bonit. Ai ka, gjithashtu, një pasqyrë të qartë që i tregon ç'është revizionizmi sovjetik dhe ç'rrezik paraqitin pazarllëqet dhe komplotet imperialisto-revizioniste kundër RD Gjermane.

Rruga e popullit liridashës gjerman për të shpëtuar republikën dhe fitoret e tij është ajo e treguar nga bijtë e vet të lavdishëm — Marksit dhe Engelsi, nga udhëheqësit e mëdhenj të proletariatit botëror — Lenini dhe Stalini. Miq të vërtetë të Republikës Demokratike Gjermane janë vetëm ata që ndjekin me besnikëri mësimet dhe rrugën e Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit. Nuk mund të jenë kurrë miq të popullit gjerman ata që vetëm me fjalë hiqen si përkrahës të tij, ndërsa me vepra kurdisin manovra dhe thurin komplete kundër interesave sovranë të RD Gjermane.

Populli shqiptar është i bindur se populli gjerman i sheh qartë rreziqet që e kërcënojnë, se ai di ta ndajë shapin nga sheqeri. Çështja e popujve tanë është e përbashkët, ne luftojmë në një front dhe i duam të mirën njëri-tjetrit. Për ne, ashtu si për vetë popullin e Republikës Demokratike Gjermane dhe për të gjithë njerëzit përparimtarë, çështja e Republikës Demokratike Gjermane është e shenjtë. Prandaj u themi komunistëve dhe popullit gjerman se në luftën e tyre të drejtë për mbrojtjen e interesave të atdheut të vet të populli dhe të komunistët shqiptarë do të kenë kurdoherë miq të vendosur e besnikë.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 298 (6650), 14 dhjetor 1969

Botohet sipas tekstit të gazetës «Zëri i popullit», nr. 298 (6650), 14 dhjetor 1969

REALIZIMI I PLANIT KËRKON ORGANIZIM, DISIPLINË, KRIJIMTARI

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

19 dhjetor 1969

Si të gjithë shokët, edhe unë jam dakord me projektplanin që na është paraqitur dhe me vërejtjet që u bënë këtu rreth tij. Tani del detyra që të gjitha këto vërejtje të merren një për një në studim nga Kryesia e Këshillit të Ministrave dhe, në bazë të tyre, të bëhen korigjimet e nevojshme. Pas kësaj punc, plani do të paraqitet në mbledhjen e Qeverisë dhe, kur ajo të vendosë përfundimisht për të, gjithë Partia, organet shtetërore dhe organizatat e masave duhet të mobilizohen për zbatimin e tij.

Është fakt që gjatë zbatimit të planeve tona kemi suksese në të gjitha drejtëmet, por kemi edhe shumë mosrealizime, prandaj në mbledhjen e Qeverisë, që do

1 Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti «Mbi plotësimin e planit të shtetit për vitin 1969 dhe detyrat e projektplanit të zhvillimit ekonomik e kulturor të RPSH për vitin 1970».

të bëhet për planin e vitit 1970, të thirren edhe kryetarët e komiteteve ekzekutive të rretheve. Kjo mbledhje, mendoj unë, duhet t'i shmanget shtruarjes së një mijë e një problemeve, pse një metodë e tillë pune, kur flitet nga pak për të gjitha, i hallakat njerëzit, i ngarkon ata me shumë çështje dhe nuk u jep mundësi të përqendrohen në ato më kryesoret e vendimtare. Në mbledhjen që do të bëhet duhet të shtrohen vetëm disa probleme kyç, që janë shumë të domosdoshme për t'u zgjidhur, kurse çështjet e dorës së dytë e të tretë, që janë të shumta, të lihen t'i zbërthejnë vetë organet përkatëse të Partisë dhe të pushtetit, ministritë etj. Gjatë diskutimit të këtyre çështjeve në mbledhjen e Qeverisë duhet të nxirren mirë të metat dhe dobësitë që ekzistojnë e që pengojnë për zgjidhjen e detyrave kryesore, se përqendrimi te hapja e rrugëve për zgjidhjen e këtyre do të ndihmojë edhe për zgjidhjen e çështjeve të tjera.

Përveç kësaj, kisha edhe disa vërejtje. Këto nuk janë për çështje të reja, por duke studiuar materialin që na është paraqitur, e ndiej të nevojshme t'i theksoj këtu edhe një herë.

Shtimin e fondit të tokës arë e kemi quajtur me të drejtë një detyrë të rëndësishme. Hapja e tokave të reja nisi me entuziazëm të madh, por më pas entuziazmi ra, kjo punë nuk u organizua mirë dhe vazhdohet të mos u bëhet një kritikë serioze të metave që shfaqen në këtë drejtim.

Neglizhenca në hapjen ritmike të tokës gjatë gjithë viteve të këtij pesëvjeçari, natyrisht, e bën të pamundur plotësimin e deficitit në vitin 1970, bile është

problem edhe realizimi i sipërfaqeve që propozohen për këtë vit.

Thuhet me të drejtë se viti 1970 është i ngjeshur me detyra, por kjo nuk do të thotë që mosrealizimet e viteve të mëparshme në hapjen e tokave të reja të merren lehtë e të kalohen me justifikime. Në qoftë se njerëzit nisen për të gjetur justifikime dhe jo për të gjetur e për të hapur toka të reja, është më mirë të mos e gënjejnë veten me shifra. Shifrat të përpiqemi t'i kthejmë në realitet.

Ministria e Bujqësisë është përgjegjëse që ndër-marrjet bujqësore nuk e realizuan planin e hapjes së tokave të reja. Në qoftë se pranojmë shifrat që propozohen tani, dhe unë jam dakord që këto të pranohen, duhet të organizohet në kulm dhe pa humbur kohë puna e krahut dhe e mekanizmave. Të mos lejohet që fshatarësia të punojë nga katër orë në ditë dhe pastaj oburra të mbyllim shkollat, universitetin e institutet, t'i bëjmë thirrje ushtrisë etj. që të venë të punojnë për të. Të evitojmë iniciativat e kota për propagandë e për bujë dhe t'i përvishemi seriozisht punës, ndryshe tokat e planifikuara nuk do t'i hapim dot.

Sipërfaqet e mbjella, veçanërisht me bimë të arave, asnjëherë nuk po realizohen, kurse shpjegimet që jepen për këtë nga Ministria e Bujqësisë janë, si të thuash, anarkike ose të rastit. Këto mosrealizime vijnë, natyrisht, për arsye të shumta objektive dhe subjektive, që duhen mbajtur parasysh gjatë hartimit të planit, pa absolutizuar as njërin, as tjetrën kategori. Ky problem, mendoj unë, është me rëndësi të madhe, pse pikërisht këto dy kategori arsyesh, që secila ka një ga-

më çështjesh në gjirin e saj, e bëjnë realizimin e planit të bujqësisë të lëkundshëm dhe jo aq të sigurt sa atë të industrisë. Prandaj, nga zhvillimi dhe nga çdo ndryshim në procesin bujqësor, lypset të nxirren konkluzione të vazhdueshme jo vetëm të natyrës së thjeshtë agrare, por edhe të leverdisë ekonomike, financiare dhe materiale, duke i llogaritur këto me prodhimet konkrete. Për ekonominë tonë kjo ka rëndësi të madhe për të përballuar deficitet që krijohen.

Plani ynë bujqësor bëhet në bazë dhe koordinohet në qendër, e cila i jep bazës edhe para, edhe pas orientimet kryesore. Gjatë hartimit të planit në bazë vepron, si në të gjitha çështjet e tjera, lufta e të kundërtave, lufta midis interesit personal dhe atij të përgjithshëm, midis interesit të planifikimit të një kooperative dhe atij të një kooperative tjetër të rrethit, interesit të të gjithë ekonomisë së rrethit e të ekonomisë socialiste në përgjithësi. Në qoftë se Ministria e Bujqësisë nuk i ndjek me kujdesin më të madh shkencor rreth më rreth e kooperativë më kooperativë këto zhvillime dhe këtë luftë, për të nxjerrë prej tyre mësimë e konkluzione, të cilat t'ia japë bazës si direktiva të përpunuarra, atëherë do të bëhen plane rutinë mbi shifra, do të gjykohen këto shifra mbi të dhëna të përgjithshme, shpesh të përhershme e të pandryshueshme për disa kategori çështjesh, qofshin ato objektive ose subjektive. Natyrisht, në një raport si ky që na paraqitet nuk mund të trajtohen të gjitha këto, por unë nuk kam parë deri tani nga Ministria e Bujqësisë, megjithëse ajo mund të ketë bërë, ndonjë studim me konsiderata të tilla.

Ne, sikurse thuhet edhe në raport, mund të numërojmë shumë arsye e të themi shumë gjëra për faktin që në asnjërin nga llojet e bimëve bujqësore nuk janë arritur rendimentet e planifikuara, por ministria na thotë vetëm një, që «Bimëve nuk u shërbehet për lufimin e sëmundjeve». Kjo nuk është serioze! Natyrisht, ne nuk duam që ministri i Bujqësisë të na numërojë këtu gjithë pikat e Kodit Agroteknik, por do të dëshironim (dhe kjo do të ishte e nevojshme dhe e dobishme për punën), që ai të na fliste për disa nga shkaqet kryesore të të metave objektive dhe subjektive, të fajeve dhe të gabimeve të vërtetuara, që të marrim masa t'i ndreqim. Në raportin që na është paraqitur s'gjen asnjë fije kritikë, pale autokritikë, në të parashtrohen vetëm shifrat e barazuara, shumë rrallë bëhet ndonjë koment, duke thënë se është plan i ngjeshur, duhet mobilizim dhe kërkohet nga ne që të vendosim.

Nuk them ndonjë gjë të re duke theksuar që çështja e bujqësisë është me rëndësi shumë të madhe për ekonominë tonë. Kushtet për zhvillimin e bujqësisë te ne kanë ndryshuar si nata me ditën në krahasim me të kaluarën. Ajo tani është një bujqësi socialiste e përparuar, për të janë bërë dhe po bëhen investime të shumta etj. Nuk kam për qëllim të zgjatem duke numëruar të gjitha kushtet e krijuara, por dua të them që, duke u mbështetur realisht në këto kushte, Partia dhe pushteti popullor, organizatat-bazë të Partisë nëpër kooperativa dhe kooperativistët, me ndërgjegje të plotë duhet t'i bëjnë pyetjen vetes: A i shfrytëzojmë ne si duhet të gjitha mundësitë e shumta që na janë krijuar, a punojmë dhe e organizojmë punën si duhet

dhe a prodhojmë si duhet dhe aq sa duhet? Kësaj pyetjeje ata të mos i përgjigjen me autokritikë boshe, por me organizim më të mirë, me disiplinë të fortë në punë, me krijimtari, me lodhje e me sakrifica. Ky është një problem i tërë, i madh, me komponentë të shumtë, që Partia dhe pushteti e kanë hedhur me kohë në fushat e veprimt. Të gjitha pjesët përbërëse të këtij problemi të madh janë në zhvillim, në stade të ndryshme zhvillimi dhe zgjidhjeje, por asnjë nuk është në zgjidhje të plotë, prandaj mendoj që duhen kapur fort të gjitha hallkat e këtij zinxhiri të madh.

Ashtu si të gjithë shokët, edhe unë jam kundër planeve irrealë, që hartohen sipas dëshirave. Planet tona, dhe veçanërisht ato për bujqësinë, ku është shumë më e zorshme se në industri të parashikohen me përpikëri të gjitha të dhënat e problemit, duhet të jenë reale. Ato të mbështeten tërësisht në kushtet e krijuara dhe në punën tonë, që të mos mbulohet mosrealizimi i tyre me arsyet e «kohës me shi» apo të «kohës së thatë», kur çdo vit e më shumë ne shtojmë mekanizimin, ujitjen, sistemimin e tokave, plehrat kimike, organike, farërat e zgjedhura, kuadrot e mësuar etj., etj.

Gjithashtu nuk jam për planifikimin e rendimenteve ekstravagante të bimëve bujqësore, por ne me doemos të kërkojmë që të arrihen rendimentet më të larta që janë marrë më parë nga një skuadër, brigadë apo kooperativë. Pikërisht për këtë rezultat real, faktik, që e kemi përpara syve tanë, të luftohet me të gjitha mënyrat që të arrihet jo vetëm nga një brigadë, po nga të gjitha brigadat e së njëjtës kooperativë dhe

jo nga një kooperativë, por nga të gjitha kooperativat tona.

Mosrealizimi i planeve bujqësore duhet të sëkëll-disë pa masë jo vetëm qendrën, por gjithë Partinë dhe punonjësit e bazës, të cilët duhet të bëhen plotësisht të ndërgjegjshëm se një gjë e tillë i shkakton dëme serioze gjithë ekonomisë kombëtare, çështjes së mbrojtjes; ajo ul nivelin e jetesës së popullit dhe bën që të mos financohen në rregull e në kohën e duhur, ose të lihen për më vonë disa investime në sektorë të tjerë. Prandaj të luftojmë euforinë pa baza dhe të kënaqurit me pak. Askush s'duhet të kërkojë t'i vijë diçka, kur vetë nuk prodhon dhe nuk e çon ku duhet atë që ka për detyrë ta prodhojë në kohë, në sasi dhe në cilësi. Partia e ka për detyrë të parë që njerëzit, të cilët «fluturojnë në Hënë», t'i bëjë të ecin me tru në kokë dhe me këmbë mbi tokë.

Le të marrim tani disa çështje të veçanta. Në qoftë se pranojmë shifrat që na janë paraqitur në raport për hapjen e tokës arë, atëherë arritja e tyre kërkon një organizim të fortë të kooperativistëve dhe të mjeteve të mekanizuara. Në qoftë se themi që për këtë do të mobilizohet e do të ndihmojë edhe qyteti, dëshiroj të tërheq vëmendjen që kjo çështje të mos na vërë në gjumë. Punonjësit e qytetit dhe rininë ne duhet t'i mobilizojmë dhe po i mobilizojmë, por të mos harrojmë se ata nuk i mbajnë duart lidhur, nuk janë pa punë që t'i dërgojmë kur të duam për të hapur toka të reja. Jo, këta janë të zënë deri në grykë me detyra, punojnë, mësojnë e stërviten ushtarakisht.

Nuk duhet të lejojmë punë anarkike, por ta orga-

nizojmë mirë fshatarësinë, që kooperativistët të shfrytëzojnë si duhet ditën e punës. Të lësh shkollën, fabrikën apo stërvitjen ushtarake dhe të shkosh për të hapur toka të reja, kur kooperativisti nuk e shfrytëzon mirë kohën, një gjë e tillë nuk mund të pranohet.

Gjithashtu nuk mund të pranohen shfajësimet pa baza për mosmbajtjen në eficiencë të plotë të mekanizmave të bujqësisë. Vetëm duke parë rritjen e shifrave të prodhimit të drithit, del sa shumë duhet të bëjmë në këtë drejtim. Shtesa e prodhimit do të vijë nga ngritja e rendimenteve, por edhe nga rritja e sipërfaqes së tokës arë. Prandaj këtu, për të mos folur për të tjerat, kemi detyra organizative dhe politike shumë të mëdha.

Dëshiroj të them disa fjalë edhe për sigurimin e ushqimit të bagëtive, problem ky që u prek shumë nga të gjithë shokët që diskutuan. Sipas mendimit tim këtij problemi vazhdohet të mos i vihet rëndësia e madhe që ka. Për ushqimin e bagëtive flitet e flitet, jepen edhe shifra, por pavarësisht nga masat e marra dhe nga disa rezultate të arritura, më shumë shitet mend, sesa bëhet një punë e mirë dhe e kualifikuar. Shumicën e lopëve në vendin tonë e kanë oborret kooperativiste, pra edhe shumica e qumështit, e mishit dhe e gjalpit merret andej. Por, megjithëse është shtruar shpesh problemi i ushqimit të tyre, kooperativat, vetëm për arsye se këto lopë janë të oborreve, nuk bëjnë asnjë përpjekje për zgjidhjen e tij dhe, si rrjedhim, rendimentet që merren nga këto bagëti janë përtokë. Kjo nuk është aspak ekonomike për republikën! Kur s'ka qumësht kooperativisti, s'ka as republika.

Por kooperativat bujqësore, në vend që të vrasin mendjen për ushqimin e të gjitha bagëtive, janë akoma shumë larg edhe nga sigurimi plotësisht i ushqimit për vetë bagëtitë e tyre. Ky problem tani duhet parë me një sy krejt ndryshe, si një problem *sine qua non* për bujqësinë e përparuar dhe, po të shihet kështu, atëherë çështja e ushqimit të bagëtive do të zgjidhet në rrugë të drejtë, shkencore, baza ushqimore do të sigurohet në sasi dhe në lloje, me përmbajtje të lartë ushqyese. Aktualisht bagëtitë lëshohen në kullota, ku «të hanë ç'të hanë», «të hanë sa të hanë» dhe më në fund «të japin sa të japin», mjafton që të ruhet numri i krerëve. Kjo formë duhet luftuar jo vetëm në kooperativat, por edhe te të gjithë punonjësit dhe drejtuesit e ndërmarrjeve bujqësore, të cilëve nuk u lejohet të mos i zbatojnë rregullat agroteknike dhe vendimet e marra, në një kohë kur mundësitë objektive dhe subjektive në këto ndërmarrje janë shumë më të mëdha se në kooperativat bujqësore.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

QË TË FORCOHET DISIPLINA, KRAHAS PUNËS IDEOPOLITIKE, TË ZBATOHEN ME RREPTËSI EDHE RREGULLAT NË FUQI

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

20 dhjetor 1969

Në përgjithësi jam dakord me raportin e paraqitur dhe me diskutimet e shokëve. Uzinat ushtarake, punën e të cilave marrim në shqyrtim, janë të reja, me një organizim të fortë dhe kanë përparime, vetëm dua të theksoj se organizatat-bazë të Partisë atje duhet të ngulin këmbë më shumë në disa çështje organizative, sidomos në forcimin e disiplinës në punë. Këtu u parashtruan disa mendime për mundësitë e një kooperimi më të mirë të uzinave ushtarake me ndërmarrjet e tjera të industrisë shtetërore, të cilat, duke qenë më të vjetra, kanë më shumë eksperiencë në këto çështje.

Në uzinat ushtarake, ku kuadrin e kemi të ri nga

1 Në këtë mbledhje u shqyrtua puna e Partisë për edukimin ideopolitik të punëtorëve në uzinat ushtarake.

profesioni dhe nga mosha, nuk është aspak mirë të na vërtetohen mungesa në disiplinën e punës, në ndjekjen e shkollave dhe të kurseve, në vendosjen e normimit të punës etj. Në qoftë se punëtorët atje janë lënë për një periudhë kohe të punojnë pa normë, kjo të mos ekzagjerohet, po të vendosen sa më parë normat, të cilat të perfeksionohen vazhdimisht, duke kaluar nga një formë norme në një formë tjetër më të përparuar. Të metat në këtë drejtim flasin për dobësi të punës së organizatave të Partisë dhe të drejtorive të këtyre uzinave, të cilat nuk kanë kuptuar si duhet jo vetëm rëndësinë që ka dhe do të ketë mekanika në industrinë tonë, por as përgjegjësinë e madhe që kanë ato për edukimin e mekanikëve të rinj, që do të marrin në duar mjetet kyç të industrisë.

Në të katër anët e vendit tonë po ngrihen uzina mekanike me makineri dhe me teknologji moderne, ku është drejtuar e do të drejtohet për të punuar rinia, që ka lindur dhe është edukuar pas Çlirimit. Ashtu si punëtorët, edhe mjeshtrit e inxhinierët që kemi në këto uzina militojnë ose në radhët e Partisë, ose në ndonjërin nga organizatat e masave. Të gjithë këta janë njerëz të ngritur politikisht dhe ideologjikisht, të aftë për të kuptuar dhe për të zbatuar me zell, në mënyrë revolucionare dhe me sukses vijën e Partisë, prandaj nuk është e drejtë, ajo që u tha këtu, se punëtorët e ardhur nga fshati për të punuar në uzinat mekanike kanë bërë përparime nga ana teknike, por kanë akoma shumë mbeturina. Të mos harrojmë se mbeturina kanë sa të duash edhe punëtorët e tjerë, bile ata që kanë ardhur nga fshati shumë herë janë më

të disiplinuar në punë se të tjerët, sepse Partia ka punuar me ta edhe në fshat, vetë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet levave të saj. S'ka asnjë dyshim se tani janë krijuar të tëra mundësitë për ngritjen arsimore, profesionale dhe për edukimin e gjithanshëm të punëtorëve të rinj.

Po përse në uzinat tona vërtetohen të metat dhe dobësitë që u përmendën këtu? Unë mendoj se arsyeja kryesore e këtyre dobësive duhet kërkuar te drejtuesit, tek organizimi i dobët i punës, te shfaqjet burokratike në metodën e punës së tyre, te mungesa e besimit në zotësinë, në zgjuarsinë, në forcën organizuese dhe krijuese të rinisë. Drejtuesit e këtyre uzinave mendojnë se ligjet, rregullat, disiplinën në punë i kuptojnë më mirë nga të rinjtë dhe se ata janë «garantë» për zbatimin e mirë të tyre. Kjo nuk është kurdoherë e vërtetë dhe këtë ta kemi mirë parasysh. Shumë herë drejtuesit tregohen tepër të ngurtë, prandaj, gjersa janë të tillë, ata tregohen edhe liberalë ndaj shkeljeve të disiplinës.

Ndodh që drejtuesit e uzinave tona ushtarake druhen nga punëtorët dhe nuk ngrihen me forcë kundër shkeljeve të disiplinës. Këtë ata e bëjnë nga frika se, duke qenë vetë oficerë, mos i akuzojnë për vendosje të një discipline ushtarake. Por kjo nuk ndodh, bile njerëzit që punojnë atje mungojnë pa leje dhe kjo arsyetohet si pa të keq me largësinë e këtyre uzinave. Por sa është kjo largësi? Zakonisht ajo nuk është më shumë se 15 minuta me autobus. Punëtorët e uzinave ushtarake duhet të kenë parasysh se anëtarit të kooperativës bujqësore ka raste që i duhet të ngrihet

që në orën 4^{oo} të mëngjesit dhe të ecë në shi e në borë me shat në krah për të vajtur në vendin e tij të punës, prandaj ata që shkojnë e ikin nga uzina me autobus, në asnjë mënyrë të mos lejohen të venë vonë në punë. Përveç vonesave e mungesave në punë, disa nga punëtorët e këtyre uzinave gjatë punës vërtiten andej-këtej nëpër uzinë. Kësaj, shokë, nuk i thonë disiplinë socialiste, disiplinë proletare. Një disiplinë e tillë nuk pajtohet aspak me normat dhe me ligjet tona, me konceptet filozofike të Partisë sonë. Kjo çështje nuk mund të kuptohet as teorikisht, në qoftë se ne nuk zbatojmë me rreptësi në praktikë ligjet shtetërore lidhur me disiplinën.

Ne nuk mund të pajtohemi me qëndrimin e atyre punonjësve, qofshin këta punëtorë, mjeshtër apo drejtorë, që nuk tregohen të rreptë në zbatimin e disiplinës shtetërore. Kjo disiplinë në vendin tonë socialist nuk ka atë qëllim që ka në vendet kapitaliste, ku shtypet klasa punëtore. Disiplina proletare në punë te ne ka në brendinë e saj një kuptim të madh ideologjik, ajo ka për qëllim edukimin e punonjësve tanë me ideologjinë marksiste-leniniste dhe me virtyte të larta komuniste, sigurimin e një rendimenti të lartë prodhimi, kursimin e shumëve kolosale për shtetin dhe të kohës për vetë punëtorët, krijimin e kushteve për një jetesë më të mirë të popullit. Këto ne i shpjegojmë mirë ideologjikisht dhe politikisht, por, kur vjen puna për t'i zbatuar në praktikë, bëhen shumë lëshime. Bile, ka edhe raste që, kur një drejtor ose mjeshtër lufton për të vënë në jetë disiplinën proletare dhe kërkon llogari, disa njerëz, që nuk e pëlqejnë kërkesën e llogarisë, e

interpretojnë këtë si shtypje nga ana e drejtorit ose e mjeshtrit. Në qoftë se Partia nuk i shpjegon drejt këto qëndrime dhe nuk i mbron këta përgjegjës në rrugë të drejtë, atëherë nuk do të kemi një disiplinë të vërtetë proletare në punë.

Do të sjell shembullin e njërit prej shqiptarëve që na erdhën tani me rastin e festës, i cili ka punuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pasi bëri shumë vizita në Shqipëri, ai shkoi edhe në një fabrikë këpucësh, hyri në të gjitha repartet, deri në mensë e në kuzhinë, ku i treguan bile edhe gjellët, dhe u kënaq shumë nga çdo gjë që pa. Kur vizitoi repartin e makinerive, iu lut një punëtori, të cilin e vuri re me vëmendje si punonte, ta lejonte të punonte pak edhe ai vetë, meqenëse dinte ta përdorte atë makinë, dhe punëtori ynë e lejoi me gjithë qejf. Miku i ardhur nga Shtetet e Bashkuara ia filloi punës me shpejtësi dhe, kur mbaroi procesin, iu drejtua punëtorit tonë me këto fjalë: «Me këtë punë kaq të ngadalshme që bën ti, në Amerikë as supën aq të shijshme, që ti e merr fare lirë në mensë, nuk mund të hash dot tërë ditën e jo më edhe mish e ëmbëlsirë». Po si e mësoi ky shqiptar i thjeshtë e i paditur zanatin në atë vend, ku punëtori shfrytëzohet deri në palcë? Nevoja, uria, metoda zinxhir, metoda «Teilor» e detyruan këtë punëtor të mësonte zanatin. Në qoftë se atje nuk do të punonte me shpejtësi dhe me cilësi, vërtet një palë këpucë do të hidheshin në shportë, por njëkohësisht do të hidhej edhe ai në rrugë të madhe dhe do të vdiste për bukën e gojës.

Krejt ndryshe është te ne në socializëm, ku punëtorët punojnë në kushte shumë të mira, kanë mundësi

të mëdha për të ndjekur me ose pa shkëputje nga puna shkolla e kurse, janë të rrethuar në çdo ambient nga një punë e madhe politike edukative, nga një kujdes i jashtëzakonshëm për ruajtjen e jetës e të shëndetit, e kanë shërimin falas, kanë klube e mensa në qendrat e punës, ku mund të hanë me çmime të lira ushqime të cilësisë së mirë etj. Dhe me tërë këto kushte të mos ketë disiplinë në punë, të shkojë njeriu atje kur të dojë e të largohet kur t'i teket, ta ndër-presë punën 20 herë gjoja për nevoja personale, këto nuk i lejon në asnjë mënyrë as ligji i Partisë, as Kodi i Punës. Për evitimin e këtyre shkeljeve, që të forcohet disiplina, krahas punës ideopolitike, të zbatohen me rreptësi edhe rregullat në fuqi, ndryshe s'e kemi bërë detyrën. Çështje të tilla kanë rëndësi jo vetëm nga ana teknike, por edhe nga ana parimore, prandaj t'i shtrojmë drejt e të jemi të rreptë si në këtë drejtim, ashtu edhe në drejtimet e tjera.

Nga ana tjetër, në një kohë kur duhet të qëndrohet sa më afër punëtorëve dhe të punohet politikisht me ta, oficerët, duke u justifikuar me shprehjen «Nuk jemi anëtarë të bashkimeve profesionale», tërhiqen nga mbledhjet e kësaj organizate që bëhen në uzinat ushtarake. Ky nuk është aspak qëndrim i drejtë. Ç'punë u prishet ushtarakëve, që s'janë anëtarë të bashkimeve profesionale, po të aktivizohen si anëtarë të kësaj organizate, të marrin pjesë edhe ata sa herë bëhen mbledhjet e saj? Mos vallë e quajnë të tepërt, po të punojnë si anëtarë të bashkimeve profesionale? Derisa këta oficerë punojnë nëpër uzina, duhet të rrojnë me kolektivin e punëtorëve, të shkrihen me të, pse sot

janë ushtarakë, kurse nesër mund të largohen nga ushtria dhe të bëhen punëtorë, drejtorë ose përgjegjës repartesh. Në këtë rast ata do të bëhen patjetër anëtarë efektivë të bashkimeve profesionale, por do të kenë eksperiencë, kur të kenë punuar edhe më parë si të tillë.

Punonjësve në ushtri u janë krijuar të gjitha kushtet, s'ka repart ushtarak, sado i vogël qoftë, që të mos ketë, fjala vjen, këndin e kuq, kurse uzinat ushtarake nuk kanë. Kjo na çudit! Mund të flitet në të tilla kushte për një edukim masiv të punëtorëve të rinj në këto uzina? Mund të flitet për një kontroll punëtor mbi këta kuadro dhe këto drejtorë? Kjo do të ishte pak e zorshme, prandaj vetë punëtorët e këtyre uzinave, të udhëhequr nga organizatat-bazë të Partisë, duhet të vënë rregull dhe të organizojnë më mirë edukimin ideopolitik e tekniko-profesional.

Partia duhet të bëjë kujdes të madh dhe të veçantë për edukimin shembullor të të rinjve dhe të rejave që punojnë në uzinat tona mekanike, që ata të edukohen me virtytet më të larta të klasës punëtore. Punëtorët e rinj edhe vetë të kenë parasysh që të bëhen luftëtarë revolucionarë të radhëve të para, politikisht dhe ideologjikisht të ngritur e të kalitur nga çdo pikëpamje. Ky është brezi i ri, që po rritet njëkohësisht me industrinë tonë mekanike, prandaj Partia, Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe ajo e Arsimit dhe e Kulturës të vënë kujdesin më të madh dhe të marrin të gjitha masat që ky brez i ri mekanikësh të ngrihet shpejt dhe në mënyrë të përsosur nga ana tekniko-profesionale.

Të mos harrojmë për asnjë çast rëndësinë e madhe që kanë dhe do të kenë edhe në të ardhmen për vendin tonë industria mekanike dhe mekanikët, dora dhe mendja e të cilëve do të ndihen dhe do të kërkohen kudo, prandaj organizimin e punës në këto uzina, ashtu sikundër edhe në të gjitha uzinat e republikës, duhet ta forcojmë nga çdo pikëpamje. Gjatë viteve të planit pesëvjeçar që po përgatitim, krahas zgjerimit të mëtejshëm të uzinave ekzistuese mekanike, do të ngremë edhe uzina të reja. Mirëpo të gjitha këto punë të mëdha do të kërkojnë edhe kuadro. Kini parasysh, shokë, se këta kuadro do të dalin edhe nga uzinat ekzistuese, prandaj mos e flini mendjen duke thënë se «Neve s'kanë ç'na marrin». Ka edhe uzina që janë relativisht të reja, po edhe ato uzina që ju dhanë juve kuadro, të reja ishin, prandaj për të gjithë del detyra t'i përgatitim kuadrot me kujdesin më të madh dhe me tempin që e lypin nevojat, koha dhe zhvillimi i vrullshëm ekonomik i vendit tonë.

Duhet të kuptohet mirë se shtimi i uzinave mekanike nuk është luks, por një nevojë e madhe dhe urgjente për ne. Megjithëse ato janë shtuar vazhdimisht, akoma nevojat tona, që rriten pa pushim, nuk plotësohen tërësisht. Të gjithë thonë se e kuptojnë këtë situatë, por në shumë uzina vazhdohet të punohet 6 orë e gjysmë deri 7 orë në ditë, kurse kapaciteti i makinerve metalprerëse shfrytëzohet vetëm 60-70 për qind. Po të vritet pak mendja, do të dalë që të tilla anomali ngjasin pikërisht në gjirin e klasës punëtore, tek elementët e kësaj klase, te kuadrot e ushtrisë, te rinia jonë punëtore. Dhe përse na ngjasin? Për mungesë-

së disipline në punë, nga kuptimi jo i drejtë politik i normave socialiste, nga mungesa e seriozitetit për ngritjen sa duhet dhe me zell të kurseve politike, ideologjike dhe teknike.

Këto të meta duhet të zhduken sa më parë nga punonjësit e uzinave mekanike, të cilët të jenë shembull për vete dhe për punëtorët e uzinave të tjera. Unë dhe gjithë shokët e Sekretariatit kemi bindjen e plotë se kështu do të bëhet.

Të gjithë mendojmë se, pavarësisht nga të metat e vërtetuara deri tani në uzinat mekanike ushtarake, ju keni pasur edhe përparime, prandaj vazhdoni më mirë punën dhe urojmë të dilni kurdoherë faqebardhë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

VENDIMI ESHTË SINTEZA E PROBLEMIT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

20 dhjetor 1969

Unë e këndova me vërejtje relacionin ku flitet për punën që duhet bërë për përgatitjen, zbërthimin dhe kontrollin e zbatimit të vendimeve dhe në përgjithësi jam dakord me sa thuhet atje. Megjithëse e kemi shtruar shumë herë, mendoj që këto çështje t'i venë Partisë për t'i pasur parasysh, por kisha edhe disa vërejtje.

Së pari, duhet të tregohet shumë kujdes që të mos kalohet, siç ndodh nganjëherë, sa nga një anë, në anën tjetër. E theksoj këtë se mos tani heqim dorë fare nga raporti dhe i japim rëndësi vetëm vendimit, prandaj është e nevojshme ta kuptojmë më qartë çështjen e vendimeve. Problemi që do të trajtohet në një vendim, duhet të shtrohet më parë drejt dhe qartë, të dalin nevoja e marrjes së vendimit dhe rëndësia e tij politike,

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth punës për përgatitjen, zbërthimin dhe kontrollin e zbatimit të vendimeve.

ideologjike, ekonomike etj. Të gjitha këto duhet të përbëjnë thelbin e raportit, i cili është i nevojshëm. Është tjetër puna që ne duhet të kemi kurdoherë parasysh që raporti të mos jetë ujë. Prandaj kujdesi dhe vlerësimi për raportin duhet të vazhdojnë edhe në të ardhmen, pse ai bën përgjithësimin e eksperiencës së punës të komunistëve dhe të masave në një periudhë të caktuar.

Së dyti, problemi në mbledhje duhet të diskutohet mbarë e mbrapsht, të diskutohen anët pozitive dhe negative të tij, rrjedhimet e mundshme në plus e në minus, lehtësitë ose vështirësitë e mundshme në zbatim dhe si duhen përballuar vështirësitë e ndryshme, të çdo natyre qofshin ato, natyrisht, në vija të përgjithshme. Kjo është e domosdoshme, pse raporti dhe diskutimet e përgatitura me kujdes përbëjnë një fazë të rëndësishme për një analizë sa më shkencore dhe për të marrë vendime sa më të drejta.

Së treti, të parashikohen masat kryesore që duhet të vihen në jetë për zbatimin e vendimit që do të merret (dhe duhet medoemos të ketë vendim), masa organizimi nga më kryesoret dhe veçanërisht ato që kërkojnë kooperim dhe bashkëpunim brenda rrethit, me rrethe të tjera apo me qendrën. Duhet kuptuar mirë se mbledhja e organit udhëheqës ose e organizatës-bazë të Partisë matet me atë se për çfarë ajo vendos, ç'perspektivë i çel punës së Partisë.

Ky proces është i domosdoshëm të bëhet mirë, të kuptohet se është kryesori, se pa e bërë këtë me seriozitetin më të madh, pa e përgatitur si duhet, pa ardhur në udhëheqje i përgatitur me cilësi, çdo gjë do

të dalë e çalë, vetë vendimi do të jetë i zbehtë dhe nuk ka për t'u zbatuar si duhet.

Të kuptohemi, vendimi që do të merret nuk bëhet, siç mund ta kuptojnë disa, për të shpjeguar çdo gjë, deri edhe masën më të fundit që duhet të merret. Ai nuk duhet të shpjegojë hollësisht çdo çështje, nuk duhet të jetë një përsëritje e raportit. Jo, vendimi është sinteza e çështjes, e problemit. Ai është diçka shkencërisht e përmbledhur, e koncentruar, që u kujton të gjithëve problemin që është studiuar, rëndësinë e tij, detyrat kryesore që duhen kryer si dhe kur do të zgjidhen, caqet që duhet të arrihen, si dhe disa nga masat më të rëndësishme që duhen marrë. Këto çështje të përmbajë vendimi.

Shokët instruktorë, në vend që të luftojnë që kjo çështje të zgjidhet drejt në gjithë procesin e vet, bien shpeshherë në pozitat e sekretarëve të organizatave-bazë dhe kam përshtypjen se duan që projektvendimi të përmbajë çdo gjë. Kjo, më duket mua, nuk është e drejtë. Që ne e kemi lënë, ose nuk e kemi praktikuar sa duhet çështjen e vendimeve, kjo është një gjë mjaft negative, të cilën duhet ta ndreqim sa më parë. Prandaj është e nevojshme t'i perfeksionojmë shokët për hartimin e vendimeve, që këto të jenë sinteza e raporteve dhe e diskutimeve që bëhen për problemet që merren në studim.

Kam përshtypjen se në raportin që na paraqitet, përgatitja e vendimit sikur i errëson fazat përgatitore që vijnë para vendimit dhe ky, më duket mua, del si i vetmi kyç i zgjidhjes së problemit. Një kuptim i tillë më duket i cekët. Vendimi ka shumë rëndësi, por, po

të shpjegohet dhe të zërthehet si duhet përmbajtja e tij, po të zgjerohen, të thellohen e të konkretizohen detyrat që janë prekur atje, po të merren masa politike dhe organizative të shumanshme, që në vendim janë shënuar vetëm në parim dhe si detyra, atëherë ai merr rëndësi të madhe. Por njerëzit në përgjithësi u shmangen këtyre gjërave ose nuk përgatiten si duhet për ta bërë punën që thashë më lart në nivelin që kërkohet, duke u kënaqur kështu me leximin e atij farë vendimi dhe vazhdojnë një punë rutinë.

Është e kuptueshme se asnjë vendim nuk mund të dalë dhe të zbatohet si duhet, kur një komitet partie, siç na raportohet, merr në studim 34 probleme në pesë muaj. Mua më duket se po teprohet, dhe ky është rezultati i rikthyerjes në shumë çështje që janë studiuar shumë herë dhe kurdoherë dobët. Një metodë e tillë pune sa e pafrytshme, aq edhe e vështirë, duhet të zhduket nga praktika e punës sonë. Nuk është kurdoherë e domosdoshme, mendoj unë, të merret mendimi i të gjithë komunistëve dhe i masave, kur hartohet një vendim, kurse kur shtrohet dhe diskutohet problemi, atëherë duhet marrë mendimi i tyre, pse në këtë fazë problemi jo vetëm sqarohet, por edhe vendimi që del për të bëhet i kuptueshëm dhe i parashikon drejt çështjet.

Kur zbatohet vendimi, duhen dëgjuar me kujdes vërejtjet e të gjithëve dhe, po të jenë me vend, të bëhen korrigjimet në vendimin bazë ose t'u bëhen korrigjimet masave që janë marrë dhe detyrave që nuk janë përcaktuar kur vendimi në praktikë nuk është

zberthyer mirë nga ata që i kanë marrë dhe i kanë zbatuar ato masa të gabuara.

Rëndësi ka edhe formulimi i vendimeve, i cili duhet të jetë kurdoherë konciz. Një vendim i formuluar mirë ka vlerë në rast se edhe shpjegohet mirë. Kjo do të thotë se rëndësinë dhe vlerën vendimit ia ngre zberthimi i tij. Ne kemi konstatuar në jetë dhe kjo do të na ngjasë edhe paskëtaj se, kur nuk bëhet si duhet zberthimi për një vendim që është përpiluar mirë, na është krijuar përshtypja se ai nuk ishte hartuar si duhet. Është, pra, e nevojshme të insistojmë jo vetëm për hartimin, po dhe për zberthimin e mirë të vendimeve. Zberthimi i vendimit nuk duhet ngatërruar me njohjen e tij që bëhet nëpërmjet leximit kolektiv ose individual. Të mendohet se duke lexuar vendimin është arritur në zberthimin e tij, kjo shpie në formalizëm e pasivitet, se njerëzit me anë të leximit marrin vetëm dijeni, por nuk dinë konkretisht se çfarë të bëjnë në kushtet e tyre. Prandaj duhet të kalitim vëmendjen e gjithë Partisë që komunistët të studiojnë dhe të diskutojnë thellë çdo problem, të pyesin për çdo gjë që nuk e kanë të qartë. Këtu merr një rëndësi të veçantë instruktazhi për veprim e zbatim për të gjithë njerëzit, të organizuar ose jo në Parti, që marrin pjesë në mbledhjet e ndryshme, ku diskutohen probleme të ndryshme, merren vendimet përkatëse dhe caktohen detyrat.

Ai që shkon në mbledhje duhet të jetë plotësisht i ndërgjegjshëm se atje ka detyrë të dëgjojë me vëmendje të madhe, të mësojë, të mbajë mend ç'thuhet, të mbajë medoemos shënim, të bëjë edhe pyetje dhe të shfaqë mendimet e tij, cilatdo qofshin ato. Pastaj du-

het të mos harrojë se, kur del nga mbledhja, atëherë fillon detyra e madhe për të cilën ai duhet të punojë që ta zbatojë, qoftë në mënyrë të organizuar nga Partia, qoftë nga organizatat e masave ose me vetë iniciativën e tij personale.

Çdo njeri që del nga mbledhja nuk duhet të thotë se «Puna ime mbaroi me mbledhjen», por të thotë «Puna ime fillon me mbylljen e mbledhjes» dhe t'i punojë koka, të përgatitet për problemin që u shtrua, të mbledhë fakte, të mendojë si do ta zbatojë vendimin në fabrikë apo në fshatin e tij edhe para se të vijë vendimi, edhe para se atë ta shtrojë organizata-bazë. Ai «të përgatitë fushën, veglat», «të triorjë farën» në mendjen e shokëve e të miqve të tij. Kësaj i thonë parapërgatitje për zbërthimin dhe për zbatimin e vendimit. Këto janë detyra normale që dalin e që duhet të kryhen për këtë çështje.

Zbërthimi i vendimeve në bazë, si për shtruarjen e problemit nga të gjitha pikëpamjet, ashtu edhe për marrjen e masave konkrete për ta realizuar vendimin, merr një rëndësi të jashtëzakonshme. Këtu qëndron fati i mirë ose i keq i vendimit. Prandaj pikërisht këtu duhet të synojnë të gjitha përpjekjet, të gjitha masat. Pas marrjes së vendimit fillon një fazë e re, më e rëndësishmja, ajo e zbatimit, se pasi punohet vendimi, nuk duhet të pakësohet kujdesi, por përkundrazi, të shtohet ai për të organizuar punën që vendimi të zbatohet, të organizohet mirë informacioni, me qëllim që të nxiten ata që mbeten prapa, të korrigjohen pasaktësitë dhe të përgjithësohet eksperiencia e mirë.

Në këtë çështje del roli vendimtar i organizatës-

-bazë të Partisë, i këshillit popullor, i udhëheqjeve të organizatave të masave në fabrikë, në kooperativë e kudo ku punohet. Këtu veçanërisht kanë rëndësi të madhe masat dhe detyrat konkrete për cilindo punonjës në veçanti dhe për të gjithë si kolektiv. Këtu kanë rëndësi, gjithashtu, caktimi i afateve, disiplina e zbatimit, kontrollet për fatin e zbatimit të detyrave, këtu realizohet dhe kontrollohet saktësia e vendimit, provohen kuadrot dhe forumet udhëheqëse, këtu është kudhra për të gjithë. Prandaj këtu, me luftën revolucionare të bazës, ne duhet të zhdukim çdo formë pune burokratike, çdo shfaqje formalizmi, rutine, mendjemadhësie të aparateve të Partisë dhe të pushtetit.

Shumë herë aparatet dhe kuadrot e tyre ndiejnë një kënaqësi jo të ligjshme duke menduar se nxjerrin nga dora e tyre një punë të kulturuar. Kjo nuk është kurdoherë e vërtetë. Puna konsiderohet shumë e mirë, kur di të organizosh, për shembull, masat e gjera të fshatit dhe për 6 muaj të përfundosh së ndërtuari në të gjithë rrethin objektet socialkulturore, ose brenda 8 orëve të organizosh masa të gjera kooperativistësh dhe të hapësh 17 kilometra kanal. Kështu punojnë organizata e Partisë dhe pushteti me popullin heroik të Dibrës. Në të tilla veprime duhet të mësojmë ne si shtrohen problemet, si diskutohen ato, si merren e si zbërthehen vendimet, pastaj si kontrollohen dhe si zbatohet vepra me sukses.

Aksioni i madh i kohëve të fundit i realizuar me sukses nga populli dibran, i udhëhequr nga Partia, duhet të bëhet shembull për gjithë vendin tonë, për të gjitha rrethet, për punët e bujqësisë dhe për ato të

industrisë, të ndërtimit etj. Fryma dhe metoda e këtij aksioni të shkëlqyer në organizim e planifikim të shërbejnë në bazë e në qendër për hartimin e planeve nacionale dhe lokale.

Ky aksion tregon qartë ç'rezerva të mëdha ekzistojnë në vendin tonë, ç'rol vendimtar luajnë puna politike dhe puna konkrete organizative, sa vendimtar është besimi në masat e popullit, jo vetëm në forcën fizike të tij, por në mendimin e tij të madh krijues, në besimin e patundur që ka krijuar ai te fjala e Partisë, në disiplinën e ndërgjegjshme, në ndjenjën e forcës kolosale të kolektivit dhe në çështjen e madhe të solidaritetit. Sa gjëra përfaqëson ky aksion i madh i popullit të rrethit të Dibrës! Ai nuk përfaqëson vetëm anën materiale dhe dobinë ekonomike, por njëkohësisht edhe anën e tij morale, politike dhe ideologjike, e cila është e pallogaritshme. Nga ky shembull i madh që na japin populli dhe organizata e Partisë e rrethit të Dibrës, ne duhet të nxjerrim mësimë të shumta, mësimë politike, ideologjike, ekonomike, ushtarake e organizative, mësimë për një vullnet dhe disiplinë të lartë masive në punë, për një organizim të përsosur masiv, për një gatishmëri masive rrufe për të zbatuar me sukses vendimet e marra nga Partia.

Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1969-1970», f. 256. Tiranë, 1970

Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1969-1970», f. 256. Tiranë, 1970

TE NGREME ME LART STILIN REVOLUCIONAR NE EDUKIM, NE ORGANIZIM, NE PUNE

Fjala në Plenumin e 9-të të KQ të PPSH¹

27 dhjetor 1969

Viti i ri 1970, viti i fundit i pesëvjeçarit të katërt, për Partinë dhe për popullin tonë duhet të jetë një vit sulmi revolucionar i paparë deri sot, në të gjitha drejtimet. Në këtë Plenum të Komitetit Qendror ne analizuar punën që kemi kryer gjer tani, kritikuar të metat, gabimet dhe boshllëqet që kemi pasur dhe caktuar detyra të reja për të ardhmen. Realizimi i plotë i këtyre detyrave do ta fuqizojë më tej punën, do të ndihmojë për të arritur rezultate përfundimtare më të mira në këtë pesëvjeçar dhe për të përgatitur një bazë akoma më të fuqishme për pesëvjeçarin e ardhshëm.

Raporti i Byrosë Politike të Komitetit Qendror, që

1 Plenumi i 9-të i KQ të PPSH, që u mbledh më 26-27 dhjetor 1969, shqyrtoi raportin e Byrosë Politike «Mbi punën e organizatave të Partisë, të masave dhe të organeve ekonomike e shtetërore për rritjen e mëtejshme të rendimentit dhe forcimin e disiplinës proletare në punë», mbajtur nga shoku Xhafer Spahiu, në atë kohë sekretar i KQ të PPSH.

mbajti në këtë Plenum shoku Xhafer Spahiu, i shtron drejt dhe shumë qartë çështjet. Ai vë mirë në dukje edhe sukseset e arritura gjer sot, që s'janë të pakta, por tregon njëkohësisht edhe ku janë dobësitë e punës dhe të luftës që bëjmë ne për ngritjen e rendimentit dhe për forcimin e disiplinës proletare në punë.

Rendimenti i punës, i parë në prizmin e teorisë dhe të praktikës revolucionare, nuk është as i thjeshtë, as një problem thjesht teknik ose burokratik, por i gërshetuar ngushtë, si çdo problem tjetër i ekonomisë politike të socializmit, me teorinë, me politikën, me teknikën, me organizimin e me një sërë çështjesh të tjera që rrjedhin prej tyre. Prandaj, si raporti i Byrosë Politike, ashtu edhe diskutimet e shumta të shokëve e vunë këtë problem në kuadrin e tij të rëndësishëm, zbërthyen shumë aspekte të tij, i dhanë atij më shumë gjallëri e jetë dhe, duke bërë analizën kritike konkrete të punëve tona, dolën me mësimet dhe detyratë reja që do të na shërbejnë ta çojmë edhe më përpara zhvillimin e ekonomisë sonë socialiste.

Punimi i materialeve të këtij Plenumi në Parti dhe në popull duhet të shënojë një kthesë tjetër akoma më të madhe në hovin tonë revolucionar për të ecur përpara. Komunistët, punëtorët, kooperativistët e gjithë punonjësit lypset ta studiojnë e ta përpunojnë thellë raportin dhe ta zbërthejnë atë lidhur me problemet konkrete të sektorit ku punojnë dhe luftojnë.

Zbërthimi i detyrave dhe i vendimeve që do të marrë ky Plenum ka një rëndësi të madhe, jo se ato nuk janë shtruar edhe herë të tjera, jo se janë probleme të panjohura, por sepse analiza e bërë na tregon se

njerëzit tanë, megjithëse kanë arritur rezultate të mira, njëkohësisht, gjatë gjithë punës që kanë bërë, kanë pasur edhe të meta, mungesa dhe kanë lejuar lëshime serioze. Burimi i të gjitha këtyre fenomeneve negative qëndron te kuptimi akoma i cekët politiko-teorik i këtij problemi dhe tek organizimi jo kudo i mirë dhe i përsosur i punës.

Në luftën kundër këtyre të metave e gabimeve dhe për gjetjen e origjinës së tyre Partia realisht është optimiste, pasi komunistët dhe masat e gjera punonjëse tregohen jashtëzakonisht të gatshme për të luftuar, dhe në fakt po luftojnë kudo, në mënyrë revolucionare. Por ne, mendoj unë, nuk e kemi ngritur akoma në shkallën e duhur nivelin e punës sonë në të dyja këto drejtime, në atë platformë të lartë dhe të vrullshme të shpirtit revolucionar të komunistëve dhe të masave. Prandaj na vihet detyrë ta përmirësojmë më tej punën, të ngremë më lart stilin revolucionar, qoftë në edukimin politiko-ideologjik, qoftë në atë ekonomiko-organizativ. Atje ku puna jonë ecën me këtë frymë, realizimet tona revolucionare, shpirtërore dhe materiale janë të mrekullueshme. Atje ku ngjet e kundërta, pra ku mbizotërojnë frenimi, çorganizimi, shfajësimet, «teorizimet» etj., ka amulli, atje nuk ka dhe nuk mund të ketë realizime sa duhet.

Cilat janë prirjet që mbizotërojnë më shumë te ne? Me plot gojën mund të themi se kudo mbizotërojnë prirjet e theksuara revolucionare. Pikërisht në këto lëvizje të mëdha masash revolucionare, që hidhen në sulme të papara ndonjëherë, Partia, mendoj unë, duhet të kërkojë dhe ka për t'i gjetur format e drejta

organizative që u përshtaten këtyre kohëve të jashtëzakonshme që po jetojmë, ku po thyhen kornizat e vendosura, thyhen normat, e reja zëvendëson vazhdimisht të vjetrën. Partia, duke ngritur në këmbë masat, duhet ta kapë përnjëherësh të renë, ta përgjithësojë e ta zhvillojë atë më tej e në mënyrë të rrufeshme. Duhet të jetë e qartë për të gjithë se njerëzit që edukoi Partia me aq kujdes dhe i frymëzoi në një mënyrë kaq të lartë, në hovin e tyre krijues nuk do të mund të durojnë dot njerëzit meskinë dhe format e metodat e vjetra dhe frenuese të punës së tyre. Këta njerëz do t'i hedhë tej furtuna e revolucionit, në rast se nuk ndjekin këtë zhvillim të vrullshëm që udhëheq Partia. Ky është një ligj dialektik që s'mund të pengohet.

Njerëzit e vendit tonë tani kanë përveshur llërët dhe realizojnë vepra të mëdha. Të tjera vepra akoma më të mëdha i presin ata në të ardhmen. Do të jemi ne vetë që do t'i ndërtojmë ato. Por në vendin tonë të gjithë, i madh e i vogël, e kuptojnë se ndërtimi i këtyre objekteve të mëdha kërkon investime të mëdha, kërkon fonde të konsiderueshme, të cilat i krijon akumulimi i planifikuar socialist. Se nga do të dalin gjithë këto fonde, për ne është e qartë, ato do të dalin nga djersa dhe nga puna jonë. Por duhet ta kenë të qartë dhe ta kuptojnë mirë të gjithë se edhe kursime lypset të bëhen për zhvillimin e pandërprerë të forcave prodhuese në vendin tonë, por njëkohësisht edhe niveli i jetesës së popullit duhet të ngrihet. Dhe për të realizuar këto synime të mëdha të Partisë është e domosdoshme të ngrihet vazhdimisht në çdo sektor rendimenti i punës, të ngrihen rendimentet e prodhimeve,

të rriten akumulimet, të ulen kudo kostoja dhe çmimet. Të gjitha këto probleme të ekonomisë sonë socialiste vazhdimisht e vazhdimisht duhet t'u shpjegohen e t'u sqarohen punonjësve tanë mirë e drejt, politikisht dhe teorikisht.

Pasi të bëhet kjo, vendimtare është çështja e organizimit konkret në jetë të punës dhe të luftës për t'i realizuar këto orientime e detyra dhe për t'i arritur këto rezultate. Pikërisht, në zbatimin e këtyre orientimeve, ne kemi mjaft të meta serioze që mendoj se rrjedhin sidomos nga një punë organizative e dobët. Për shembull, te ne nuk organizohet si duhet qoftë puna teorike, qoftë puna organizative, që lufta për t'i futur punëtorit në gjak normimin të ketë sukses të plotë, që lufta për rrënjosjen e disiplinës dhe të ndërgjegjes proletare në punë të bëhet një normë kryesore e gjithë njerëzve tanë si në teori, ashtu edhe në praktikë, që lufta për t'i dhënë shoqërisë sonë sa më shumë, sa më mirë dhe sa më lirë të frymëzojë cilindo nga punonjësit tanë.

Natyrisht, kudo, në çdo ndërmarrje ku punohet, ne duhet të forcojmë organizimin, rregullin e disiplinën në punë. Për t'ia arritur kësaj është e domosdoshme të luftojmë vazhdimisht për të ngritur ndërgjegjen klasore të punonjësve. Por si organet qendrore, ashtu edhe organet drejtuese në rrethe e në bazë kanë përgjegjësi të madhe për shumë çështje që nuk i zgjidhin drejt, që pengojnë dhe zvarritin zgjidhjen e tyre të mirë dhe në kohën e duhur. Për shembull, duke marrë parasysh se struktura e prodhimit në industri zgjerohet, në rast se ne nuk i rrimë mbi kokë kësaj

çështjeje dhe nuk marrim në kohë masat e duhura, rendimenti, në vend që të na ngrihet, përkundrazi do të ulet, siç po ngjet në fakt në disa raste këta 2-3 vjetët e fundit; ose vazhdojmë të mbajmë disa ndërmarrje paralele jorentabël dhe jo shumë të domosdoshme nga ana ekonomike, në një kohë kur prodhimi i tyre mund të zëvendësohet në rrugë të tjera dhe me shpenzime më të pakta; ose le të marrim çështjen e rendimentit të punës në bujqësi, i cili, në krahasim me atë në industri, është shumë i ulët. Këtij problemi ne duhet t'i vëmë një rëndësi të madhe nga ana organizative dhe edukative, pse nuk po trajtohet si duhet si nga qendra, ashtu edhe nga komitetet e Partisë të rretheve. Si këto që përmenda ka edhe shumë probleme të tjera.

Ne me të drejtë u kërkojmë llogari dikastereve për disa probleme kyç, për arsye se ato e kanë përdorur pa vend të drejtën e shtesës prej 2 për qind të fuqisë punëtore që u është lënë në kompetencë, duke rënë kështu në pozitat oportunisto-liberale të mjaft ndërmarrjeve që nuk luftojnë sa duhet për forcimin e disiplinës në punë, nuk vlerësojnë si diçka shumë të çmueshme kohën e punës, nuk bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme për mënjanimin e humbjeve gjatë saj etj. Si rrjedhim, dikasteret tona ekonomike nuk marrin të gjitha masat për të ndjekur e për të kontrolluar zbatimin me rreptësi të normave në punë dhe vendosjen e normave teknike, por në vend të tyre e gjejnë më lehtë të përdorin rrugën më të kushtueshme dhe më antiekonomike, atë të përdorimit të 2 për qindshit dhe të kapërcimit të fondit të pagave. Veprime të

këtij lloji janë antiekonomike dhe tregojnë se disa prej kuadrove tanë kanë akoma paqartësi politike dhe ideologjike.

Ne duhet të vëmë me të vërtetë alarmin, kur konstatojmë se 30 për qind e numrit të punonjësve të ndërmarrjeve tona ekonomike, si edhe ai i gjithë punonjësve të sektorit të bujqësisë, lihen jashtë kërkesave serioze për rritjen e rendimentit. Si ia lejojmë vetes një gjendje të tillë? Në asnjë mënyrë, shokë, nuk duhet të ecim në këtë rrugë, po të bëjmë të gjitha përpjekjet për t'i gjetur sa më parë format dhe metodat e përshtatshme që rendimenti të planifikohet për të gjithë, pa përjashtim.

Me të drejtë bëjmë pyetjen: Organizatat e Partisë dhe organizatat e bashkimeve profesionale në të gjitha ato qendra pune dhe kooperativa bujqësore ku vërtetohen këto të meta, kur trajtojnë problemin e shfrytëzimit në maksimum të kohës së punës dhe të zbatimit atje të disiplinës proletare, flasin vetëm teorikisht ose në përgjithësi, apo këto çështje i lidhin vazhdimisht me ndodhitë konkrete që vërtetohen gjatë punës dhe që prekin interesin individual dhe atë të përgjithshmin? I theksojnë ato të metat individuale për të dalë nga këto në konkluzione të përgjithshme? Përpiqen të ndreqin në këtë mënyrë gabime të pjeshme për të shmangur gabimet kolektive? Kjo mënyrë pune ka rëndësi, më duket mua, në çdo fazë të zhvillimit e të kalitjes së ndërgjegjes revolucionare të punonjësve tanë dhe veçanërisht në kushtet aktuale.

Për ngritjen dhe për kalitjen e ndërgjegjes revolucionare të punonjësve tanë i duhet vënë rëndësi, në

radhë të parë, punës ideopolitike. Kjo është alfa e çështjes. Por nuk duhen lënë pas dore në asnjë mënyrë as masat organizativo-teknike, pse ato janë materializimi i orientimeve politike, ndihmojnë të realizohet detyra politike, të vërtetohen në jetë vija dhe drejtësia e politikës së Partisë. Në vetë këto masa organizativo-teknike, të marra mirë dhe me kohë, vërtetohen ajo pjekuri, ajo zotësi, ai kuptim i drejtë i problemit, ajo disiplinë e rreptë proletare që ndihmojnë të kryhet detyra. Pra edhe në këto masa ka politikë dhe ideologji proletare dhe e kundërta, kur këto lihen pas dore dhe tregohet oportunizëm, atëherë ka ideologji joproletare.

Mua më duket se disiplina proletare kërkon nga të gjithë punonjësit, kudo ku janë (dhe kjo duhet të futet në kokë dhe të afishohet në mënyrë të dukshme), se ligjet e vendosura nga shteti proletar në lidhje me orarin e punës dhe rregulloret që kanë lidhje me të duhet të zbatohen me rreptësi. Kjo çështje duhet kuptuar në të gjithë kompleksin e vet. Vajtja me përpikëri në orën e caktuar në vendin e punës, fillimi menjëherë nga puna, marrja në kohën e duhur qysh më parë e të gjitha masave organizative, sigurimi i materialeve dhe i të tëra mjeteve të nevojshme për punën, me qëllim që asgjë dhe për asnjë çast të mos pengojë punëtorin në cilindo proces pune gjatë 8-orëshit, të gjitha këto janë detyra të përhershme që duhen zbatuar me rreptësi përditë, nga çdo punonjës. Në kohën e punës të gjithë nervat duhet të jenë të ngritur. Me përjashtim të arsyeve të forta, asgjë e paarsyeshme nuk duhet të shkaktojë largimin nga pu-

na. Ne lypset t'i edukojmë ideologjikisht njerëzit tanë me një disiplinë të hekurt proletare në punë, njëkohësisht t'i mësojmë ata edhe në praktikë ç'është kjo disiplinë, si duhet të kuptohet dhe të zbatohet ajo. Disiplina proletare në punë duhet t'u hyjë në gjak punonjësve tanë, pse jemi akoma larg nga ajo që ata ta kenë kuptuar teorikisht rëndësinë e saj dhe ta zbatojnë atë si duhet në praktikë.

Këto çështje duhet të afishohen kudo dhe t'u futen në kokë të gjithëve, në radhë të parë vetë drejtuesve të dikastereve që drejtojnë ndërmarrjet, ose që kanë detyrime ndaj tyre. Këto detyrime ata duhet t'i plotësojnë absolutisht dhe në kohën e parashikuar, ndryshe zinxhiri këputet dhe fillojnë pastaj lëshimet, shfajësimet, autokritikat e kota e pa shumë dobi. Disiplina proletare duhet të jetë e rreptë për të gjithë, për udhëheqësit dhe për punonjësit pa dallim.

Mbarëvajtja e punëve në bujqësi, gjithashtu, nuk arrihet vetëm duke u kënaqur me realizimin si shifër të përqindjes së pjesëmarrjes së kooperativistëve në punë, siç kënaqen të na raportojnë disa herë, prandaj ne duhet të shohim nga afër deri sa ditë-punë bën konkretisht çdo kooperativist, si e shfrytëzon ai ditën e punës, si e realizon normën dhe ç'rendiment jep. Në qoftë se nuk do ta shohim këtë çështje në gjithë kompleksin e vet dhe nuk do të luftojmë që të rriten të gjithë komponentët e saj, atëherë nuk mund të flasim shumë për ngritjen e rendimenteve në punë, në bimë, në uljen e kostos dhe në ngritjen e mirëqenies së masave punonjëse në fshat dhe në qytet.

Duke bërë fjalë për këto probleme, ne duhet të

kemi kurdoherë mirë parasysh se pjesa më e madhe e popullsisë së vendit tonë jeton në fshat, prandaj merret me mend ç'rezerva kolosale ekonomike të pashfrytëzuara ruhen akoma atje, gjersa pjesëmarrja në punë vazhdon të jetë e paktë, kur numri i ditëve të punës është i ulët, kur kooperativisti në disa raste punon rreth 4-5 orë në ditë, sidomos në dimër, dhe rendimenti i punës nuk llogaritet.

Natyrisht, zgjidhja e këtij problemi të madh për fshatin nuk paraqitet aq lehtë i organizueshëm sikurse në fabrika, por ai nuk është i paorganizueshëm. Çështja qëndron në atë që në fshat duhet të mendohet dhe të merren masa që të punohet gjithë vitin, në të gjitha stinët, me po atë intensitet që kërkojnë bimët bujqësore dhe blegtoaria, ato që ekzistojnë dhe ato që duhen krijuar. Prandaj atje edhe puna politiko-ideologjike duhet të bëhet e thellë dhe e plotë, por edhe puna organizative kërkon, gjithashtu, një kujdes të veçantë, lidhur me kushtet e bujqësisë, me favoret dhe me disfavoret e saj të shumanshme jo vetëm subjektive, por edhe objektive, siç janë stina e vjeshtës dhe ajo e dimrit, që pa një studim dhe pa krijimin e kushteve të nevojshme të punës, nuk mund të bëhet si duhet shfrytëzimi i plotë i forcave të fshatit.

Normimi i punës kudo, në çdo sektor, është absolutisht i domosdoshëm, ndryshe nuk mund të flitet për rendiment, për ngritjen e tij, për arritjen e objektivave të tjerë të planit. Edhe në ata sektorë, pa dyshim të paktë dhe specialë, ku nuk mund të përcaktohet dot normë, kjo duhet të konsiderohet si diçka e përkohshme dhe jo një metodë pune. Normat jo vetëm është

e nevojshme të vendosen kudo, po ne duhet të arrijmë që punonjësi ynë, i një vendi socialist, të mos mund ta kuptojë dot punën pa norma, të mos punojë pa menduar se normat ai duhet t'i kapërcejë, të kërkojë që të vendosen norma të reja, norma sa më mirë të bazuara teknikisht, pse vetëm atëherë mund të themi se ka arritur të kuptojë politikisht, ideologjikisht dhe ekonomikisht rëndësinë e normës si për interesin e përgjithshëm, ashtu edhe për interesin e tij vetjak.

Vendosja e një norme teknikisht të drejtë do të thotë se vlera e faktorit kohë është kuptuar nga punëtori, do të thotë se janë shtuar njohuritë e tij dhe aftësia e tij profesionale është ngritur. Si rrjedhim, është vlerësuar roli i makinerisë që ai përdor, shfrytëzimi e mirëmbajtja e saj nga ana e punëtorit janë rritur, dhe ky, duke e zotëruar mirë këtë mjet, duke kuptuar mirë metodologjinë e planit, jo vetëm e tejkallon planin, por nga duart dhe nga makina e tij nxjerr prodhime me cilësi të mirë dhe me kosto të ulët.

Problemi i normave, i përcaktimit të drejtë dhe i përmirësimit të tyre në zhvillim e sipër, disiplina në zbatimin e tyre, vlerësimi i makinerisë si mjet i rëndësishëm i prodhimit, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i saj i plotë, disiplina e rreptë në punë dhe, si rrjedhim, shfrytëzimi i çdo minute gjatë orarit të punës së punëtorit dhe të makinës, organizimi i mirë i gjithë punës në ndërmarrje dhe sidomos organizimi i vogël, të cilit i vëmë pak rëndësi, dobësi kjo që bën të na humbasë shumë kohë kot, të na kushtojë mjaft mundim dhe të na çrregullojë organizimin e përgjithshëm që mund ta kemi bërë mirë, të gjitha këto duken si probleme të

veçanta, por janë pjesë të një problemi, zgjidhja e drejtë e të cilit kërkon një interesim të plotë nga të gjithë, duke filluar që nga drejtori dhe deri te portieri i ndërmarrjes.

Përgjegjësitë dhe detyrat individuale te ne nuk mund të zbatohen jashtë përgjegjësisë kolektive. Natyrisht, secili ka dhe duhet të mbajë përgjegjësi individuale për detyrat që i janë ngarkuar, prandaj ai duhet të bëjë përpjekje që t'i kryejë sa më mirë dhe të përgjigjet për to, por ne kemi kudo edhe përgjegjësi kolektive. Kjo do të thotë se në përgjegjësinë individuale të secilit kanë pjesën e tyre edhe shokët e tij të punës, të cilët duhet ta ndihmojnë shokun në punë, të ndërhyjnë në kohë kur nuk e kryen atë si duhet, të bashkëpunojnë tok me të më konkretisht. Çështja e normës ka karakter të përgjithshëm, kolektiv, por ka edhe karakter individual, ajo kërkon interesimin e vetë punëtorit, por edhe të të gjithë punëtorëve së toku. Për të interesohet, natyrisht, edhe normisti. Por na thuhet se «në më të shumtat e herës për normat nuk interesohen as drejtorët, as inxhinierët». Ky është një gabim i madh, pse, në rast se ngjet me të vërtetë kështu, dhe unë mendoj se nuk ngjet kurdoherë kështu, do të thotë që kuadrot tanë kryesorë as ekonominë s'e kuptojnë, as ideologjinë dhe politikën e Partisë në fabrikë dhe jashtë saj nuk i bëjnë drejt.

Organizimit të vogël, për të cilin fola pak më lart, i vini rëndësi të madhe, pse me të vendoset disiplina në punë, pse, po të lihet ai pas dore, mund të shthuret disiplina, me të vlerësohet ose nënvleftësohet koha e punës, me të tregohet kujdesi për realizimin e

normës ose jo, me të ruhet ose nuk ruhet makina, nga ai varet nëse do të dalë i mirë ose i keq prodhimi. Këtu është puna, këtu kullon djersa, këtu është kudhra, këtu kalitet çeliku. Prandaj këtu duhet të përqendrohet i gjithë kujdesi ynë, të gjejë zbatim puna politike dhe ideologjike që bëjmë jashtë, këtu tregohet dhe vërtetohet organizimi i mirë, njihen më mirë se kudo njerëzit e klasës, disiplina e klasës, ndërgjegjja e klasës.

Një shembull të madh organizimi të përsosur në punë na dha aksioni i 14 dhjetorit i organizatës së Partisë dhe i popullit të Dibrës, për hapjen e 17 kilometrave kanal brenda një dite pune. Ky aksion rrufe pasqyron më së miri aftësinë udhëheqëse e organizuese të organizatës së Partisë të këtij rrethi, zbërthimin si duhet të direktivave të Partisë, disiplinën e ndërgjegjshme revolucionare në punë. Nga ky shembull i shkëlqyer duhet të mësojnë e të nxjerrin detyra gjithë Partia, të gjitha organet e pushtetit dhe organizatat e masave, në industri, në bujqësi, në ndërtim etj. Nga ky aksion i përqendruar ne duhet të nxjerrim mësim si të shtrohen e të diskutohen problemet, si të merren e të zërthehen vendimet dhe si të ndiqen ato gjer në zbatimin e tyre të plotë.

Aksioni në përgjithësi nuk ka rëndësi vetëm thjesht materiale, ekonomike, por ka sidomos rëndësi politike dhe ideologjike, pse ai forcon në masat tona frymën e solidaritetit dhe të kolektivizmit, rrit më tej patriotizmin e zjarrtë socialist, ngjall në to besimin në forcat e tyre fizike e morale për të realizuar shpejt, mirë dhe para afatit vepra të mëdha të përbashkëta

për forcimin e atdheut e për lumturinë e popullit, forcon disiplinën e ndërgjegjshme revolucionare dhe besimin në udhëheqjen e drejtë e të çeliktë të Partisë, revolucionarizon më tej mendjet e njerëzve tanë dhe hedh poshtë mbeturinat e së kaluarës, kalbësirat si: burokratizmin, konservatorizmin mikroborgjez, mbeturinat fetare, zakonet prapanike etj. Eksperienca e komunistëve dhe e gjithë punonjësve të rrethit të Dibrës le të shërbejë si një mësim i madh për gjithë Partinë dhe punonjësit e vendit tonë.

Organizatrat e Partisë dhe mbarë populli ynë gjithë këto ditë, të frymëzuar nga shembulli i rrethit të Dibrës, kanë ndërmarrë një sërë aksionesh të rëndësishme. Një nga këta është aksioni i 26 mijë kooperativistëve dhe punonjësve të qytetit dhe të fshatit të rrethit të Tiranës, të cilët me një entuziazëm e me mobilizim shembullor hapën brenda 4-5 orëve 22 kilometra kanal. Shembull i lartë për t'u lavdëruar është edhe ai i punëtorëve të Ndërmarrjes së Riparimit të Automjeteve të Komunikacionit në kryeqytet që, në sajë të kuptimit të drejtë ideopolitik të detyrës dhe të një mobilizimi e vendosmërie revolucionare, brenda një dite arritën të montojnë 49 rimorkio, punë kjo që në kushte të zakonshme ata parashikonin ta kryenin brenda tremujorit të parë të vitit të ardhshëm.

Shkëndija që shkrepri në rrethin e Dibrës, tani po përhapet si një zjarr i madh i papërmbajtur në mbarë vendin tonë, ku vargu i aksioneve shtohet nga dita në ditë. Ne të gjithë jemi dëshmitarë të një ngritjeje të pashembullt masash prej dhjetëra mijë njerëzish, të gatshëm për të kryer me një shpirt të lartë luftarak

dhe me vendosmëri të pashoqe çdo detyrë që u ngarkon Partia. Kështu i janë përgjigjur me radhë thirrjes së Partisë për aksione të mëdha punëtorët, fshatarët, gratë, rinia, ushtria dhe inteligjencia jonë popullore gati në të katër anët e Shqipërisë.

S'ka dyshim se kjo valë aksionesh do të vazhdojë të rritet gjithnjë e më shumë dhe do të kthehet në një lëvizje të re, të madhe, që do të çojë në ndërtimin, në përparimin e mëtejshëm dhe në forcimin me një vrull të ri më të lartë të atdheut tonë socialist. Kjo ngritje e paparë e masave punonjëse, kjo gatishmëri e madhe e tyre, ky patriotizëm i zjarrtë dhe vendosmëri e papërkulur janë fryt i punës së madhe të vazhdueshme edukative të Partisë.

Por Partia kudo, në qendër, në rrethe e deri në bazë, duhet të ketë mirë parasysh që gatishmërisë e patriotizmit të punonjësve tanë për punë të dobishme e frytdhënëse për ndërtimin e socializmit dhe për forcimin e aftësisë mbrojtëse të atdheut, t'u përgjigjet kurdoherë me një punë drejtuese dhe organizuese të nivelit të lartë. Në të gjitha këto aksione të mëdha masive është e domosdoshme të luftohen me rreptësi çrregullimi e konfuzioni që mund të shkaktohen nga mosmarrja në kohën e duhur të masave të plota organizative ose nga grumbullimi i një numri më të madh njerëzish nga sa nevojiten. Prandaj të llogaritet mirë që në aksione të tërhiqen aq vullnetarë sa duhet dhe jo më tepër. Në asnjë mënyrë dhe në asnjë rast të mos lejohet nga Partia që për pakujdesi dhe mosorganizim të mirë të punës të luhet me gatishmërinë e njerëzve dhe të komprometohet kështu vija e drejtë e

Partisë në sytë e punonjësve në këto grumbullime të mëdha masive.

Krahas kësaj, në të gjitha këto raste të luftohet, gjithashtu, çdo prirje për bujë e reklamë më shumë për t'u dukur, sesa për punë konkrete. Aksionet tona duhet të karakterizohen kurdoherë, siç thotë populli, nga «fjalë pak e punë shumë».

Ne jemi të bindur se, në rrugën e drejtë të Partisë, masat tona punonjëse, kaq shumë të gatshme dhe entuziaste për të kryer çdo detyrë, do të mobilizohen me të gjitha forcat edhe për realizimin e kësaj çështjeje të rëndësishme që shtruan në këtë Plenum, për rritjen e mëtejshme të rendimentit në punë. Besimi ynë për realizimin e plotë nga ana e punonjësve tanë të vendimeve që do të marrim është i patundur, pse Partia tashmë i ka përtërirë njerëzit, ka transformuar ndërgjegjen e tyre, deri edhe plakun e ka bërë të ri.

Ja ç'më shkruan, në mes të tjerash, në një letër që më drejton këto ditë plaku 90-vjeçar, Abaz Hoxha, nga fshati Zgërbonjë i rrethit të Beratit:

«...Unë jam 90 vjeç dhe mbaj mend se vendi ynë ka qenë i shtypur nga feudalët dhe nga borgjezia që ishin në fuqi. Ata na shtypnin dhe na torturonin, na merrnin edhe atë që nuk kishim me shqelma në bark, duke na lënë në mes të këqijave, kurse sot, në sajë të udhëheqjes së drejtë të Partisë, jetojmë të lirë dhe të lumtur, nxitojmë të punojmë për ndërtimin e atdheut tonë. Ne e dimë përse punojmë. Sot nuk punojmë më për bejlerët dhe për çifligarët, por për vete, për lulëzimin e vendit tonë.

Më lejoni, — vazhdon Abaz Hoxha, — t'ju bëj

disa krahasime me të kaluarën, kur ngriheshim me një gomar nga Zgërbonja dhe shkoni në Vlorë për të marrë pak kripë, duke bërë rrugë me ditë të tëra në shi, në dëborë e në baltë. Kur shkoni në pazar për bereqet, e merrim aq sa thoshte ai që na e shiste pa peshë. Kështu ne kemi hequr të zitë e ullirit, kurse sot i kemi në shtëpi të gjitha çfarë na nevojiten. Të rojë Partia sa malet e botës, që gjatë 25 vjetëve të Çlirimit krijoi të mira të panumërta për popullin tonë! Por për një gjë kam maraz, që u plaka dhe nuk do të mund të shikoj përmirësimet që do të bëhen në të ardhmen.

Sa të lumtur dhe të gëzuar dhe të gjithë të bashkuar shkojnë njerëzit në punë, duke kënduar, pasi dinë pse punojnë. Unë vetë nuk punoj dot, por kur shoh se njerëzit shkojnë të gjithë së bashku në punë, të udhëhequr nga Partia, më bëhet zemra mal dhe them: Ah, sikur të më punonin këmbët e duart e të shkoja edhe unë me ta në ndërtimet që bën populli ynë nën udhëheqjen e Partisë! Gjithë këto të mira janë një plumb i rëndë për armiqtë tanë dhe për revizionistët modernë, që e kanë halë në sy vendin tonë. Por të keqen do t'i marrin... Po të duan le ta prekin tokën tonë, të shikojnë se ç'do t'i gjejë. Nuk ta priste mendja kurrë të elektrifikohej Shqipëria, të bëhej dyqani e të ngriheshin me mijëra shkolla në fshat, të lidhej fshati me rrugë automobilistike, të vinin makinat e traktorët në fshat e shumë e shumë mrekulli që janë bërë e që s'i kishte parë ndonjëherë historia. Përpara shkonin njerëzit në Selanik të punonin dhe rrinin me vite të tëra pa ardhur në shtëpi, kurse tani punojnë në shtëpinë e tyre. Ah, sikur të bëhesha edhe një herë djalë!...».

Këto më shkruan xha Abazi 90-vjeçar nga një fshat i thellë i malësisë së Beratit. Kjo letër në mënyrë të thjeshtë përmban një filozofi të madhe, filozofinë e Partisë sonë. Kjo tregon se humanizmi socialist te ne e ka burimin në qëndrimet e njeriut, që krijon duke punuar, dhe jo në «qenien spirituale», siç kuptohej përpara. Ai është një humanizëm në kundërshtim flagrant me pseudohumanizmin kristian që predikon prifti i Romës, ose me atë farë «humanizmi» të barbarëve modernë që vrasin dhe skllavërojnë popujt.

Humanizmi socialist te ne po bëhet çdo ditë e më shumë një fenomen masiv. Dashuria e thellë e njeriut për njeriun punonjë është karakteristika kryesore në shoqërinë tonë socialiste. Të gjitha energjitë që derdh secili në vendin tonë në punën e përbashkët shoqërore, kanë si qëllim të vetëm të lartë mbrojtjen e atdheut, lirinë e popullit, mirëqenien e njeriut, lumturinë dhe bukurinë e tij të shpirtit. Prandaj anembanë Shqipërisë sot masat e organizuara të punonjësve punojnë me ndërgjegje të lartë. Secili përpiqet të japë atë kontribut që në pamje, duke e marrë veças, duket si një gjë e vogël, por të bashkuar të gjithë për një qëllim të vetëm, nën udhëheqjen e Partisë, çajnë male, ndërtojnë me shpejtësi uzina e fabrika të reja, rrugë e hekurudha, shkolla e shtëpi kulture, për lulëzimin e vendit, për lumturinë e për mirëqenien e përgjithshme, ku njeriu ynë gjen edhe lumturinë e mirëqenien individuale. «Të gjithë për një e një për të gjithë» është motoja jonë. Dhe në këtë drejtim shembujt e dashurisë së pafund për atdheun, për popullin, për njeriun te ne s'kanë të mbaruar:

Le të kujtojmë vetëm një nga shembujt e ditëve të fundit. U shkulën 40 punonjës të moshave nga më të ndryshmet të SMT-së të rrethit të Tiranës për t'i dhuruar pjesë të lëkurës së trupit të vet një shoku të tyre, jeta e të cilit ishte në rrezik nga një djegie aksidentale gjatë punës. Ja një shembull i lartë solidariteti, shpirti sakrifice e vetëmohimi për njeriun, ja ç'njerëz me zemër të madhe, ja ç'humanizëm revolucionar ka edukuar dhe edukon përditë Partia!

Partia, revolucioni i dhanë popullit tonë fuqinë. Ai e ushtron atë mbi çdo gjë dhe bën transformime kolosale mbi tokën, mbi fabrikën, mbi kulturën, mbi arsimin, krijon një gjendje krejt të re. Kështu te ne lindin çdo ditë shpresa të reja, ligje të reja, zakone të reja, mendime të reja, te çdo njeri farkëtohet çdo ditë një ndërgjegje e re.

Bota e vjetër transformohet pandërprerë, revolucionarizohet jeta, transformohen, në radhë të parë njerëzit dhe ndjenjat e tyre. Me socializmin lind e kalitet humanizmi i ri. Atë që shpreh thjesht e qartë mallësoni plak i Beratit në letrën e tij dhe që e shkaktonte zhvillimi materialist i njerëzimit, gjenia e Marksit e ka skalitur për shekuj, duke e quajtur lëvizja absolute e së ardhmes.

Këtyre ndryshimeve kolosale në mendjen dhe në ndërgjegjen e njerëzve tanë, këtyre fitoreve të mëdha që ka korrur Partia për edukimin politik dhe ideologjik të njeriut tonë të ri, me një gatishmëri e vrull të paparë në punë dhe në mbrojtjen e fitoreve nga çdo armik, me një vendosmëri për transformime të tjera të thella, kësaj gjendjeje kaq revolucionare të për-

gatitur prej një kohe të gjatë që nga krijimi i saj, Partia tani duhet t'i përgjigjet me një punë drejtuese e organizuese gjithnjë e më të përsosur, për ta çuar kurdoherë përpara revolucionin tonë të pandalshëm fitimtar. Prandaj, le të mobilizohemi me të gjitha forcat tona, me besim të patundur te Partia dhe te populli ynë i mrekullueshëm, për të realizuar me nder edhe detyrat e rëndësishme që u shtruan në këtë Plenum.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 3 (6667), 4 janar 1970

*Botohet sipas librit:
Enver Hoxha. «Raporte e fjalime 1969-1970», f. 264.
Tiranë, 1970*

TE SHPARTALLOHEN KOMPLOTET KRIMINALE KUNDËR INTERESAVE SOVRANË TE RD GJERMANE

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

11 janar 1970

Dialogu i përzemërt që filloi nga fundi i vitit të kaluar midis revizionistëve sovjetikë dhe militaristëve gjermanoperëndimorë, po hyn tani në fazën e pazarllëqeve konkrete, në përcaktimin e premisave e të kushteve për përfundimin e një marrëveshjeje globale në përshtatje me synimet e tyre ekspansioniste e imperialiste. Në rendin e ditës janë vënë stipulimi i një traktati sovjeto-gjerman për «heqjen dorë reciprokisht nga përdorimi i forcës», «njohja zyrtare e kufijve Oder-Najse», lidhja e një marrëveshjeje të madhe tregtare me afat të gjatë midis Bonit e Moskës, vendosja e marrëdhënieve diplomatike e vendeve revizioniste me Gjermaninë Perëndimore etj., etj.

E gjithë kjo veprimtari e dyanshme diplomatike, që prek drejtpërsëdrejti çështjen gjermane, një nga problemet kyç të lëna trashëgim nga Lufta e Dytë Botërore dhe të lidhura ngushtë me fatet e Evropës, ka

ngjallur shqetësimin e ligjshëm të të gjithë popujve të kontinentit tonë. Askush nuk e ka të vështirë të konstatojë se ndodhemi përpara një situatë kur po thuret një komplot i ri monstruoz revizionisto-imperialist, i cili drejtohet jo vetëm kundër shteteve sovranë të Evropës, por edhe kundër popujve të të gjithë botës.

Fakt është se «politika e re lindore e Bonit» dhe ndryshimi rrënjësor i qëndrimit të qeverisë së tanishme sovjetike ndaj problemit gjerman synojnë në krijimin e një raporti të ri forcash në qendër të Evropës, i cili do t'u shërbente forcimit të militarizmit gjerman dhe planeve agresive të imperializmit revizionist sovjetik. Shtypi perëndimor, i cili shpreh shqetësimet e borgjezisë sunduese evropiane dhe intensifikimin e orvatjeve të aleancës sovjeto-amerikane për të ushtruar diktatin dhe për të vendosur sundimin e saj në gjithë botën dhe që e ndien jo pak frikën e një fuqizimi të mëtejshëm të militarizmit gjerman, ka vënë në dukje se afrimi i ri midis revizionistëve sovjetikë dhe militaristëve të Bonit, bisedimet dhe planet e tyre të ardhshme synojnë në atë që, siç e quan ai, «Evropa të balancohet përsëri».

Në të vërtetë ku kërkohet të arrihet? Klika e Brezhnjev-Kosigin, në marrëveshje me imperializmin amerikan, i cili vepron në të njëjtën mënyrë nga ana e vet, ka kohë që përpiqet të sigurojë krahët në Evropë, të ruajë sferat e saj të influencës në këtë zonë dhe ta përqendrojë në Lindje gjithë peshën e strategjisë së saj agresive e ekspansioniste. Këtij plani i shërbejnë edhe iniciativat e saj famëkeqe të të ashtuquajturit.

sigurim evropian, propozimet për likuidimin e paktit të Varshavës e atij të Atlantikut, për pakësimin e forcave të armatosura të fuqive të mëdha në Evropë etj., etj.

Por zbatimi i këtyre planeve ka ndeshur deri tani në problemin gjerman e, më konkretisht, në këmbënguljen e Gjermanisë Perëndimore, e cila nuk është e predispozuar ta shesë lirë «miqësinë» e saj. Bile, sa më tepër u janë shtuar vështirësitë e brendshme e të jashtme revizionistëve sovjetikë, sa më tepër këta të fundit e kanë drejtuar tehun e agresionit të tyre drejt Lindjes, aq më tepër ata e kanë ngritur çmimin e bashkëpunimit të tyre. Është pikërisht në këtë situatë që në tregun e ujqve imperialistë, revizionistët sovjetikë hodhën interesat e Republikës Demokratike Gjermane, nxorën në pazar independencën dhe sovranitetin e saj. Është pikërisht në këtë situatë që lindi «politika e re lindore» e Brandit, e cila ndryshe nga ajo e Adenauerit, që kërkonte me forcë të gllabëronte RD Gjermane dhe tokat polake matanë Oderit e Najses, synon të arrijë po ata objektiva, por duke tundur degën e ullirit dhe markat. Adenaueri, Erhardi, Kizingeri dhe gjithë demokristianët gjermanë realizimin e revanshizmit të tyre, shpresën për të krijuar Gjermaninë e madhe të Fyhrerit e kishin mbështetur krejtësisht në një konflikt midis Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik. Ata u bënë nxitësit më të mëdhenj të luftës dhe nuk kursyen asgjë për ta transformuar Vermahtin në shtyllën bazë të NATO-s dhe Gjermaninë Perëndimore në plasdarmin kryesor të agresionit kundër Bashkimit Sovjetik dhe vendeve socialiste të

Evropës. Por në kushtet e reja, kur imperialistët amerikanë janë bërë aleatët më të ngushtë të revizionistëve sovjetikë, kur aleanca sovjeto-amerikane ndër qëllimet e saj kryesore ka edhe atë të konsolidojë statuskuonë e tanishme dhe të forcojë sundimin e secilit partner mbi zonat e veta të influencës, ndjekja edhe më tej e një strategjie të tillë do të ishte e kotë dhe pa kuptim. Aq më tepër militaristët gjermanë nuk mund t'u përmbaheshin metodave të vjetra në një kohë kur aleatët amerikanë, të siguar nga revizionistët në Evropë, filluan ta përqendrojnë agresionin dhe ekspansionin e tyre imperialist në Azi dhe në vendet e Amerikës Latine.

Brandi dhe politika e tij lindore janë produkt i ndryshimeve që ndodhën në politikën e Bashkimit Sovjetik e të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, i strategjisë së tyre globale të «paqes në Evropë e të luftës në Azi». Kthesën e fortë taktike të militaristëve gjermanë nuk mund ta bënin dot demokristianët, që ishin lidhur me planet e vjetra e të skaduara dhe që ishin komprometuar si njerëz të politikës së përdorimit të forcës dhe ultrarevanshiste. Borgjezia gjermane nxori në krye socialdemokratët, të cilët, duke qenë deri tani në opozitë, nuk ishin angazhuar aq shumë publikisht ndaj «politikës së vjetër lindore» të Dalles-Adenauerit. Për më tepër këmbimi i kuajve në kancelarinë e Bonit u krijon disa kushte lehtësuese propagandistike sundimtarëve të Moskës për t'i justifikuar pazarllëqet e tyre me Gjermaninë Perëndimore. Nuk është aspak e rastit reklama që i bëhet në Moskë kabinetit të Brandit si «realist», «konstruktiv», i cili, gjoja, me «mi-

rëkuptim» u del përpara iniciativave sovjetike në lidhje me çështjen gjermane, me «sigurimin evropian» etj.

Tani revizionistët sovjetikë dhe të tjerët po i vënë në kryq kërkësës për njohjen nga Boni të Republikës Demokratike Gjermane si shtet sovran, i lirë dhe i pavarur. Gromikoja vazhdon të bisedojë në një «atmosferë pune e mirëkuptimi» me ambasadorin e RF të Gjermanisë në Moskë, Helmuth Allardt, duke lënë mënjanë pretendimet e Bonit ndaj RD Gjermane. Kryeministri polak Cirankieviç, nga ana e tij, deklaroi më 22 dhjetor se qeveria polake është e gatshme për bisedime me RF të Gjermanisë, duke vënë si kusht vetëm njohjen e kufirit Oder-Najse.

Lëshimet pa parim të revizionistëve sovjetikë e polakë në kurriz të RD Gjermane militaristët e Bonit duket se i mirëpresin dhe nuk mungojnë t'i shpërblejnë. Qeveria e Brandit dha me kënaqësi aprovimin e saj për një marrëveshje të madhe ekonomike sovjetogjermanoperëndimore, në bazë të së cilës dy firmat monopoliste «Tisen» dhe «Manesman» do ta furnizojnë Bashkimin Sovjetik me 1 milion e 200 mijë tonë tuba çeliku për një gazsjellës, i cili për më se 20 vjet do ta ushqejë çdo vit RF të Gjermanisë me 3 miliardë metra kub gaz natyror nga Siberia. Tani po flitet për një kredi të madhe që Boni do t'u akordojë edhe klikës revizioniste të Gomulkës e satelitëve të tjerë të Moskës.

«Në politikën tonë lindore, — deklaronte më 22 dhjetor ministri i Jashtëm i RF të Gjermanisë Valter Sheel, — jemi në procesin e iniciativave me shanse për suksese më të mira se ndonjëherë tjetër në historinë e pasluftës». Shanset për të cilat bën fjalë Sheeli janë

në të vërtetë qëllimet e errëta të revanshistëve gjermanoperëndimorë. Nëpërmjet marrëveshjeve politike, ekonomike, kulturore etj. drejtuesve të rinj të Bonit u hapen shtigjet për depërtim të gjithanshëm në vendet revizioniste të Evropës Lindore, u krijohen kushte për të dalë në prapavijat e RD Gjermane, për ta gllabëruar dhe për ta aneksuar gradualisht këtë të fundit.

Mund të duket si kontradiktor fakti që Bashkimi revizionist Sovjetik, i cili është bërë një shtet imperialist agresiv, nga njëra anë mundohet me të gjitha mënyrat e mjetet të zgjerojë perandorinë e tij, të forcojë gjithnjë e më tepër sundimin e tij mbi vendet satelite, kurse nga ana tjetër nuk ngurron të sakrifikojë RD Gjermane që është një nga avanpostet e tij kryesore në Perëndim. Në të vërtetë këtu s'ka asnjë kontradiktë dhe ne nuk mendojmë se revizionistët sovjetikë e kanë vënë atë në ankand me një çmim të ulët. Si kudo edhe në këtë rast veprojnë ligjet dhe logjika imperialiste e ndarjes dhe e rindarjes së zonave të influencës, të cilat nuk është e thënë të bëhen gjithnjë me anë të forcës, të tërheqjes dhe të rikompensimeve territoriale reciproke etj. Duke hequr dorë nga mbrojtja e Republikës Demokratike Gjermane dhe duke shitur interesat e saj të lartë sovranë, revizionistët sovjetikë, është tjetër punë në mos u dalçin hesapet, mendojnë të krijojnë një Gjermani të madhe mike të tyre, një zonë të gjerë neutrale me të njëjtën ekuidistancë nga të dyja superfuqitë, gjë që do të siguronte kështu planin imperialisto-revizionist të paqes në Evropë dhe të luftës në Azi e në kontinentet e tjera.

Këtë objektiv, tanimë të konturuar qartë, synon i ashtuquajhuri traktat mbi heqjen dorë reciprokisht nga përdorimi i forcës, për të cilin po zhvillohen tani bisedime intensive midis Moskës e Bonit, ose njohja zyrtare e kufijve Oder-Najse nga Gjermania Perëndimore. Në qoftë se do të ishte ndryshe, atëherë përse Bashkimi Sovjetik kërkon një «sigurim të veçantë» nga Gjermania Federale dhe jo nga NATO-ja, në të cilën bën pjesë edhe kjo? A nuk do të arrihej po ai qëllim, le ta quajnë si të duan në Moskë, në qoftë se, për shembull, do të përfundohej një traktat për mos-përdorimin e forcës midis Paktit të Atlantikut e atij të Varshavës? A nuk do të angazhoheshin njëlloj anëtarët e tyre? Përse një marrëveshje analoge si ajo që dëshirohet të arrihet midis Gjermanisë Perëndimore dhe Bashkimit Sovjetik nuk përfundohet edhe midis dy Gjermanive? Mos vallë duke i uzurpuar të drejtën e saj sovrane për të vendosur vetë për fatet e saj mbrohet RDGJ? Mos vallë duke aprovuar kështu botërisht pretendimet e revanshistëve të Bonit se RDGJ nuk është një shtet sovran me të gjitha atributet e nevojshme, por vetëm një «zonë okupacioni» dhe se për problemet e saj ata mund të bisedojnë vetëm me Moskën, forcohet njohja e RDGJ, në bazë të së drejtës ndërkombëtare, si shtet i pavarur e sovran?

Ose le të marrim çështjen e njohjes së kufijve Oder-Najse, për të cilën revizionistët sovjetikë e polakë e, bashkë me ta edhe Brandi, po bëjnë një zhurmë mjaft të madhe këto kohët e fundit. Kërkesa e popullit polak që të garantohen kufijtë e shtetit të vet, që të njihet e të respektohet edhe nga Republika Fe-

derale e Gjermanisë kufiri i saj perëndimor është plotësisht e drejtë. Por pse kjo kërkesë bëhet vetëm dhe e shkëputur për Oder-Najsen e jo edhe për kufijtë perëndimorë të Gjermanisë Lindore? Kundër kujt drejtohet kjo Lokarno e re? Ç'fat i rezervojnë revizionistët sovjetikë RD Gjermane?

Kërkesa revizioniste për njohjen e kufirit Oder-Najse bashkë me traktatin për heqjen dorë reciprokisht nga përdorimi i forcës me Bonin, duke përfshirë RD Gjermane nga ky kuadër, nuk lë më asnjë dyshim se kufijtë e mbrojtjes për Bashkimin Sovjetik nuk fillojnë më në Elbë, por në Oder.

Krerët revizionistë të Moskës mundohen që t'i mbulojnë synimet e tyre imperialiste të afërta e të largëta me lloj-lloj demagogjish. Ata kërkojnë t'u mbushin mendjen të tjerëve se çështjen gjermane duan t'ua lënë ta zgjidhin vetë gjermanëve. Ky është një mashtrim i pashembullt, me anë të të cilit ata kërkojnë të vrasin me një gur dy zogj. Nga njëra anë ata duan të justifikojnë kapitullimin e tyre të heqjes dorë nga nënshkrimi i traktatit të paqes me Gjermaninë, domethënë nga njohja *de facto* e *de jure* e realiteteve të krijuara në Gjermani pas shkatërrimit të Hitlerit, dhe nga ana tjetër të mbulojnë turpin e shitjes së interesave jetikë sovranë të RD Gjermane militaristëve të Bonit.

Por kjo lojë e ndyrë nuk do t'i sjellë asnjë dobi klikës renegate Brezhnjev-Kosigin. Syleshët janë shumë të paktë në kohën tonë. Populli i Republikës Demokratike Gjermane nuk mund të mos i shikojë komplotet që thuren kundër tij dhe të rrijë indiferent kur

po vihet në provë e ardhmja e atdheut të vet. Ai nuk mund të pranojë kurrë që republika e tij, krijimi i së cilës ishte një fitore e madhe për të gjithë popullin gjerman, një ngjarje me rëndësi historike për gjithë popujt e Evropës, të bëhet fli e interesave ekspansionistë të renegatëve që kanë uzurpuar pushtetin në Moskë.

Popujt e Bashkimit Sovjetik, të Polonisë, të RDGJ dhe të vendeve të tjera ku janë në fuqi revizionistët, duhet të hapin sytë, të kuptojnë komplotin e ri që po thuret në kurriz të RDGJ midis klikës Brezhnev-Kosigin dhe qeverisë së militaristëve të Bonit. Këtë duhet ta kuptojnë edhe popujt e tjerë të Evropës. Ky komplot ripërtërit revanshizmin militarist gjerman dhe mpreh dhëmbët e tij. Lufta për njohjen e RDGJ si shtet sovran me të drejta të plota nga RFGJ, në radhë të parë, dhe nga shtetet e tjera perëndimore, është e lidhur ngushtë jo vetëm me mbrojtjen e RDGJ, por edhe me ruajtjen e interesave të sigurimit të vërtetë e të paqes së vërtetë në Evropë, me luftën kundër planeve agresive të imperialistëve të Moskës, të imperialistëve amerikanë e të revanshistëve të Bonit.

Asnjë nuk duhet të mashtrohet nga propaganda false imperialisto-revizioniste se afrimi midis Bonit e Moskës do të sjellë uljen e tensionit në Evropë dhe do t'i largojë flakët e luftës nga kontinenti ynë. Historia ka provuar më se një herë se nxitja e apctiteve të revanshizmit gjerman ka qenë katastrofike për Evropën. Jo më pak fatale kanë qenë edhe përpjekjet për t'i shtyrë agresorët drejt Lindjes, gjoja për të shpëtuar «qytetërimin evropian». Prandaj në kohën e sot-

me, dhe posaçërisht në rrethanat e afrimit e të pazarllëqeve të rrezikshme midis revizionistëve sovjetikë dhe revanshistëve të Bonit, mbrojtja e RD Gjermane, njohja e saj në bazë të së drejtës ndërkombëtare si shtet i pavarur e sovran janë një gur prove për të gjitha forcat e shëndosha demokratike, për të gjithë popujt e Evropës e të botës. Demaskimi dhe shpartallimi i kompleteve kriminale që thuren kundër RD Gjermane janë një goditje që u jepet planeve agresive imperialisto-revizioniste, përgatitjeve për luftë që bëjnë të dyja fuqitë e mëdha imperialiste për të vënë nën zgjedhën e tyre të gjithë popujt e botës.

Populli shqiptar, ashtu si kurdoherë, do të mbrojë me vendosmëri dhe nga pozita parimore interesat sovranë të Republikës Demokratike Gjermane, do të përkrahë pa u lodhur luftën e popullit liridashës gjerman kundër kompleteve të pabesa të imperialistëve revizionistë sovjetikë dhe aleatëve e miqve të tyre, militaristëve gjermanoperëndimorë dhe imperialistëve amerikanë.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 9 (6673), 11 janar 1970

Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 557

SHKOLLAT USHTARAKE T'I KALITIN KUADROT NGA ÇDO PIKËPAMJE

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

15 janar 1970

Jam dakord me vërejtjet që bënë shokët. Raporti që na është paraqitur na vë në dijeni për gjendjen e punëve në ushtri, qoftë nga ana ushtarake, qoftë nga ana ideologjike dhe politike. Po të krahasojmë nivelin ideopolitik me përgatitjen ushtarake të kuadrove, del se nga ana profesionale ata janë më të përgatitur. Kjo nuk do të thotë se niveli ideologjik e politik i efektivit të ushtrisë sonë është i ulët, përkundrazi, kuadrot ushtarakë janë të ngritur, po ne duhet të punojmë që ta përmirësojmë edhe më shumë gjendjen në këtë drejtim. Një gjë e tillë do të arrihet duke forcuar punën në të gjitha hallkat, në radhë të parë punën për edukimin marksist-leninist nëpër shkollat ushtarake, në organizatat-bazë të Partisë, duke shfrytëzuar në maksimum mjetet që kemi në ushtri, format dhe metodat më të mira të punës.

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth punës për edukimin ideopolitik të kuadrove e të kursantëve në Akademinë Ushtarake, në shkollën e bashkuar të oficerëve «Enver Hoxha» dhe në shkollat e tjera ushtarake.

Në veprimtarinë që zhvillohet për edukimin ideopolitik të ushtrisë, në fakt, janë braktisur mjaft forma stereotipe, megjithatë duhet të luftohet akoma në këtë drejtim, sepse vetë karakteri i ushtrisë është i tillë që, për ta kryer këtë punë si duhet, kërkohen disa forma krejt ndryshe nga ato të terrenit. Nuk mund t'i themi ushtrisë që të heqë dorë nga dhënia e urdhrave të prerë dhe nga kërkesa për zbatimin e tyre me rreptësi. Është e kuptueshme që kuadri ushtarak, sidomos, do të anojë pak a shumë nga kjo anë, në ushtri nuk është e mundur të zhduket krejtësisht kjo frymë pune, çështja është të luftohet shabllonizmi dhe në këtë drejtim atje kanë filluar të duken përmirësime.

Këtu u tha se si i trajtojnë problemet kuadrot e Akademisë Ushtarake, si i zhvillojnë temat, si i zbërthejnë ato më tej etj. Nga këto që dëgjuam, më duket se shokët e akademisë nuk i kapin keq problemet. Ata i zhvillojnë mirë temat, i lidhin parimet edhe me praktikën, sepse janë të ngritur teorikisht. Trajtimi i një sërë problemesh ideopolitike nga kuadrot e akademisë edhe në planin filozofik, edhe në mënyrë praktike, në frymën e korrigjimit të njerëzve me shembuj konkretë, qoftë nga jeta e ushtrisë, qoftë në përgjithësi nga praktika e jetës në vendin tonë, është një edukatë pozitive marksiste-leniniste, me të cilën brumosen oficerët tanë. Natyrisht, në akademi, si kudo, mund të ketë dhe ka të meta, por duke vepruar kështu do të arrihen më tepër përparime në punë.

Puna mësimore edukative në Akademinë Ushtarake duhet t'i edukojë, t'i kalitë kuadrot nga çdo pikëpamje, edhe si ushtarakë të mirë e të zotë, edhe si ku-

adro politikë, të pastër e revolucionarë, me një disiplinë të çeliktë, sepse në ushtri duhet të ketë një disiplinë të rreptë proletare. Konstatohet që disa oficerë kanë shfaqje e mbeturina të huaja, ose nuk luftojnë si duhet për zbatimin me rigorozitet të detyrave. Por kur një kuadër nuk zbaton një vendim ose një urdhër, kjo tregon se ai ka një psikologji të sëmurë, ka një moskuptim të vijës, ka një sëmundje që duhet shëruar, e cila duhet t'i vihet në dukje. Prandaj këto gjëra, domethënë karakteristikat personale të disave, është mirë të lidhen edhe me lëndët teknike, me qëndrimin që duhet të mbajë kuadri për zbatimin e teknikës e të artit ushtarak, si dhe me sjelljet e tij në shoqëri.

Këtu u bënë edhe disa propozime, që më duket se janë mjaft të drejta, prandaj për realizimin e tyre shokët e akademisë duhen ndihmuar. Midis të tjerash u kërkua që të ngarkohet një njeri kompetent për të dhënë atje një cikël leksionesh për probleme që nuk trajtohen gjatë zhvillimit të lëndëve të tjera, por që preokupojnë vendin tonë, me qëllim që oficerët të njihen edhe me këto. Kuadrot e akademisë, natyrisht, nuk kanë nevojë të futen deri në hollësi të disa çështjeve, si, fjala vjen, të normave, por ata kanë shumë nevojë të njihen me zhvillimin ekonomik të vendit dhe me vijat e përgjithshme të kësaj ekonomie, të njihen me një sërë problemesh të mprehta e pikash të dobëta të ekonomisë sonë, për zgjidhjen e drejtë të të cilave luftojnë populli dhe Partia. Oficerët që ndjekin akademinë dhe gjithë kuadrot e ushtrisë mendoj se kanë shumë nevojë për leksione, ku të flitet edhe se ç'përpyekje bëhen për t'i zgjidhur dhe si po zgjidhen problemet e ndrysh-

me ekonomike e ideologjike në vendin tonë, pse nëpërmjet tyre do t'u hapet ai horizont që kërkojmë. Qëllimi është që, duke mësuar marksizëm-leninizmin, oficerët tanë të lidhen më mirë me zbatimin konkret të vijës së Partisë, me jetën e vendit. Forma që propozohet të përdoret në akademi është një nga rrugët për forcimin e kësaj lidhjeje. Arritjes së këtij qëllimi do t'i shërbejë edhe shtimi i numrit të kuadrove të ushtrisë të cilët do të dërgohen në Shkollën e Partisë, që do të bëhet i mundur në të ardhmen me zgjerimin e aktivitetit të kësaj shkolle.

Përveç këtyre rrugëve, për t'i lidhur më mirë kuadrot e ushtrisë me problemet që preokupojnë Partinë dhe popullin, është e domosdoshme që në konferencat për probleme ekonomike ose në seminarët për çështje ideologjike të organizuara në rrethe me komunistët e terrenit, të mos thërriten vetëm komisari ose komandanti i njësisë, por edhe oficerë nga të bazës, sipas rangut dhe çështjeve që shtrohen në to. Në këto mbledhje nuk është e nevojshme t'u kërkohet atyre të flasin për çështje të ushtrisë, pse oficerët nuk do të venë atje për të shtruar të tilla çështje, po për të njohur më mirë vijën e Partisë, për të mësuar si zbatohet ajo në jetë. Si gjithë të tjerët, edhe ata, përderisa janë në një mbledhje partie, kanë të drejtë të japin mendimin e tyre dhe ky duhet t'u kërkohet, por jo për çështjet ushtarake. Kjo do të jetë një ndihmë tjetër për ta.

Po kështu është e drejtë vërejtja që bëri shoku Ethem Gjinushi¹ që në mbledhjet dhe në seminarët e

1 Në atë kohë komisar i Akademisë Ushtarake.

gjera që zhvillohen në Tiranë për problemet ekonomike, duhen ftuar edhe pedagogë të akademisë ose të shkollave të tjera ushtarake për t'u njohur me to. Deri tani kjo çështje është neglizhuar, prandaj në të ardhmen duhet pasur parasysh që të thirren më shumë ushtarakë në mbledhje të tilla. Megjithatë unë mendoj se njohja e problemeve ekonomike nga kuadrot e ushtrisë nuk mund të realizohet vetëm kështu.

Shokët e ushtrisë duhet të përpiqen të mësojnë akoma më tepër dhe jo vetëm për specialitetin e tyre. Specializimi, natyrisht, duhet të ekzistojë në ushtri. Për shembull, oficeri që është artiljer, çështjet e artilerisë duhet t'i dijë mirë, por, duke qenë njëkohësisht komandant reparti, është e nevojshme të ketë dijeni edhe nga ekonomia politike, të interesohet edhe për çështjet që kanë të bëjnë me prapavijën e repartit të tij dhe të mos shkojë me mendimin se për këtë ka shefin e prapavijës dhe për çdo gjë që bën ky të thotë amin.

Për problemet ekonomike të ushtrisë kuadrot e saj s'kanë shumë dijeni dhe as që përpiqen të mësojnë, duke e quajtur këtë jo të nevojshme, se, sipas tyre, «ato i dinë specialistët». Një pikëpamje e tillë nuk duhet të ekzistojë te kuadrot e ushtrisë. Komisarrit, fjala vjen, nuk i lejohet të merret vetëm me çështjet politike dhe të mos mësojë vazhdimisht edhe për problemet ushtarake, duke u justifikuar se ato i dinë, sipas detyrës që ka secili, komandanti i repartit, shefi i artilerisë, i xhenios, i prapavijës etj. Sigurisht, gjithsecili ka funksionin e vet, ka specialitetin e tij, në të cilin duhet të perfeksionohet. Çdo kuadër ka përgjegjësitë e veta individuale për realizimin e detyrave të

repartit ose të njësisë, por ka edhe përgjegjësi kolektive. Them që kuadri ka edhe përgjegjësi kolektive për kryerjen e detyrave, sepse, kur bëhet mbledhja e shtabit ose kur është anëtar partie dhe merr pjesë në mbledhjen e organizatës-bazë të repartit ku bën pjesë, ai duhet të jetë aktiv dhe për çdo problem që shqyrtohet të thotë mendimin e vet me kompetencë. Por artilleri, për shembull, mund të flasë me kompetencë për problemet e ndërlydhjes që do të diskutohen në mbledhje, kur t'i njohë qysh më parë ato. Një kërkesë e tillë është e domosdoshme të kuptohet mirë dhe drejt nga kuadrot tanë ushtarakë.

Ka oficerë që mendojnë se komisarit duhet t'i bëjë të gjitha, pse pa të komandanti s'bëka dot asgjë. Si nuk bën dot asgjë komandanti pa komisarit?! Problemet e repartit nuk janë të huaja për komandantin dhe nuk është e nevojshme që komisarit të jetë në çdo vend e në çdo qoshe, të merret jo vetëm me çështjet politike, por edhe me punë të tjera. Këto nuk janë kuptime të drejta. Të mendosh kështu për rolin e komisarit, jo vetëm nuk je në rregull, po i largohesh parimit të udhëheqjes kolektive. Natyrisht, komisarit është dhe duhet të jetë në repart, ai duhet të marrë vesh edhe nga punët e drejtimit, të kuptojë në vija të përgjithshme, për shembull, edhe ligjet e artilerisë, edhe çështjet ekonomike, por në asnjë mënyrë nuk i lejohet të marrë përsipër gjithë barrën e komandantit të prapavijës, pse secili ka detyrën dhe përgjegjësitë e tij. Puna duhet të kryhet në mënyrë të tillë që komisarit, në rast nevojë, kur mungon për një arsye ose për një tjetër komandanti, ta zëvendësojë lehtë atë. Mendimi

që pa komisarin në repart nuk mund të bëhet asgjë, s'duhet të ekzistojë kurrkund, sepse nuk është aspak kështu. Partia nuk përbëhet vetëm nga një njeri në repart, po nga gjithë komunistët që punojnë atje. Prandaj të gjitha këto çështje duhen parë me shumë kujdes.

Organizimi më mirë i studimit në ushtri ka shumë rëndësi. Për këtë problem, më duket mua, nuk është nevoja të kërkojmë shumë kuadro, sepse të tillë kemi plot, por duhet organizuar mirë puna me ta. Në Akademinë Ushtarake, në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve ose në atë të Aviacionit apo të Marinës kemi plot kuadro të vjetër, bile që kanë mbaruar edhe akademi, prandaj në qoftë se e perfeksionojmë si duhet në to organizimin e studimit, nuk është aspak nevoja të kemi për këtë qëllim 15 apo 20 veta në Drejtorinë Politike. Në shkollat ushtarake mund të kemi aq kuadro sa janë tani, bile edhe më pak, vetëm duhet të dimë t'u japim atyre esencën e çështjeve dhe t'i ndihmojmë e t'i kontrollojmë që punën ta bëjnë sa më mirë dhe mendoj se ata janë në gjendje ta bëjnë këtë.

Rëndësi e veçantë i duhet kushtuar përgatitjes në shkollë të kuadrove për problemet e prapavijës, sektor ky ku ushtria harxhon shuma të mëdha, të cilat mund të administrohen drejt vetëm nga njerëz që kanë kryer shkollën e posaçme për ekonomistë apo për financierë. Në sektorin e prapavijës duhet të caktojmë kuadro që të kenë mbaruar shkolla të këtij profili, ashtu siç kemi bërë edhe për sektorët e tjerë të ekonomisë sonë, për të cilët kemi nxjerrë e po nxjerrim vazhdimisht specialistë. Mirëpo për ushtrinë nuk kemi përgatitur sa duhet ekonomistë, prandaj ta shtojmë nu-

mrin e kuadrove të tillë. Veç kësaj, në programet e lëndëve që zhvillohen në akademi ose në shkollat e tjera ushtarake, ku parashikohen disa njohuri për prapavijën, duhet të bëjmë ndryshimet përkatëse, në mënyrë që oficerëve, të cilët do të ndjekin akademinë, t'u japim njohuri të mjaftueshme në këtë fushë, me qëllim që si komisarët, edhe komandantët tanë, siç thashë edhe më përpara, kur të marrin drejtimin e reparteve, të dinë edhe ç'është ekonomia, të marrin vesh edhe nga punët e prapavijës, sepse ushtria është një konsumator i madh, ku bëhen shumë shpenzime, prandaj duhet të dimë si bëhen dhe ku shkojnë këto shpenzime.

Propozoj që shokët e Ministrisë së Mbrojtjes ta studiojnë me kujdes çështjen e forcimit të prapavijës së ushtrisë me kuadro të përgatitur, sepse ky sektor nuk mund të ecë me kuadro të përgatitur nëpër kurse një apo dymujore. Tani ka ardhur koha që në prapavijë të kemi njerëz të zotë dhe të aftë për të administruar me nikoqirllëk çdo gjë, për të organizuar në mënyrë të përsosur ekonominë e madhe të ushtrisë, që në kohë rreziku të mos gjendemi përpara një kaosi dhe repartet të mos na mbeten pa furnizim të rregullt. Çdo gjë duhet parashikuar drejt, të organizohet në mënyrë të përsosur dhe të na ecë si sahat në çdo situatë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

SHOKËT E ZGJEDHUR NË UDHËHEQJE DREJTPËRDREJT NGA PRODHIMI PËRBËJNË NJË FORCË TË MADHE DREJTIMI

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

16 janar 1970

Lidhur me këtë problem mund të themi, si përfundim, se eksperiencia e këtij viti duhet të na shërbejë për ta përmirësuar më tej në të ardhmen punën me shokët e rinj të zgjedhur në udhëheqje të Partisë. Mendoj se, si nga shokët e Komitetit të Partisë të Rrethit të Fierit, ashtu edhe nga shokët e gjithë rretheve të tjera është e nevojshme të kuptohet thellë që udhëheqja e Partisë në rreth të lidhet ngushtë me bazën. Vendimi i rëndësishëm që mori Partia për të sjellë në udhëheqje të saj një numër të madh kuadrosh nga baza dhe që masa e Partisë e gjeti plotësisht të

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raporteve të paraqitura nga komitetet e Partisë të rretheve Fier, Krujë dhe Durrës për eksperiencën e fituar pas ardhjes në udhëheqje të organeve dhe të organizatave të Partisë të njerëzve drejtpërdrejt nga prodhimi.

drejtë, veç të tjerave, ndihmon së tepërmi edhe për lidhjen e udhëheqjes së Partisë me bazën.

Në teori kjo çështje kuptohet, por në praktikë nuk bëhen të gjitha përpjekjet që njerëzit e prodhimit të zgjedhur në komitetet e Partisë të rretheve të aktivizohen si duhet për drejtimin e organizatës së Partisë të rrethit. Një punë e tillë nuk bëhet mirë, prandaj vazhdon të ekzistojë një kuptim shumë i ngushtë për udhëheqjen e Partisë. Duhet të venë në bazë anëtarët e Byrosë Politike apo anëtarët e byrove të komiteteve të Partisë të rretheve, që nëpërmjet tyre baza të shohë udhëheqjen e Partisë. Kjo praktikë nuk është aspak e drejtë, bile është shumë e çalë.

Është e çalë, së pari, nga ana teorike, sepse anëtarët e Byrosë Politike të Komitetit Qendror apo anëtarët e byrosë së komitetit të Partisë të rrethit përbëjnë vetëm një pjesë të udhëheqjes, bile një pjesë fare të vogël të saj. Natyrisht, këta shokë kanë një të kaluar shumë të mirë dhe eksperiencë të madhe partie, por eksperiencia e tyre është minimale përpara eksperiencës së madhe e të gjithanshme të tërë udhëheqjes së Partisë në të gjitha instancat. Të ecësh pa qëllim, sipas rutinës dhe pa një logjikë të shëndoshë marksiste-leniniste, të veprosh në mënyrë që baza udhëheqjen e Partisë ta shikojë vetëm tek udhëheqësit kryesorë, ndërsa të tjerët të mos i konsiderojë çdo ditë e çdo orë si udhëheqës që ajo vetë i ka zgjedhur, kjo është shumë e gabuar.

Një praktikë të tillë ne duhet ta korrigjojmë, pse është e çalë edhe nga ana e detyrave praktike vazhdimisht në rritje, që na vënë përpara Partia dhe zhvi-

llimi dialektik marksist-leninist i shoqërisë sonë socialiste. Veç kësaj koha rrjedh dhe udhëheqësit aktualë të Partisë kalojnë nga mosha, prandaj e kemi për detyrë të punojmë që gradualisht të përgatitim zëvendësuesit. Nuk duhet të lejojmë që masa ta konceptojë udhëheqjen e Partisë vetëm te Enver Hoxha apo te shokët e tjerë të Byrosë Politike të Komitetit Qendror, duke kapërcyer udhëheqjen e Partisë të rrethit, e nisur nga mendimi se këtë ose atë çështje e zgjidhin vetëm ata. Jo, shokë, çështjet nuk i zgjidhin vetëm udhëheqësit kryesorë të qendrës, ato nuk i zgjidh dot vetëm as sekretari i parë i komitetit të Partisë të rrethit, po i zgjidh, në radhë të parë, tërë udhëheqja kolegjiale e Partisë, në rreth, duke përfshirë edhe atë anëtar të plenumit të komitetit të Partisë të rrethit që kryen detyrën e kryetarit të një kooperative bujqësore ose që punon drejtpërdrejt në prodhim. Një konceptim i tillë i problemit është në interesin e madh të Partisë. Kështu duhet të kuptohen edhe lidhjet e udhëheqjes me masën e Partisë. Një gjë e tillë nuk mund të realizohet vetëm me propagandë, por edhe me punë konkrete të vazhdueshme.

Njerëzit që ka zgjedhur tani Partia në forumet e saj a janë të tillë që masa t'i njohë me të vërtetë si udhëheqës? E them me bindje se në përqindjen më të madhe Partia ka zgjedhur në udhëheqje anëtarët e saj më të mirë, ata që dallohen në të gjitha drejtimet, në radhë të parë, për qëndrimet e drejta politike dhe ideologjike, për aftësitë e tyre organizative dhe profesionale. Natyrisht, mund të ketë edhe ndonjë që në kompleks nuk i ka të gjitha këto cilësi, megjithatë sho-

kët e zgjedhur janë njerëz me një bagazh të mirë, që i kanë mundësitë të ecin përpara. Tani varet shumë nga ne dhe nga komitetet e Partisë të rretheve që këta udhëheqës të rinj, pa i shkëputur në asnjë mënyrë nga masat, të dimë t'i aktivizojmë. E them këtë, se ekzistojnë pikëpamje të gabuara, siç janë kulti i byrosë, kulti i mbledhjeve, kulti i diskutimeve, vlerësimi i shokëve jo nga puna që bëjnë, po nga fjalët që thonë.

Ndodh që ndonjëri prej të zgjedhurve në plenumin e komitetit të Partisë të rrethit, edhe pse është njeri i pjekur, i logjikshëm dhe me eksperiencë të gjatë, nuk diskuton dot, sepse nuk e ka fituar akoma as kurajën, as shprehinë për të folur. Ky shok, mendoj unë, fundja le të mos diskutojë për ca kohë, Partisë nuk i vlen aq shumë çështja nëse ai diskuton ose jo në mbledhje, derisa punën që i është ngarkuar e kryen aq mirë. Një shok i tillë që tani në fillim ndoshta thotë vetëm pak fjalë, por më pas do të mësojë me siguri të diskutojë, është shumë më i mirë se ndonjë tjetër që diskuton shpesh, flet si bilbil, por grin si mulliri pa kokrra, kurse në punë nuk ia thotë. Vlera e një udhëheqësi dhe komunisti duhet të matet, në radhë të parë, me punën që bën në dobi të shoqërisë dhe jo nga llafet. E ç'e do Partia atë që nuk punon mirë, vetëm për faktin se flet bukur?! Partia vlerëson lart atë që, edhe pse s'flet, edhe pse ndoshta nuk di të diskutojë mirë, ditë e natë qëndron në krye të detyrës dhe e kryen atë më së miri.

Te disa udhëheqës kryesorë të Partisë në rrethe ekziston tendenca e dëmshme që një shok, i cili di ta organizojë mirë punën në bazë dhe në sajë të ekspe-

riencës së vet të përparuar ka rezultate të mira, porsa zgjidhet në udhëheqje të Partisë në rreth, e largojnë nga puna në prodhim dhe e sjellin në aparatën e komitetit të Partisë, ose e caktojnë, ta zëmë, në komisionin e çështjeve organizative të sektorit të naftës për të kontrolluar pusët, duke e justifikuar këtë lëvizje me nevojën që ekziston atje për një njeri të tillë. Në këtë mënyrë një punëtor kaq i mirë largohet nga prodhimi, hiqet nga puna ku i jep më shumë shoqërisë. Jo, shokë, kështu nuk duhet të lejojmë të ecet. Me këtë nuk dua të them që, edhe kur nevojitet të vendoset patjetër në një vend pune një anëtar plenumi, ky të mos largohet nga detyra që ka në prodhim, pra, të mos caktohet në një detyrë tjetër të domosdoshme për interes të punës. Për të përballuar të tilla nevoja që lindin dhe të ne janë vazhdimisht në rritje, duhet të punojmë e të përgatitim sa më shumë punëtorë të tjerë në nivelin e këtij punëtori shembullor, për t'i pasur si rezervë, me qëllim që t'i ngremë kur paraqiten këto nevoja. Një lëvizje të tillë duhet ta bëjmë kurdoherë pa dëmtuar punën dhe kësaj do t'ia arrijmë po të dimë të çojmë pranë një punëtori të përparuar e me eksperiencë të madhe punëtorë të tjerë me perspektivë, njerëz të zotë.

Le të supozojmë tani se një punëtor i tillë është anëtar i plenumit të Komitetit të Partisë të Rrethit të Fierit. Duke qenë në prodhim, ku punën e bën në mënyrë shembullore, ky punëtor nuk ka kohë të largohet nga pusi i naftës, ta zëmë, por, po t'i kërkohet t'u japë të tjerëve eksperiencën e tij shumë të vlefshme, ai do ta gjejë kohën edhe për këtë. Në qoftë se i thu-

het, për shembull, që, si anëtar i plenumit, Partia dëshiron që metodën, frymën dhe vrellin e tij revolucionar në punë, format organizative dhe disiplinën e rreptë proletare që ka vendosur në vendin ku punon t'ua bëjë të njohura edhe shokëve të tjerë të sektorit të naftës, pa u larguar nga puna, apo në qoftë se i lihet ta gjejë vetë kohën kur mund të lëvizë për të shkuar në qendra të tjera, ai do ta kryejë mirë edhe këtë detyrë. Në qoftë se ai nuk mund të largohet dot nga puna, atëherë t'i çohen në vendin e punës njerëzit që mendohet të përfitojnë nga eksperiencia e tij.

Punëtorin shembullor, të zgjedhur në plenumin e komitetit të Partisë të rrethit, nuk duhet ta shkëputim nga puna që kryen në prodhim, duke menduar se, po të ngarkohet me një detyrë në zyra, puna këtu do të bëhet më mirë. Me shokët e rinj që zgjidhen në udhëheqje të veprojmë siç kemi thënë kurdoherë. Ata t'i lëmë atje ku janë; t'i aktivizojmë sa më mirë, pa vepruar në mënyrë burokratike duke i caktuar në komisione e nënkomisione, se në këtë mënyrë i kthejmë në burokratë; dhe, nga ana tjetër, t'i ndihmojmë të drejtojnë si udhëheqës e ta kryejnë si duhet këtë detyrë të rëndësishme që u ka ngarkuar Partia.

Një punëtori që është anëtar i plenumit, kur kemi nevojë, mund t'i caktohet edhe një zonë e tërë në patronazh. Komiteti i Partisë, kur nuk ka shumë instruktorë, e ngarkon këtë të ndjekë punën në të gjitha organizatat-bazë të Partisë të kësaj zone dhe jo vetëm për një ose për dy çështje, por për të tëra problemet, për ato organizative, për bujqësinë, për naftën etj. Dhe derisa është ngarkuar nga komiteti i Partisë

të përgjigjet për një zonë të tërë, është e domosdoshme që çdo i deleguar, kushdo që shkon atje nga qendra, të takohet në radhë të parë me të, ta vërë në korent për punën që do të bëjë, sepse ky anëtar plenumi është në dijeni të problemeve, mban lidhje me të gjithë sekretarët e organizatave-bazë të zonës dhe mund ta ndihmojë të deleguarin jo vetëm me këta, por edhe me ata anëtarë partie që e sheh të arsyeshme se duhet të aktivizohen me këtë rast. Kështu baza do të kuptojë se anëtari i plenumit është një udhëheqës i aftë, serioz, me autoritet dhe i drejtë, ndryshe, po të mos jetë i tillë, ajo e heq. Kur anëtari i plenumit bën gabime, del përpara masës dhe bën autokritikë; ndërsa kur gabimi është i rëndë, komiteti i Partisë organizon mbledhje dhe e heq pa hezitim nga udhëheqja. Autoritetin që ia jep Partia, anëtari i plenumit duhet ta ushtrojë në rrugë të drejtë, me mjetet, me format, me metodat që përputhen me normat e Partisë.

Anëtari i plenumit duhet të ketë edhe iniciativë në punë, natyrisht brenda normave të Partisë, eksperiencës dhe ndërgjegjes së tij si komunist. Sekretarët, byroja dhe komiteti i Partisë i rrethit të kenë parasysh që anëtari i plenumit, përveç punës, fjala vjen, si kryetar i një kooperative, si punëtor, përgjegjës reparti etj., të cilën e ka për detyrë ta kryejë mirë, si udhëheqës partie duhet të punojë edhe për zgjidhjen e problemeve të tjera, prandaj të ndihmohet e të mos i kufizohet veprimtaria në disa forma, siç ka vepruar Komiteti i Partisë i Rrethit të Fierit, që i ka inkuadruar anëtarët e plenumit në komisione e nënkomisione të ndryshme. Me mënyrën si kanë vepruar shokët e rre-

thit të Fierit, më duket, është kaluar drejt një defor-
 mimi organizativ të direktivës që ka lëshuar Komiteti
 Qendror i Partisë. Anëtarët e plenumit të komitetit të
 Partisë nuk janë instruktorë të aparateve, po udhëhe-
 qës partie në atë shkallë dhe në atë nivel sa edhe anë-
 tarët e byrosë, prandaj roli i tyre nuk mund të re-
 duktohet duke i caktuar në disa komisione të veçanta
 permanente. Nuk përjashtohet që, kur është nevoja,
 anëtarë të plenumit të drejtojnë edhe punën e ndonjë
 komisioni të krijuar për një problem të caktuar, që
 koha e kërkon të zgjidhet, për shembull, për të kontro-
 lluar punën në Degën e Punëve të Brendshme të rre-
 thit. Dy-tre anëtarët e plenumit të caktuar në një
 komision të tillë, në emër të komitetit të Partisë kon-
 trollojnë dhe ndihmojnë për forcimin e punës së orga-
 nizatës-bazë të Partisë të degës dhe përgatitin rapor-
 tin përkatës lidhur me gjendjen e konstatuar dhe me
 masat që mendohet të merren për ta çuar edhe më
 përpara punën e Partisë në këtë sektor. Po kështu
 mund të krijohet një komision i veçantë, me dy ose
 me tre anëtarë të tjerë plenumi në krye, për të parë
 si shkon puna për hapjen e tokave të reja në rreth.
 Në këtë komision nuk duhet të jenë të njëjtët shokë
 që kanë qenë edhe në komisionin e mëparshëm, me qël-
 llim që anëtarët e plenumit të mos kthehen në njerëz
 që merren vetëm me disa çështje specifike të vogla,
 sepse ndryshe shmangen nga roli i tyre udhëheqës.

Anëtarët e plenumit të komitetit të Partisë, që
 kanë edhe punë të tjera, duke i futur në disa komi-
 sione, për t'u marrë, jashtë detyrës së përditshme me
 të cilën janë ngarkuar, edhe me zgjidhjen e ndonjë

problemi specifik, nuk do ta luajnë si duhet rolin e tyre si udhëheqës partie. Në këtë mënyrë, dashur pa dashur, atyre u thuhet që s'është e nevojshme të merren me çështjet e tjera, pse ato, sipas kësaj praktike, i dinë anëtarët e byrosë dhe sekretarët e komitetit të Partisë. Pikërisht te koncepti i ngushtë që ekziston te drejtuesit e Komitetit të Partisë të Rrethit të Fierit për udhëheqjen e Partisë, qëndron edhe arsyeja e deformimit që i kanë bërë direktivës së Komitetit Qendror, gjë që s'është as e drejtë, as e lejueshme, sepse edhe anëtarët e plenumit janë udhëheqës dhe si të tillë kanë të drejtë e duhet të venë në të gjitha organizatat-bazë të Partisë.

Në parim, anëtarët e plenumit duhet të njihen me të gjitha problemet e Partisë në rreth. Natyrisht, ata mund të ngarkohen të drejtojnë edhe komisione, po jo të futen në një komision të gjithë ose qoftë edhe disa prej tyre. Në një komision mjafton të caktohen një ose dy anëtarë plenumi, kurse të tjerët fare mirë mund të jenë komunistë të thjeshtë ose njerëz të paorganizuar në Parti. Duke ngarkuar me drejtimin e një komisioni një ose dy nga anëtarët e komitetit të Partisë, të cilët do të vrojtojnë, do të kontrollojnë e do të ndihmojnë punën e anëtarëve të tjerë, do të ngremë në një shkallë më të lartë edhe nivelin e anëtarëve të tjerë të Partisë.

Është e nevojshme të ketë, për shembull, një komision për problemet e arsimit pranë komiteteve të Partisë të rretheve, ashtu sikurse e kemi edhe pranë Komitetit Qendror të Partisë? Natyrisht, është e nevojshme. Në krye të këtij komisioni me rëndësi mund të

caktohen edhe dy ose tre anëtarë të plenumit të komitetit të Partisë, sepse është për diçka speciale, po këta dy-tre shokë, si udhëheqës, nuk mund t'i kufizojmë vetëm në këtë punë, pse ata kanë të drejtë dhe duhet të merren edhe me probleme të tjera të Partisë në rreth. Kështu veprohet në qendër me anëtarët e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë, të cilët bëjnë pjesë në komisionin për punët e arsimit pranë Komitetit Qendror. Ata merren edhe me probleme të tjera partie. Në një komision si ky, siç thashë, mund të ketë edhe njerëz të paorganizuar në Parti, specialistë kompetentë.

Siç dihet, anëtarët e plenumit janë njerëz të caktuar në një punë. Mirëpo, po të llogariten mbledhjet e shumta që bëhen me ta, do të dalë se në fund të 15-ditëshit, sidomos ata që janë punëtorë, do të mbehen pa rrogë, ose do të marrin të ardhura më pak se kur nuk ishin zgjedhur në udhëheqje. Pavarësisht se ata s'flasin, dhe këtë e bëjnë se e duan Partinë, kjo nuk duhet lejuar. Krejt ndryshe është me sekretarët dhe me instruktorët e komiteteve të Partisë, të cilët rrogën e marrin, sado mbledhje të bëjnë.

Anëtari i plenumit duhet të jetë i palodhur në punë dhe t'i ndihmojë organizatat-bazë të Partisë në të gjitha drejtimet, për çështjet politike dhe ideologjike, të kulturës, për problemet e bujqësisë, për hapjen e tokave të reja, për disiplinën proletare etj. Në goftë se e ndien veten jo plotësisht të aftë për këtë, se akoma s'ka fituar autoritet, është i butë etj., duhet të ndihmohet, po edhe vetë të përpiqet për t'u ngritur në nivelin e një kuadri udhëheqës, të jetë aktiv,

sa më i drejtë dhe të mësojë vazhdimisht për çdo problem që lidhet me detyrat që i ka ngarkuar Partia. Në qoftë se anëtari i plenumit, për shembull, nuk ka dijeni për përdorimin e plehrave, të përpiqet të studiojë për to dhe për rëndësinë e tyre, mund të bisedojë për këtë qëllim, ta zëmë, edhe me agronomin e kooperativës dhe të mos presë që këtë t'ia thotë sekretari i komitetit të Partisë. Pasi përgatitet, ai është në gjendje të gjykojë drejt për plehërimin dhe, kur shikon se diçka nuk ecën në këtë drejtim, thërret sekretarin e organizatës-bazë të Partisë të kooperativës bujqësore ose agronomin dhe i porosit të marrin masat e duhura për ndreqjen e gjendjes. Këta i binden, jo thjesht për faktin se ai është drejtues, por se e shohin që është i palodhur në punë, aktiv dhe i drejtë, që është i papërkulur përpara vështirësive dhe interesohet natë e ditë për mbarëvajtjen e punës. Njerëzit, kur shikojnë që një shok rri vazhdimisht në punë, studion, merr masa, sakrifikon çlodhjen e gjumin dhe thërret, bile edhe natën, shokë përgjegjës në vende ku puna nuk shkon mirë, pikërisht për këto cilësi të shquara e duan. Duke vepruar në mënyrë aktive, anëtari i plenumit ngre njëkohësisht edhe nivelin e aftësitë e veta.

Anëtarët e plenumit dhe sekretarët e organizatave-bazë të Partisë, përveç përpjekjeve individuale që bëjnë në punë e sipër, ngrihen edhe nëpërmjet kurseve që organizon Partia. Këto kurse do t'i shërbejnë si duhet këtij qëllimi në qoftë se për ngritjen dhe për funksionimin e tyre komitetet e Partisë do të kenë parasysh edhe natyrën e punës së komunistëve që do të marrin pjesë në to, prandaj plani i këtyre kurseve të

mos bëhet nga zyra dhe njerëzit të mos tërhiqen në to kohë e pa kohë, pa pyetur për dëmin që shkakton largimi pa kriter i tyre nga puna. Nuk duhet të mendohet sikur njerëzit e zgjedhur nëpër forume janë në çdo kohë në dispozicion të komitetit të Partisë. Ky ta organizojë punën mirë e si duhet me ta dhe jo sa herë t'i bjerë në mendje njërit ose tjetrit të zhvillohet një kurs, shokët e bazës të tërhiqen menjëherë nga puna. Që të mos dëmtohet prodhimi, para se të hartohet programi i kursit, është e nevojshme që komiteti i Partisë të konsultohet me ata anëtarë plenumi që kanë në patronazh organizatat-bazë të Partisë të një zone, për të gjetur së bashku kohën më të përshtatshme për hapjen e kursit. Kjo kohë nuk duhet caktuar drejtpërsëdrejti nga rrethi, pa asnjë konsultim me shokët e bazës.

Kështu duhet vepruar edhe kur mendohet që anëtarët e plenumit dhe sekretarët e organizatave-bazë të thirren për një mbledhje në qendër të rrethit. Sekretarët e komiteteve të Partisë në këto raste nuk mund të mendojnë se vetëm ata i dinë këto punë, ndërsa anëtari i plenumit, i cili është ngarkuar me ndjekjen e problemeve të një zone, nuk ditka gjë. Jo, nuk është mirë t'i mësojmë komunistët të mendojnë se sekretarët e komiteteve të Partisë dinë gjithçka e më mirë se kushdo, kurse anëtarët e plenumit, që punojnë në bazë ose sekretarët e organizatave-bazë nuk ditkan gjë! Po të veprohet kështu, arrihet pa dashje që udhëheqja të shihet vetëm te sekretari i komitetit të Partisë ose tek anëtari i byrosë, kurse shokët e tjerë të plenumit, sipas kësaj pikëpamjeje, nuk janë tjetër veçse

njerëz që duhet të zbatojnë detyrat siç ua thonë dhe kur ua thonë të parët. Duke ndjekur një praktikë të tillë të dëmshme, që e ka burimin në këto pikëpamje, shokët e plenumit nuk informohen për të tëra problemet e Partisë në rreth dhe, duke mos qenë të informuar, nuk marrin pjesë aktive në zgjidhjen e tyre dhe nuk diskutojnë në mbledhje.

Shokët sekretarë të Komitetit Qendror të Partisë, që kanë qenë shumë herë në Fier, mund ta dinë më mirë nga unë gjendjen në plenumin e Komitetit të Partisë të këtij rrethi, se unë atje kam qenë vetëm një herë dhe nuk mund të jap një mendim të plotë, por dëshiroj të them se, kur mora pjesë në një mbledhje të byrosë së Komitetit të Partisë të Rrethit të Beratit, që u bë vjet në muajin shkurt në Qytetin Stalin¹, vura re me kënaqësi se të tërë shokët e rinj që e morën fjalën me këtë rast, folën shumë mirë. Ata, bile, diskutuan me një nivel shumë të lartë, sikur të kishin vite që ishin zgjedhur në udhëheqje, dhe folën fare pa druajtje, megjithëse në mbledhje isha edhe unë. Kjo ndodhi se ishin shumë mirë në dijeni të problemit që preokuponte organizatën e Partisë të rrethit. Prandaj edhe ju në Fier, shoku Lamçe², në rast se dëshironi që anëtarët e plenumit të flasin e të japin mendime pa druajtje, është e domosdoshme t'u jepni mundësi që të njihen mirë me problemet e Partisë në rreth, sepse, duke i futur nëpër komisione, ua ngush-

1 Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 40, f. 150.

2 I drejtohet shokut Lamçe Sheme, në atë kohë sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Fierit.

toni sferën e veprimtarisë si udhëheqës. Me një praktikë të tillë pune ata nuk mund të diskutojnë dhe do të flasin vetëm kur shqyrtohet në udhëheqje ndonjë çështje për të cilën janë ngarkuar ose janë të informuar edhe ata. Kurse duke vepruar siç thashë më lart, një punë e tillë u hap anëtarëve të plenumit të komiteteve të Partisë të rretheve horizonte jashtëzakonisht të mëdha.

Shokët e zgjedhur në udhëheqje drejtpërdrejt nga prodhimi përbëjnë për Partinë një forcë të madhe drejtimi. Duke i ndihmuar vazhdimisht që të ngrihen politikisht dhe ideologjikisht, duke i inkurajuar e duke u dhënë kompetenca në punë dhe me veprimtarinë e vet të palodhur, atyre do t'u rritet autoriteti e do të njihen nga masa si udhëheqës partie. Duhet të kemi parasysh, shokë, që nëpërmjet tyre do të përgatitim udhëheqjen e brezave të ardhshëm të vendit tonë, tok me të cilët do të ngrihet dhe do të ecë përpara e gjithë Partia, prandaj elementët e udhëheqjes të mos i ngremë në rrugën e vjetër. Ne, herë pas here, duhet të krijojmë edhe komisione e gjithçka tjetër të nevojshme për punën. Edhe centralizmin demokratik të mos e forcojmë në mënyrë të ngushtë, burokratike, por në rrugë të drejtë, që të mos na ulet gjithë ky hov revolucionar në punën e Partisë.

Siç e theksova më parë, tendenca e drejtuesve të komiteteve të Partisë në rrethe për t'i kthyer si pagjë të keqe anëtarët e plenumit në instruktorë, për t'i futur në komisione e nënkomisione të përhershme është e gabuar. Me këtë, e përsëris edhe një herë, nuk dua të them që ne të mos i futim në komisione

anëtarët e plenumit, por t'i aktivizojmë në ato komisione që janë me të vërtetë të nevojshme. Nga ana tjetër, nuk është e thënë që një anëtar plenumi të mos largohet fare nga prodhimi e të mos ngrihet në përgjegjësi, por nuk është aspak e drejtë t'i bëjmë të gjithë funksionarë. Një ose dy prej tyre mund të kenë prirje, ta zëmë, për kulturën dhe ne duhet të punojmë e t'i ndihmojmë këta që të specializohen në këtë drejtim, për t'i dërguar, kur del nevoja, kudo që lypset, dhe në vend të tyre të ngrihen të tjerë. Partia ka kurdoherë interes t'i zbulojë prirjet e njerëzve, t'i nxitë këta që të specializohen në drejtimet ku kanë prirje, sepse zhvillimi i gjithanshëm i vendit ka nevojë për qindra njerëz të tillë, por veç të mbahet parasysh që jo e tërë udhëheqja e Partisë të sistemohet me punë nëpër zyra. Në bazë ka plot njerëz të përgatitur për kulturën, ashtu sikurse ka edhe për të gjithë sektorët e tjerë. Nga radhët e tyre ata më të zotët e me formim të mirë komunist do të ngrihen edhe në përgjegjësi. Kështu, në luftë dhe në punë, ne do të rritim vazhdimisht kuadro të rinj.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

POLICI ËSHTË NJERI I PARTISË DHE AKTIVIST SHOQËROR

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

16 janar 1970

Për të përmirësuar përbërjen dhe për të përtëritur efektivin e Policisë sonë Popullore mendoj se mund të veprojmë në këtë mënyrë: Një kontingjent i caktuar të rinjsh nga ata që thirren çdo vit për të kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak, të caktohet për të shërbyer në armën e policisë, ku këta të rinj të mbahen për aq kohë sa do të shërbenin si ushtarë. Kur të mobilizohen, meqenëse do të ngarkohen të kryejnë detyrën e policit, që ta bëjnë mirë punën, ata duhet të dërgohen për të kryer kursin e policisë. Duke vepruar kështu, do të kemi edhe mundësi të zgjedhim elementin për këtë sektor me kriteret që dëshirojmë.

Gjatë kohës që këta të rinj do të kryejnë shërbimin e detyrueshëm ushtarak në radhët e policisë,

1 Në këtë mbledhje u shqyrtua puna e komiteteve të Partisë të rretheve Tiranë dhe Durrës për edukimin ideopolitik dhe përtëritjen e efektivit të Policisë Popullore.

Partia duhet të punojë me synimin që, kur të afrojë koha e lirimimit nga shërbimi ushtarak, t'u bëhet thirrje që, po të dëshirojnë, të qëndrojnë për të shërbyer definitivisht në polici. Thirrjes mund t'i përgjigjen, ta zëmë, 50-60 veta, kurse të tjerët lirohen, pastaj, kur të mobilizohen ushtarët e rinj, një pjesë e tyre caktohet prapë për ta kryer shërbimin në polici. Kështu të veprohet derisa të arrijmë ta përtërijmë tërësisht efektivin e policisë dhe ta zgjidhim plotësisht këtë problem. Nuk di si u duket shokëve ky mendim, por them se, po të jemi dakord të gjithë, mund të provohet kjo mënyrë e zgjidhjes së problemit.

Ata që do të pranojnë dhe do të caktohen të shërbejnë në këtë armë është mirë të jenë me shkollë të mesme. Kështu, mendoj unë, mund të zgjidhet çështja e përmirësimit të përbërjes dhe e përtëritjes së efektivit të policisë. Në këtë mënyrë do të kursehen edhe fonde që mund të përdoren për ngritjen e ndërtesave të banimit, që policët të mund t'i sjellin më shpejt familjet në vendet ku do të shërbejnë.

Propozimi im që një pjesë e të rinjve ta kryejë shërbimin ushtarak në armën e policisë, mendoj se duhet studiuar dhe duhet vënë në jetë. Pasi t'ia arrijmë që ta përtërijmë përbërjen e policisë, nuk është më nevoja të qëndrojmë në këtë fazë, por duhet pasur parasysh që kjo punë të bëhet shkallë-shkallë e jo menjëherë, sepse një pjesë e punonjësve të tanishëm të kësaj arme është e domosdoshme të qëndrojë në shërbim, mbasi ka eksperiencë dhe do të duhet për të mësuar të rinjtë.

Puna e aktivistëve vullnetarë, që është praktikuar

në shërbimet e policisë, ndihmon për edukatën e përgjithshme të qytetarëve, për qëndrimet e drejta politike e morale që ata duhet të mbajnë ndaj problemeve shoqërore e shtetërore, ndaj ligjeve, ndaj pronës socialiste, ndaj shokut, familjes, shoqërisë etj. Të gjitha këto duhet të jenë objekt i një pune të madhe edukative, që është e domosdoshme ta bëjnë Partia dhe organizatat e masave jo vetëm nga ana propagandistike, por edhe konkretisht në praktikë. Ajo që bëjnë tani dhe që duhet të bëjnë në të ardhmen aktivistët vullnetarë, kur puna e tyre konkretizohet në praktikë, është një ndihmë e madhe për policinë.

Rëndësi ka çështja që ne të kemi një trupë të policisë të organizuar e të edukuar mirë, që të njohë me themel ligjet dhe politikën e Partisë, të jetë politikisht dhe ideologjikisht e ngritur dhe të ketë fituar respektin e qytetarëve, të pushtetit dhe të Partisë, respekt që Policia jonë Popullore e fiton vetëm me punë.

Pavarësisht nga dobësitë dhe nga disa të meta, mendoj se, në përgjithësi, me atë nivel kulturor që ka sot efektivitë e policisë, punonjësit e këtij sektori janë përpjekur ta kryejnë ndershmërisht, në rrugën e Partisë dhe në mënyrë të kënaqshme detyrën që u është ngarkuar. S'ka dyshim që kjo detyrë mund të kryhej edhe më mirë, por për këtë duhet të jepet edhe ndihma e nevojshme.

Në radhë të parë të mos nënvleftësohen paragjykimet që ekzistojnë lidhur me policinë. Vështirësitë që hasen ndër të rinj të qytetit për t'u futur në polici tregojnë se ekzistojnë disa paragjykime për këtë sektor të rëndësishëm. Këto bëjnë që disa të mos e çmojnë si

duhet rolin e policit dhe detyrën e tij ta kuptojnë jo drejt. Po ta kuptonte si duhet i riu rëndësinë e armës së policisë, siç e kupton në të vërtetë Partia, me dëshirë të madhe do të kërkonte të bëhej polic, sepse policia është një nga armët më të domosdoshme të diktaturës sonë, që ka të bëjë ditë e natë me popullin, me ligjet, me politikën e Partisë. Përse futja në ushtri ose në organet e Sigurimit të Shtetit kuptohet drejt dhe të rinjtë janë kurdoherë të gatshëm të shërbejnë në to, kurse në polici jo? Kjo ndodh sepse mjaft të rinj, sidomos nga radhët e rinisë shkollore, nuk e kuptojnë drejt rolin e policisë.

Policia Popullore është armë e diktaturës së proletariatit, armë e Partisë. Punonjësit e saj janë nga njerëzit më të mirë të Partisë, ata kanë detyra të rëndësishme, të lavdërueshme, prandaj edhe kujdesi e respekti ndaj tyre të jenë në lartësinë e duhur. Shokët e Partisë e të pushtetit në rrethe të kujdesen për nevojat që kanë punonjësit e policisë, për shembull, për strehim. Është e vërtetë që nevojat për strehim janë të mëdha dhe ne e dimë se nuk ka mundësi t'u jepet të tërëve menjëherë shtëpi, por për këtë duhet të ketë një plan që të plotësohen edhe kërkesat për punonjësit e policisë. Kjo të kihet parasysh, se, ndërsa një tornitor punon 8 orë dhe pasi lë punën çdo gjë e gjen në rregull kur kthehet në shtëpi, ku çlodhet, mëson, bisedon, del edhe shëtitje ose vete në kinema, polici vazhdon të jetë në punë, bile mund t'i ndodhë që edhe të përleshet me ndonjë kriminel, pse ky zanat ka edhe rreziqet e veta. Mua më kanë ardhur letra nga punëtorë të policisë, në të cilat më shkruajnë se kanë disa

vjet që shërbejnë në këtë armë dhe nuk ua bëjnë pasaportizimin. Kjo nuk është e drejtë, prandaj të shikohet, se kështu nuk ka si të zbatohen urdhëresat.

Shumë e drejtë është edhe çështja që ngriti shoku Rita [Marko]. Në Durrës mund të ketë me dhjetëra policë, po kjo nuk do të thotë që këta ta kenë syrin nga të katër anët dhe të tjerët t'i lënë të tëra dyert e penxheret hapur, paratë të shpërndara andej e këndeje dhe t'ia futin gjumit, duke u nisur nga mendimi se çdo gjë ua ruan policia. Jo, për këtë ekzistojnë edhe disa rregulla, që duhen zbatuar me rreptësi. Në qoftë se dikush e lë automobilin ku t'i dojë qejfi, edhe atje ku nuk lejohet, dhe atë ia dëmtojnë, policia do të përpiqet ta zbulojë dëmtuesin, por nuk mban asnjë përgjegjësi për dëmin. Prandaj, në qoftë se një shofer kërkon të qëndrojë diku, automobilin duhet ta lërë në vendin e caktuar të qëndrimit, ku nuk lëviz as qimja, pse ajo zonë është edhe nën kontrollin e policit, ndërsa kur e fut në qorrsokak, për arsye të ndryshme, atëherë përgjegjësinë e ka vetë.

Një problem tjetër me rëndësi është edhe edukata dhe qëndrimi që duhet mbajtur nga ana e qytetarëve ndaj policëve. Organet e Partisë e të pushtetit duhet të qëndrojnë më afër policisë, të bisedohet me punonjësit e saj jo vetëm në formë të organizuar. Është e nevojshme që këta të trajtohen ngrohtë nga e gjithë shoqëria dhe veçanërisht nga shokët drejtues të Partisë e të pushtetit, nga kuadrot dhe nga komunistët, të cilët duhet të luftojnë çdo pikëpamje të gabuar që mund të ekzistojë për punonjësit e policisë. Polici është njeri i Partisë, ai për vetë natyrën e shërbimit

që kryen duhet konsideruar dhe është, në fakt, edhe një aktivist shoqëror, prandaj me të nuk bisedohet ngahera vetëm për çështje pune e shërbimi, por edhe për çështje shoqërore e kulturore, për letërsi, për një film etj.

Policët në vendin tonë janë në shërbim të pushtetit popullor dhe në mbrojtje të rendit publik. Kur më jepet rasti të takohem me policë, unë u shtrëngoju duart, se i dua dhe ushqej respekt e dashuri të sinqertë për ta. Natyrisht, këtë e bëjnë edhe shokë të tjerë të Partisë e të pushtetit. Policët meritojnë respektin dhe dashurinë e gjithë shoqërisë sonë socialiste, pse ata kryejnë detyra me rëndësi në shërbim të popullit e të Partisë.

Këto që thashë mund të duken si gjëra të vogla, po kanë shumë rëndësi, prandaj t'i kemi kurdoherë mirë parasysh. Nga ana tjetër, ne duhet të marrim dhe ato masa që propozojnë shokët, të cilat përpara se t'ia rekomandojmë Qeverisë, duhen studiuar edhe një herë me kujdes.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

LUFTA E ARMATOSUR E POPULLIT PALESTINEZ ËSHTE E PAMPOSHTUR

Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»

21 janar 1970

Fitoret e shkëlqyera të arritura nga rezistenca palestineze në luftën kundër pushtuesve izraelitë shënojnë lindjen e një faktori krejtësisht të ri e vendimtar në realitetin e Lindjes së Mesme dhe të konfliktit arabo-izraelit. Fjala është për afirmimin e çështjes kombëtare palestineze, e cila, pas luftës së qershorit 1967, në mënyrë krejtësisht autonome i imponoi gjithë botës njohjen e forcës dhe të personalitetit të saj.

Është e vërtetë se «problemi palestinez» ka ekzistuar që nga dita e parë e krijimit të shtetit të Izraelit, por deri kohët e fundit fuqitë e mëdha imperialiste, duke përfituar edhe nga konfuzioni e përçarjet e botës arabe, ia patën dalë ta lënë prapa derës dhe ta trajtojnë atë vetëm si një problem refugjatësh, që duhen «ndihmuar» e «sistemuar» për t'i harruar atdheun e tyre dhe fytyrën e vet kombëtare. Ato kërkonin të forconin me çdo kusht shtetin e Izraelit, për ta pasur xhandar të interesave të tyre në Lindjen e Mesme dhe

t'i përçanin vendet arabe, me qëllim që të shfrytëzonin pastaj vështirësitë e tyre për depërtim e sundim kolonialist në këtë zonë. Nuk mbahen mend sa rezoluta, projekte, sugjerime, ndërmjetësime etj. janë adoptuar e ndërmarrë në emër të OKB-së nga fuqitë e mëdha, të cilat e manipulojnë dhe e drejtojnë atë. Por në të gjitha këto «dokumente» e «plane» ka munguar vazhdimisht çështja palestineze si çështje kombëtare, si problem kryesor i Lindjes së Mesme, që është i veçantë nga konflikti i përgjithshëm arabo-izraelit. Kjo «harrësë» vihet re edhe në rezolutën famëkeqe të OKB-së të 22 nëntorit 1967, të manipuluar nga imperialistët amerikanë e revizionistët sovjetikë, të cilën me të drejtë populli palestinez e ka hedhur poshtë si krejtësisht të papranueshme.

Të gjitha këto tregojnë qartë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik, të cilët kanë futur thellë duart e tyre në konfliktin e Lindjes së Mesme dhe që pretendojnë ta vënë veten në pozitën e «arbitrit ndërkombëtar», jo vetëm nuk e duan, por e mbytin me çdo mënyrë zgjidhjen e problemit nacional palestinez. Qëndrimi i tyre nuk është vështirë të shpjegohet. Të dyja palët duan të ruajnë interesat e vet imperialistë që kanë në këtë zonë, t'i zgjerojnë ata dhe të krijojnë kushte të favorshme për intensifikimin e mëtejshëm të planeve të tyre ekspansioniste e hegjemoniste.

Zgjidhja e çështjes nacionale palestineze do të prekte medoemos Izraelin, të cilin Shtetet e Bashkuara të Amerikës e nxitin dhe e përdorin si vegël për realizimin e planeve të tyre armiqësore kundër vendeve

arabe, si bazën kryesore të mbështetjes dhe të depërtimit të tyre imperialist në Lindjen e Mesme, ndërsa për revizionistët sovjetikë kjo do të thoshte zhdukje e asaj gjendjeje të rëndë e të komplikuar të krijuar në atë zonë, të cilën ata e shfrytëzojnë për qëllimet e tyre hegjemoniste. Llogaritë e klikës Brezhnjev-Kosigin mbështeten në kërcënimin e përhershëm izraelit ndaj vendeve arabe, në shpresën se nga nevoja këto do t'i drejtohen Moskës dhe do të pranojnë kushtet e saj të diktatit. E vetmja gjë që dëshirojnë me të vërtetë të dyja fuqitë e mëdha imperialiste, është shuarja e luftës së ligjshme antiimperialiste e antisioniste të popujve arabë dhe në mënyrë të veçantë e luftës nacionalçlirimtare të popullit palestinez, ruajtja e gjendjes së nderë dhe shfrytëzimi i tragjedisë së popujve arabë për grabitjen e pasurive të tyre natyrore dhe për shfrytëzimin e pozitave strategjike të Lindjes së Mesme.

Por tani lufta partizane popullore palestineze u ka kallur tmerrin si imperialistëve amerikanë, ashtu edhe revizionistëve sovjetikë. Ata ndodhen sot përpara faktit kur për të jo vetëm nuk mund të heshtin, por edhe nuk mund ta mposhtin. Izraeli, megjithëse i armatosur deri në dhëmbë me mjetet më moderne nga i gjithë reaksioni ndërkombëtar, po tronditet e po shkallmohet çdo ditë e më shumë nga lufta çlirimtare, të cilën partizanët trima palestinezë e kanë ndezur në të katër anët. S'ka asnjë dyshim se kriza që ka kapur shtetin e Izraelit në të ardhmen do të thellohet edhe më tej. Fakt është se rezistenca palestineze, me gjithë përpjekjet që janë bërë për ta diskredituar e për ta shtypur, është rritur e është zhvilluar gjithnjë më shumë, duke

i dhënë grushte dërrmuese gjithë politikës imperialiste e revizioniste në Lindjen e Mesme dhe duke shkaktërruar manovrat e intrigat e saj të gjertanishme. Rritja e rezistencës palestineze në një luftë të organizuar nacionalçlirimtare, me një program të qartë që u përgjigjet interesave kombëtarë të popullit palestinez e që lidhet ngushtë me tërë luftën antiimperialiste të popujve arabë, dëshmon se vendet e Lindjes së Mesme tanimë janë plotësisht në gjendje t'u bëjnë ballë me sukses si forcës së armëve të pushtuesve të huaj, ashtu edhe manovrave diplomatike të imperialistëve e të revizionistëve.

Megjithëkëtë nuk duhet menduar se të gjitha rreziqet që u kanosen popujve arabë, e në mënyrë të veçantë atij palestinez, janë zhdukur ose janë pakësuar. Imperialistët e revizionistët zotërojnë mjete të mëdha, dinë të manovrojnë dhe të shfrytëzojnë çdo pasiguri e lëkundje. Ata nuk do të heqin dorë kurrë nga qëllimi që t'i detyrojnë vendet arabe të kapitulojnë, e sidomos nga qëllimi që të asgjësojnë forcat e armatosura palestineze dhe të varrosin përgjithnjë problemin kombëtar palestinez. Këtyre qëllimeve u shërbejnë rezolutat e OKB-së dhe planet e saj të ndërmjetësimit, që nuk janë gjë tjetër përveçse fryt i komplotit antiarab të qeverive amerikane e sovjetike, ose bisedimet dypalëshe e katërpalëshe që organizojnë ato për të arritur gjoja në një zgjidhje politike të problemeve të Lindjes së Mesme.

Sidomos një rrezik të madh për luftën antiimperialiste e çlirimtare të popujve arabë paraqesin revizionistët sovjetikë, të cilët u hiqen si miq, ndërsa në

të vërtetë janë armiq të tyre, jo më pak të egër e të djallëzuar se edhe imperialistët amerikanë. Armiqësia e tyre ndaj çështjes arabe ka qenë kurdoherë e prani-shme, në çdo kohë dhe në çdo etapë të konfliktit të gjatë arabo-izraelit. Në mënyrë të veçantë ajo është shfaqur kundër popullit palestinez, luftës së armatosur dhe çështjes së tij nacionale. Revizionistët sovjetikë deri sot kanë mbajtur një heshtje prej varri ndaj problemit nacional palestinez, sikur ai të mos ekzistonte fare, sikur ai të mos ishte pjesë përbërëse e një problemi të madh ndërkombëtar, për të cilin ata thonë se «preokupohen» shumë, se janë gjoja mbrojtës të së drejtës së popujve për vetëvendosje, liri e pavarësi. Për më tepër, ata e kanë kundërshtuar me sa kanë mundur luftën e armatosur të popullit palestinez, duke e quajtur atë, në një kor me propagandën imperialiste, «veprime terroriste», «provokacione», «akte negative ekstremiste» etj. Krerët e Moskës janë munduar, sidomos, të krijojnë në vendet arabe mosbesim ndaj rezistencës palestineze, duke sugjestionuar se me veprimet e saj luftarake kundër Izraelit ajo pengoka zgjidhjen e konfliktit, se i nxiti sionistët të ndërmarrin raprezalje etj. Ata kryenin po atë punë që bënte edhe imperializmi amerikan, i cili kërkonte, nga ana e tij, t'u impononte vendeve të veçanta arabe paqe me Izraelin, me kusht që ato të ndalonin aktet e veprimtarisë së partizanëve palestinezë në territoret e tyre.

Tani që lufta e armatosur e popullit palestinez jo vetëm që nuk u shua, por u zgjerua edhe më tepër, duke u bërë një faktor determinues në Lindjen e Mesme, sundimtarët e Kremlinit ndryshuan taktikë. Kohët

e fundit në shtypin revizionist sovjetik dhe në deklaratat e udhëheqësve revizionistë vihet re një kthesë njëqindtetëdhjetëgradëshe. Me një hipokrizi e demagogji të pashembullt, ata pretendojnë se «përkrahin» luftën e armatosur palestineze dhe se janë të gatshëm ta «ndihmë». Kuptohet se këtu nuk është fjala as për përkrahje, as për ndihmë. Qëllimi i tyre në situatën e re të krijuar është që t'i lidhin pas qerres së tyre forcat e armatosura palestineze, t'i mashtrojnë e t'i përçajnë ato. Duke dhënë disa armë, ata do të përpiqen të hedhin në dorë kontrollin e luftës nacionalçlirimtare palestineze, ta mbajnë atë brenda kuadrit që u përshtatet interesave të tyre hegjemonistë dhe koniunkturave që krijohen në bashkëpunimin dhe në konkurrencën me imperializmin amerikan. Është në natyrën e revizionistëve dhe të metodave të tyre të egra që, tok me armët, të vënë edhe konditat, që bashkë me to të kërkojnë dërgimin në vend edhe të «këshilltarëve», «specialistëve», spiunëve, sabotatorëve etj., me anë të të cilëve të arrijnë qëllimet e tyre. Rezistencën palestineze, po ta hedhin në kllapë, ata do të kërkojnë ta përdorin pastaj si monedhë shkëmbimi për të rregulluar pazarllëqet e ndyra me imperializmin amerikan në Lindjen e Mesme e në zona të tjera të botës.

Ajo që kanë më tepër frikë imperialistët, revizionistët dhe gjithë reaksionarët është lufta partizane popullore. Kur nuk u shkojnë presioni, kërcënimi dhe mjetet e tjera të frikësimit, ata përpiqen ta pengojnë e ta shuajnë atë me demagogji e mashtrim. Këtë po orvaten të bëjnë tani edhe revizionistët sovjetikë ndaj lëvizjes nacionalçlirimtare të Palestinës.

Populli palestinez, që lufton për një çështje të drejtë dhe që i ka provuar në shpinën e tij gjatë këtyre njëzet vjetëve të gjitha mashtrimet, hipokrizitë, gënjeshtat e shpifjet e fuqive të mëdha imperialiste, nuk mund të mos e kuptojë se dora që gjoja i shtrijnë revizionistët sovjetikë është një dorë që kërkon ta zërrë për fyti dhe ta mbytë. Ai nuk mund të mos e kuptojë se krerët që sundojnë sot në Moskë janë aleatë të imperialistëve amerikanë, se për interesat e tyre imperialistë ata janë të gatshëm të sakrifikojnë interesat më të lartë të çdo populli, duke përfshirë edhe ata të popullit palestinez. Në qoftë se revizionistët sovjetikë u detyruan të pranojnë tani «të njohin» luftën e armatosur të popullit palestinez, këtë ua imponoi lufta heroike e partizanëve, burrave e grave të Palestinës. Do të jetë përsëri po kjo luftë që do të bëjë të dështojnë edhe intrigat e tyre të reja, përpjekjet e tyre për të sabotuar nga brenda rezistencën palestineze, për ta shndërruar atë në një bisht të politikës së tyre hejgemoniste e skllavëruese.

Populli shqiptar, i cili është solidar dhe përkrah nxehtësisht popullin vëlla palestinez, ka besim të plotë se lufta e tij partizane popullore do të triumfojë mbi armiqtë e shumtë sionistë e imperialistë dhe do t'i bëjë hi e pluhur të gjitha intrigat e komplotet që ata kurdisin për ta lënë atë pa atdhe dhe në skllavëri të përjetshme.

Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 17 (6681), 21 janar 1970

Botohet sipas librit: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 565

TU VIHET MË SHUMË RËNDËSI GJYKATAVE TË FSHATRAVE DHE TË QYTETEVE

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit
të Kuvendit Popullor¹*

24 janar 1970

Raporti i paraqitur në Presidium nga shokët e Gjykatës së Lartë mendoj që e pasqyron qartë funksionimin dhe veprimtarinë e gjykatave të fshatrave, të qyteteve dhe të lagjeve të qyteteve, të cilat kanë shërbyer si për gjykimin e çështjeve konkrete, ashtu edhe për ngritjen ideopolitike të masave të popullit. Pikërisht për këto arsye krijimi i tyre para një viti ka rëndësi të madhe. Puna e gjykatave zhvillohet në mënyrë komplekse, sepse objekti i çështjes konkrete që sillet për gjykim, që diskutohet dhe, më në fund, zgjidhet me vendim, e ka burimin te disa shkaqe, siç janë shfaqjet mikroborgjeze dhe mbeturinat e së kaluarës, të cilat

¹ Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit për veprimtarinë e gjykatave të fshatrave, të qyteteve dhe të lagjeve të qyteteve, paraqitur nga Gjykata e Lartë.

manifestohen nga disa njerëz me veprimet që bëjnë në dëm të shoqërisë, në dëm të kolektivit.

Pasi gjykohen çështjet penale, civile ose kundërvajtjet, që janë në kompetencën e këtyre gjykatave, përcaktohet dhe rruga e shlyerjes së fajit me masa edukative e politike dhe me masa të lehta penale ose me masa administrative. Pra, sikurse thashë, bëhet kështu një gjykim kompleks, sepse harmonizohet masa edukuese me masën penale ose administrative. Në këto kushte gjykatat e fshatrave, të qyteteve dhe të lagjeve të qyteteve marrin një rëndësi të veçantë për punën e Partisë me masat, sepse Partia, siç dihet, ka marrë përsipër detyrën që të udhëheqë luftën kundër të gjitha mbeturinave dhe shfaqjeve borgjeze e mikroborgjeze, që t'i edukojë njerëzit politikisht. Në këtë punë këto gjykata ndihmojnë shumë.

Nëpërmjet gjykatave i vihet gishti elementit të sëmurë që i ka më të theksuara shfaqjet e huaja dhe që vepron në kundërshtim me politikën e Partisë dhe me ligjet e shtetit. Kjo është arsyeja që Partia këtyre gjykatave duhet t'u vërë rëndësi të veçantë. Por mund të themi se kjo punë nuk është bërë mirë gjer tani dhe bile, në përgjithësi, është neglizhuar. Partia duhet t'u vërë më shumë rëndësi këtyre organizmave të rinj shoqërorë me karakter thellësisht popullor, në radhë të parë, duke aktivizuar në ta njerëz me qëndrim të mirë politik. Por vetëm kjo nuk është e mjaftueshme. Shokët që punojnë në këto gjykata duhet të jenë të aftë për të vepruar si propagandistë të Partisë, duke u marrë drejtpërdrejt me elementin konkret që ka vepruar në kundërshtim me ligjin. Ata duhet ta vënë si

duhet përpara fakteve dhe përpara gjykimit të masës këtë element konkret, me qëllim që nga veprimi i tij i kundërligjshëm të nxirren mësim nga masa.

Për të arritur këto synime të mëdha, duhet, pra, që në gjykata të veprojnë njerëz të ngritur politikisht dhe ideologjikisht, të cilët detyrën si gjyqtarë ta çmojnë shumë e të mos e lënë si detyrë të dorës së fundit, nën pretekstin se Partia u ka ngarkuar detyra të tjera. Ai që e kupton përçiptas këtë detyrë të rëndësishme, nuk e ka kuptuar vijën e Partisë në këtë sektor. Ka më shumë rëndësi që gjyqtari të gjykojë një çështje të tillë sesa të bëjë dy konferenca për probleme të tjera. Prandaj si gjyqtarë duhet të zgjidhen njerëz që jo vetëm t'i kuptojnë drejt ligjet, të kuptojnë në esencë politikën e Partisë që shprehet nëpërmjet akteve ligjore që nxjerrin Kuvendi Popullor, Presidiumi i tij dhe Qeveria, por, në të njëjtën kohë, të dinë t'i interpretojnë e t'i zbatojnë ato drejt, në bazë të vijës së Partisë. Nga ana tjetër, gjyqtarët duhet të njohin mentalitetin dhe prirjet e gjithsecilit, shkallën e fajit dhe rrezikshmërinë e veprës e të personit që ka shkelur ligjin dhe, në këtë mënyrë, të dinë të gjykojnë, për shembull, nëse një përsëritës duhet dënuar rëndë apo lehtë, duke vlerësuar në radhë të parë rrezikshmërinë e veprës, ose duhet shfajësuar për mungesë provash etj.

Nëpërmjet këtyre gjykatave, që veprojnë në gjirin e popullit, masat e gjera punonjëse aktivizohen për dhënien e drejtësisë dhe lidhen më ngushtë me Partinë. Kështu, vetvetiu, populli gradualisht forcon pikëpamjen e drejtë se demokracia jonë socialiste

shkon drejt zgjerimit të pandërprerë dhe se s'ka gjë më të drejtë sesa vija e Partisë. Kur gjyqtari, duke zbatuar metodën e bindjes dhe të edukimit e duke u mbështetur në pendimin e sigurtë dhe në autokritikën e fajtorit, pushon gjykimin e çështjes penale ose të kundërvajtjes, populli do ta aprovojë atë, ashtu sikurse do të aprovojë edhe dënimin me gjobë të kundërvajtësit, pse ka besim te gjyqtari, që është njeri i Partisë. Ja përse është e domosdoshme që këta njerëz të mos zgjidhen sidokudo, por të zgjidhen më të mirët dhe të mos lihen pa përkrahje. Të veprohej ndryshe, do të ishte gabim. Zgjedhja e njerëzve të tillë ka rëndësi të madhe, sepse ata, duke gjykuar objektivisht dhe në rrugën e Partisë çështjet që u paraqiten, do të vënë në vend drejtësinë dhe do të luftojnë burokratizmin e çdo shfaqje tjetër negative në shoqërinë tonë.

Në këto gjykata njerëzit duhet të jenë ekspeditivë¹. Kjo nuk do të thotë që çështja të gjykohet shkel e shko, përkundrazi, do të thotë që të zbulohen me shkathtësi situatat, rrethanat e çështjes, faji e fajtori dhe këto përfundime t'i vihen në dukje edhe masës, e cila të mësojë t'i respektojë vullnetarisht ligjet e shtetit që shprehin vullnetin e saj.

Në gjykimin nga ana e këtyre gjykatave i duhet vënë rëndësi, në radhë të parë, aspektit politiko-edukativ, por nuk duhet lënë pas dore edhe çështja e dënimeve dhe e dëmshpërblimeve për dëmet që i bëjnë shoqërisë individë të veçantë. Me gjithë punën e madhe edukuese që duhet të bëhet, prapëseprapë, me-

1 Nga frëngjishtja — të shpejtë, operative.

ndoj unë, zbatimi i dënimeve do të jetë i paevitueshëm. Natyrisht, kryesia e Gjykatës së Lartë e kupton këtë problem, pse ajo ka eksperiencën e saj.

Nuk përjashtohet që në praktikë në ndonjë rast jepet gjykim jo i peshuar mirë, masa dënimi herë më të rënda, herë të lehta. Kjo mund të ndodhë, sepse disa herë ata që gjykojnë nuk janë të ngritur politikisht dhe, si të gjithë njerëzit, nuk janë krejt të pas-truar nga mbeturinat mikroborgjeze. Natyrisht, dobësi të tilla do të shmangen në punë e sipër dhe do të korrigjohen nga diskutimet popullore, nga ngritja ideologjike e gjyqtarëve etj. Këto çështje i dinë e duhet t'i kenë mirë parasysh shokët e Gjykatës së Lartë.

Partia duhet të luftojë që këto gjyqe të bëhen publike dhe pa formalizëm, të përgatiten mirë dhe, kur të zhvillohen në masë, të gjendet momenti më i përshtatshëm për lagjen dhe fshatin, dua të them kur njerëzit të jenë të lirë nga punët, me qëllim që pjesëmarrja e tyre të jetë sa më e madhe dhe gjykimi të bëjë sa më tepër efekt edukues. Gjyqtarët ta kenë mirë parasysh se nuk dalin përpara masave vetëm për të gjykuar personin që ka kryer fajin, por sidomos edhe për t'i edukuar vetë masat. Këtë duhet të mos e harrojnë kurrë. Po ta kuptojnë mirë këtë kërkesë të Partisë, shokët gjyqtarë do të bëjnë përpjekje për përgatitjen sa më serioze të gjyqeve. E theksoj këtë se ka disa shokë që orvaten të tregojnë zotësinë duke e zgjatur arsyetimin e vendimit sipas disa rregullave të ngurta procedurale, duke vënë në dukje edhe ato gjëra që s'duhën ose që i njeh masa, ndërsa harrojnë kryesoren, që nëpërmjet gjykimit të edukojnë masat.

Prandaj duhet të luftohet, sa të jetë e mundur, që të thjeshtohet procedura e gjykimit në të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor, pa u ndikuar nga sistemi i vjetër procedural. Sigurisht, në këtë drejtim ka përparime të mëdha, por duhet thënë se ka akoma mjaft punë për të bërë. Unë nuk them të hiqen nga procedura gjërat e nevojshme, por mendoj të spastrohet rutina, e cila na ka lënë mjaft gjëra që nuk pajtohen me natyrën popullore të gjykatave tona.

Për gjykatat nuk duhet të interesohet vetëm Partia, por edhe organet e pushtetit, domethënë këshillat popullorë, të cilët është nevoja të tregojnë një interesim të madh për to. Këshillat popullorë duhet të kujdesen për të gjithë veprimtarinë e gjykatave, ata lypset të njohin jo vetëm detyrat e tyre, por edhe detyrat e gjykatave, si dhe «fijet» që i lidhin me këto gjykata. Këto «fije» të lidhjes së tyre nuk duhen këputur, por të forcohen, përndryshe nuk zbatohen drejt as ligjet. Gjykatat e fshatrave, të qyteteve e të lagjeve të qyteteve vërtet kanë lidhje me gjykatat e rretheve, por kjo nuk i shkarkon aspak këshillat popullorë nga detyra që të njohin mirë rolin dhe kompetencat e gjykatave dhe t'i ndihmojnë ato për kryerjen sa më mirë të funksioneve të tyre.

Nuk është e lejueshme për organet e pushtetit që të shkelin afatet e dërgimit të çështjeve në gjyq. Të grumbullosh 200 raste kundërvajtjesh dhe pastaj të thuash: «Hajde ti tani dhe gjykoji», sikurse u përmend këtu, do të thotë ta nënvleftësosh fare gjykatën. Në qoftë se veprohet në bazë të kësaj procedure që imponon këshilli popullor, gjykimet do të bëhen me

shpejtësi të madhe dhe shkel e shko. Ky është veprim i gabuar dhe me pasoja të rënda.

As gjyqtarët nuk duhet të mungojnë që të kërkojnë drejtpërdrejt ndihmën e këshillave popullorë, me qëllim që t'i kryejnë sa më mirë detyrat e ngarkuara. Mund të ketë ndonjë gjyqtar oportunist ose kryeneq, raste të tilla ngjasin në jetë, por Partia i zbulon, i gjykon, i ndreq, çështja është që kompetencat e tyre duhet të respektohen, të zbatohen drejt dhe të punohet që bashkëpunimi dhe besimi midis organeve të pushtetit dhe gjykatave të forcohen. Gjyqtarët kanë besim ndaj të zgjedhurve në këshillin popullor, por dhe këta duhet të kenë besim të plotë te njerëzit e zgjedhur në gjykatë. Çdo anëtar partie dhe patriot ka për detyrë të zbatojë kompetencat e tij me përpikërinë më të madhe dhe në qoftë se ka vend për kritikë, duhet të kritikojë, por në mënyrë arbitrare dhe pa vendosur besimin reciprok nuk mund të veprohet. Po të mos i ndreqim të metat në këto drejtime, nuk do të jemi në regull.

Ka shumë rëndësi të shikohet me kujdes vlerësimi i drejtë dhe jo i njëanshëm e mbi baza subjektive i gjyqtarëve të fshatrave, të qyteteve dhe të lagjeve të qyteteve nga organet e Partisë e të pushtetit ku ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre si aktivistë shoqërorë, të cilët, siç dihet, janë edhe ndihmësgjyqtarë të gjykatave të rretheve. Kam përshtypjen se qoftë nga komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, qoftë nga vetë këshillat popullorë ka ngurrime për t'i ndihmuar gjykatat dhe vihen re shenja nënvleftësimi ndaj tyre.

Këtej del detyra që duhet t'u vihet më shumë rëndësi gjykatave, sipas mendimit tim, në këto drejtime:

1. Në zgjedhjen e gjyqtarëve në mënyrë të studuar mirë e me shumë kujdes.

2. Në edukimin politiko-ideologjik të tyre. Partia, më duket mua, duhet ta vlerësojë edukimin e gjyqtarëve të këtyre gjykatave në një shkallë ose aty afër me punën edukative që bëhet me sekretarët e organizatave-bazë, sepse këta luajnë një rol të madh edukues në zbatimin e vijës së Partisë.

3. Kujdes i madh duhet të tregohet edhe për edukimin profesional të gjyqtarëve. Në këtë drejtim duhet të japin ndihmën e tyre gjykatat e rretheve dhe Gjykata e Lartë.

Më në fund, kam një vërejtje për shokët e aparatit të Presidiumit. Raporti që na është paraqitur, siç e thashë në fillim, është shumë i mirë, ndërsa vërejtjet e aparatit më duken të tepërta. Shokët e aparatit të Presidiumit s'ka nevojë të na mbushin me shembuj, duke na treguar se ngjau kështu ose ashtu në filan fshat etj. Çfarë ngjet andej u duhen më shumë gjykatave të bazës dhe Gjykatës së Lartë, ndërsa neve këtu në Presidium na duhen më tepër konkluzione.

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

DISKUTIMI MASIV DO TA MØBILIZOJË POPULLIN PËR HARTIMIN DHE PËR ZBATIMIN E PLANIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 shkurt 1970

Shokët diskutuan gjerësisht rreth relacionit të paraqitur nga Komisioni i Planit të Shtetit për paraprojektplanin e pesëvjeçarit të pestë. Këto diskutime ishin shumë të mira e të vlefshme, sepse në to u ngritën dhe u rrahën mjaft probleme interesante, parimore, praktike, operative dhe konkrete. Ky zhvillim progresiv i ekonomisë sonë, të gjitha këto suksese që janë arritur nga Partia, nga punonjësit dhe nga kuadrot, si dhe këto diskutime kaq të vlefshme duhet të na shërbejnë për të ndërtuar në përgjithësi drejt dhe realisht planin e ardhshëm pesëvjeçar.

Realizimin e planit të katërt pesëvjeçar, sigurisht, do ta shikojmë më vonë, por, sipas mendimit tim, edhe

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth relacionit «Mbi paraprojektplanin për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës popullore gjatë pesëvjeçarit të pestë 1971-1975», paraqitur nga Komisioni i Planit të Shtetit.

tani që kanë kaluar katër vjet, mund të themi praktikisht që rezultatet e arritura janë inkurajuese për plotësimin e këtij plani, sepse detyrat që vuri Kongresi i 5-të i Partisë janë realizuar me sukses, bile janë tejkaluar. Natyrisht, për tejkalimet është dashur të shtohen edhe investimet, që janë shfrytëzuar në interes të ekonomisë popullore, por të mos harrojmë se në këtë drejtim ka ndikuar shumë edhe hovi revolucionar i masave punonjëse, i klasës punëtore, i kuadrove, i të gjithëve. Realizimi dhe tejkalimi i detyrave të planit deri tani janë një bazë e mirë për të ecur përpara.

Në planin e ardhshëm pesëvjeçar duhet të përcaktojmë detyra të realizueshme, që edhe të na mobilizojnë për përpjekjet e mëdha dhe sakrificat e vazhdueshme që duhet të bëjmë. Gjatë viteve të ardhshme duhet të rritet akoma më shumë ndjenja e përgjegjësisë për realizimin e planit të të gjithë punonjësit e, në radhë të parë, të ne udhëheqësit e Partisë e të shtetit në qendër dhe në bazë. Është detyra jonë të qëndrojmë në pararojë dhe të jemi shembull në çdo drejtim.

Shokët që punojnë në bazë luftojnë me vështirësi-të, por ndaj atyre, zakonisht, bëhen kritika më shumë sesa ndaj njerëzve me përgjegjësi. Kjo gjë nuk shpjegohet me druajtjen e njerëzve për të kritikuar shokët me përgjegjësi, por me faktin se kuadrot e organeve qendrore, megjithëse nuk qëndrojnë duarlidhur dhe janë në korent të vështirësive të punës në bazë, nuk ndeshen drejtpërsëdrejti e çdo ditë me vështirësitë e shokëve tanë që punojnë në gjirin e masave.

I them këto për të treguar se në studimet që bëhen dhe në vendimet ose në udhëzimet që jepen nga

organet qendrore duhet të ketë akoma më shumë përgjegjësi, disiplinë e pjekuri, me qëllim që të ndihmohet puna. Kuadrot e çdo kategorie kanë të drejtë të kritikojnë, por duhet edhe të kritikohen dhe t'i kuptojnë drejt kritikën. Shumë herë bie rasti të kritikohet ndonjë shok për të metat e punës në sektorin e vet, por kjo nuk do të thotë aspak se ulet respekti për punën e tij ose përpjekjet e tij për të kryer detyrën errësohen. Këtu në Byronë Politike i kritikojmë të tjerët për të metat, por edhe ne vetë nuk i parashikojmë të gjitha gjërat si duhet, pra edhe ne të tjerët duhet të bëjmë përpjekje të mëdha, se nuk jemi pa gabime dhe pa të meta. Mendoj që kur kritikojmë shfaqjet e burokratizmit apo kur diskutojmë për punët e një sektori, për organizimin e punës etj., duhet të nxjerrim edhe ne përgjegjësinë tonë, të reagojmë e të reflektojmë thellë.

Në vija të përgjithshme orientimet që jepen në relacionin e përgatitur për planin e ardhshëm pesëvjeçar, mund t'i konsiderojmë si një bazë të mirë për hartimin përfundimtar të këtij plani. Por, sikurse u vërtetua dhe në diskutimet e shokëve, paraprospekti ka edhe të meta, sidomos në paraqitjen dhe në përpunimin e tij. Forma në të cilën na u paraqiti ai nuk është e përshtatshme, prandaj duhet parë dhe duhet ndryshuar jo vetëm për Byronë Politike, kur t'i paraqitet përsëri, por edhe për ministritë, edhe për bazën. Forma e punës që kanë ndjekur shokët e Komisionit të Planit të Shtetit, duke e bërë plotësisht planin nga a-ja deri te zh-ja, do të thotë që, qoftë Byroja Politike, qoftë dikasteret, qoftë baza, të mos kenë

çfarë të thonë, ose të thonë vetëm disa gjëra të vogla. Po a është e përshtatshme që në këtë periudhë, kur ne përpunojmë orientimet kryesore të direktivave të planit pesëvjeçar, të procedojmë sikur kemi arritur në atë shkallë që i kemi përcaktuar këto direktiva? Mua nuk më duket e përshtatshme që këto direktiva t'ua japim tash ministrive dhe bazës, duke u thënë që u morën parasysh të gjitha diskutimet e vërejtjet e tyre dhe tani mund të bëjnë ndryshime deri në njëfarë marzhi, por jo më shumë, se gjithçka është konsumuar.

Ky nuk është një problem thjesht organizativ, por edhe parimor. Në qoftë se ne pranojmë dhe marrim parasysh diskutimet, sugjerimet dhe propozimet e bazës për hartimin e planit dhe këtë metodë pune e kemi në parim, atëherë duhet t'ua lëmë me të vërtetë të hapura rrugët për diskutim dikastereve, ndërmarrjeve dhe kooperativave. Kur themi ta diskutojë një problem ndërmarrja ose kooperativa bujqësore, do të thotë që atë ta diskutojë klasa punëtore ose një masë e konsiderueshme e kooperativistëve dhe jo vetëm drejtoria e ndërmarrjes ose kryesia e kooperativës. I organizuar në këtë mënyrë, diskutimi i planit do të vërë në lëvizje logjikën e fortë të masave, diturinë, eksperiencën e tyre.

Natyrisht, Komisioni i Planit të Shtetit për vete dhe për Byronë Politike ka përgatitur një material, në bazë të të cilit ministrive dhe bazës u përcaktohen disa orientime të padetajuara që për ne janë një limit, një *plafond*¹ për disa gjëra, por jo për të gjitha. Këtë ta

1 Frëngjisht — tavan. Këtu me kuptimin cak.

kemi parasysh, pse, veç të metave të tjera, paraqitja e planit në këtë mënyrë, me detyra cip më cip, shtrënguar e llogaritur pa rezerva, qoftë materiale ose në devizë, vështirëson punën për zgjidhjen e problemeve të paparashikuara që mund të dalin.

Për një sërë çështjesh, që ne po i shtrojmë ditë-ditës, masat e popullit, punëtorët mund t'i ngrenë detyrat e planit. Këtu duhet pasur kujdes që të sqarohen masat për orientimet e përgjithshme dhe për kushtet tona, për të mënjanuar rrezikun e ndonjë gjykimi të prirur vetëm nga dëshirat, pa marrë parasysh mundësitë reale. Sidoqoftë, kjo gjë nuk duhet të na trembë, pse diskutimi masiv i çështjeve të ndryshme me masat e gjera të popullit, do të nxitë mendimin krijues, do të rritë hovin revolucionar dhe do t'i mobilizojë ato për hartimin dhe për zbatimin e planit. Kur të shtrohen këto probleme për diskutim në bazë nga shokë drejtues që i dinë mirë mundësitë tona «për t'i shtrirë këmbët sa kemi jorganin», masat do të na kuptojnë drejt dhe do të ndihmojnë shumë. Kjo do të thotë që kur t'i dërgojmë direktivat për t'u diskutuar në masa, t'u parashtrijmë atyre njëkohësisht në vija të përgjithshme që shteti ynë nuk disponon mundësi më tepër se kaq. Kështu ato, me pjekurinë politike që i karakterizon, nuk do të gjykojnë sipas dëshirave të perealizueshme, çka do të ishte e rrezikshme dhe e palejueshme.

Ndryshon problemi kur masat shohin se mund të bëjnë me forcat e veta dyfishin e asaj që parashikohet. Në këto raste secili, duke gjykuar realisht mbi mundësitë kolektive për shfrytëzimin deri në fund të

rezervave të brendshme të rrethit ose të fabrikës, bën propozimin konkret. Kur Komisionit të Planit të Shtetit t'i bëhen nga masat punonjëse propozime të tilla, këto duhet të jenë të shkoqitura mirë, të thuhet, për shembull, që shtesa kërkohet vetëm për 10-20 për qind të planit të propozuar, ndërsa 80-90 për qind të tij do të plotësohen me forcat e vetë ndërmarrjes ose rrethit. Pasi të studiohet seriozisht propozimi i masave nga pikëpamja ekonomike, e nevojave tona dhe e prioritetit që duhet t'i jepet, futet si detyrë në plan, duke u mbështetur në zotimin e masave dhe në fondin rezervë. Kjo është rruga e drejtë e planifikimit, me të cilën mund të ecim përpara.

Kërkesat e pabazuara në mundësitë reale nuk duhen futur në plan, prandaj është vepruar drejt që janë bërë shumë shkurtime nga kërkesat dhe nga propozimet e tepruara të dikastereve. Kështu do të veprohet edhe për propozimet që mund të bëhen nga baza, kur ato nuk do të përputhen me mundësitë dhe me kushtet tona konkrete.

Shokët Hysni, Rita e Manush, si dhe shokët e tjerë në diskutimet e tyre ngritën mjaft gjëra interesante, por sa shumë probleme me vlerë do të ngrenë edhe punëtorët, duke u këshilluar me ta! Si do të veprohej me propozimet e drejta të tyre, në qoftë se do të pranonim një planifikim cip më cip? Punëtorët, ta zëmë, mund të kërkojnë me të drejtë që të ndërtohet një dhomë frigorifer për peshkun, por propozimi i tyre nuk do të planifikohej, se do ta kishim të vështirë t'i siguronim materialet që duheshin për këtë, përderisa çështjet janë vënë në plan, siç thashë, cip më cip.

Po pranuar në parim një hartim të tillë të planit, të jemi të ndërgjegjshëm se gjatë kohës së zbatimit të tij do të detyrohemi ta ndryshojmë shpejt nga kërkesat që vijnë, të cilat, në vështrimin e parë, mund të duken të ekzagjeruara, por, në fakt, mund të jenë të leverdishme nga ana ekonomike. Në rrethana të tilla nuk do të dinim çfarë të bënim, por do të prishnim këndeja e do të rregullonim andej.

Pra, unë mendoj që nuk duhet të parashikohen dhe të planifikohen të gjitha gjërat një për një, se më vonë dalin një mori çështjesh, për realizimin e të cilave duhet të kemi një fond rezervë. Me paraqitjen e shtrënguar të planit nuk na mbeten fonde rezervë, sepse edhe ato që kemi krijuar, janë vetëm për sigurimin e materialeve, të lëndës së parë dhe për sigurimin e ritmikës së procesit të prodhimit të fabrikave e të uzinave ekzistuese, kurse fonde për gjëra të tjera të domosdoshme, që lypsen për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe të prodhimit nuk kemi. Këtij problemi duhet t'i dalim përpara, t'i gjejmë rrugën e zgjidhjes, ndryshe iniciativat e punëtorëve që kërkojnë pajisje të vogla dhe rezultatet e shkencës në zhvillim, për të cilën foli shoku Ramiz, nuk mund të realizohen pa materiale, pra, pa rezerva. Këto mendoj se duhet t'i kemi mirë parasysh gjatë hartimit të këtij plani pesëvjeçar.

Për tërheqjen sa më të gjerë të mendimit të punonjësve të bazës e, në radhë të parë, të klasës punëto-re për hartimin e planit pesëvjeçar kërkohet, sidomos, organizimi më i mirë i luftës kundër shfaqjeve të burokratizmit dhe të teknokratizmit. Nuk mund të themi se shokët e funksionarët nuk bëjnë përpjekje në

këtë drejtim, e vërteta është se ka përpjekje dhe lufta lidhet me perspektivat, por megjithatë kam përshtypjen se në praktikë burokratizmi nuk luftohet thellësisht. Megjithëse punët shkojnë përpara, ato nuk ecin me ritmin që duhet, pse ka shumë pengesa burokratike. Nga çështjet që u ngritën këtu, por edhe nga mjaft të tjera konstatojmë se punonjësit e bazës, klasa punëtore, në radhë të parë, dhe punonjësit e tjerë pyeten përciptazi ose shumë pak për probleme me rëndësi. Ne, patjetër, duhet të kemi besim te kuadrot tanë, se ata janë njerëz të Partisë jo vetëm pse kanë taserën e saj në xhep, por sepse qëndrojnë vazhdimisht, bashkë me ne, në pararojë për zbatimin në jetë të të gjitha direktivave të Partisë dhe të ligjeve të shtetit, që materializojnë këto direktiva. Megjithatë nuk veprohet mirë në ato raste kur dikasteret dhe funksionarët kanë më tepër besim te teknikët e te kuadrot me arsim të lartë, sesa në masën e gjerë të punonjësve.

Mendoj se bazës nuk duhet t'ia dërgojmë të tëra orientimet për planin e ardhshëm që tani, pasi kjo nuk do të ishte mobilizuese. Komisioni i Planit të Shtetit le ta ketë të përgatitur paraprosjektplanin për çdo vit dhe, mbasi të merren të gjitha mendimet e bazës, të jepet i detajuar për çdo vit, ashtu siç është bërë edhe herë të tjera.

Në qoftë se do të bëjmë një kthesë vërtet serioze dhe të thellë në këtë drejtim, do të na hapen horizonte më të gjera. Një nga këto horizonte është edhe hartimi i një plani me të vërtetë real për situatat aktuale, ku do të thonë fjalën me plot zjarr revolucionar punëtori, kooperativisti dhe kuadri. Eksperienca na tregon që,

kur kemi vepruar kështu, rezultatet kanë qenë të mëdha. Është fakt se hovi revolucionar i Partisë dhe i masave është i shkëlqyer.

Mendoj se këta dy-tre vjetët e fundit, kur hovi revolucionar i masave u ngrit në një shkallë të lartë, plani edhe në bujqësi, e cila, me gjithë sukseset e arritura, nuk e ka realizuar detyrën e vënë nga Kongresi i 5-të i Partisë, duhej të ishte realizuar më mirë. Kjo duhet të na bëjë të mendojmë për të ardhmen. Për bujqësinë nuk do të zgjatem, sepse shumë çështje u diskutuan, por kur pashë shifrat që na ishin dhënë në materialin e parë të shpërndarë nga Komisioni i Planit të Shtetit, më tërhoqi vëmendjen ndarja e rendimentit të drithërave të bukës për pesë vjetët e ardhshëm. Duke menduar për këtë gjë, i bëra pyetjen vetes: Pse për vitin 1971 rendimenti i drithërave është caktuar 20 kuintalë për hektar, për vitin 1972 — 21 kuintalë etj.? Për ç'arsye në vitin 1971 të mos marrim 21 kuintalë për hektar, çfarë ndryshimi ka midis vitit 1971 dhe 1972 për sa i përket mekanizimit, ujitjes ose plehrave? Vetëm me një kujdes të veçantë të kooperativistëve gjatë korrjes, stivimit e grumbullimit të grurit, pra duke evituar firot, ne fitojmë një kuintal për hektar. Atëherë mbi ç'bazë është parashikuar ky rendiment dhe ku mbështetet rritja e tij graduale nga viti në vit, apo një gjë e tillë është bërë në mënyrë krejt aritmetike?

Në qoftë se në vitin 1972, që është viti i dytë i pesëvjeçarit të pestë, do të jepnim pleh kimik më tepër se në vitin 1971, atëherë këtë ndarje të rendimentit unë e kuptoj, por ne nuk japim më shumë pleh kimik.

Sipas të dhënave që paraqiten këtu, po kjo sasi plehu do t'i jepet fshatarësisë nga fundi i vitit 1974. Atëherë pse në vitin 1971 të mos marrim rendimentin e vitit 1974, kur do të fillojë shtesa e plehut? Unë e shtroj çështjen kështu: A nuk duhet ne të vëmë një mesatare të arsyeshme, por edhe të domosdoshme? Po ta shtrojmë problemin që në vitin 1975 do të arrijmë rendimentin 26 kuintalë për hektar, kjo mund të na duket e vështirë, por mendoj se nuk duhet ta marrim çështjen kështu, sepse deri në vitin 1975 i thonë edhe gjashtë vjet, kohë gjatë së cilës ne do të zhvillojmë një luftë të fortë organizative, politike, shkencore, që nuk do ta ketë parë deri më sot vendi ynë në fushën e bujqësisë. Gjatë kësaj kohe, qoftë prej punës së ndër-gjegjshme të njerëzve, qoftë prej përdorimit si duhet të të gjitha mjeteve që kemi, si dhe nga masat që do të marrim, kemi mundësi që në vend të 22 kuintalëve për hektar, mesatarisht për të pesë vjetët, të arrijmë 23 dhe 23,5 kuintalë për hektar. Derisa llogaritet që vetëm nga firot humbasim një kuintal për hektar, siç mund të humbasim edhe në ndonjë shërbim tjetër, atëherë, po të forcojmë mobilizimin, plus dhe të gjitha masat që do të marrim, jemi në gjendje ta ngremë prodhimin mesatar për tërë pesëvjeçarin.

Jam dakord me shokët që problemi i bujqësisë paraqitet i vështirë, por jam optimist për realizimin e këtyre që thashë. Natyrisht, rezultatet nuk mund të arrihen pa një punë shumë më të mirë organizative, politike, shkencore dhe disiplinore nga sa është bërë deri tani.

Ta kuptojmë thellë, shokë, që planet kurdoherë

duhet t'i lidhim me situatën politike të brendshme dhe të jashtme. Sikurse u tha këtu, për realizimin e detyrave të planit, në radhë të parë, duhet të mbështetemi në këmbët tona. Kinezëve duhet t'u kërkojmë, pasi t'i arsyetojmë kërkesat tona, aq sa është e domosdoshme dhe aq sa ata do të kenë mundësi të na i japin. Është çështje tjetër nëse do të na i japin të gjitha sa do t'u kërkojmë, por ne, si miq që jemi, e kemi për detyrë t'ua themi nevojat dhe kërkesat tona.

A jemi krejt të sigurt se do të na vijë ndihma e shokëve kinezë? Jo! Atëherë çfarë do të bëjmë? Dy rrugë do të na mbeten: ose të reduktojmë planet tona, gjë që nuk duhet ta bëjmë, ose do të vëmë të gjitha forcat që të marrim të pamundurën, në radhë të parë, nga toka jonë dhe, në të njëjtën kohë, të shfrytëzojmë në maksimum makineritë tona, industrinë tonë, gjë që duhet ta bëjmë medoemos. Në këtë situatë është e drejtë ta përgatitim ombrellën tonë që tani, kur është koha e mirë, pa pritur të fillojnë shirat e furtunat.

Armiqtë i kemi përreth nesh dhe situatat në botë nuk janë të qeta. Këtyre situatave të vështira duhet t'u dalim përpara. Kjo gjë arrihet me një organizim të fortë e të shëndoshë, me mobilizim të gjithanshëm për të realizuar dhe bile për të tejkaluar planet tona edhe në bujqësi. Tani gjendja jonë ka ndryshuar si nga ana e ngritjes së nivelit ideopolitik të kuadrove të Partisë dhe të pushtetit, ashtu dhe nga ana materiale në lëmin e bujqësisë.

Ne akoma nuk i kemi vënë në lëvizje si duhet forcat fizike dhe mendore të njerëzve për çështjen e ma-

dhe të vendosjes së disiplinës në punë, e cila nuk është rrënjosur thellë në ndërgjegjen e të gjithëve. Partia i ka studiuar e i ka analizuar këto gjëra, Komiteti Qendror i Partisë ka marrë edhe vendime për to, por më shumë duhet të punojmë për zbatimin e tyre në jetë.

Të mos kënaqemi me një propagandë të përciptë, me një konferencë, diskutim apo artikull gazete që mund të bëjmë. Këto çështje të shpjegohen politikisht, por njëkohësisht të vendoset edhe disiplina proletare kudo. Përpara se një punëtor, për shembull, të merret me vendosjen e rregullit në dyqane, të vendosë rregull në tornon e tij. Në qoftë se në torno nuk ka rregull dhe disiplinë, pra, kur vetë punëtori s'është në rregull, s'ka se si të rregullojë punët e tjera. Prandaj «pushkën» që i ka dhënë Partia, ai duhet të dijë ta përdorë kundër «armikut» brenda në veten e tij, që është moskuptimi i disiplinës proletare, sorollatja kot, kur në vend të tetë orëve bën vetëm gjashtë orë punë. Punëtorët e sektorit të naftës bëjnë shumë kontrole për të vënë rregull në sektorë të tjerë, por nuk kanë vënë si duhet rregull në punën e tyre, ku u kanë ngjarë mjaft avari, që nuk u falen. Sot mora një letër prej tyre, më shkruajnë se do të ndreqin avaritë që ndodhën në dy sonda në pusët e Divjakës, rregullimi i të cilave kushton 1,5 milion lekë. Po pse nuk i parandalojnë këto avari shokët e klasës punëtore që punojnë në sektorin e naftës? Këto i them pse çështja e disiplinës proletare në punë duhet të merret me tërë seriozitetin.

Shtimi i prodhimit të drithërave është kurdoherë një çështje kryesore, nga e cila nuk duhet hequr dorë,

sepse përbën një mjet të rëndësishëm për t'i dhënë shtytje të mëtejshme dhe më të fuqishme zhvillimit të degëve të tjera të bujqësisë. Tani për tani, pa e ngushtuar sipërfaqen e mbjellë me drithëra, ta përqendrojmë vëmendjen në intensifikimin e bujqësisë, për të marrë nga toka më shumë prodhime, pra, politika jonë është të punojmë për të marrë rendimente të larta, që të krijojmë mundësi të reja për zhvillimin e bujqësisë dhe të blegtorisë. Për shtimin e prodhimit duhet të udhëhiqemi nga kërkesa për t'u përqendruar tek ato lloje bimësh, për të cilat kemi nevojë më tepër. Kështu do të krijojmë një bazë të shëndoshë në drithëra, në luledielli etj.

Për shtimin e prodhimit ka shumë rëndësi që të ecim në të dy drejtimet: edhe për të marrë nga toka sa më shumë prodhime, edhe për zgjerimin e mëtejshëm të sipërfaqes nëpërmjet hapjes së tokave të reja. Sidoqoftë, drejtimi kryesor të jetë kurdoherë lufta për rendimente të larta. Ne duhet të luftojmë për rendimente të larta, për shembull, në pambuk, por nuk mund të shtojmë sipërfaqet e mbjella, sepse, po u përhapëm shumë, do ta humbasim forcën organizuese dhe drejtuese. Gjithashtu duhet të kemi parasysh se për një gjë të tillë akoma nuk i kemi në një shkallë të mjaftueshme plehrat dhe mekanizimin e bujqësisë.

Ne duhet të synojmë që me shtimin e prodhimit jo vetëm t'i sigurojmë popullit gjërat e nevojave të përditshme, por edhe të sigurojmë rezerva të konvertueshme, për të krijuar rezerva edhe në devizë. Po të kemi rezerva gruri, ato mund t'i shesim jashtë kur të duam, pse gruri është flori. Deri tani nuk i kemi

pasur konditat, prandaj nuk e kemi llogaritur fare eksportin e prodhimeve të bujqësisë, por tani ka ardhur koha që bujqësia të preokupohet seriozisht për eksportin dhe të mos ecë më si përpara. Këtë çështje duhet t'ia sqarojmë edhe popullit.

Mendimi im është që të mos eksportojmë rezervat e prodhimeve bujqësore që duhen për të plotësuar nevojat e popullit e të bagëtive. Në rast se brenda 3-4 vjetëve do të arrijmë të sigurojmë rezultatet e dëshiruara, do të krijojmë mundësi edhe për eksportimin e drithërave, por edhe sikur të mos e arrijmë këtë, përsëri kemi fitim, sepse nuk do të importojmë më drithëra. Qysh sivjet duhet të luftojmë që të mos importojmë më drithëra dhe të ulim importin e yndyrnave. Realizimi i kësaj detyre do të ishte një fitore e madhe.

Një problem tjetër është shtimi i frutave dhe i zarzavateve. Rëndësinë e pemëtarisë duhet ta kemi të gjithë të qartë. Partia dhe pushteti e kanë marrë seriozisht zhvillimin e kësaj dege dhe prandaj bëhen investime, por që të arrihen objektivat e caktuar lypset edhe mobilizimi i popullit, që është i gatshëm të mbjellë pemë në masë, por, dhe për këtë të jemi të ndërgjegjshëm, ka njerëz të cilët nuk e kanë kuptuar si duhet rëndësinë e pemëtarisë. Në qoftë se popullin do ta mësojmë t'i rritë me kujdes bimët e mbjella, do të shtohen edhe të ardhurat nga kjo degë me rëndësi e bujqësisë sonë.

Shteti ynë po investon me miliarda lekë për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe të kulturës. Përveç industrisë, investime të shumta po bëhen edhe në bujqësi për ujtitjen, për hapjen e tokave të reja dhe

për ndërtimin e tarracave, për shtimin e sasisë së plehut etj.

Si kurdoherë edhe tani Partia mendon seriozisht për shtimin e furnizimit të popullit me mallrat e përdorimit të gjerë dhe për rritjen e të ardhurave reale për frymë të popullsisë. Në vendet kapitaliste dhe revizioniste çmimet ngrihen në qiell. Në tregjet e tyre nuk ka ose ka fare pak mish, vezë, djathë etj., sepse janë në krizë. Kurse te ne Partia dhe Qeveria jo vetëm kanë mbajtur një stabilitet furnizimesh dhe nuk kanë lejuar ngritjen e çmimeve, por, përkundrazi, për disa artikuj kanë ulur çmimet. Kështu, në këto situata, populli ynë ka qenë i kënaqur. S'ka dyshim që mirëqenia e tij mund të rritet edhe më tepër, por punonjësit tanë janë të ngritur politikisht dhe e kuptojnë që Partia ka zbatuar një politikë të drejtë në shpërndarjen e të ardhurave kombëtare, sepse brenda një kohe të shkurtër në vendin tonë janë bërë me nikoqirllëk gjithë këto ndërtime kolosale. Edhe në familje, që të shkojnë mbarë punët, çdo gjë duhet bërë në masën e duhur, se ndryshe mund të hash mirë, por s'ke të vishesh. Një grua, për shembull, mund t'i bëjë dy triko me lesh akrilik, në qoftë se do të hajë mish jo pesë herë, po vetëm tri herë në javë, kurse po të mos punonte fare, nuk mund të bënte asnjë. Kështu është edhe me administrimin e ekonomisë së shtetit në tërësi. Për rritjen e mirëqenies së popullit tonë ka ndikuar edhe fakti që shteti ka siguruar efektivisht të drejtën e punës për të gjithë dhe nuk ka lejuar që shtetasit tanë të bëhen skllever për të shitur forcën e krahut jashtë atdheut, siç ka bërë Titoja në Jugosllavi.

Populli ynë i kupton mirë këto probleme, por edhe në pastë njerëz që akoma nuk i kuptojnë, duhet t'ua shpjegojmë dhe, po ta bëjmë mirë këtë punë, ata do të binden. T'i themi popullit që vitin e kaluar arritëm një sukses të madh duke rritur rendimentin e drithërave dhe, në qoftë se nga kjo lind pyetja pse nuk ulet çmimi i bukës, t'i sqarojmë njerëzit që buka do të jetë këtu, e ruajtur në rezervë për kohë të keqe dhe, në të njëjtën kohë, do të ketë edhe përmirësime në nivelin e jetesës së popullit.

Gjatë planit të pestë pesëvjeçar jo vetëm do të krijohen mundësi që ta përmirësojmë jetesën e popullit, por kam bindjen se do të thyhen edhe këto norma që po vëmë.

Për sa i përket industrisë ushqimore, duhet të jemi me sedër dhe të punojmë më me rendiment e me cilësi që prodhimet e saj të shërbejnë jo vetëm për të plotësuar nevojat e brendshme, por edhe për eksportin. Ato që u thanë këtu për eksportin e disa mallrave, janë shumë të drejta, prandaj të krijojmë kushte e t'i grumbullojmë, duke filluar që nga kërmilli, midhjet etj. dhe të gjenden tregje shitjeje, sepse pika-pika bëhet një lumë. Këto mund të duken çikërrima dhe të nënvleftësohen, por të ardhurat që mund të sigurohen nga eksportimi i tyre janë 2-3 milionë dollarë, pra nuk janë të pakta.

Këto probleme, në radhë të parë, duhet t'i kuptojë Partia, pse kur Partia e kuptoi rëndësinë e drithërave dhe u mor me to, u arritën rezultate të mira, por e keqja është se u lanë mënjanë të tjerat. Përsëri ekziston rreziku që të merremi vetëm me një

problem dhe të lëmë në harresë të tjerat. Këto oshilacione të punës së Partisë në kuptimin e përgjithshëm të zhvillimit të bujqësisë duhet t'i luftojmë. Të rrënjosim mirë në ndërgjegjen e njerëzve kuptimin për perspektivat e planit, të përmirësojmë format organizative të punës, të forcojmë disiplinën proletare në zbatimin e planit dhe të respektojmë me rigorozitet disiplinën financiare, ndryshe rezultatet e parashikuara nuk arrihen.

Nuk kam ndonjë kundërshtim që për blegtorinë të gjykohen shifrat e parashikuara në paraproyektplan, rëndësi ka krijimi i mundësive për të përmirësuar furnizimin e popullatës me qumësht. Jo vetëm ministri i Bujqësisë, por e gjithë Partia duhet ta kuptojë mirë se viçat e mëshqerrat e racës që kemi sjellë tani nga jashtë dhe na kanë kushtuar shumë dollarë, janë e ardhmja e zhvillimit të lopës, janë baza kryesore e shtimit të qumështit. Në qoftë se ndërmarrjet bujqësore nuk i trajtojnë mirë, furnizimi i popullit me qumësht do të çalojë.

Një problem që duhet të na preokupojë është edhe diferenca midis të ardhurave të kooperativave të fushës dhe atyre të malësisë. Sigurisht, diferenca do të ketë, bile ato do të shtohen si nga prodhimi i qumështit, ashtu edhe nga rendimentet e larta në pambuk e në drithëra që do të marrin më tepër për hektar kooperativat fushore, por duhet t'i kushtojmë vëmendje edhe rritjes së rendimentit të prodhimit në kooperativat malore, që dhe ato të shtojnë të ardhurat e tyre.

Në rrethin e Lushnjës dhe të Durrësit, për shem-

bull, do të arrijnë të marrin nga 25 deri 40 kuintalë drithëra për hektar, gjithashtu rendimenti do të rritet edhe në pambuk, por dihet se me rritjen e rendimenteve shtohen edhe të ardhurat e kooperativistëve dhe, rrjedhimisht, rritet edhe fuqia blerëse e tyre, gjë që kërkon furnizimin e tregut me më shumë mallra. Nuk mund t'i themi fshatarit që të ardhurat e realizuara tej shumës 15 lekë për ditë-punë t'i depozitojë detyrëmisht në arkën e kursimeve, sepse kjo gjë varet krejtësisht nga vullneti i tij, kooperativisti mund të mos dojë t'i kursejë paratë e veta, po dëshiron të blejë me to gjithçka që i pëlqen. Fshatarit, gjithashtu, nuk mund t'i ndalohet të marrë më tepër se 15 lekë për ditë-punë, prandaj është e nevojshme të studiojmë dhe të gjejmë të tjera forma të drejta për shpërndarjen e të ardhurave, siç janë përdorimi i një pjese të tyre nga kooperativa për investime prodhuese, për sigurimin e pensionit të pleqërisë të kooperativistëve etj.

Jam dakord me çka është thënë në paraproyektplan për sektorin e minierave dhe të naftës. Disa pyetjeve që më kishin lindur për naftën u dha përgjigje të qartë materialit i veçantë që është paraqitur. Çështjen e naftës do ta marrë në analizë edhe Qeveria në mbledhjen e saj të 5 marsit. Ajo do të vërë përpara përgjegjësisë kuadrot e Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave, kuadrot drejtues dhe specialistët e sektorit të naftës, por Partia duhet të vërë përpara përgjegjësisë edhe vetë punëtorët. Duke pasur këto rezerva që na paraqiten në material, mund të ecim, por me konditë që rezervat e caktuara t'i realizojmë dhe perspektiva është që t'i realizojmë, sepse në sektorin e

naftës, veç të metave të mëdha, ka edhe përvojë të mirë.

Duhet ta kuptojmë që nafta është jo vetëm absolutisht e domosdoshme për ekonominë tonë, por edhe rentabël. Në qoftë se do të forcojmë disiplinën dhe frymën e klasës në çdo gjë, pra të forcojmë disiplinën shkencore, teknike dhe disiplinën e planit e të kursimit, nafta jonë do të bëhet edhe më rentabël, sepse, siç del nga studimi që është paraqitur, avaritë atje kanë ndodhur sepse ka pasur lëshime. Për këtë çështje kanë faj të gjithë, që nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave e deri te drejtuesit në bazë. Ministria ka fajet e saj të rënda, pse nuk ka ditur ta organizojë mirë punën, është marrë me gjëra të vogla dhe ka lënë të mëdhatë, si kontrollin teknik e shkencor, që është kryesori, ka pasur besim të tepruar te kuadrot kryesorë të sektorit të naftës, të cilët, në punë e sipër, kanë shfaqur edhe «lakra». Shfaqjet negative të disa kuadro të naftës vijnë nga mendjemadhësia e tyre, nga mendimi që u është krijuar se ata janë «mbretërit e naftës», se vetëm ata dinë çfarë bëjnë e të tjerë s'ka më. Këto mendime të gabuara çojnë në nënvleftësimin në praktikë të mendimit të klasës punëtore dhe në mosbesimin ndaj punëtorëve. Me një fjalë, duhet të forcojmë, sidomos, drejtimin e punëve të naftës, se atje çalojmë.

Për mosrealizimet dhe avaritë nuk mbeten pa faj as klasa punëtore dhe organizata e Partisë në naftë. Sigurisht, organizata e Partisë në sektorin e naftës nuk i ka lidhur duart, por prapëseprapë nuk ka ditur të udhëheqë si duhet dhe sa duhet zbatimin teorik dhe praktik të parimeve të Partisë e të ligjeve të shtetit. Gjersa ministria u ka dhënë në duar punonjësve të

sektorit të naftës rregulloret, Partia duhej të kishte vënë në vend disiplinën e planit, disiplinën financiare dhe atë teknike. Indiferentizmi ndaj kërkesave të disiplinës të çon në konsideratën e gabuar se disiplina është çështje që u përket vetëm teknikëve. Duke u nisur nga ky koncept, ndodh që kur teknikët nuk i zbatojnë me rigorozitet rregullat, ngjajnë avari, siç kanë ngjarë. Edhe klasa punëtore në sektorin e naftës, që nuk është pa eksperiencë dhe pa partishmëri, nuk ka qenë në lartësinë e detyrave të saj për të krijuar një ambient të tillë, ku të thotë fjalën e vet. Këto dobësi të punës në sektorin e naftës vijnë nga mbivlerësimi i kuadrove me arsim të lartë. Kuadrot me arsim të lartë duhen nderuar, por edhe duhen mësuar e kontrolluar. Ata duhen konsideruar si ndihmës të klasës punëtore, se janë në shërbim të saj, dhe jo klasa punëtore si ndihmëse e tyre. Por, në fakt, ka ndodhur që kuadri nuk është kritikuar edhe në ato raste kur gabimisht e ka udhëzuar punëtorin të veprojë në kundërshtim me rregulloren. Ky nuk është respekt i vërtetë për kuadrot, por është një respekt jomarksist.

Problemet e avarive dhe pasojat që rrjedhin prej tyre mendoj se duhet t'i kemi parasysh. Unë jam dakord me shokun Adil që të gjitha këto avari dhe mungesa të reflektohen mirë. Kryesorja është që ato të parandalohen sa të jetë e mundur më shumë dhe, kur ndodhin, të ndreqen sa më shpejt, ndryshe do të vazhdojmë të sjellim përsëri sonda e mjete të tjera për të zëvendësuar të dëmtuarat nga avaritë e shkaktuara për pakujdesinë e njerëzve. Këto janë shkelje flagrante dhe në asnjë mënyrë nuk mund të lejohen.

Çështja e dytë që kisha për të diskutuar lidhur me shfrytëzimin e nëntokës, është ajo e gjetjes së vendburimeve dhe e shfrytëzimit të gazit natyror. Mua më duket se gazin po e lëmë përsëri si apendiks të ndërmarrjes së shpim-kërkimeve, kurse unë mendoj se është koha ta organizojmë si ndërmarrje më vete zbulimin e vendburimeve të gazit. Gjetja e gazit, që duhet kërkuar në tokë dhe në det, siguron të ardhura të mëdha për ekonominë dhe hap perspektiva, si për sa i përket plotësimit të nevojave të brendshme, ashtu dhe për eksportin. Kjo kërkon që kur të planifikojmë naftën, të fillojmë të mendojmë seriozisht për investime nga rezervat që na mbeten dhe të tjera që duhet të shtojmë edhe për gazin.

Për çështjet e tjera që u diskutuan jam dakord. Jam dakord edhe me propozimet që u bënë për transportin. Makinat, sikur të jetë e mundur, të vijnë vetëm pas vitit 1971, domethënë pasi të jenë bërë llogaritë e hekurudhës së Përrenjasit, kurse tani të punojmë me ato automjete që kemi, duke u marrë më mirë me organizimin e punës.

Për sa i përket zhvillimit të industrisë mekanike, që në të ardhmen merr më shumë rëndësi, jam dakord me të gjitha vërejtjet e shokëve dhe mendoj se në këtë drejtim duhet të marrim të gjitha masat që u përmendën.

Gjatë viteve të ardhshme do të shtohet prodhimi i energjisë elektrike, se do të ndërtohen dy hidrocentrale të mëdha, përveç një sërë hidrocentralesh të vogla, do të ngrihet Kombinati Metalurgjik në Elbasan etj. Industria jonë në këtë pesëvjeçar nuk do të kufizohet

vetëm me nxjerrjen e mineraleve, por do të bëjë edhe përpunimin e tyre. Mbi bazën e shtimit të energjisë elektrike, do të shkrihen mijëra tonë mineral hekuri për të prodhuar çelique të petëzuara etj., do të bëhet përpunimi i thellë i naftës, do të zhvillohen më tej industria e prodhimit të plehrave kimike, industria e nxjerrjes së mineraleve të dobishme, nxjerrja e kromit, bie fjala, do të dyfishohet etj. Gjatë planit të ardhshëm do të forcohet dhe do të zhvillohet me ritme më të shpejta industria mekanike për prodhimin e pjesëve të këmbimit, për prodhimin në vend të makinerive, të mekanizmave dhe të pajisjeve që më parë s'i prodhonim. Gjithashtu do të zhvillohet edhe industria kimike e prodhimeve plastike, për prodhimin e fijeve sintetike etj.

Në interes të popullit ne po bëjmë një plan real, të thurur me kujdes. Mbi bazën e zhvillimit të pandërprerë të forcave prodhuese do të bëhet e mundshme që të sigurohet një rritje e vazhdueshme e prodhimit të përgjithshëm shoqëror dhe e të ardhurave kombëtare. Kjo me siguri do t'i entuziazmojë popullin dhe Partinë, do të rritë mobilizimin e masave dhe do të thellojë kuptimin e drejtë të direktivave të Partisë lidhur me forcimin organizativ të Partisë dhe të pushtetit. Ky plan është inkurajues, vetëm se duhet të punojmë akoma më tepër.

Mendoj se disa çështje kapitale të mos presim që t'i shikojmë bashkë me shumë të tjera derisa të bëjmë diskutimin e planit në bazë, por t'i studiojmë në mënyrë të veçantë. Një problem i caktuar, që gjykohet me rëndësi, për shembull, problemi i bujqësisë, të dis-

kutohet më vete jo vetëm në masa, po edhe në Byro-
në Politike. Është më mirë të diskutojmë një orë për
një problem të caktuar, sesa t'i marrim në shqyrtim
të gjitha çështjet së bashku. Kështu, duke diskutuar për
një problem të vetëm të rëndësishëm, arrijmë në disa
konkluzione të drejta, të thelluara. Pastaj Qeveria e
punon materialin e dhënë në vija të përgjithshme, de-
risa të vendoset përfundimisht.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proccs-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

KËSHILLTARËT VEPROJNË NË EMËR TË POPULLIT

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH¹*

26 shkurt 1970

Në lidhjet e këshilltarëve me popullin ka shumë të mira, por ka edhe shfaqje të formalizmit. Shpesh thuhet se këshilltarët bëjnë mbledhje, japin llogari, bëjnë kritikë dhe autokritikë para zgjedhësve etj., ndërsa kur vjen puna për të dhënë llogari për vendimet që janë marrë, kur dalin kërkesa të cilave u duhen dhënë zgjidhje, këshilltarët këtë nuk e bëjnë si duhet. Ndodh që anëtarët e këshillit popullor, kur vënë në zonat përkatëse, u flasin zgjedhësve se çfarë ka thënë Partia për këtë ose për atë çështje dhe nuk japin llogari përse, për shembull, nuk i ka shkuar koopera-

1 Në këtë mbledhje, ku u shqyrtua raporti i paraqitur nga Presidiumi i Kuvendit Popullor «Mbi zbatimin e detyrës që shtroi Plenumi i 6-të i Komitetit Qendror të PPSH për përsosjen e mëtejshme të organizimit dhe të funksionimit të organeve të zgjedhura të pushtetit», raportuan edhe të ftuar nga rrethet Gjirokastrë, Gramsh, Korçë dhe Shkodër.

tivës bujqësore fara e jonxhës, përse nuk ka eternit për të mbuluar stallat etj. Në raste të tilla zgjedhësit kanë plotësisht të drejtë të thonë: «Shoku këshilltar, përse ke ardhur këtu? Ato që na thua ti, ne i kemi të qarta, se kemi një organizatë-bazë partie që na drejton». Prandaj këshilltari popullor duhet të shkojë i përgatitur mirë për të dhënë llogari para zgjedhësve të tij.

Ta kemi të qartë se personaliteti i këshilltarit nuk mund të ngrihet në qoftë se ai e shpie zërin e zgjedhësve për planin në komitetin ekzekutiv dhe ky nuk e ndryshon planin, kur një gjë të tillë e kërkojnë nevojat e krijuara. Këshilltari ka të drejtë e përgjegjësi për hartimin dhe për zbatimin e planit ekonomik po aq sa ka edhe kryetari i komitetit ekzekutiv. Këshilltari i zgjedhur, fjala vjen, në zonën e Shllakut, është po aq përgjegjës për gjendjen në këtë zonë sa edhe kryetari i komitetit ekzekutiv. Kështu i kuptoj unë të drejtat dhe detyrat e këshilltarëve popullorë. Por që të krijojë lidhje të mira me popullin, këshilltari duhet të jetë në korent dhe të interesohet vazhdimisht për zbatimin e detyrave që i përkasin zonës ku është i zgjedhur, si dhe për të gjitha nevojat e saj. Ai duhet të luftojë dhe të sjellë në këshillin popullor fjalën e popullit të zonës së vet, në bazë të së cilës të ngrejë probleme dhe të kërkojë që ato të zgjidhen drejt e shpejt. Kërkesat e zgjedhësve mund të mos jenë të gjitha të arsyeshme, këto duhen parë me kujdes, por kërkesat e drejta doemos duhen zgjidhur.

Këtu u tha se kryesia e këshillit popullor të rrethit nuk i aktivizon të gjithë anëtarët e këshillit popullor

në studimin e problemeve të ndryshme dhe në kontrollin e zbatimit të vendimeve. Po pse nuk e bën këtë? Cila është ajo rregullore që e ndalon kryesinë e këshillit popullor të rrethit të thërresë pesë-gjashtë këshilltarë dhe t'u thotë të marrin këtë ose atë vendim të këshillit popullor, ta studiojnë dhe të shkojnë e të kontrollojnë zbatimin e tij? Edhe Presidiumi i Kuvendit Popullor kështu bën, thërret Prokurorin e Përgjithshëm ose deputetë dhe i ngarkon me detyra. Këto mund t'i bëjnë edhe kryesitë e këshillave popullorë të rretheve, kurse ashtu siç veprojnë ato në fakt, e kanë reduktuar fare rolin e këshilltarit. Gjersa shokët drejtues të rretheve e kuptojnë politikën dhe vijën e masës që ndjek Partia, kjo është abëcëja, njerëzit e zgjedhur nga masa në organet e pushtetit duhen aktivizuar gjerësisht në shumë drejtime.

Përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve të këshillit popullor është komiteti ekzekutiv, por është njëkohësisht edhe këshilltari, i cili duhet të jetë i mobilizuar, të lëvizë për zgjidhjen e problemeve të zonës, të vejë në komitet për këto, të shkojë edhe te zgjedhësit e t'i informojë se ç'u bë për kërkesat e tyre. Kur konstaton se diçka që u vendos në këshill, nuk ka përfunduar akoma, t'u thotë zgjedhësve se çështjen do ta sqarojë brenda dy ditëve. Pas kësaj të shkojë e t'i kërkojë llogari kryetarit të komitetit ekzekutiv pse nuk është kryer ajo punë, për të cilën vendosi këshilli, për shembull, dy muaj më parë, dhe kërkon të mblidhet komiteti ekzekutiv e të marrë masa, që çështja të zgjidhet menjëherë, se ka dhënë fjalën që do të shkojë të bëjë mbledhjen e popullit

dhe do të përgjigjet. Në këtë drejtim, më duket mua, duhet të luftojmë, sepse kjo nuk lidhet thjesht me personalitetin e një njeriu, po me personalitetin e pushtetit të demokracisë popullore dhe me zbatimin e vendimeve që merren. Në qoftë se bëhet vetëm ashtu siç dëshiron komiteti ekzekutiv dhe pritët që problemet të zgjidhen kur t'i vijë mbarë atij, të gjitha këto forma pune demokratike, javash-javash, shndërrohen në forma burokratike.

Te ne komitetin ekzekutiv e kontrollojnë këshilltarët në emër të popullit që i ka zgjedhur, por ka raste që këta dëgjohen pak dhe kështu, padashur, krijohet autoriteti i funksionarëve. Lufta kundër kësaj shfaqjeje ka shumë rëndësi nga ana parimore, sipas mendimit tim, prandaj duhet ta vazhdojmë më tej punën që kemi filluar në këtë drejtim. Këto nuk i them vetëm për shokët e rrethit të Shkodrës, se ata mund të punojnë mirë, derisa një këshilltar ua vuri këmbët në një këpucë që u rregulluan llagëmet e qytetit, ose këshilltari i Kelmendit i kritikoi dhe i vuri në lëvizje, por ky problem, ashtu si thashë edhe më parë, duhet ndrequr në përgjithësi.

Për trajtimin e këshilltarëve aparati i komitetit ekzekutiv shikon shembullin e drejtuesve. Në qoftë se ai vëren që anëtarët e komitetit ekzekutiv e veshetrojnë anëtarin e këshillit popullor me të vërtetë me syrin e Partisë, atëherë edhe ai do ta respektojë shumë atë, ndërsa kur shikon që kryetari i komitetit është i plotfuqishëm dhe nuk pyet fare për këshillin popullor, atëherë edhe aparati nuk ia vë veshin këtij. Punonjësit e aparatit mund t'i kenë në kokë parimet

për vijën e masave, por ndofta nuk u vete në mendje që këshilltarët mund të mos e zgjedhin nesër kryetarin e komitetit ekzekutiv të rrethit në atë detyrë, pasi mendojnë që atë person e ka vënë kryetar Komiteti Qendror, Byroja Politike. Në fakt, Partia bën rekomandimin për zgjedhjen e shokëve në udhëheqjen e pushtetit në rreth, duke çmuar cilësitë dhe vendosmërinë e tyre për të zbatuar vijën dhe orientimet e Partisë, por që të bëhesh kryetar i komitetit ekzekutiv të rrethit duhet medoemos të të zgjedhë populli, prandaj nuk është i drejtë mendimi që këtë ose atë shok e ka emëruar Komiteti Qendror, se ai i ka krahët e ngrohtë dhe nuk e luan as topi. Këto pikëpamje mund të ndryshojnë në punë e sipër, në qoftë se punonjësit e seksioneve të komitetit ekzekutiv shikojnë që, kur vjen një këshilltar për të shtruar një problem të drejtë në komitetin ekzekutiv, kryesia vepron ashtu siç thotë ai, sepse këshilltari është i zgjedhur nga populli. Kur punonjësit e aparatit, për shembull, do të marrin vesh që kryetari i komitetit ekzekutiv i dha të drejtë një këshilltari, se e pranoi gabimin para tij dhe do të shkojë edhe në mbledhjen e popullit për të bërë autokritikë, atëherë do të mendojnë që kryetari qëndron si i tillë pse e ka zgjedhur populli, duke pasur edhe rekomandimin e Komitetit Qendror të Partisë.

Organet ekzekutive dhe urdhërdhënëse kanë rëndësi shumë të madhe, prandaj duhet t'i bëjmë që t'i kryejnë mirë detyrat dhe të fitojnë respektin e masave, në mënyrë që diktatura e proletariatit dhe format e demokracisë të kuptohen jo vetëm në teori, po edhe në praktikë. Këto organe duhet të lidhen ngushtë

dhe të bashkëpunojnë fort e në rrugë të drejtë me masat e popullit, domethënë të veprojnë sipas kërkesave të masave, kur ato janë të drejta e të mundshme, dhe t'i sqarojnë për ato kërkesa që janë të padrejta ose nuk ka mundësi të plotësohen.

Lidhur me kompetencat e përgjegjësve të seksioneve të komiteteve ekzekutive të rretheve mendoj se ato nuk duhen caktuar nga qendra. Komitetet ekzekutive kanë aparatet e tyre të njohura me ligj, kurse aparati ka seksionet përkatëse sipas profileve dhe nevojave të punës. Natyrisht, nga qendra mund të bëhen vërejtje se aparati është i madh ose i vogël, se fondet e caktuara në përputhje me nevojat që ekzistojnë në rrethe janë të mëdha ose të vogla, por problemet e organizimit të punës në aparat i zgjidh komiteti ekzekutiv. Aktivizimi i punonjësve të aparateve është detyrë e komiteteve ekzekutive. Përgjegjësi i seksionit të shëndetësisë, për shembull, si punonjës i aparatit, që mund të jetë ose jo anëtar i komitetit ekzekutiv, përgjigjet përpara komitetit për shëndetësinë. Për zgjidhjen e problemeve ai ka punonjësit e seksionit që drejton, të cilët i ngarkon me detyra për realizimin e punëve që ka komiteti ekzekutiv në lëmin e shëndetësisë. E njëjta gjë mund të thuhet, fjala vjen, edhe për përgjegjësin e seksionit të arsimit. Ky bën ndarjen e detyrave midis punonjësve të seksionit ku punon dhe, kur shikon se dikush tregohet aktiv e mund të përballojë detyra më të koklavitura, e ngarkon atë me probleme të tjera. Përveç kësaj, përgjegjësi i seksionit të arsimit mund të krijojë pranë vetes edhe një grup të përbërë me mësues nga më të

mirët, me të cilët diskuton, bën edhe ndonjë mbledhje jashtë orarit të punës, për t'u këshilluar rreth problemeve që dalin në punët e arsimit. Pra, vetë përgjegjësi i seksionit është ai që gjykon dhe gjen forma të përshtatshme të punës për të zbatuar në mënyrë krijuese kompetencat dhe detyrat e ngarkuara nga shteti për komitetin ekzekutiv të rrethit në fushën e arsimit.

Brenda kufijve të caktuar, vetë komiteti u cakton kompetencat përgjegjësve të seksioneve. Në këtë mënyrë duhet të veprojë ai edhe kur është puna për vendosjen e një kuadri. Komiteti ekzekutiv ka të drejtë të shikojë, të vëzhgojë, të bëjë propozime dhe të insistojë në ministri, në Kryeministri dhe në Komitetin Qendror të Partisë për ndryshimin e organikave kur këto nuk janë në rregull ose janë të fryra. Kjo është një detyrë me rëndësi.

Si mendoni ju, shoku Bilal¹, a ka vendime, urdhëresa dhe udhëzime të organeve qendrore, që juve ju duken të ngurta nga ana financiare ose nga anët e tjera dhe ju pengojnë për të zhvilluar më tej iniciativat krijuese? A keni ju ndonjë mendim që, nga eksperienca e punës suaj si rreth, del i nevojshëm rishikimi i disa gjërave të cilave u ka kaluar koha? Nuk e kam fjalën vetëm për pengesa lidhur me kompetencat që ka komiteti ekzekutiv i rrethit, po edhe me organizimin e funksionimin e ndërmarrjeve nacionale që keni në rrethin tuaj, që nuk ju lejojnë të ndërhyni

¹ Bilal Parruca, në atë kohë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Shkodrës.

për përmirësimin e punës. Pra, keni ndonjë vërejtje në këtë drejtim, që ndoshta mund të rishikohet?

Po ju orientoj pak më mirë. Duke ditur se klasa punëtore në Shkodër është e përparuar, se punëtorët atje janë njerëz me duar të arta dhe me imagjinatë, që çfarë u sheh syri ua bën dora, a keni menduar për të gjetur disa forma më të zhdërvjellëta të organizimit të punës? Në Shkodër, veç artizanatit dhe industrisë lokale, keni edhe industrinë mekanike, parkun automobilistik etj., që janë ndërmarrje me karakter kombëtar, në disa probleme të të cilave Komiteti Ekzekutiv i Rrethit nuk futet dot. A do të ishte në dobi të punës po t'i merrnin në dorë komitetet ekzekutive të rretheve këto çështje të ndërmarrjeve nacionale, që të mos ndodhë si në rastin e Parkut Automobilistik të Shkodrës, ku, siç u tha këtu, drejtori nuk e zbatoi urdhrin e kryetarit të komitetit ekzekutiv dhe nuk i lejoi shoferët që iu kërkuan, të shkonin të punonin me makinat 30 tonëshe për transportimin e zhavorit në Vaun e Dejës?

A keni mundësi ju, shokët e Komitetit të Partisë e të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit të Shkodrës që, pa dëmtuar punën, me ata punëtorë të kualifikuar që keni dhe me gjendjen tuaj mekanike, të prodhoni edhe gjëra të tjera të nevojshme për ekonominë dhe për popullin? Në qoftë se i keni këto mundësi, për prodhim detalesh e pajisjesh të tjera, natyrisht, ju duhen edhe materiale më tepër, se me «frymën e shenjtë» ato nuk bëhen. Por materialet bazë që ju duhen juve janë të kufizuara nga buxheti, se ne nuk notojmë në vaj, janë të kufizuara edhe prej planifikimit që bëhet

nga qendra. Ju që jetoni pranë punëtorëve mund të konsttoni më mirë nga ministritë që tornot, pjalat ose makineri të tjera nuk shfrytëzohen si duhet dhe se ne to mund të prodhohen, përveç atyre që janë planifikuar, edhe gjëra të tjera. Fjalën e kam për ndërmarrjet nacionale, sepse ndërmarrjeve të tjera që varen nga rrethi ju duhet t'u nxirrni vaj.

Mendoj që në planin e ardhshëm pesëvjeçar kjo çështje të shikohet në këtë frymë, sepse me një disiplinë të fortë ne jemi në gjendje të bëjmë përmirësime dhe të prodhojmë gjëra të vlefshme për ekonominë dhe për popullin tonë. Punëtorët tanë të zotë, me makineritë ekzistuese, kanë mundësi të prodhojnë akoma më shumë, më mirë, më shpejt e më lirë.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Byrosë
Politike të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

GRATË DUHET T'I GËZOJNË PLOTËSISHT TË GJITHA TË DREJTAT QË U SIGURON LIGJI

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

27 shkurt 1970

Jam dakord me diskutimet e shokëve, por dua të theksoj disa çështje.

Ndërmarrjet, institucionet, organizatat shoqërore dhe, në radhë të parë, Partia në bazë duhet të tregojnë kujdesin më të madh për mbrojtjen e të drejtave të grave. Te ne nuk lejohet që gratë të punojnë në punë të rënda e të dëmshme për shëndetin, siç mund të jenë punimet nën tokë, ngarkimi dhe shkarkimi i sendeve me peshë të rëndë etj. Këto direktiva janë dhënë me kohë dhe tani që diskutojmë nuk themi ndonjë gjë të re, veçse po theksojmë ato që janë thënë dhe që duhet të zbatohen plotësisht nga Partia, nga organet e shtetit dhe të ekonomisë.

¹ Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti «Mbi zbatimin e legjislacionit dhe të orientimeve të Partisë për mbrojtjen e gruas punëtore dhe kooperativiste», përgatitur nga komisioni për punën me gruan pranë KQ të Partisë.

Ju shokë të Bashkimeve Profesionale bëni mirë që flitni për mënjanimin e aksidenteve dhe të paaftësisë së përkohshme në punë, për ndihmën që duhet të japin mjekët dhe poliklinikat në këtë drejtim, po duhet të ngrini zërin edhe për mbrojtjen e të drejtave të grave në prodhim. Është e domosdoshme të insistohet më shumë për mekanizimin e proceseve të punës, që, përveçse ndikon në rritjen e rendimentit, lehtëson dhe punën e gruas në prodhim. Në mekanizim janë bërë përparime, megjithatë akoma nuk i kemi shfrytëzuar sa duhet të gjitha mundësitë që ekzistojnë.

Duhet ta kuptojmë drejt që gratë kooperativiste do të punojnë në bujqësi në procese pune, të cilat vërtet s'janë të lehta, por që s'janë as shumë të rënda sa t'u dëmtojnë shëndetin, sepse dihet që edhe punët bujqësore nuk janë të gjitha njëlloj të rënda. Prashitja, për shembull, megjithëse gjatë punës gruas i dhemb mesi, është më e lehtë nga hapja e kanalit ose nga qilizma, prandaj nuk është e saktë të thuhet që prashitja është më e vështirë se këto, ose nga ndonjë proces tjetër pune i tillë. Me sa di unë, Këshilli i Ministrave i ka përcaktuar punët shumë të rënda që ndalohen për gratë, po nuk mund të pretendohet se në këtë përcaktim të proceseve të punës s'ka edhe gabime, që vërtetohen në praktikën e përditshme. Në raste të tilla, kur gjykohet me vend, mund të bëhen korrigjime. Nuk përjashtohet, gjithashtu, që, kur caktohen gratë në punë, të bëhen edhe padrejtësi e hatëre, duke privilegjuar miqtë e të njohurit dhe plot gjëra të tjera të kësaj natyre. Ndaj këtyre shkeljeve Partia duhet të jetë vigjilente, por edhe vetë gratë

të bëhen të ndërgjegjshme për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Kualifikimi i grave në punë duhet të kuptohet mirë, që të mos ketë dallim midis grave dhe burrave në këtë drejtim. Kjo është një detyrë shumë e rëndësishme. Që të kryhet me sukses kualifikimi i grave, të cilat përbëjnë një forcë të madhe ndërtuese të socializmit, përveç mobilizimit të Partisë, të organizatave të gruas dhe të organizatave të tjera të masave, është absolutisht i domosdoshëm interesimi i vetë grave për rritjen e aftësive të tyre në punë. Kjo gjë kërkon edhe disa sakrifica nga vetë gratë, të cilat, natyrisht, do të bëhen në rrugë të zakonshme, normale dhe në përputhje me kushtet tona. Gratë duhet ta përfitojnë dhe ta shfrytëzojnë ndihmën që u jep shteti, veçse të mbahet parasysh që, sado e madhe të jetë kjo ndihmë, të gjitha lehtësitë nuk krijohen menjëherë. Ndihamat dhe lehtësitë e krijuara nga shteti në të ardhmen do të vijnë duke u shtuar më shpejt, megjithatë lypset që edhe vetë gruaja t'i organizojë më mirë punët e shtëpisë dhe jetën familjare. Të gjithë e dimë që ajo është akoma shumë e ngarkuar me punë, prandaj, që të fitojë kohë të lirë për t'u marrë me detyrat shtetërore, duhet t'i ndajë punët e shtëpisë me burrin dhe me fëmijët e rritur. Pa vepruar kështu, është e zorshme që të gjitha vështirësitë t'ia zgjidhë shteti. Çdo mendim i kundërt do të ishte një utopi.

Është e vërtetë që shteti ka marrë masa të mira për mbrojtjen e shëndetit dhe të të drejtave të grave që punojnë, por në këtë drejtim duhen bërë më shumë përpjekje, sidomos për të nxitur kujdesin e ndërmarr-

jeve, të institucioneve dhe të organizatave të ndryshme. Duhet të insistojmë për përkrahjen e iniciativave të bazës, që shpesh pengohen nga pakujdesia dhe nga nënvleftësimi i problemit. Në qoftë se do të pajtohemi me arsyet e shumta që nxirren për pengimin e këtyre iniciativave, arsye që në parim duken si të drejta, po në praktikë pengojnë, atëherë iniciativat do të ecin ngadalë. Ne duhet ta lëmë të lirë zhvillimin e iniciativave, jo që të zhvillohen pa kontroll e pa fre, por që të inkurajohen zhvillimi i mendimit krijues dhe preokupacioni i masave punonjëse për zgjidhjen e problemeve të tilla me rëndësi, siç është garantimi i të drejtave të pamohueshme të grave.

Ka gjëra që duhet të ishin bërë më parë e megjithatë nuk janë bërë. Ky është një gabim i madh që duhet riparuar. Disa detyra të ngutshme me iniciativën e bazës mund të realizohen shpejt, natyrisht, pa pretenduar që të arrihet përnjëherësh kulmi i dëshiruar, pse kërkesat e ekzagjeruara janë jashtë realitetit tonë aktual. Kur thuhet, për shembull, të shtohen çerdhet e kopshtet për fëmijët ose të shtohen mensat për punëtorët dhe për fshatarët, nuk duhet menduar që të tëra do t'i bëjë përnjëherësh shteti, pse edhe fondet e caktuara për këto qëllime kanë një kufi, prandaj për ndërtimin e tyre lypset edhe kujdesi i vetë ndërmarrjeve ose i kooperativave bujqësore. Iniciativat e masave, krijimtaria dhe ndjenja e përgjegjësisë së tyre për zgjidhjen e problemeve që shtron jeta nuk duhet të kenë kufi. Interesimin e masave, për të gjitha arsyet që thamë, duhet ta inkurajojmë fort.

Këtu u tha që në Kombinatin e Tekstileve në

Berat është ngritur çerdhe fëmijësh, ku ka dhoma për të izoluar fëmijët e sëmurë, dhoma për latantët etj. Po pse nuk bëjnë edhe ndërmarrjet e tjera nga këto gjëra? Për plotësimin e nevojave Partia duhet të interesohej njëllëj kudo, sidomos atje ku punojnë mjaft gra. Pse nuk insistojnë gratë dhe organizatat-bazë të Partisë të ndërmarrjeve të mëdha që në to të ketë çerdhe? Partia në bazë medoemos duhet ta marrë me seriozitet këtë problem, sepse ky, si shumë probleme të tjera të bazës, nuk mund të zgjidhet me urdhër nga qendra. Partia ka dhënë direktivën që gruas t'i krijohen kushte lehtësuese. Udhëheqja e Partisë mund të japë edhe disa orientime, po nuk mund të udhëzojë deri në hollësi, për shembull, se si duhet të ushqehet fëmija. Pra, kur direktiva është dhënë, i takon bazës ta zbërthejë këtë. Ne nuk i dërguam Kombinatit të Tekstileve në Berat ndonjë udhëzim të hollësishëm, por ai mori direktivën, pa nevojat dhe u detyrua të ngrejë çerdhe për fëmijët. Kështu, me iniciativë, duhet të veprojnë të gjithë e jo të mbushim bazën me direktiva dhe me udhëzime. Nuk duhet ta mësojmë Partinë që për çdo gjë të presë udhëzime nga Sekretariati ose nga Komiteti Qendror. Për çështjen e gruas Partia i ka dhënë direktivat me kohë, prandaj baza duhet të ngrihet në këmbë dhe t'i zbatojë, se nuk mund të ecet duke shtuar udhëzimet e duke i bërë ato më të hollësishme, siç tha një shok i sektorit të edukimit. Edhe Qeveria nuk do të merret gjithnjë me këto çështje e të nxjerrë udhëzime të përsëritura, por të luftojë që këto të zbatohen.

Duhet të mësohemi që direktiva për një çështje të mos dalë më shumë se një herë. Kur ajo shkon në bazë, të zërthehet e të zbatohet dhe të mos jepet më për çdo problem një direktivë apo udhëzim i veçantë. Kështu të veprojnë Partia dhe Qeveria, ndryshe nuk mund të zgjidhen problemet. Kur Qeveria, për shembull, merr një vendim dhe caktohet afati i zbatimit, çdo institucion, qoftë ministri apo ndërmarrje, duhet ta zbatojë atë me përpikëri dhe brenda kohës së caktuar të japë llogari para organeve kompetente.

Për zgjidhjen e problemeve të tilla, siç janë ngritja e çerdheve dhe e kopshteve për fëmijë, kërkohet të kontribuojnë edhe vetë punëtorët dhe punëtorët, sepse nuk duhet të mendohet dhe të pritët që çdo gjë të sigurohet me fondet e shtetit. Në qoftë se nuk e ka në çerdhe kalamanin, secili do ta ushqejë në shtëpi, prandaj duhen parë edhe mënyra të tjera për t'u ardhur në ndihmë grave. Kështu, në rast se çerdhet e hapura nga shteti janë mbushur plot dhe sot për sot s'ka mundësi të shtohet kapaciteti i tyre, atëherë nevojat të plotësohen në këtë apo në atë formë, duke përcaktuar se çfarë do të japë shteti dhe sa do të paguajnë prindërit. Për një ndërmarrje të madhe, mendoj unë, nuk është vështirë të rregullojë një ose dy dhoma për çerdhe fëmijësh.

Ndodh që fëmija, kur del nga shkolla, nuk ka ku të rrijë, prandaj pret në rrugë, me çelës në qafë, sa t'i kthehen prindërit nga puna. Këto probleme janë, por shteti, që ka dhe shumë detyra të tjera me rëndësi, nuk mund t'i zgjidhë të gjitha pa pasur ndih-

mën e organizatës së rinisë dhe të organizatave të tjera të masave, të cilat duhet të mendojnë për zgjidhjen e problemit të kohës së lirë të fëmijëve. Por edhe vetë familja të mendojë e të preokupohet me tërë seriozitetin për këtë problem, pse, siç thashë, vetëm kujdesi i shtetit, sado maksimal të jetë, nuk mjafton. Prandaj, del përsëri çështja e organizimit të punëve në familje, pse pikërisht këtu ka një rezervë të madhe për lehtësimin e punës së gruas, e cila të luftojë që këtë rezervë ta shfrytëzojë sa më mirë.

Deri tani fola për garantimin e të drejtave të grave në qytet, por kjo duhet parë sidomos në fshat. Thuhën shumë fjalë se punët në familjen fshatare organizohen kështu e ashtu, po në të vërtetë atje shumë punë i bën akoma gruaja, kur ka prej tyre që fare mirë mund dhe duhet t'i kryejnë burrat.

Problem mjaft i rëndësishëm është edhe shfrytëzimi i kohës së punës, jo vetëm nga burrat, po edhe nga gratë. Orari i punës të respektohet me përpikëri nga të gjithë punëtorët, kooperativistët dhe nëpunësit, kurse në këtë raport kritika më duket se bëhet e njëanshme. Së pari, të gjitha gratë nuk mund ta kenë punën te dera e shtëpisë, pse mund të ndodhë që ta kenë edhe gjysmë ore, bile edhe një orë larg. Punëtorët e kombinatit «Josif Pashko», për shembull, dhe të shumë ndërmarrjeve e të institucioneve të tjera në Tiranë e gjatë shkojnë në punë edhe me autobus. Kjo gjë është vështirë të realizohet për të tërë kooperativistët, prandaj, në qoftë se kërkojmë që çdo grua ta ketë punën te dera e shtëpisë, ose të shkojë në punë

me automjet, do të thotë se nuk jemi realistë. Çfarë mund të bëjë shteti në qoftë se fshatares i duhet të bëjë një orë rrugë për të vajtur nga shtëpia deri në arë? Te ne koha normale e punës është tetë orë në ditë dhe vajtjet e ardhjet nga shtëpia nuk llogariten në të. Në të vërtetë, sipas matjeve të kronometruara, del se punëtorët tanë nuk punojnë tamam 8 orë në ditë, kurse kooperativistët punojnë edhe më pak. Në qoftë se shfrytëzohet rigorozisht tetorëshi në punë, për të cilin duhet të luftojmë, atëherë nuk ka përse të qëndrohet nga dhjetë e dymbëdhjetë orë në uzinë ose në arë. Sigurisht, këtu nuk e kam fjalën për disa punë të stinës në bujqësi në kohë fushatash ose për raste të veçanta, kur, për nevoja të domosdoshme të punës dhe të prodhimit, mund të punohet edhe tej kohës normale të punës. Problemi i shfrytëzimit të kohës së punës duhet parë në tërë kompleksitetin e tij, sepse nuk përjashtohen rastet e komprometimeve reciproke midis drejtuesve të ndërmarrjeve, nga njëra anë, dhe punëtorëve, nga ana tjetër. Ka raste që drejtorët abuzojnë dhe nuk i respektojnë të drejtat e ligjshme të punëtorëve dhe sidomos të grave. Të gjitha këto duhet t'i luftojmë, por ndodh që edhe punëtorët u bëjnë lëshime drejtuesve dhe nuk i godasin kur veprojnë keq, sepse edhe ata vetë nuk e shfrytëzojnë plotësisht orarin e punës.

Partia e ka shtruar kurdoherë drejt çështjen e mbrojtjes së të drejtave të grave dhe në këtë drejtim ka mjaft suksese. Por ne duhet të luftojmë akoma që gratë t'i gëzojnë plotësisht të gjitha të drejtat që u

siguron ligji dhe të mos lejojmë shkeljen e tyre nga asnjëri. Është e domosdoshme që këto t'u garantohen sidomos grave në fshat, sepse, për sa u përket grave të qytetit, këtyre: «Nuk para ua ha qeni shkopin», pse ato i njohin të drejtat e tyre dhe ngulin këmbë për to.

Duhet luftuar pengesat që u krijohen grave fshatare nga disa kryesi kooperativash bujqësore, të cilat kanë tendenca për të mos ua dhënë në kohë lejën e para dhe të paslindjes. Partia duhet ta mbrojë fort këtë të drejtë të grave fshatare të pranuar nga asambljetë e kooperativave. Organizata-bazë e Partisë dhe këshilli popullor i fshatit të përpiqen për realizimin efektiv të kësaj të drejte dhe të mos e lënë këtë çështje vetëm në dorën e kryetarit të kooperativës. E drejta e gruas për një lejë të mjaftueshme para dhe pas lindjes përshkohet thellësisht nga fryma e humanizmit tonë socialist, që synon ruajtjen e shëndetit të nënës dhe të fëmijës, prandaj jo vetëm nuk duhet të nxirren pengesa, por edhe sikur vetë ndonjë grua të kërkojë për arsye të ndryshme që të punojë në këtë periudhë, ta detyrojmë të përdorë lejën, duke e shpërblyer sipas rregullave.

Lidhur me shpërblimin e grave punonjëse gjatë lejës së lindjes dalin disa çështje që duhen rishikuar. Kur sëmuret punëtori ose nëpunësi, sipas ligjit «Mbi sigurimet shoqërore shtetërore», e përfiton ndihmën për paaftësi të përkohshme, që i llogaritet në bazë të pagës që kishte. Unë them që edhe gruas shtatzënë, e cila për shkak të zhvillimit normal të barrës çohet në një punë më të lehtë, shpërblimi për lejën e lindjes nuk

duhet t'i llogaritet mbi bazën e pagës më të vogël që ajo mund të marrë muajin e fundit para lejës, prandaj, pasi të studiohet kjo çështje, mund të shikohet edhe ligji.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TE RINJTE TE SHKOJNE PER TE PUNUAR ATJE KU KA NEVOJE ATDHEU

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit
të KQ të PPSH¹*

27 shkurt 1970

Përmirësimi i përbërjes së nxënësve dhe të studentëve që vazhdojnë shkollat duhet parë i lidhur me zhvillimin e vendit tonë, se vërtet disa nga prindërit e të rinjve sot janë nëpunës, por ata kanë ardhur nga radhët e punëtorëve dhe Partia i ka caktuar të punojnë si nëpunës. Prandaj, për dhënien e së drejtës së studimit, natyrisht, do të merret parasysh nota e mirë, por duhet parë edhe origjina dhe gjendja shoqërore e prindërve të nxënësit.

Çështjen e dhënies së bursave duhet ta shikojmë në bazë të buxhetit, duke bërë, njëkohësisht, edhe një seleksionim të atyre që u takon bursa mbi bazën e notës mesatare të nxënësve dhe të qëndrimit politik

1 Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të paraqitur nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës «Mbi zbatimin e politikës së Partisë për plotësimin e kontingjenteve të shkollave të mesme e të larta».

të prindërve të tyre. Në rast se janë dy nxënës, për shembull, me nota të mira dhe me të ardhura të barabarta, bursën do ta përfitojë ai që e ka mesataren e notës më të lartë dhe biografinë më të mirë.

Dua të them diçka edhe për çështjen e gjuhëve të huaja, sidomos në universitet. Më duket se mësimi i gjuhëve të huaja në shkollat e larta nuk është marrë seriozisht nga studentët dhe nga pedagogët. Kjo është një gjë negative. Shumë të paktë janë djemtë dhe vajzat që mbarojnë shkollat e larta dhe arrijnë të shfrytëzojnë librat në gjuhën e huaj që thuhet se e kanë mësuar në shkollë. Mirëpo duhet bërë e qartë se nuk ka kualifikim në rast se studentët nuk i futen seriozisht për të mësuar të paktën një gjuhë të huaj. Të zotërosh dy gjuhë të huaja është më mirë, por të paktën një është absolutisht e domosdoshme. Kjo do të japë mundësi që kuadrot të kuptojnë librat që lexojnë dhe të dinë të përdorin fjalorët, ndryshe kualifikimi i tyre do të ecë mjaft ngadalë. Siç na thonë, dhe ne vetë shikojmë se në bibliotekat tona ka mjaft libra për probleme teknike në anglisht, frëngjisht, italisht e rusisht, të cilët rrinë në rafte. Vetëm vitin e kaluar kanë ardhur me porosi 2 000 libra të tillë të nevojshëm për gjeologët dhe për inxhinierët e naftës. Prandaj duhet të preokupohemi që kuadrot tanë të jenë në gjendje t'i shfrytëzojnë këto të reja të shkencës e të teknikës botërore.

Nuk është çështja te lekët valutë që harxhojmë për sjelljen e librave në gjuhë të huaja, por te rëndësia që ka shfrytëzimi i tyre, se aty brenda është eksperiencia botërore, e cila ka çuar shkencën përpara.

Në qoftë se studentët tanë mendojnë se është e mjaftueshme vetëm të diplomohen, për shembull, inxhinierë apo mjekë, ata nuk janë shumë të ndërgjegjshëm për detyrat e mëdha që u ka ngarkuar Partia në ndërtimin e socializmit.

Situata te ne është e tillë që nuk kemi mundësi të shumta për të bërë përkthime, pse, sado të përpiqemi në këtë drejtim, nuk është e mundur të përkthehet tërë literatura teknike botërore. Prandaj, shokë, këtë problem ta theksojmë shumë. Gjithsecili nga ne ka eksperiencë në këtë çështje, shpeshherë u rikthehemi librave për probleme të caktuara, shikojmë, kërkojmë andej e këtej. Për sa i përket literaturës marksiste-leniniste, Partia ka marrë masa dhe ka përkthyer në gjuhën shqipe shumicën e veprave të Marksit, të Engelsit, të Leninit dhe të Stalinit.

Edhe për caktimin në punë të të rinjve që mbarojnë shkollat duhet të tregojmë më shumë kujdes, pse në këtë çështje, siç tha edhe shoku Hysni [Kapo], kemi një eksperiencë të hidhur. Ka prej të diplomuarve në shkolla të ndryshme të mesme profesionale që «Kanë çarë ferrën», duke shkuar pas mbarimit të tyre ku u ka dashur qejfi, prandaj ata që mbarojnë për një profil të caktuar të punojnë në atë profil dhe atje ku do të caktohen. Nuk është politika e Partisë që ai, i cili ka mbaruar shkollën për mjek apo për mësues, të punojë vetëm në rrethin e tij, ai mund të shkojë edhe në një rreth tjetër, për të jetuar e për të punuar së bashku me punonjësit e këtij rrethi. Vështirësitë që ndeshen në praktikë në këtë drejtim e kanë bazën edhe tek ekzistenca e mendimeve patriarkale.

Më parë mësuesit dhe mësueset që përgatiteshin në Elbasan i dërgonim nëpër fshatra, se kishim nevojë, dhe vumë rregulla që ata, pas njëfarë kohe, të ktheheshin afër familjeve. Nga kjo ndodhi që mësueset korçare nuk martoheshin atje ku punonin, pse pritnin të ktheheshin përsëri në Korçë. Një herë në Librazhd një shok takoi disa prej tyre, të cilat, kur i pyeti «Pse nuk martoheni?», iu përgjigjën: «Do të kthehemi përsëri në Korçë!».

Dikur ai që mbaronte shkollën kërkonte të kthehej pranë prindërve për t'i ndihmuar, pse ata ishin të varur ekonomikisht prej tij, kurse tani kushtet kanë ndryshuar krejtësisht. Prindërit s'kanë më nevoja ekonomike, por duan që birin ose bijën e tyre ta kenë pranë, ta shikojnë, se kështu është jeta. Mirëpo kjo kërkesë e prindërve mund të plotësohet edhe duke vajtur ata herë pas here, çdo 5-6 muaj te të bijtë ose anasjelltas. Pra djemtë dhe vajzat do të shkojnë për të punuar atje ku ka nevojë atdheu.

*Botohet për herë të parë sipas
tekstit të nxjerrë nga proces-
verbali i mbledhjes së Sekre-
tariatit të KQ të PPSH
që gjendet në AQP*

TREGUESI I LËNDËS

A

Aksionet dhe lëvizjet revolucionare të masave — 314, 318-319, 328-331

Aleanca dhe kontradiktat sovjetiko-amerikane — 5, 196, 204-207, 210-211, 238, 241-242, 287, 339, 376-378

Armiqtë, vigjilenca dhe lufta kundër tyre — 46, 48, 62-64, 66, 67-68, 260-261

Arsimi — revolucionarizimi i shkollës. Nxënësit e studentët dhe edukimi komunist i tyre — 169-170, 234-235, 432-435

B

Bashkimi Sovjetik

— kriza dhe disfatat e revizionizmit sovjetik. Rrëzimi i Hrushovit. Grupi i Brezhnjevitch vazhdues i vijës së Hrushovit — 1-16

— shndërrimi i Bashkimit Sovjetik në një shtet socialimperialist. Politika demagogjike dhe ekspansioniste; përpjekjet e

tij për të ruajtur hegjemoninë mbi vendet revizioniste — 5-8, 9-10, 11-13, 134, 197, 199-204, 238-241, 246, 341, 378-381

— afrimi dhe pazarllëqet me RF të Gjermanisë dhe qëndrimi ndaj RD Gjermane — 240-241, 281-287, 336-345

— veprimtaria armiqësore dhe bllokada kundër Shqipërisë — 152, 176-177, 179-181, 221-222, 246-247, 256

Blegtoria dhe zhvillimi i saj — 297-298, 406

Botëkuptimi — 28-29

Bujqësia

— politika e Partisë për zhvillimin e saj. Intensifikimi i bujqësisë dhe hapja e tokave të reja — 160-166, 215, 291-292, 398-399, 402, 403-404

— drithërat, perimet dhe pemëtaria — 398-399, 401-403

Burokratizmi dhe lufta kundër tij — 186-189, 396-397

Ç

Çekosllovakia — pushtimi ushtarak sovjetik; qëndrimi i popullit çekoslovak ndaj këtij pushtimi — 6, 200, 210, 239-240

D

Demokracia socialiste dhe demokracia borgjeze — 27, 65-68, 186-189, 261-263

Dëshmorët, heronjtë; akte heroike — 91-93, 144, 167

Diktatura e proletariatit — 182-190

Disiplina proletare — 301-304, 306-307, 323-325, 400-401, 408-409

E

Edukimi ideopolitik i masave, i kuadrove e i komunistëve dhe lufta kundër shfaqjeve të huaja tek ata — 43-44, 52-54, 67-70, 83-85, 171-174, 322-323

Engels, Frederik — 25, 103, 288, 434

Enver Hoxha (të dhëna autobiografike) — 20-21, 49, 249, 374

Evropa; «sigurimi evropian» — 195-196, 211-212, 238, 241-242, 243-244, 287, 336-338, 344

F

Faktori i brendshëm dhe faktori i jashtëm, roli i tyre në jetën shoqërore — 138, 177-179, 251-252, 399-400

Familja

— demokratizimi i familjes dhe lufta kundër zakonëve prapanike në gjirin e saj — 32-35, 115-117

— martesë — 35-41, 114, 116-117

— kujdesi për nënën dhe për fëmijën — 112-113, 278-279, 425-428

Feja, lufta kundër saj — 127-129

Fëmijët, kujdesi i Partisë për mirërritjen dhe edukimin e tyre — 106-108, 111-121

Fshati socialist. Lufta për ngushtimin e dallimeve midis qytetit e fshatit — 161-164

G

Greqia; gjendja e brendshme dhe politika e jashtme — 135, 226-227, 247

Gruaja — politika e Partisë për emancipimin e gruas. Mbrojtja e të drejtave të grave në shoqëri dhe në punë — 27-35, 99, 115-117, 236-237, 264-266, 422-431

GJ

Gjermania — Republika Demokratike Gjermane; synimet e BS, të RFGJ dhe të fuqive të tjera imperialiste ndaj saj — 240, 280-281, 283-289

Gjermania — Republika Federale e Gjermanisë, synimet imperialiste të saj; problemi i traktatit të paqes me Gjermaninë — 238, 240-241, 242-243, 282-283, 284-285, 337-345

Gjykatat popullore, gjyqtarët — 382-389

H

Historia e Shqipërisë, studimet për historinë e Shqipërisë — 73-82

Humanizmi socialist — 333-334

I

Imperializmi — karakteri agresiv dhe kontradiktat në gjirin e tij — 12-13, 196-197, 375-376, 378

Industrializimi socialist
— politika e Partisë për industrializimin socialist të vendit. Arritje dhe perspektiva të zhvillimit të industrisë — 151-157, 159, 215, 410-411

— industria mekanike. Prodhimi në vend i pjesëve të këmbimit — 124-125, 299-307

— elektrifikimi i vendit; industria e naftës dhe e gazit — 18-19, 154, 267, 407-410

— industria ushqimore. Peshkimi — 101-102, 405

Internacionalizmi proletar — 137-139, 178-179, 180-181

Investimet, akumulimet — 102, 259, 260, 319-320

J

Jugosllavia, revizionizmi jugosllav — 134-135, 245-246, 255

K

Këshillat popullore, komitetet ekzekutive dhe aparatet e tyre. Këshilltarët — 387-388, 413-419

Klasa punëtore (proletariati), qëllimi historik dhe luftërat e saj revolucionare — 146-147, 195-196, 205-208

Klasa punëtore në RPSH; roli, edukimi ideopolitik dhe kualifikimi profesional i saj — 124, 155

Klasat dhe lufta e klasave — 43-44, 46-49, 64, 67-68, 184

Komunizmi — 29, 53, 184

Kontradiktat dhe kriza në botën kapitaliste e revizioniste

— 158, 196-197, 198, 238-243

Kooperativat bujqësore; zhvillimi dhe forcimi i tyre —

160-164, 324-325, 406-407

Kosova dhe popullsia shqiptare që banon në trojet e veta në Jugosllavi. Politika demagogjike, terrori dhe masat shkombëtarizuese të revizionistëve jugosllavë kundër kësaj popullsie — 245, 250, 255

Kuadrot, specialistët
— politika e Partisë me kuadrin. Përgatitja dhe ngritja e kuadrove të rinj — 354-359, 367-368

— metoda e stili i punës së kuadrove dhe lidhjet e tyre me masat — 269-270, 391-392

Kultura, letërsia dhe artet — 85-89, 170-171

L

Lenin, Vladimir Iliç — 7, 25, 180-181, 183, 267, 288, 434

Lëvizja marksiste-leniniste

— partia marksiste-leniniste, karakteristikat leniniste revolucionare. Ndërtimi dhe veprimtaria ilegale dhe legale e saj — 140-142, 232-234, 244-245
— rritja e forcimit i saj.

Lufta e partive m-l kundër imperializmit, revizionizmit e reaksionit.

Solidarësia dhe përkrahja e tyre për PPSH — 2, 10-11, 14-16, 137-139, 196, 230-233, 243-244

Lëvizjet dhe luftërat nacionalçlirimtare dhe revolucionare të popujve — 195-197, 205-207, 243-244

Ligjet objektive të shoqërisë — 52-53, 60, 64, 158

Lindja e Mesme — 5, 211, 244, 375-376, 377, 378, 379, 380

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar

— objektivat, mësimet dhe rëndësia historike e saj — 59-62, 145-147, 178, 251-252

— marrja e pushtetit dhe vendosja e popullit në fuqi — problem themelor i saj — 59-62, 182, 225

Lufta e njëkohshme kundër imperializmit dhe revizionizmit — 15, 133-134, 192, 198-199

Lufta e së resë me të vjetrën dhe fitorja e së resë — 24-25, 42-44, 64-65, 319

M

Marks, Karl — 25, 103, 112, 186, 288, 334, 434

Marksizëm-leninizmi — bu-sull dhe udhëheqje për veprim; domosdoshmëria e për-vetësimit dhe e mbrojtjes së tij — 44, 74-75, 173, 227-228, 234-235, 257

Mbështetja në forcat e veta — 178-180, 181, 251-252, 260, 400

Mbledhja e Dytë e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar (Berat, tetor 1944) — 58-60, 65

Mbrojtja e atdheut. Përgatitja e masave popullore për mbrojtje — 186, 220, 235, 237-238, 246-247, 270-271

Mërgimi — shqiptarët e mërguar dhe shoqëritë shqiptare të mërgimit — 249-250, 251, 271-277, 303

Ministritë

— Komisioni i Planit të Shtetit — 390, 392-394, 395, 397, 398

— Ministria e Arsimit dhe e Kulturës — 119, 305

— Ministria e Bujqësisë — 292, 293, 294

— Ministria e Industrisë dhe e Minierave — 305, 407, 408

Mirëqenia materiale dhe ngri-tja e nivelit kulturor të ma-save — 101, 174-175, 258-260, 268-269, 404-405

N

NATO — 5, 238, 242, 338, 342
Ndërtimi i socializmit në Shqipëri

— politika e Partisë për ndërtimin socialist të ve-ndit — 147-151, 174-176, 258-260

— roli i rendit socialist në formimin e njeriut të ri — 69, 110-111, 138-139, 166-167, 171-172, 334

O

Oportunizmi dhe lufta kundër tij — 134-135, 193-194, 201-202

P

Palestinezët — lufta e popu-llit palestinez për të fituar lirinë, të drejtat kombëtare dhe atdheun e vet — 211, 375, 376, 377-378

Partia e Punës e Shqipërisë — karakteristikat m-l revo-lucionare të saj

— besnikëria e saj ndaj m-l dhe vendosmëria për ta zbatuar atë në kush-tet konkrete — 74-75, 133, 150-151, 227, 228, 234

— roli udhëheqës i Partisë

- në Luftën Nacionalçli-
rimtare dhe në ndër-
timin socialist të vendit
— 59-62, 108-111, 145-
-146, 189-190, 213-214,
334-335, 354-356, 408-409
- studimi, zbërthimi dhe
zbatimi i vendimeve e i
direktivave të Partisë —
308-315, 317-318, 426-427
- uniteti në Parti. Lidhjet
e saj me masat — 69-72,
108-109, 214
- qëndrimi kritik objektiv
ndaj të metave e gabi-
meve — 46-56, 64-65, 66-
-67, 68-70, 90, 262-263
- përkrahja internaciona-
liste për partitë m-I, për
lëvizjet revolucionare dhe
të drejtat e popujve të
botës — 137-139, 147,
243, 280-281, 288-289
- përvoja dhe masat e
PPSH për zhvillimin e
pandërprerë të revolu-
cionit dhe për t'i prerë
rrugën revizionizmit në
Shqipëri — 62-65, 133,
167-174, 182-190
- Partia e Punës e Shqipërisë*
— organet udhëheqëse qend-
rore. Organizatat dhe organet
e Partisë në rrethe
- Komiteti Qendror i Par-
tisë dhe Byroja Politike
- 58, 73, 80, 92, 104,
119, 392, 412
- Plenumi i 9-të i KQ
(26-27 dhjetor 1969) —
316-335
- plenumi i Komitetit të
partisë të rrethit dhe
anëtarët e tij; byroja
dhe sekretarët e komi-
tetit të Partisë — 84,
356-368
- Komiteti i Partisë i Rre-
thit të Beratit — 366
- organizata dhe Komiteti
i Partisë i Rrethit të Di-
brës — 314-315, 328-329
- Komiteti i Partisë i Rre-
thit të Fierit — 360-361,
362, 366-367
- organizata dhe Komiteti
i Partisë i Rrethit të
Tepelenës — 45-56
- Partia Komuniste e Austra-
lisë (marksiste-leniniste). Bi-
sedë me përfaqësues të kësaj
partie — 230-248*
- Partia Komuniste e Brazilit.
Bisedë me përfaqësues të kë-
saj partie — 139-142*
- Planifikimi, planet*
- parime të planifikimit;
vija e masave në harti-
min dhe në zbatimin e
planeve — 125-126, 293,
295, 392-398
- plani i katërt dhe i pes-
të pesëvjeçar — 126, 215-

- 216, 290-298, 390-412
 — planifikimi dhe plotësimi i planeve në bujqësi — 291-298, 398-399, 403-407
- Policia Popullore, polici* — 369-374
- Politika e jashtme e RPSH*
 — parimet themelore marksiste-leniniste të politikës së jashtme — 62, 190-192, 193-194, 208, 254-255
 — lufta kundër imperializmit, revizionizmit dhe reaksionit — 2, 190-194, 221-222, 252-254, 256-257, 287
 — rritja e prestigjit dhe e autoritetit të PPSH dhe RPSH në botë. Miqtë, dashamirët për Shqipërinë — 70-71, 194-195, 238
 — solidarësia dhe përkrahja e popullit shqiptar për Vietnamin, për popujt arabë dhe për popujt e tjerë të botës — 130-136, 147, 208-213, 218-224, 228-229, 280-281, 288-289, 345, 381
- Populli shqiptar*
 — traditat patriotike dhe të punës; luftërat e tij për liri, pavarësi e përparim shoqëror — 61, 100, 145-
- 146, 219-220, 250, 263-264
 — roli vendimtar i tij në Luftën Nacionalçlirimtare dhe në ndërtimin socialist të vendit — 61-62, 166-167, 260, 261
- Puna*
 — roli dhe rëndësia e saj. Organizimi socialist i punës — 23-24, 31, 320, 323, 327-328, 330-331
 — normat, normimi i punës — 300, 325-327
- Pushteti popullor*
 — formë e diktaturës së proletariatit. Forcimi, konsolidimi i tij — 63, 66-67, 182-190
 — organet e larta të tij (Presidiumi i Kuvendit Popullor; Këshilli i Ministrave (Qeveria)) — 59, 92, 290-291, 389, 395, 407, 412, 415, 423
- R**
- Rendimenti i punës dhe rritja e pandërprerë e tij* — 317, 319-327
- Revizionizmi modern. Vendet revizioniste, rivendosja e kapitalizmit në këto vende — Kontradiktat në gjirin e tyre* — 9-10, 157-158, 164-165, 187

Revolucioni proletar; ngritja, zhvillimi i tij — 42-43, 195-197, 207-208, 221

Revolucioni tekniko-shkencor — 156-157

Rezervat shtetërore — 269, 396

Rinia

— edukimi komunist i saj për ndërtimin socialist dhe për zhvillimin e pandërprerë të revolucionit — 19-20, 23, 235-236, 434-435

— marrëdhëniet ndërmjet të rinjve e të rejave. Dashuria — 31-32, 36-41, 55, 102-104, 113-115, 116-117

S

Stalin, Josif Visarionoviç — 3, 7, 133, 179, 180-181, 256, 288, 434

SH

Shëndetësia. Pastërtia, higjiena — 22-23, 174-175

Shfaqjet e huaja, lufta kundër tyre — 27-35, 38-42, 54-55, 83-84, 236-237

Shkollat ushtarake — 346-353
Shtetet e Bashkuara të Amerikës

— gjendja e brendshme; politika e luftës, e agresionit dhe e sundimit — 12-13, 132, 135, 195-196, 197-198, 222-223, 267-268
— qëndrimi armiqësor kundër Shqipërisë — 63, 254-255

Shtypi dhe propaganda borjjezo-revizioniste — 12, 224, 254-255

T

Teoritë borgjezo-revizioniste
— kritikë pikëpamjeve teknokratike për revolucionin tekniko-shkencor, për «shoqërinë industriale, teknokratike» etj. — 157-158, 165

— bashkëkzistenca paqësore, «çarmatimi i përgjithshëm», «sovraniteti i kufizuar» dhe kritika kundër tyre — 8, 202-204, 206-207, 211-212

Tërmetet dhe masat për zhdukjen e pasojave të tyre — 17-18, 20-21

Traktati i Varshavës. Denoncimi i tij nga RPSH — 5, 201-202, 238-239, 242, 284, 342

Tregtia e jashtme — eksporti, importi — 124-125, 402-403, 405

TH

Thashethemet, shpifjet dhe lufta kundër tyre — 40-41, 45-46, 66

U

Ushtria Popullore

- forcimi, revolucionarizimi. Edukimi politik dhe ushtarak i efektivit të saj — 185-186, 346-350
- kuadrot, kuadrot e prapavijës; përgatitja dhe aftësimi i tyre — 346-353
- armatimi. Uzinat ushtarake — 299-307

V

Vendet arabe — lufta e popujve arabë kundër agresorëve izraelitë dhe komploteve imperialiste e revizioniste — 210-211, 376-377, 378-379

Vietnami — lufta e popullit vietnamez kundër agresorëve amerikanë. Përpyekjet e revizionistëve sovjetikë për sabotimin e saj — 130-136, 209, 218-227, 228-229

ZH

Zhvillimi dialektik në shoqëri — 24-25, 41-44, 52-53, 60, 64-65, 69, 158, 261-262, 334-335

TREGUESI I EMRAVE

A

- Alia, Ramiz — 396
Amazonas, Zhoao — 139
Aleksandri i Madh — 81
Adenauer, Konrad — 338, 339
Ajzenhauer, Duajt — 135
Aliaj, Hekuran — 45, 46
Allardt, Helmuth — 340
Antoni, Mark — 79

B

- Bako, Koci — 128
Barxotas, Vasilis — 226
Bauer (vëllezërit) — 103, 112
Belizar (gjenerali) — 79
Bonaparti, Napoleon — 133
Brand, Vili — 282, 285, 338,
339-340, 342
Brezhnjev, Leonid — 8, 12,
13, 16, 133, 202, 284

C

- Cezar, Jul — 79
Cirankieviç, Jozef — 241, 340
Curri, Bajram — 264

Ç

- Çarçani, Adil — 409
Çajupi, Andon Zako — 250
Çekrezi, Velerika — 123
Çërçill, Uinston — 135
Çuka, Pano — 84

D

- Dalles, Xhon Foster — 339
Dë Gol, Sharl — 242
Dubçek, Aleksandër — 239
Duraku, Rexhep — 272

E

- Erhard, Ludvig — 338

F

- Filipi i Dytë (i Spanjës) —
100
Frashëri, Elpiniqi — 274-
-276

G

- Gomulka, Vladislav — 282,
284, 340

Gromiko, Andrei — 8, 283,
340

H

Hoxha, Nexhmije — 26, 278,
279

Hoxha, Abaz — 331-333

Homeri — 76

Ho Shi Min — 130, 227

Hitler, Adolf — 8, 25, 132,
338, 343

Hrushov, Nikita — 1-5, 10,
16, 133, 281

Husak, Gustav — 187, 239,
285

J

Jakubovski, Ivan — 239

Justinian — 79

K

Kapo, Hysni — 395, 434

Kavo, Hulusi — 265, 270, 272,
274

Kao Ki — 134

Karl (ish-perandor spanjoll)
— 100

Kasemi, Osman — 273-274

Kizinger, Henri — 338

Koculi, Qazim — 25

Kola, Vangjel — 122, 123

Kosigin, Aleksei — 5, 12, 13,
16, 133, 284

Kristo, Pandi — 63

Kruja, Mustafa — 25

Krup — 241

Kupi, Abaz — 260

L

Lulo, Asim — 272-273

M

Marko, Rita — 373, 395

Myftiu, Manush — 74, 395

Mahmuti, Bektash — 21

Mahmuti, Jakup — 272

Malaj, Jazo — 102

Malëshova, Sejfulla — 63

Martaneshi, Baba Faja (Xha-
ni, Mustafa) — 91

Mihajllloviç, Drazha — 134

Mone, Minella — 102

Musolini, Benito — 25, 133

Myshkeri, Olimbi — 99-100,
102

N

Naser, Gamal Abdel — 246

Nikson, Riçard — 132, 134,
136, 224, 270

P

Parruca, Bilal — 419

Pllloçi, Farije, Riza, Hava, Sa-
nije, Lene — 91, 92-93

Pllloçi, Isuf — 91-93

Pompidu, Zhorzh — 243

Q

Qemali, Ismail — 264

- R
Tito, Josif Broz — 133, 134,
135, 245, 255, 404
- Rei, Leon — 78
Roxhers, Uiliam — 242
Rustemi, Avni — 264
- S
Sadiku, Iljas — 273
Servantes, Migel Saavedra de
— 100
Sinaj, Xhevahire — 45-49
Skënderbeu, Gjergj Kastrioti
— 145, 264
Spahiu, Xhafer — 317
Svoboda, Ludvig — 239
- SH
Sheel, Valter — 340-341
Shehu, Qazim — 45-49
Shehu, Telat — 276-277
Sheme, Lamçe — 366
Shubashiç, Ivan — 134-135
- T
Tarifa, Sevo — 84
- U
Ugolini, Luixhi — 78
Uillson, Harold — 254
Ulbriht, Valter — 240
- V
Vafiadhis, Markos — 226
- X
Xoxe, Koçi — 63
- XH
Xhaja, Lije, — 278-279
Xhonson, Lindon — 5
- Z
Zahariadhis Niko — 226
Zogu, Ahmet — 25, 251

TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA

A

- Afrikë — 5, 195, 197, 244
Akademia Ushtarake — 347-
-349, 352, 353
Algjeri — 78, 100
Amerika Latine — 5, 6, 195,
197, 244, 339
Angli — 170, 242, 253
Angolë — 195
Ankara — 258
Apoloni (Pojan, Fier) — 76,
77, 78, 79
Argjentinë — 250, 259, 268,
270
Australi — 244, 250
Azi — 5, 195, 197, 339, 341

B

- Berat — 57-58, 153
Berlini Perëndimor — 281
Birmani — 6, 195
Bisedimet e Parisit (ndërmjet SHBA dhe Vietnamit) — 134, 222
Bizanti, kultura bizantine — 77
Brazil — 140, 270
Bullgari — 200, 242, 246, 285

D

- «Deklarata mbi të drejtat e qytetarëve» — 59
Dibër — 18, 267, 314-315, 328
Divjakë (Lushnjë) — 401
Dukagjin (Shkodër) — 160,
174
Durrës — 76, 77, 78, 79, 100,
153, 373, 406-407

E

- Egjipt — 246
Elbë (lumi) — 343
Etruskët — 75

F

- Fabrika e Llambave Elektrike — Vlorë — 94-98
Fabrika e Sodës Kaustike — Vlorë — 99
Fakulteti i Shkencave të Natyrës i U.T. — 99
«Familja e shenjtë» ose «Kritika e kritikës kritike» (libri

~, K. Marks, F. Engels) — 103
 Fier — 152-153
 Francë — 238, 242-243, 250, 267

G

Greqia e Lashtë, kultura greke — 76, 77, 81

GJ

Gjykata e Lartë — 382, 386, 389

H

Helsinki — 241
 Hidrocentrali i Vaut të Dejës — 126, 153, 260
 Himarë (Vlorë) — 100
 Hungari — 96, 161, 200, 242, 285

I

Ilirët, kultura ilire — 75, 76, 77, 78, 79
 Indi — 6, 195, 244
 Indokinë (gadishulli ~) — 244
 Itali — 101, 161, 169, 170, 244, 267

Izrael — 375-376, 377
 Izvor (Tepelenë) — 17-18, 20-21, 24, 25-26

J

Japoni — 244

K

Kajro — 135
 Kazerta (Itali) — 135
 Kimi — 99
 Kinë — 241, 400
 Kisha e Labovës së Kryqit — 77
 KNER — 284
 Koloseu i Romës — 78
 Kolumbi — 195
 Kombinati i Metalurgjisë së Zezë (Kombinati metalurgjik «Çeliku i Partisë») — Elbasan — 410
 Kombinati i Tekstileve — Berat — 426
 Konferenca e Hagës — 242-243
 Kongresi i Përmetit (24 Maj 1944) — 59-60
 Korçë — 122, 123-124, 126-129, 153, 435
 Kore — 133, 267
 Korfuz (Greqi) — 100
 Krujë — 154
 Kufiri Oder-Najse — 240,

281, 284, 286, 336, 338, 340,
342-343
Kukës — 153, 267

L

Laos — 195
Librazhd — 18
Ligji për këshillat nacional-
çlirimtarë — 59
Lufta e Dytë Botërore — 336
Lushnjë — 153, 406-407

M

Mali i Vicit (Greqi) — 226
Mallakastër — 267
«Manesman» (firma monopo-
liste~) — 340
Martanesh — 93
Molosi — 81-82
Mongoli — 200
Mozambik — 195
Myzeqe — 160

N

Ndërmarrja e shtypshkronja-
ve «Mihal Duri» — 170-171
Nju-Jork — 258

NJ

«Njollat e murrme» (drama~)
— 85-89

O

Oder (lumi~) — 343
OKB — 255, 376

P

Partia Demokratiane dhe ajo
Socialdemokrate (RF e Gjer-
manisë) — 338, 339
«Partia Komuniste e Greqisë»
— 227
Pellazgët, kultura pellazgjike
— 75-76, 81
Persi — 81
Përmet — 267
Pilur (Vlorë) — 100
Poli i Veriut — 101
Poloni — 200, 241, 284, 342-
-343, 344
Pukë — 160

R

Rabie (Tepelenë) — 17-18, 20-
-21, 24, 25-26
Radio Moska — 180
Ravenë (Itali) — 79
Reforma Agrare — 162
Roma, kultura romake — 75,
77, 78, 79
Rumani — 200, 239, 242, 286

S

Sarandë — 100
Siberi (Bashkimi Sovjetik) —
340
Siri — 78

SMT — Tiranë — 334
Spanjë — 161

SH

Shans-Elize — Paris — 258
Shëngjin (Lezhë) — 100
Shkodër — 153, 416, 419-421
Shkolla e bashkuar e oficerëve «Enver Hoxha», e Aviacionit dhe ajo e Marinës — 352
Shkolla e mesme e Delvinës, e Konispolit dhe ajo «Qemal Stafa» — Tiranë — 169
Shkolla e Partisë «V.I.Lenin» — 349

Shpallja e Pavarësisë — 145, 250

«Shpipëria e lirë» (organizata) — 261

Shtëpia e fëmijës «8 Nëntori» — Tiranë — 106-108, 117-121

T

Tajlandë — 195

TASS (agjencia e lajmeve) — 1

Tepelenë — 18, 45, 54-55, 83, 90, 267

Termocentrali i Fierit — 153, 177

Tiranë — 153, 329

«Tisen» (firma monopoliste) — 340

Traktati i Munihut — 286

Tregu i Përbashkët Evropian — 242-243

U

Ulqin (Jugosllavi) — 100

Uzina e Instrumenteve të Precizionit — Korçë — 122-125, 129

Uzina e Polivinilkloridit — Vlorë — 98, 99

V

Varkizë (Greqi) — 135

«Vatra» (shoqëria) — 250, 260-261

Venezuelë — 195

Vlorë — 98, 100, 101, 102, 104, 153

Z

«Zëri i popullit» (gazeta) — 4

Zgërbonjë (Berat) — 331-333

Zvicër — 170

L È N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 42—TË V—VIII

1969

PESE VJET TË HRUSHOVIZMIT PA HRUSHOVIN — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (12 tetor 1969)	1—16
I GËZOFSHI SHTËPITË E REJA, PUNË TË MBA- RË DHE PLOT SUKSESE — Nga biseda me një grup kooperativistësh të Izvorit e të Rabies të rrethit të Tepelenës (16 tetor 1969)	17—26
TË DREJTAT DHE LIRITË E GRUAS DHE TË RI- NISË TË KUPTOHEN THELLË E TË MBROHEN NGA TË GJITHË — Fjala në mbledhjen e Sekreta- riatit të KQ të PPSH (18 tetor 1969)	27—56
PUSHTETI YNË, I NGRITUR MË GJAKUN E PO- PULLIT, DREJTOHET NGA VETË MASAT PUNO- NJËSE — Fjala në drekën e shtruar në Berat me rastin e 25-vjetorit të formimit të Qeverisë Demo- kratike të Shqipërisë (22 tetor 1969)	57—72
STUDIMET HISTORIKE T'I SHËRBEJNË SQARI- MIT TË PROBLEMEVE TË GJENEZËS SË PO- PULLIT TONË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (3 nëntor 1969)	73—82
T'I STUDIOJMË ÇËSHTJET IDEOLOGJIKE DHE TË VEPROJMË AKTIVISHT PËR ZGJIDHJEN E TYRE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (3 nëntor 1969)	83—90

- TË TILLË HERONJ DO TË MBETEN PËRJETË
PISHTARË QË DO T'U NDRIÇOJNË RRUGËN
BREZAVE TË SOTËM DHE TË ARDHSHËM TË
SHQIPËRISË — Letër drejtuar familjes së Heroit të
Punës Socialiste Isuf Plloçi (14 nëntor 1969) 91—93
- DUKE FITUAR EKSPERIENCË DHE NJOHURI
TEKNIKE, JU DO TË KRYENI DETYRA TË NDËR-
LIKUARA — Nga biseda me një grup punonjësish
të Fabrikës së Llambave Elektrike të Vlorës (22 nën-
tor 1969) 94—105
- ZEMRA E PARTISË ËSHTË SHUMË MË E MA-
DHE SE ZEMRA E NJË NËNE — Fjala në takim
me fëmijët dhe me personelin e shtëpisë së fëmijës
«8 Nëntori» të kryeqytetit (23 nëntor 1969) 106—121
- JU PUNËTORËT TË JENI NË FRONTIN E PARË
TË PRODHIMIT DHE TË LUFTËS IDEOLOGJIKE
— Nga biseda me një grup punonjësish të Uzinës
së Instrumenteve të Precizionit të Korçës (25 nëntor
1969) 122—129
- LUFTA KUNDËR IMPERIALIZMIT AMERIKAN
NUK MUND TË FITOHET PA E LIDHUR ATË ME
LUFTËN KUNDËR REVIZIONIZMIT SOVJETIK —
Nga biseda me një delegacion të Partisë e të Qeve-
risë së RD të Vietnamit (27 nëntor 1969) 130—136
- FITORET TONA I DETYROHEN EDHE LUFTËS SË
PROLETARIATIT BOTËROR E TË PARTIVE MAR-
KSISTE-LENINISTE — Nga përshëndetja në pritjen
e delegacioneve të partive marksiste-leniniste (27
nëntor 1969) 137—142
- 25 VJET LUFTË E FITORE NË RRUGËN E SO-
CIALIZMIT — Fjalim i mbajtur në mbledhjen so-
lemne me rastin e 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut
dhe të fitores së revolucionit popullor (28 Nëntor
1969) 143—217

- TË JEMI KURDOHERË VIGJILENTË NDAJ REVIZIONISTËVE SOVJETIKË** — Nga biseda me një delegacion të Frontit të Çlirimit Kombëtar dhe të Qeverisë së Përkohshme Revolucionare të Republikës së Vietnamit të Jugut (30 nëntor 1969) 218—229
- NJOHJA E KONTRADIKTAVE NË BOTËN KAPITALISTO-REVIZIONISTE U SHËRBEN MARKSISTË-LENINISTËVE PËR LUFTËN E TYRE** — Nga biseda me një delegacion të Partisë Komuniste të Australisë (marksiste-leniniste) (8 dhjetor 1969) 230—248
- PERËNDOI AJO KOHË QË E DETYRONTE SHQIPTARIN TË MERRTE RRUGËN E KURBETIT** — Nga biseda me përfaqësuesit e kolonive shqiptare në vende të huaja (9 dhjetor 1969) 249—277
- ARDHJA NË JETË E NJË NJERIU TË NE SHTON GËZIMIN PËR MËMËN, PËR FAMILJEN, PËR GJITHË SHOQËRINË** — Letër drejtuar punëtores së ndërmarrjes bujqësore «Gjergj Dimitrov», Lije Xhaja (11 dhjetor 1969) 278—279
- TË MBROHEN ME VENDOSMËRI INTERESAT SOVRANË TË REPUBLIKËS DEMOKRATIKE GJERMANE** — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (14 dhjetor 1969) 280—289
- REALIZIMI I PLANIT KËRKON ORGANIZIM, DISIPLINË, KRIJIMTARI** — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (19 dhjetor 1969) 290—298
- QË TË FORCOHET DISIPLINA, KRAHAS PUNËS IDEOPOLITIKE, TË ZBATOHEN ME RREPTËSI EDHE RREGULLAT NË FUQI** — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (20 dhjetor 1969) 299—307
- VENDIMI ËSHTË SINTEZA E PROBLEMIT** — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (20 dhjetor 1969) 308—315

TË NGREMË MË LART STILIN REVOLUCIONAR
NË EDUKIM, NË ORGANIZIM, NË PUNË — Fjala
në Plenumin e 9-të të KQ të PPSH (27 dhjetor 1969) 316—335

1970

TË SHPARTALLOHEN KOMPLOTET KRIMINALE
KUNDËR INTERESAVE SOVRANË TË RD GJER-
MANE — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i po-
pullit» (11 janar 1970) 336—345

SHKOLLAT USHTARAKE T'I KALITIN KUADROT
NGA ÇDO PIKËPAMJE — Diskutim në mbledhjen
e Byrosë Politike të KQ të PPSH (15 janar 1970) 346—353

SHOKËT E ZGJEDHUR NË UDHËHEQJE DREJT-
PËRDREJT NGA PRODHIMI PËRBËJNË NJË FOR-
CË TË MADHE DREJTIMI — Diskutim në mble-
dhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (16 janar 1970) 354—368

POLICI ËSHTË NJERI I PARTISË DHE AKTIVIST
SHOQËROR — Diskutim në mbledhjen e Sekreta-
riatit të KQ të PPSH (16 janar 1970) 369—374

LUFTA E ARMATOSUR E POPULLIT PALESTI-
NEZ ËSHTË E PAMPOSHTUR — Artikull i botuar
në gazetën «Zëri i popullit» (21 janar 1970) 375—381

TU VIHET MË SHUMË RËNDËSI GJYKATAVE
TË FSHATRAVE DHE TË QYTETEVE — Diskutim
në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor
(24 janar 1970) 382—389

DISKUTIMI MASIV DO TA MOBILIZOJË POPU-
LLIN PËR HARTIMIN DHE PËR ZBATIMIN E
PLANIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike
të KQ të PPSH (26 shkurt 1970) 390—412

KËSHILLTARËT VEPROJNË NË EMËR TË POPU- LLIT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (26 shkurt 1970)	413—421
GRATË DUHET T'I GËZOJNË PLOTËSISHT TË GJITHA TË DREJTAT QË U SIGURON LIGJI — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (27 shkurt 1970)	422—431
TË RINJTË TË SHKOJNË PËR TË PUNUAR ATJE KU KA NEVOJË ATDHEU — Diskutim në mbledh- jen e Sekretariatit të KQ të PPSH (27 shkurt 1970)	432—435
TREGUESI I LËNDËS	439
TREGUESI I EMRAVE	449
TREGUESI GJEOGRAFIK DHE I EMËRTIMEVE TË TJERA	453